

DREJTËSIA TRANZICIONALE

Anton Vukpalaj



DREJTËSIA TRANZICIONALE

Qasjet, mekanizmat dhe qëllimet

Anton Vukpalaj

Impresum**Titulli:**

Drejhtësia Transicionale - qasjet, mekanizmat dhe qëllimet

Botues:

Fondacioni-Konrad-Adenauer në Republikën e Kosovës

Autorë:

Anton Vukpalaj

Viti:

2020

Lektorë:

Hatixhe Pireva

Koordinimi:

Fondacioni Konrad Adenauer

Shtypi dhe dizajni:

Envinion

Tirazhi:

500 ekzemblarë

Publikimi mund të shkarkohet falas në:

<http://www.kas.de/kosovo>

Vërejtje:

Qëndrimet e prezantuara në këtë libër janë pikëpamje personale të autorit dhe ato nuk paraqesin patjetër qëndrimet e Fondacionit-Konrad-Adenauer.

Përmbajtja

PARATHËNIE	07
HYRJE	09
PJESA I: ORIGJINA DHE QASJET E DREJTËSISË TRANZICIONALE	15
1. Drejtësia dhe tranzicioni	16
1.1. Historik i drejtësisë tranzicionale	17
1.2. Paqe apo drejtësi	22
1.3. Raporti drejtësi - tranzicion	24
2. Qasjet e drejtësisë tranzicionale	29
2.1. Drejtësia retributive	29
2.1.1. Etika penale dhe ndëshkimi	31
2.1.2. Funksionet e ndëshkimit	34
2.2. Drejtësia rindërtuese	40
2.3. Drejtësia tradicionale	42
PJESA II: MEKANIZMAT GJYQËSORË DHE JOGJYQËSORË TË DREJTËSISË TRANZICIONALE	47
3. Mekanizmat gjyqësorë	48
3.1. Gjykatat ndërkombëtare penale	48
3.1.1. Tribunalet Ushtarake të Nurembergut dhe Tokios	49
3.1.2. Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi	51
3.1.3. Tribunali Ndërkombëtar Penal për Ruandë	57
3.1.4. Gjykata Ndërkombëtare Penale	59
4. Tribunalet penale hibride dhe/ose të ndërkombëtarizuara	63
4.1. "Panelet Rregullorja 64" në gjykatat e Kosovës	65
4.2. Panelet e Posaçme për Krime të Rënda brenda Gjykatës së Qarkut të Dilid (Timori Lindor)	70
4.3. Tribunali Special për Sierra Leonen	72
4.4. Dhomat e Jashtëzakonshme në gjykatat e Kamboxhias	75
4.5. Tribunali Special për Libanin	78
4.6. Dhoma për Krime Luftë në Gjykatën e Bosnjë-Hercegovinës	81
4.7. Dhomat e Specializuara të Kosovës	84
5. Mekanizmat jogjyqësorë të drejtësisë tranzicionale	95
5.1. Komisionet e së vërtetës dhe pajtimit	95
5.2. Amnistitë	102
5.3. Reforma institucionale	109
5.4. Vetingu dhe lustrimi	110
PJESA III: PAJTIMI DHE DREJTËSIA TRANZICIONALE	117
6. Pajtimi	118
6.1. Qasjet minimale dhe maksimale të pajtimit	120
6.1.1. Pajtimi politik	121
6.1.2. Pajtimi ndërpersonal	122
6.1.3. Diferenca ndërmjet pajtimit politik dhe atij ndërpersonal	125
6.2. Pajtimi franko-gjerman pas Luftës së Dytë Botërore si model i pajtimit të suksesshëm	126
6.2.1. Pajtimi si strategji e Republikës Federale të Gjermanisë për kthimin e sovranitetit të humbur	128
6.2.2. Pajtimi si strategji e Francës për ta mbajtur Gjermaninë nën kontroll	129
6.2.3. Traktati i Elysée-së	131
6.2.4. Konsolidimi i pajtimit franko-gjerman	134
KONKLuzion	138
BIBLIOGRAFIA	140

Familjes sime

Parathënie

Interesimi im për drejtësinë tranzicionale ka filluar në fund të viteve 1990 dhe është i lidhur ngushtë me krimet e kryera në Kosovë dhe në vende të tjera të ish-Jugosllavisë në atë kohë. Kjo periudhë do të shënojë institucionalizimin e drejtësisë penale ndërkombëtare, sidomos pas themelimit të Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, në vitin 1993. Drejtësia tranzicionale do të zgjerohet si fushë e studimit dhe si fushë e praktikës. Por, në Kosovë dhe në Ballkan kjo drejtësi është reduktuar kryesisht në mekanizmat e saj gjyqësorë dhe kjo ka qenë pengesë për të pasur njohuri më shumë për mekanizmat e tjerë të kësaj drejtësie, të cilët u kanë ndihmuar shoqërive të tjera në vende tjera të botës që të ballafaqohen me të kaluarën e tyre. Kjo drejtësi nuk mund të limitohet vetëm në gjykata, qofshin ato vendore apo ndërkombëtare, dhe ato janë vetëm një komponent i saj. Ky libër zhvillon një qasje gjithëpërfshirëse të fushës së drejtësisë tranzicionale, ku karshi mekanizmave gjyqësorë të saj shpjegohen edhe qasjet dhe mekanizmat e tjerë, siç janë: komisionet e së vërtetës dhe pajtimit, reformat institucionale, vetingu, amnistitë etj. Tre nga mekanizmat e drejtësisë tranzicionale, që janë: Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, Dhoma për Krime Luftë brenda Gjykatës së Bosnjë-Hercegovinës dhe Dhomat e Specializuara të Kosovës, zënë një vend të veçantë në këtë studim. Këto tri institucione simbolizojnë mënyrën se si ka evoluar drejtësia penale ndërkombëtare dhe e ndërkombëtarizuar, dhe u mundësojnë lexuesve vendorë që të kuptojnë më mirë këtë drejtësi në raport me Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor, si dhe u mundësojnë atyre ta kuptojnë vendin e këtyre institucioneve brenda mekanizmave të tjerë gjyqësorë të drejtësisë tranzicionale në nivel global.

Ky libër është bazuar në ligjëratat e mbajtura në kuadër të vizitave të mia në Shkollën e Shkencave Sociale dhe Politike në Universitetin e Glasgow-t, Skoci (2017); në Fakultetin e Letërsisë dhe Shkencave Humane në Universitetin e Fribourg-ut në Zvicër (2018) dhe në Departamentin e Shkencave Politike në Universitetin e Liège-s, në Belgjikë (2018). Pjesë të librit janë edhe disa ligjërata të mbajtura me dy gjenerata të studentëve të Shkollës Politike në Prishtinë, si dhe me studentët e Shkencave Politike të Universitetit të Prishtinës, në kuadër të lëndës Studimet e Paqes dhe Konfliktit.

Ky libër është rezultat i bashkëpunimit me Fondacionin Konrad-Adenauer-Stiftung në Prishtinë, të cilin dua ta falënderoj. Diskutimet me kolegët nga Departamenti i Shkencave Politike dhe me disa kolegë të tjerë nga Fakulteti Filozofik (Universiteti i Prishtinës) i kanë bërë argumentet e këtij libri më koherente dhe më të qarta. Falënderoj profesorët: Bekim

Baliqi, Arben Hajrullahu, Adem Beha, Shemsi Krasniqi dhe Arsim Canolli, të cilët kanë treguar interesim të vazhdueshëm për hulumtimin tim. Gjithashtu falënderoj akademik prof. Anton Kolë Berishajn, i cili e ka ushqyer refleksionin tim gjatë gjithë kohës së shkrimit të këtij libri. Në fund, dua të falënderoj bashkëshorten time Marinën dhe djemtë Albanin e Luanin për durimin e treguar, për muaj të gjatë të punës në këtë libër.

Anton Vukpalaj

Hyrje

Në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore ka pasur rreth 250 konflikte të armatosura në gjithë botën, të cilat kanë shkaktuar ndërmjet 70 dhe 170 milionë viktima.¹ Deri në vitin 1982 numri i personave të gjykuar për krimet e kryera gjatë këtyre konflikteve ka qenë shumë i vogël. Pas vitit 1982 kjo do të fillojë të ndryshojë dhe progresivisht çdoherë e më shumë do të kërkohet drejtësi. Konsiderohet se pas kësaj date një e treta e konflikteve të zhvilluara janë shoqëruar me masa të drejtësisë tranzicionale.² Kërkesat për drejtësi të viktimave të dhunës së diktaturave në Amerikën Latine, në fillim të viteve 1980 të shekullit të kaluar, do të ndikojnë që regjimet pasautoritare të iniciojnë gjykimin e individëve që kishin kryer krime dhe atyre të cilët i kishin organizuar dhe urdhëruar ato. Diktaturat e vendosura nga juntat ushtarake në Argjentinë, Kili dhe Uruguai kishin shkaktuar me mijëra të vrarë dhe të zhdukur. Pajtimi në këto shoqëri ishte i pamundur pa dalë në sipërfaqe e vërteta e krimeve, si dhe pa gjetjen e trupave të personave të zhdukur. E drejta për të ditur të vërtetën progresivisht do të marrë përkrahjen e duhur ndërkombëtare, si dhe të elitave demokratike pasautoritare në këto shtete. Shembja e Murit të Berlinit, në vitin 1989, do të shënojë një periudhë të re të kërkimit të llogaridhënies. Shoqëritë paskomuniste do të debatojnë përreth fajësisë për shkeljet e kryera gjatë diktaturave të mëparshme duke ndërmarrë masa, siç ishin ndjekja penale e personave që kishin pasur lidhje me Partinë Komuniste ose që kishin qenë bashkëpunëtorë të regjimit.³ Të gjitha regjimet paskomuniste do të ballafaqohen me kërkesa të viktimave të ish-regjimeve për drejtësi dhe riparim. Një situatë e ngjashme do të ndodhë edhe në Afrikën e Jugut pas rënies së Aparteidit, në fillim të viteve 1990.

Lufta në Kroaci dhe në Bosnjë-Hercegovinë, dhe dështimi për t'i ndaluar atrocitetet në këto vende do t'i ngrëjë zërat e përkrahësve të drejtësisë tranzicionale që të kërkohet llogari për krimet e kryera. Në vitin 1993, me themelimin e Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi (TNPJ) do të fillojë një “periudhë e artë” e drejtësisë tranzicionale dhe motoja “nuk ka paqe pa drejtësi” do të ketë kuptim për herë të parë pas Luftës së Dytë Botërore. Një vit më vonë do të krijohet Tribunali Ndërkombëtar Penal për Ruandë. Në

1 S.N. Rimmer (2010). Gender and Transitional justice, the women of East Timor. London: Routledge. Fq. 42-43.

2 Po aty.

3 M. Ellis (1996). Purging the past: The Current State of Lustration Laws in the Former Communist Bloc. Law and Contemporary Problems, 59 (4), ff.181-196, fq.181.

fillim të viteve 2000 do të eksperimentohen modele tjera të tribunaleve penale, të cilat do të kombinojnë kombëtares dhe ndërkombëtares.⁴ Ky eksperiment do të fillojë në Kosovë me “Panelet Rregullorja 64”, të cilat do t’i themelojë administrata e OKB-së e vendosur në Kosovë pas vitit 1999. Këto panele konsistojnë në integrimin e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë në gjykatat vendore. Në dhjetë vjetët vijues do të themelohen në mbarë globin edhe pesë gjykata të quajtura “hibride” duke u bazuar në këtë eksperiment.

Paralelisht me zhvillimin e gjykatave ndërkombëtare penale do të fuqizohen edhe mekanizma të tjerë jogjyqësorë të drejtësisë tranzicionale. Në rend të parë, komisionet e së vërtetës dhe pajtimit. Këto komisione e kanë zanafillën në Amerikën Latine (Argjentinë, Kili...) dhe do të barten në vende të tjera për t’i shoqëruar tranzicionet pasautoritare. Ato do të preferohen në shtete ku kishte pak hapësirë për themelimin e gjykatave penale. Komisioni i së vërtetës dhe pajtimit në Afrikën e Jugut do t’ua japë këtyre komisioneve një jetë të re. Ky komision ishte krijuar në vitin 1995 dhe ishte vendosur nën autoritetin e priftit protestant me famë botërore Desmond Tutu. Lideri historik jug-afrikan, Nelson Mandela, kishte bërë zgjedhjen e një procesi të tranzicionit “të butë” pa hakmarrje, i cili do të ketë sukses planetar. Desmond Tutu kishte deklaruar më vonë së në Afrikën e Jugut do të kishte qenë gabim, madje edhe e pamundur, që të imponohet “paradigma e gjykimeve të Nurembergut”⁵ për shkak, mes tjerash, edhe të burimeve të limituara politike dhe ekonomike të shtetit jug-afrikan në atë kohë.⁶ Sipas tij, proceset gjyqësore kishin qenë një barrë për gjykatat vendore, të cilat e kishin pasur të pamundur ta ndanin drejtësinë për viktimat, si dhe t’i kontribuonin pajtimit politik të vendit.⁷ Komisionet e së vërtetës dhe pajtimit do të shumëfishohen duke kaluar numrin 40 dhe do të paraqiten si alternativë ndaj gjykatave penale. Mekanizma të tjerë jogjyqësorë do të krijohen për t’i ndihmuar shoqëritë paskonfliktuale dhe pasautoritare që të ballafaqohen me të kaluarën.

4 D. Bloomfield, T. Barnes, L. Huyse (2003). *Reconciliation after violent conflict, A Handbook*. Stockholm: International IDEA, fq. 100.

5 Kjo paradigmë u referohet proceseve të liderëve nazistë në Nuremberg pas Luftës së Dytë Botërore.

6 M. Amstutz (2013). *International Ethics, Concepts, Theories, and Cases in Global Politics*. Lanham, Boulder, New York, Toronto, Plymouth: Rowman and Littlefield Publishers, Inc., fq. 163.

7 Po aty.

Çka është drejtësia tranzicionale?

Drejtësia tranzicionale ka të bëjë me të gjitha masat, të cilat një shoqëri në tranzicion ndërmerr për të kërkuar llogaridhënie dhe riparim për dhunën masive dhe shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera nga anëtarët e ish-regjimit. Ato përfshijnë “një gamë gjithnjë e më të gjerë të mekanizmave dhe institucioneve, duke përfshirë gjykatat, komisionet e së vërtetës dhe pajtimit, projektet memoriale, riparimet dhe të ngjashme, për të korrigjuar gabimet e së kaluarës, për të mbrojtur dinjitetin e viktimave dhe për të ofruar drejtësi në kohë tranzicioni.”⁸ Këto masa kanë të bëjnë me konsolidimin e rregullit të ri demokratik jokonfliktual.⁹ Interaksioni i saj me tranzicionin bën që kjo lloj drejtësie të jetë gjithmonë subjekt i kompromiseve. Ajo nuk mund të ofrojë solucione të përkryera për shkak se shoqëritë në tranzicion janë gjithmonë të përçara dhe shpesh këto përçarje janë të thella ndërmjet përkrahësve të ish-regjimeve dhe atyre të regjimeve të reja.¹⁰ Një ndër sfidat e drejtësisë tranzicionale është se si të ndërpritet armiqësia e krijuar mes njerëzve, të riparohen marrëdhëniet e ndërprera jo vetëm në nivel të përkrahësve të regjimeve të vjetra dhe të reja, por edhe në nivel të individëve, familjeve, komuniteteve dhe shoqërisë në përgjithësi. Dhe mekanizmat e saj kanë për qëllim që ta lehtësojnë këtë proces.

Në vitin 1997 juristi francez Louis Joinet, në një raport të OKB-së, i kishte përcaktuar disa parime të drejtësisë tranzicionale që kishin për qëllim t’u siguronin viktimave të dhunës katër të drejta: të drejtën për të ditur të vërtetën, të drejtën për drejtësi, të drejtën për riparim dhe garancinë e mospërsëritjes. Qëllimi kryesor është që “t’i kontribuojnë paqes afatgjate dhe rindërtimit të shoqërive mbi parimin e zbatimit të ligjit.”¹¹ Qëllimet mund të ndryshojnë në kontekste të ndryshme, por disa prej tyre janë konstante, si “njohja e dinjitetit të individëve, korrigjimi dhe njohja e shkeljeve, dhe qëllimi për të parandaluar që ato të përsëriten.”¹² Si pjesë e ristrukturimit të shoqërive pas konflikteve, masat e drejtësisë tranzicionale synojnë arritjen e pajtimit në nivel individual dhe në nivel të shoqërisë. Në mënyrë indirekte, qëllimi i saj është arritja e një koherence brenda shoqërisë. Kjo është një sfidë e madhe për shumë shoqëri, të cilat pikërisht për shkak se në të kaluarën nuk kishin qenë në gjendje t’i zgjidhnin konfliktet në mënyrë paqësore, kishin rrëshqitur në dhunë.

8 S. Buckley-Zistel, S. Koloma Beck, C. Braun, F. Mieth (2014). *Transitional Justice Theories*, London: Routledge, fq.1.; N. Turgis (2015). La justice transitionnelle, un concept discuté. *Les Cahiers de la Justice*, (3), 333-342, fq. 333.

9 R. Figari Layus (2010). *Transitional Justice in the midst of ongoing armed conflicts, the case of Colombia*. Potsdam: Universitätsverlag Potsdam, fq. 27.

10 E. Posner, A. Vermeule (2003). Transitional Justice as Ordinary Justice. *Harvard Law Review*, 117, fq.762.

11 L. Joinet (2002). *Lutter contre l'impunité, 10 questions pour comprendre et agir (Eds.)*. Paris: La Découverte. ; R. Kerr. E. Mobekk (2007). *Peace and Justice, seeking accountability after war*. Cambridge: Polity Press, fq. 2.

12 Shih definicionin e “drejtësisë tranzicionale të bërë nga Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale (International Center for Transitional Justice (ICTJ)) në: <https://www.ictj.org/about/transitional-justice>

Për këtë arsye, sfidat me të cilat shoqëritë ballafaqohen pas konflikteve janë të mëdha dhe kërkojnë reforma strukturore në nivel politik, ekonomik dhe shoqëror. Qëllimi tjetër është trajtimi i pasojave të konflikteve i cili bëhet, mes tjerash, përmes rindërtimit dhe ristrukturimit të institucioneve, vendosjes së shtetit ligjor me qëllim të parandalimit të kthimit të shoqërive në dhunë.¹³ Të gjitha këto qëllime janë në vetvete sfida të mëdha, të cilat kërkojnë kohë për t'u arritur.

Kontekstet në të cilat vepron drejtësia tranzicionale ndryshojnë nga një shoqëri në tjetrën. Duthie konsideron se konteksti ndryshon varësisht se a kemi të bëjmë me shoqëri ku ende ka konflikt, ku ato e kanë kaluar konfliktin dhe kanë filluar tranzicionin, apo janë në një fazë pastranzicionale. Dhe, sipas tij, kontekstin e përcaktojnë në masë të madhe “brishtësia institucionale dhe politike, shkalla e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror etj.”¹⁴ Secili nga këto kontekste kërkon mekanizma adekuatë, të cilët “mund të shkojnë nga promovimi i shtetit të së drejtës deri te zgjidhja e konflikteve, ndërtimi i paqes, shfajësimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, demokratizimi, zhvillimi dhe ndryshimet shoqërore.”¹⁵ Masat, të cilat janë adekuate për një vend të caktuar, varen nga shumë faktorë politikë, shoqërorë dhe ligjorë, të cilët edhe janë tregues për atë se çfarë mund të ndërmerret e çfarë jo, si dhe në çfarë kohe. Kjo e bën drejtësinë tranzicionale një lloj “arti” për të kërkuar drejtësi në vende ku ka kundërshtime lokale, brishtësi shtetërore dhe mungesë të burimeve.¹⁶

Temat e studiuara

Ky studim ka për qëllim të nxjerrë në pah temat kryesore që kanë të bëjnë me konceptin e drejtësisë tranzicionale. Duke pasur parasysh kompleksitetin e një analize gjithëpërfshirëse të kësaj fushe, ky studim nuk pretendon t'u japë përgjigje të gjitha pyetjeve që kanë të bëjnë me të, por më shumë të shërbejë si një udhëzues, i cili mundëson kuptimin e kësaj fushe. Qëllimi i këtij studimi është që t'u japë përgjigje një sërë pyetjeve, të cilat shtrohen në të gjitha situatat e shoqërive në tranzicion, që janë: cili është roli i ndëshkimit përmes tribunaleve penale (vendore, hibride ose ndërkombëtare), cili është roli i mekanizmave të tjerë rindërtues të drejtësisë tranzicionale, si mund të arrihet pajtimi brenda shoqërive, dhe

13 N. Turgis, *La justice transitionnelle, un concept discuté*, fq. 338.

14 R. Duthie (2017). “Justice Mosaics: how context shapes transitional justice in fractured societies-report.” ICTJ. <https://www.ictj.org/justice-mosaics-report>.

15 Po aty.

16 Po aty.

si i kontribuon ai shtet ndërtimit? Cili është roli i drejtësisë tranzicionale në demokratizimin e shoqërive? Këtyre pyetjeve do të tentoj t'u përgjigjem edhe përmes studimit të qasjeve dhe mekanizmave të ndryshëm përmes të cilëve drejtësia tranzicionale synon arritjen e qëllimeve të saj.

Libri është i ndarë në tri pjesë dhe ka gjithsej gjashtë kapituj. Pas analizës së koncepteve bazë, qëllimeve të saj dhe konteksteve të veprimit, kapitulli i parë ka të bëjë me evoluimin historik të drejtësisë tranzicionale, tensionet dhe dilemat, të cilat e kanë shoqëruar dhe e shoqërojnë (mos)vendosjen e saj në shoqëri paskonfliktuale, si dhe raportin e saj me tranzicionin. Në kapitullin e dytë janë analizuar tri qasjet e drejtësisë tranzicionale, që janë: ajo retributive (ndëshkuese), e cila ka të bëjë me ndjekjen penale të personave përgjegjës; qasjen rindërtuese (riparuese), e cila është një alternativë ndaj të parës; dhe qasjen tradicionale, e cila ka të bëjë me përgjigjet ndaj dhunës përmes mekanizmave tradicionale (indigjenë). Në pjesën e dytë analizohen mekanizmat gjyqësorë dhe jogjyqësorë të drejtësisë tranzicionale. Në kapitullin e tretë, i cili ka të bëjë me mekanizmat gjyqësorë, do të analizohen suksesivisht Tribunalet Ushtarake të Nurembergut dhe Tokios, Tribunalet Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavi dhe Ruandë, si dhe Gjykata Ndërkombëtare Penale. Në vazhdim do të analizohen tribunalet “hibride” dhe/ose të ndërkombëtarizuara. Në kapitullin e pestë do të analizohen mekanizmat jogjyqësorë të drejtësisë tranzicionale duke filluar me komisionet e së vërtetës dhe pajtimit, amnistitë, reformat institucionale dhe vetingun/lustrimin. Pjesa e tretë ka të bëjë me pajtimin. Kapitulli i gjashtë analizon konceptet e pajtimit nga perspektiva politike dhe ajo ndërpersonale. Kapitulli i gjashtë bën një analizë politike të pajtimit franko-gjerman, i cili ka shërbyer si model i pajtimit për shtetet e Evropës Perëndimore pas Luftës së Dytë Botërore.

I. Origjina dhe qasjet e drejtësisë tranzicionale

1 Drejtësia dhe tranzicioni

Drejtësia tranzicionale është fushë e studimit dhe e praktikës, e cila në katër dekadat e fundit ka shënuar ngritje të shpejtë duke rezultuar me një heterogjenitet të madh sa u përket qasjeve dhe mekanizmave të saj. Deri nga mesi i viteve '90 nuk është përdorur fjala drejtësi tranzicionale. Asaj i është referuar si “drejtësi pas krimit” ose “drejtësi retroaktive.”¹⁷ Studimi trevëllimësh i autorit Neil Kritz, në vitin 1995, i ka dhënë shtytje përdorimit të këtij termi dhe me kohë ai është përhapur në gjithë botën.¹⁸ Kritz i takonte grupit të studiuesve të “Studimeve të demokratizimit” (*Democratisation Studies*), fushë kjo e cila ishte e lidhur ngushtë me tranzicionin demokratik të shoqërive në Amerikën Latine dhe më pas edhe në Evropën paskomuniste.¹⁹ Si shoqëri, të cilat kishin filluar demokratizimin, një ndër pyetjet që shtrohej nga hulumtuesit e studimeve të demokracisë ishte se deri në çfarë mase këto shoqëri duhej të kërkonin llogari për krimet e regjimeve paraprake. Për Kritz, kjo ishte “një dilemë elementare me të cilën përballen të gjitha qeveritë në tranzicion [...] nëse duhet të ndiqen penalisht liderët e regjimeve të përmbysura ose ndihmësit e tyre për shkeljet që ia kanë bërë kombit.”²⁰ Diskutimi i drejtësisë tranzicionale në kuadër të studimeve të demokratizimit do të ketë për efekt që ky term të nënkuptojë mënyrat se si regjimet e reja demokratike duhet të merren me abuzimet e regjimeve paraprake sa u përket krimeve të kryera gjatë diktaturave.²¹ Fiksimi i drejtësisë tranzicionale me tranzicionin do të shtrojë pyetjen se: a duhet që tranzicionet të shoqërohen me masa të drejtësisë tranzicionale apo jo, dhe, nëse po, a e rrezikojnë ato vendosjen e paqes në këto shoqëri?

17 J. R. Quinn (2017). “The development of transitional justice.” In Lawther, L. Moffett, D. Jacobs (Eds.), *Research Handbook of Transitional Justice*. Cheltenham: Edward Elgar Publishing, fq. 11; J. Elster (2004). *Closing the books, transitional justice in historical perspective*, Cambridge, Cambridge University Press, fq. XII.

18 N. J. Kritz (1995). *Transitional justice: How emerging democracies reckon with former regimes (Volume I, II, III)*. Washington DC: United States Institute of Peace Press.

19 *Democratisation studies* do të konstituohen si fushë autonome pas publikimit të studimit të : G. O'Donnel, Ph. Schmitter dhe L. Whitehead (1986). *Transitions from the Authoritarian Rule*. Baltimore: John Hopkins University Press. Në këtë libër autorët shpjegojnë dinamikën e transformimit të regjimeve politike në këto shtete. Më vonë këto studime do të zgjerohen tek Evropa Jugore dhe ajo ish-komuniste, pas vitit 1989. Shih: N. Guilhot, Ph. C. Schmitter (2000). De la transition a la consolidation, une lecture retrospective des democratization studies, *Revue française de science politique*, (50) 4-5, 2000, fq. 615-632, fq. 615.

20 N.J. Kritz, *Transitional justice: How emerging democracies reckon with former regimes*, fq. XXI; C. Denicourt-Fauvel (2020). *Au-delà du chaos: l'héritage de l'impunité institutionnalisée pour expliquer l'extrême violence au Guatemala post-conflit*. Tezë doktorate e mbrojtur në Universitetin e Otawas, e qashme në: https://ruor.uottawa.ca/bitstream/10393/40565/1/DenicourtFauvel_Camille_2020_the%C%80se.pdf, fq. 34

21 D. Preysing (2016). *Transitional Justice in Post-Revolutionary Tunisia (2011–2013) How the Past Shapes the Future*. Wiesbaden: Springer, fq.28.

Pas një analize të historikut të drejtësisë tranzicionale, në këtë kapitull do të analizohet dilema paqe-drejtësi, e cila është në qendër të vendosjes së masave të drejtësisë tranzicionale në periudha tranzicioni. Në vazhdim kapitulli do ta analizojë raportin e drejtësisë tranzicionale me tranzicionin.

1.1. Historik i drejtësisë tranzicionale

Drejtësia tranzicionale është konceptualizuar në dekadën e fundit të shekullit 20, por disa autorë si Jon Elster konsiderojnë se të gjitha shoqëritë që nga antikiteti kanë qenë të vetëdijshme se e ardhmja e regjimeve të reja ka qenë e lidhur ngushtë me mënyrën se si këto shoqëri janë sjellë me anëtarët e regjimit paraprak. Ester e ilustron këtë duke analizuar dy rivendosjet e demokracisë në Athinën e vjetër më 411 dhe 403 (p.e.s.), të cilat i konsideron si drejtësi tranzicionale. Elster thotë:

Athinasit kishin *dy* episode të drejtësisë tranzicionale të njëpasnjëshme. Ka mundësi që pas episodit të parë ata të kenë mësuar se si të veprojnë në episodin tjetër. Pas rënies së oligarkisë së parë në vitin 411, athinasit rivendosën demokracinë paraoligarkike, bënë ndëshkim të ashpër dhe miratuan ligje të reja për të parandaluar oligarkët e ardhshëm nga tentimi për të marrë pushtetin. Ajo që ata nuk e bënë ishte të trajtonin shkaqet kryesore të grusht shtetit oligarkik. Në vitin 403, demokratët që u kthyen në pushtet reagues ndryshe. Nga njëra anë, ata miratuan ndryshime kushtetuese për t'i eliminuar shkaqet që e kishin sjellë mosrespektimin e demokracisë. Në anën tjetër, ata u tërhoqën mbrapa sa i përket ndëshkimit të oligarkëve, duke preferuar kështu të shikonin përpara dhe të arrinin pajtimin shoqëror e jo të shikonin mbrapa duke ndëshkuar.²²

Shpjegimet e mundshme se pse athinasit kishin ndërmarrë masa më të buta pas restaurimit të dytë të demokracisë, sipas tij, kanë mundur të jenë ndikimi që spartanët kishin pasur pas rrëzimit të aleatëve të tyre, oligarkëve, nga pushteti, ose edhe një marrëveshje me këta të fundit.²³

22 Elster, *Closing the books, transitional justice in historical perspective*, fq. 3.

23 Po aty.

Shumica e autorëve pajtohen se drejtësia tranzicionale është zhvilluar në së paku tri faza. Faza e parë fillon me krijimin e Tribunaleve Ushtarake të Nurembergut dhe Tokios, të cilët konsiderohen si mekanizmat e parë gjyqësorë, të cilët i kanë paraprirë zhvillimit të drejtësisë tranzicionale më vonë. Një ndër studiuesit e parë të drejtësisë tranzicionale, Ruti Teitel, konsideron se janë këto Tribunale të cilat përbëjnë bazën e kësaj drejtësie. Në një studim mbi gjenealogjinë e drejtësisë tranzicionale, Teitel konsideron se “faza I e gjenealogjisë, faza e pasluftës, filloi në vitin 1945. Përmes simbolit të saj më të njohur, gjykimet penale të organizuara nga aleatët në Nuremberg, kjo fazë pasqyron triumfin e drejtësisë tranzicionale brenda skemës së ligjit ndërkombëtar.”²⁴ Tribunalet e Nurembergut dhe Tokios kishin qenë një zgjerim i mekanizmave të drejtësisë penale ekzistuese brenda shteteve perëndimore të bartura në nivel ndërkombëtar, të krijuara për t’i gjykuar liderët nazistë gjermanë dhe japonezë. Kjo fazë e drejtësisë tranzicionale është ekskluzivisht gjyqësore dhe si e tillë ka vendosur themelet e drejtësisë retributive (*retributive justice*) ndërkombëtare. Përveç ndëshkimit të krimit, verdiktet dhe jurisprudenca e këtyre Tribunaleve kanë pasur për qëllim t’i japin fund mosndëshkimit dhe e gjithë kjo duhej t’i shërbente Gjermanisë së pasluftës për t’u ballafaquar me të kaluarën e saj naziste. Qëllimi ishte që gjykatat vendore të vazhdonin gjykimin e krimeve edhe pas mbylljes së këtyre dy Tribunaleve ndërkombëtare. Këto Tribunale do të krijojnë standarde edhe për shtetet e tjera që të jenë në gjendje t’i gjykojnë kriminelët e tyre të luftës. Megjithatë, në vende të tjera, Lufta e Ftohtë do të bëhet pengesë për institucionalizimin e drejtësisë penale ndërkombëtare duke e bërë të vështirë sjelljen para drejtësisë të ish-liderëve autoritarë. Në shumicën e rasteve tranzicioni kishte përfunduar me amnisti ose vetamnisti të personave përgjegjës për krime duke e bërë të pamundur ndëshkimin e krimeve.

Faza e dytë e drejtësisë tranzicionale është e lidhur ngushtë me atë që Samuel Huntington e quan vala e tretë e demokratizimit dhe e cila, ashtu siç u tha më lart, përputhet me fillimin e demokratizimit të shteteve të Evropës Jugore (Spanjë, Portugali, Greqi) në vitet 1970; atyre të Amerikës Latine në vitet 1980 dhe të Evropës Qendrore dhe Lindore pas rënies së Murit të Berlinit, si dhe Afrikës së Jugut, pas rënies së Aparteidit, në fillim të viteve 1990.²⁵ Në fillim të kësaj faze ballafaqimi me të kaluarën ishte limituar ekskluzivisht në gjykimin e ish-lidershipit të regjimit paraprak. Kështu, për shembull, në vitin 1975, pas rënies së tyre nga pushteti, liderët e juntës ushtarake greke që kishin qeverisur Greqinë nga viti 1967-1974 do të sillen para drejtësisë dhe do të dënohen me burgim të përjetshëm. Në

24 R. Teitel (2003). *Transitional Justice Genealogy*. *Harvard Human Rights Journal* 16, fq. 70.

25 Po aty, fq. 71 ; F. Oduro (2012). *Transitional Societies, Democratic Accountability and Policy Responses: The Formulation of the Truth Commission-Approach to a Transitional Justice Policy (South Africa, Nigeria, Ghana)*. Carleton: Universiteti i Ottawës, fq. 31.

vitin 1985, në Argjentinë do të gjykohej anëtarët e juntës ushtarake, e cila kishte qeverisur këtë shtet nga viti 1976-1983 dhe që kishte qenë përgjegjëse për shkelje masive të të drejtave të njeriut. Disa gjeneralë do të dënohen me burgim të përjetshëm në një proces gjyqësor, i cili ishte zhvilluar nën presion të lartë. Kjo edhe për shkak se ndikimi i anëtarëve të ish-regjimit ishte ende i madh.²⁶ Kjo është arsyeja pse në këtë fazë të dytë ballafaqimi i shoqërive në tranzicion me të kaluarën e tyre do të kërkohet të bëhet përmes komisioneve të së vërtetës dhe pajtimit. Si mekanizma pragmatikë, këto komisione kishin për qëllim zbardhjen e krimeve të regjimeve paraprake duke kontribuar kështu në diskreditimin e tyre. Komisioni i parë i së vërtetës do të krijohet në vitin 1983, në Argjentinë. Kjo ishte bërë e mundur pas ndryshimit të pushtetit në këtë shtet. Më 16 dhjetor 1983, presidenti i parë demokratik i Argjentinës, Raul Alfonsín, e kishte themeluar atë. Në raportin e dorëzuar më 20 shtator 1984, Komisioni kishte dokumentuar rreth 9 000 vrasje të kryera nga regjimi paraprak.²⁷ Ky Komision do ta bëjë të mundur sjelljen para drejtësisë dy vjet më vonë të liderëve ushtarakë të ish-regjimit. Komisioni i dytë i së vërtetës do të themelohet në Kili pas zgjedhjes demokratike të presidentit Patricio Aylwin në vitin 1989. Komisioni nacional i së vërtetës dhe pajtimit, siç ishte emëruar ky komision, kishte mandat që të zbardhte krimet e diktaturës së Augusto Pinochet, i cili kishte qenë në pushtet nga vitet 1973-1990. Mandati i këtij komisioni kishte qenë që “të krijojë një fotografi sa më të plotë të shkeljeve më serioze të të drejtave të njeriut; të mbledhë prova për të mundësuar krijimin e një liste që identifikon emrin, fatin dhe vendndodhjen e viktimave; të rekomandojë dëmshpërblime për familjet e viktimave dhe të rekomandojë masa ligjore dhe administrative për të parandaluar shkeljet në të ardhmen.”²⁸ Në raportin e dorëzuar nga ky komision thuhej se 2 000 persona ishin vrarë gjatë diktaturës për motive politike. Disa komisione të tjera ishin krijuar në vitet vijuese, si në El Salvador, në vitin 1992, ose në Guatemala në vitin 1994. Më pas, me dhjetëra komisione do të krijohen në të gjithë botën (shih kapitullin 4). Megjithatë, komisioni i cili do të arrijë famë botërore dhe që do të bëhet model për të gjitha komisionet e themeluara më pas do të jetë ai i Afrikës së Jugut, i krijuar në vitin 1995, pas rënies së regjimit të Aparteidit. Ky komision ishte negociuar në kuadër të marrëveshjes ndërmjet liderit historik jug-afrikan, Nelson Mandela, dhe presidentit të fundit të regjimit segregacionist, Frederik

26 Për një analizë të detajuar të këtyre ngjarjeve shih kapitullin 3 të librit të: K. Sikkink (2012). *The Justice Cascade: How Human Rights Prosecutions are Changing World Politics*. New York, London: W.W. Norton and Company.

27 N. Roht-Arriaza, Javier “Mariezcurrena (2006). *Transitional Justice in the Twenty-First Century: Beyond Truth versus Justice* (Eds.), CUP, fq. 304.

28 M. Ensalaco (1994). Truth Commissions for Chile and El Salvador: A Report and Assessment. *Human Rights Quarterly*. 16 (4), 656–675.

de Klerk.²⁹ Komisioni ishte vendosur nën udhëheqjen e priftit protestant, Desmond Tutu. Ashtu siç do ta shohim më pas, konteksti politik në të cilin zhvillohet tranzicioni në masë të madhe i përcakton edhe mekanizmat e drejtësisë tranzicionale. Komisioni jug-afrikan ishte krijuar për të ruajtur stabilitetin politik dhe për të penguar rrëshqitjen e shoqërisë në dhunë. Një ndër rreziqet ishte edhe ikja e kapitalit në rast se të bardhët, të cilët e kontrollonin ekonominë e shtetit, do të gjykoreshin për krimet e kryera gjatë diktaturës. Kjo kishte qenë arsyeja pse liderët e këtij shteti ishin marrë vesh që ballafaqimi me të kaluarën të mos bëhej përmes proceseve gjyqësore por përmes mekanizmave alternativë. Komisioni i cili do të themelohet, do të marrë mandat që, mes tjerash, edhe t'i amnistojë “me kusht” personat, të cilët do të rrëfeshin për krimet e tyre para komisionit.³⁰ Në këtë fazë të krijimit të komisioneve të së vërtetës dhe pajtimit preokupim kryesor i përkrahësve të kësaj drejtësie kishte qenë mbrojtja e të drejtave të njeriut gjatë tranzicionit dhe progresivisht kjo do të kontribuojë në formësimin e konceptit të një drejtësie universale të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Dhe kjo do të vendosë themelet e drejtësisë tranzicionale. Si rezultat, literatura e cila analizon drejtësinë tranzicionale gjatë kësaj kohe është dominuar nga juristë dhe avokatë. Pierre Hazan thotë se merita e komisioneve të së vërtetës dhe pajtimit është optimizmi i tyre dhe krijimi i kushteve për të filluar pajtimin.³¹ Kjo fazë e dytë do të prodhojë tensione ndërmjet atyre që mbronin ballafaqimin me të kaluarën përmes ndëshkimit dhe të tjerëve të cilët ishin për amnistimin e krimeve. Përkrahësit e komisioneve konsideronin se “ajo që është korrekte dhe e drejtë në rrethana politike të jashtëzakonshme duhej të përcaktohej nga vetë natyra e tranzicionit”.³²

Faza e tretë është faza e ngritjes së drejtësisë tranzicionale në nivel global. Ky globalizim do të bëhet i mundur përmes konsolidimit të së drejtës penale ndërkombëtare. Në këtë fazë drejtësia tranzicionale do të merret me shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut përmes dënimit të personave, të cilët kanë kryer krime lufte, krime kundër njerëzimit ose gjenocide. Baza e gjykimit të këtyre personave do të jetë shkelja flagrante e së drejtës ndërkombëtare humanitare. Teitel konsideron se në fund të shekullit njëzet do të lindë një drejtësi tranzicionale e qëndrueshme, fazë kjo “që karakterizohet me një përshpejtim definitiv të drejtësisë tranzicionale të shoqëruar me globalizimin dhe e karakterizuar nga kushtet e rritjes së paqëndrueshmërisë politike dhe dhunës.”³³ Kjo do ta sjellë drejtësinë

29 K. Andrieu (2015). “Juger, réconcilier, réparer: la justice transitionnelle pour sortir de la violence?” In IRG (Eds.), *Tous Responsables? chronique de la gouvernance* (ff. 111-123). Paris: Edition Charles Léopold Mayer, fq. 117-118.

30 Oduro, *Transitional Societies, Democratic Accountability and Policy Responses*, fq.176.

31 P. Hazan (2010). *Judging War, Judging History, Behind Truth and Reconciliation*. Stanford: Stanford University Press, fq. 29-30.

32 R. Teitel, *Transitional Justice Genealogy*, fq. 76.

33 Po aty, fq. 71.

tranzicionale nga periferia, ku ajo kishte qenë për një kohë të gjatë, në qendër. Ligji dhe dispozitat ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut do të bëhen parime kryesore për ballafaqimin e shoqërive me të kaluarën. Mekanizmat gjyqësorë të drejtësisë tranzicionale do të themelohen duke u bazuar në parimin se paqja mund të arrihet më së miri përmes ligjit. Dy institucione penale ndërkombëtare do të luajnë një rol kyç në ngritjen e drejtësisë tranzicionale dhe ato janë: Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi (TNPJ) dhe Tribunali Ndërkombëtar Penal për Ruandë (TNPR), të cilët do të themelohen në vitin 1993 respektivisht 1994. Këto Tribunale ishin krijuar për të dënuar shkeljet masive të të drejtave të njeriut të kryera në këto dy shtete në fillim të viteve 1990, pas konflikteve të armatosura. Ato kishin qenë institucionet e para penale ndërkombëtare të krijuara pas Tribunaleve Ushtarake të Nurembergut dhe Tokios. Në vitin 1998 do të nënshkruhet Statuti i Romës, i cili ka vendosur bazat e themelimit të Gjykatës Ndërkombëtare Penale (GJNP) e cila, për dallim nga këta të parët, do të jetë tribunal permanent. Statuti i Romës do të hyjë në fuqi më 1 korrik 2002. Këtyre tribunaleve duhet shtuar edhe tribunalet penale hibride ose të ndërkombëtarizuara, të cilat do të inspirohen nga këto të parat dhe do të kontribuojnë në vendosjen e standardeve të drejtësisë në nivel të shteteve ku ato do të vendosen. Kështu, globalizimi i drejtësisë tranzicionale do të shoqërohet edhe me institucionalizimin dhe profesionalizimin e saj në shumë aspekte.³⁴ Kjo fazë do të karakterizohet me një diversifikim të aktorëve, ku përveç atyre lokalë, përfshirë edhe qytetarët ordinarë, do të ketë një rritje të përkrahësve të kësaj drejtësie, që Kathryn Sikkink e quan “kaskadë e drejtësisë.”³⁵ Ajo fillon si një fenomen i vogël, i cili me kohë do të marrë përmasa që askush nuk i kishte paraparë. Megjithatë, me përdorimin e këtij termi, Sikkink nuk pretendon se “është bërë ose do të bëhet drejtësi e përsosur, ose se shumica e autorëve të shkeljeve të të drejtave të njeriut do të mbajnë përgjegjësi penale. Përkundrazi, “kaskada e drejtësisë” do të thotë se ka pasur një ndryshim që ka të bëjë me legjitimitetin e normës së përgjegjësisë penale individuale për shkeljet e të drejtave të njeriut dhe një rritje të ndjekjeve penale në emër të kësaj norme.”³⁶ Në mesin e këtyre aktorëve duhet përmendur edhe qendrat e studimit të specializuara, siç është Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale (*International Center for Transitional Justice-ICTJ*), e cila me kohë do të fitojë notoritetet të pakontestueshëm ndërkombëtar në këtë fushë.³⁷ Gjithashtu do të ketë interesim për drejtësinë tranzicionale nga ana e studiuesve dhe ajo do të bëhet objekt i studimit të shumë fushave të shkencave

34 Hazan, *Judging War, Judging History*, fq. 30-31.

35 Sikkink, *The Justice Cascade: How Human Rights Prosecutions are Changing World Politics*, fq. 9.

36 Po aty.

37 N. Turgis, *La justice transitionnelle, un concept discuté*, fq. 334.

shoqërore, si: antropologjia, sociologjia, politologjia, historia, kriminologjia, psikologjia, etj. E gjithë kjo do t'i kontribuojë institucionalizimit të së drejtës penale ndërkombëtare, i cili do ta bëjë të vështirë mohimin e respektimit të principeve dhe kërkesave, të cilat do të vijnë nga bashkësia ndërkombëtare në raport me shkeljet e të drejtave të njeriut. Njëkohësisht, OKB-ja dhe institucionet e tjera relevante ndërkombëtare do t'i promovojnë mekanizmat e drejtësisë tranzicionale. Në vitin 2004, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së (Kofi Anan) do të publikojë një raport përmes të cilit kërkonte që OKB-ja të jetë përkrahëse e masave dhe mekanizmave të cilët e promovojnë drejtësinë tranzicionale në shoqëritë paskonfliktuale.³⁸ Ky raport potencon formalisht se një lloj mekanizmi i drejtësisë tranzicionale është vendimtar për shoqëritë e dala nga konflikti i dhunshëm dhe adresimi i krimeve të së kaluarës është esencial për ndërtimin e paqes së qëndrueshme.³⁹ Më pas, në strategjitë e OKB-së dhe atyre të BE-së do të figurojnë elemente të drejtësisë tranzicionale si parakusht për të fituar përkrahjen e tyre.⁴⁰

1.2. Paqe apo drejtësi

Një ndër pyetjet e para që shtrohet në shoqëritë që dalin nga konfliktet është se a duhet që tranzicioni të shoqërohet me masa të drejtësisë tranzicionale apo jo? Në shumë vende kjo reduktohet në një pyetje të thjeshtë “paqe apo drejtësi?”. Në njërën anë janë ata që mendojnë se ndjekja e personave përgjegjës mund ta zgjasë luftën më shumë sesa ta ndalojë atë dhe të jetë pengesë për paqen, kurse, në anën tjetër, ata të cilët konsiderojnë se çdo tranzicion duhet të shoqërohet me masa ndëshkuese kundër personave që kanë kryer krime. Kjo dilemë shtron pyetjen se a është ndjekja e kriminelëve në përputhje me ndjekjen e paqes dhe a mund të arrihen paqja dhe drejtësia në të njëjtën kohë?⁴¹ Ndjekjet penale në periudha tranzicioni mund të kenë për efekt që regjimet autoritare të përdorin forcë edhe më të madhe detyruese për të mbajtur pushtetin e tyre. Për një kohë të gjatë përgjigjja ka qenë se paqja mund të arrihet vetëm përmes amnistimit të krimeve, i cili është konsideruar si “imperativ moral,” një etapë e pashmangshme për të arritur pajtimin.⁴² Dhe deri në vitet

38 Shih dokumentin UN, S/2004/616, “The rule of law and transitional justice in conflict and post-conflict societies” në: <https://www.un.org/ruleoflaw/files/2004%20report.pdf>

39 Kerr dhe Mobekk, *Peace and Justice, seeking accountability after war*, fq. 2.

40 Oduro, *Transitional Societies, Democratic Accountability and Policy Responses*, fq. 34.

41 A. D'Amato (1996). Peace vs. accountability in Bosnia. *American Journal of International Law*, 88, ff. 500–506.

42 P. Hazan (2008), Les Dilemmes de la Justice Transitionnelle. *Mouvements*, 53, (1), ff. 41-47, Fq. 43.

1980, mungesa e ndëshkimit të krimeve të së kaluarës ka qenë normë. Në një fjalim të tij pas Luftës së Dytë Botërore dhe përballë sfidës së ballafaqimit të Francës me të kaluarën e saj kolaboracioniste me nazizmin (Qeveria e Vichy-së), presidenti francez Charles de Gaulle kishte thënë se “Franca nuk ka nevojë për të vërtetën, ajo ka nevojë për unitet nacional dhe për shpresë.”⁴³ Ballafaqimi me të kaluarën përmes harresës e jo kujtesës do të jetë argument dominues në shumë shtete të botës. Mbrojtësit e kësaj qasjeje konsideronin se për të ndërtuar një të ardhme të përbashkët duhej të mësoheshin të jetonin me ata, të cilët deri dje i kishin persekutuar, pa u kërkuar atyre ndonjë llogari për veprat e tyre.

Hazan konsideron se “ky vizion i një amnistie-amnezie, e cila i shëron plagët e luftës, do të ndryshojë në mënyrë radikale pas fundit të Luftës së Ftohtë.”⁴⁴ Dalja në sipërfaqe e së vërtetës do të bëhet standard për t’u ballafaquar me të kaluarën. Nga ajo se a duhet apo jo që shoqëritë të ballafaqohen me të kaluarën, është kaluar në atë se “çfarë forme duhet të ketë ajo dhe se cila duhet të jetë shkalla e përfshirjes ndërkombëtare dhe kush duhet të shënjestrohet?”⁴⁵ Ky parim do të fillojë në Amerikën Latine pas rënies së regjimeve diktatoriale dhe do të përhapet në të gjitha kontinentet.⁴⁶ Në fillim të viteve 1980, me hapjen e dritareve të tranzicionit në Argjentinë dhe pastaj në Uruguai dhe në Kili, ishte menduar, para së gjithash, se si mund të përdroreshin këto “momente të tranzicionit” për të trajtuar shkeljet e regjimit paraprak.⁴⁷ Më pas kërkesat për llogaridhënie dhe për zbulimin e së vërtetës do të marrin përmasa globale, pikërisht duke iu falënderuar shumë aktorëve ndërkombëtarë, të cilët do t’i përkrahin këto kërkesa.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se koha e harresës kishte përfunduar. Një numër i madh shtetesh, të cilat kanë kaluar nëpër konflikte të armatosura, nuk kanë arritur kurrë të zbatojnë ndonjë masë të drejtësisë tranzicionale. Shkaqet janë të ndryshme, por një nga më të shpeshtat është kthimi në dhunë dhe përshkallëzimi i situatës pas një hapeje fillestare. Më shumë se 40% e konflikteve të përfunduara me marrëveshje të negociuara pas pesë vjetësh i kthehen përsëri dhunës.⁴⁸ Të tilla janë një numër shtetesh arabe, të cilat pas “Pranverës arabe” në vitin 2013 i janë kthyer dhunës. Nga këto shtete vetëm Tunizia ka pasur sukses në vendosjen e masave të drejtësisë tranzicionale. Në Siri dhe në Libi situata është përshkallëzuar deri në ekstrem, saqë është sjellë në konsideratë edhe shteti e

43 Po aty.

44 Po aty.

45 Kerr dhe Mobekk, *Peace and Justice, seeking accountability after war*, fq. 2.

46 Po aty, fq. 43.

47 T. O. Hansen (2017). “The time and space of transitional justice.” In Lawther, Moffett, dhe Jacobs, *Research Handbook of Transitional Justice*, fq. 34.

48 D. Philpott (2012). *Just and unjust: An Ethic of Political Reconciliation*. Oxford: Oxford University Press, fq. 1.

të mos flasim për ballafaqimin me të kaluarën. Egjipti, në anën tjetër, edhe përtej hapjes së përkohshme, e cila ishte arritur pas revoltës popullore, është rikthyer përsëri në diktaturë.

Parakusht i ballafaqimit me të kaluarën, sipas Philpott, është që shoqëritë së pari “të arrijnë të paktën një paqe minimale [...] të monitorohet armëpushimi; të shuhet krimi i shfrenuar; të krijohet një forcë policore civile; të kthehen refugjatët e zhvendosur, kampet e të cilëve mund të shndërrohen në vende rekrutimi për policinë sulmuese.”⁴⁹ Kjo tregon se shumë shoqëri nuk e kanë luksin që të marrin parasysh ballafaqimin me të kaluarën për shkak të pafuqisë që të krijojnë një kontekst të favorshëm, i cili është i nevojshëm për të shqyrtuar mundësinë e ballafaqimit me të kaluarën.

Tendenca për të harruar të kaluarën ka qenë dominuese edhe në Ballkanin Perëndimor. Në shumicën e shteteve të dala nga ish-Jugosllavia kanë munguar dhe mungojnë politikat e ballafaqimit me të kaluarën. Shumica e regjimeve kanë preferuar paqen pa drejtësi dhe ikjen nga përgjegjësia e krimeve të kryera. Gjatë negociatave të zhvilluara ndërmjet serbëve, kroatëve dhe boshnjakëve në Dayton, në vitin 1995, për t'i dhënë fund luftës në Bosnjë, palët serbe dhe kroate kishin kërkuar që bashkëpunimi me Tribunalin Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi të mos figurojë në marrëveshjen finale. Dispozitat e Marrëveshjes së Dejtonit, të cilat i obligonin nënshkruesit që të bashkëpunojnë me gjykatën ish-in integruar vetëm pas presionit të ushtruar nga kryeprokurori Richard Goldstone, i cili, nga Dejtoni, ku kishte shkuar për të tërhequr vëmendjen ndërkombëtare, kishte deklaruar se çdo lloj amnistie eventuale do të refuzohej nga Tribunali.⁵⁰ Personat përgjegjës për krime lufte janë dënuar nga një gjykatë ndërkombëtare që ka qenë TNPJ-ja, puna e së cilës ka hasur në pengesa të shkaktuara nga qeveritë e shteteve të Ballkanit.

1.3. Raporti drejtësi-tranzicion

Tranzicioni është periudhë ndërmjet dy regjimeve, e cila karakterizohet me një lloj suspendimi të rregullit shoqëror të zakonshëm, ku nuk zbatohen plotësisht as ligjet dhe standardet e regjimit të vjetër “të keq” dhe as ato të regjimit të ri “të mirë.”⁵¹ Drejtësia, e cila vendoset në këtë kohë, quhet tranzicionale për shkak se ajo zhvillohet në një kontekst

49 Po aty.

50 A. Vukpalaj (2010). *Ex-Yugoslavie, de la guerre a la justice, La Serbie, la Croatie et la Bosnie-Herzegovine a l'epreuve du Tribunal penal international pour l'ex-Yugoslavie (TPIY)*. Paris : Michel Houdiard Editeur, fq. 35.

51 M. S. Williams, R. Nagy, J. Elster (2012). *Transitional Justice* (Eds.). New York London: New York University Press, fq. 21.

specifik që është tranzicioni. Megjithatë, ashtu siç u tha më lart, kjo nuk do të thotë se të gjitha tranzicionet shoqërohen me masa të drejtësisë tranzicionale. Gjithashtu, të pakta janë shtetet të cilat gjatë tranzicionit kanë pasur sukses të plotë në gjykimin e krimeve dhe në zbardhjen e së kaluarës së errët. Në shumë shtete, duke përfshirë këtu edhe ato të Ballkanit Perëndimor, ende nuk është zbardhur fati i të gjitha viktimave të luftërave dhe shoqëritë të cilat kanë kaluar nëpër konflikte nuk kanë arritur plotësimin e standardeve të drejtësisë tranzicionale.⁵²

Për ta kuptuar raportin ndërmjet drejtësisë dhe tranzicionit duhet ta shtrojmë pyetjen se: a është drejtësia e cila vendoset gjatë tranzicioneve, e ndryshme nga drejtësia e zakonshme? Një ndër teoricienët e parë dhe më me renome të drejtësisë tranzicionale, Ruti Teitel, thotë se konteksti i tranzicionit e bën drejtësinë tranzicionale të ndryshme nga drejtësia e zakonshme.⁵³ Drejtësia, thotë ajo, “në kohë të ndryshimeve politike është e jashtëzakonshme.”⁵⁴ Për ta ilustruar këtë, ajo e bën një krahasim ndërmjet sundimit të ligjit në shtetet demokratike dhe shteteve në tranzicion. Në demokraci, sipas saj, “sundimi i ligjit do të thotë respektimi i rregullave të njohura, në krahasim me veprimet arbitrare [...] shteti ligjor nënkupton ligjshmëri, stabilitet dhe respektimin të rregullave në fuqi”, kurse tek shoqëritë në tranzicion sundimi i ligjit krijon tension me tranzicionin për shkak se ai ka për qëllim “transformimin e sistemit të tyre politik, ligjor dhe ekonomik”. Kështu, përderisa në shtete demokratike ligji ka për qëllim mbajtjen e rregullit shoqëror, në shoqëritë në tranzicion, përveç mbajtjes së rregullit shoqëror, ai ka për qëllim ta mundësojë edhe transformimin e shoqërisë. Në këtë aspekt Teitel thotë se “sundimi i ligjit është përfundimisht kontingjent; në vend se thjesht të bazohet në rendin ligjor, ai shërben për të ndërmjetësuar zhvendosjen normative të vlerave që i karakterizojnë këto periudha të jashtëzakonshme.”⁵⁵ Kjo e bën drejtësinë tranzicionale në këto shoqëri të kontekstualizuar dhe parciale. Kjo qasje është e bazuar mbi postulatit se drejtësia tranzicionale është formë e drejtësisë e nevojshme dhe jo në kundërshtim me paqen dhe stabilitetin.⁵⁶ Dhe ky kontekst i jashtëzakonshëm bën që në këtë kohë të zbatohen standarde specifike të drejtësisë. Teitel thotë se mekanizmat ligjorë të zakonshëm, të cilët e shpërndajnë drejtësinë në demokraci janë ose të fokusuar në të kaluarën, siç janë për shembull proceset penale, të cilat kanë të bëjnë me riparimin/kompensimin e një dëmi specifik në të kaluarën, ose janë të fokusuara

52 P. De Grief (2012). “Theorizing Transitional Justice.” In, Williams, Nagy, Elster, *Transitional Justice*, (ff. 31-78). fq. 35.

53 R. Teitel (2000). *Transitional Justice...* op. cit. Fq.6.

54 Po aty.

55 R. Teitel (2000). *Transitional Justice*. Oxford: Oxford University Press ; P. De Grief, *Theorizing Transitional Justice*, fq. 35.

56 N. Turgis, *La justice transitionnelle, un concept discuté*, fq. 337-338.

në të ardhmen, siç janë masat e reja ligjore ose kushtetuese, të cilat do të zbatohen në të ardhmen. Të tilla janë, sipas saj, proceset gjyqësore kundër personave, të cilët kanë ushtruar dhunë në të kaluarën për shkak se, mes tjerash, shoqëritë në tranzicion bëjnë përpjekje për t'i përdorur këto procese gjyqësore, për të tërhequr një linjë ndërmjet regjimeve të së kaluarës dhe atyre të reja.⁵⁷ Në këtë aspekt ato janë edhe retrospektive, edhe prospektive. Raste të tjera që tregojnë veçoritë e drejtësisë tranzicionale janë politikat riparuese, të cilat nënkuptojnë se demokracitë kanë detyrim që t'i riparojnë dëmet e shkaktuara nga shteti dhe këto politika janë gjithmonë retrospektive. Për drejtësinë riparuese tranzicionale, masat ligjore riparuese janë edhe retrospektive, që do të thotë se kanë për qëllim riparimin e dëmit të shkaktuar nga shteti në të kaluarën, por ato janë edhe prospektive, sepse kanë për qëllim transformimin e shtetit dhe krijimin e një identiteti të ri politik shtetëror.⁵⁸

Autorët, të cilët e mbrojnë këtë qasje, e konsiderojnë drejtësinë tranzicionale si drejtësi liberalizuese, si një hap të nevojshëm drejt një rregulli demokratik liberal, ku janë të respektuara të drejtat e plota.⁵⁹ Në këtë aspekt kjo qasje është konstruktiviste.⁶⁰ Kjo qasje e drejtësisë tranzicionale si e jashtëzakonshme në kohë tranzicioni nuk e mohon faktin se mund të ketë edhe anashkalim të drejtësisë, siç janë amnistitë dhe faljet e krimeve në disa raste, por ato janë, sipas tyre, një fazë e cila çon drejt demokracisë liberale ku do të zbatohet plotësisht ligji konform standardeve demokratike. Për këtë arsye ato bëhen me kompromise sa i përket zbatimit të ligjit për shkak të situatës specifike të tranzicionit. Kjo qasje konsideron se drejtësia tranzicionale e ka një karakter instrumentalist, ku secili mekanizëm ka finalitete më të gjëra, të lidhura ngushtë me themelet e shtetit dhe drejtimin e tranzicionit.⁶¹

Posner dhe Vermeule në analizën e tyre të drejtësisë brenda kontekstit të tranzicionit konsiderojnë se drejtësia tranzicionale është si drejtësia e zakonshme (ordinare) dhe në asnjë mënyrë funksioni i saj nuk është i ndryshëm nga funksionet që drejtësia luan në demokraci.⁶² Këta autorë konsiderojnë se “teoricienët e drejtësisë tranzicionale zakonisht gabojnë duke i trajtuar tranzicionet e regjimeve si një subjekt në vetvete, duke mohuar kështu rëndësinë ose interesin e krahasimeve dhe analogjive midis tranzicioneve të regjimeve, nga njëra anë, dhe shumëllojshmërive të mëdha të tranzicioneve që ndodhin në demokracitë e konsoliduara, në anën tjetër.”⁶³

57 Teitel, *Transitional Justice*, fq. 11; De Grief, “Theorizing Transitional Justice,” fq. 59.

58 Teitel, *Transitional Justice*, fq. 119.

59 R. F. Layus (2010). *Transitional Justice in the midst of ongoing armed conflicts, the case of Colombia*. Potsdam: Universitätsverlag Potsdam, fq. 29.

60 Teitel, *Transitional Justice*, fq. 27.

61 Turgis, *La justice transitionnelle, un concept discuté*, fq. 336.

62 Posner dhe Vermeule, *Transitional Justice as Ordinary Justice*, fq. 762.

63 Po aty, fq. 762-763.

Megjithatë, ata nuk e përjashtojnë mundësinë që konteksti i tranzicionit mund të kërkojë kompromise, të cilat në kushte normale nuk do të ishin të pranueshme.⁶⁴ Kompromiset supozojnë se pritshmëritë e zakonshme të drejtësisë në sisteme demokratike nuk plotësohen në kohë tranzicioni.⁶⁵ Këto kompromise mund të jenë dhënia e amnistisë për të zbuluar të vërtetën e krimeve, falja e dënimit ose edhe sjellja para drejtësisë vetëm e personave që kanë pasur përgjegjësinë më të madhe për kryerjen e atrociteteve, duke i shmangur të tjerët përgjegjës dhe të gjitha këto për të sjellë sadopak drejtësi. Argumenti kryesor i Vermeule-s dhe Posner-it për të kundërshtuar diferencimin e drejtësisë në shtetet në tranzicion, në raport me drejtësinë në demokracitë e konsoliduara, është se edhe këto të fundit kalojnë në mënyrë permanente nëpër tranzicione të brendshme dhe ngjashëm, sikur shtetet në tranzicion, ato nuk mbërrijnë gjithmonë t'i plotësojnë standardet e drejtësisë, të cilat u atribuohen.⁶⁶ Edhe në këtë drejtësi të zakonshme, sipas tyre, ka gjithmonë parregullsi dhe, për këtë arsye, diferenca ndërmjet drejtësisë ordinare dhe asaj tranzicionale është më shumë çështje shkalle. Këta autorë konsiderojnë se ka vazhdimësi ndërmjet këtyre drejtësive. Disa autorë të tjerë e konsiderojnë se drejtësia tranzicionale nuk është as drejtësi e jashtëzakonshme dhe as drejtësi kompromisesh, por më shumë një zbatim i drejtësisë në kushte të ndryshme. Pablo de Grief konsideron se në vend të shprehjes drejtësi tranzicionale do të duhej të përdorej shprehja “drejtësi në kohë tranzicioni” dhe principet e normat e drejtësisë do të duhej të ndryshoheshin dhe të zbatoheshin duke marrë parasysh kontekstin.⁶⁷

Drejtësia tranzicionale dhe tranzicioni janë të ndryshme edhe sa i përket temporalitetit. Temporaliteti i tranzicionit nuk përputhet gjithmonë me drejtësinë tranzicionale. Kështu, për shembull, në fazat e para të tranzicionit paskonflikt prioritet nuk është drejtësia, por më shumë çështjet e sigurisë dhe ulja e tensioneve brenda shoqërisë. Në anën tjetër, disa masa të drejtësisë tranzicionale, siç janë reformat institucionale, për shembull, nuk mund të bëhen brenda një afati të shkurtër kohor dhe kërkojnë zakonisht shumë dekada për t'u bërë. Ose, zbulimi i personave të zhdukur është po ashtu proces i cili e tejkalon tranzicionin. As pajtimi si qëllim final nuk mund të arrihet shpejt dhe kërkon paraprakisht një sërë ndryshimesh, të cilat mundësojnë fillimin e një procesi të tillë, i cili zgjat më pas me dekada. Këto temporalitete të ndryshme bëjnë që një shoqëri në tranzicion nuk është gjithmonë në gjendje të absorbojë shumë mekanizma të drejtësisë tranzicionale njëkohësisht.

64 Layus, *Transitional Justice in the midst of ongoing armed conflicts*, fq. 28.

65 Po aty.

66 Po aty.

67 De Grief, “Theorizing Transitional Justice”, fq. 64.

Raporti drejtësi-tranzicion shtron edhe pyetjen e kohëzgjatjes së mekanizmave të drejtësisë tranzicionale. A duhet që këto masa të jenë të përkohshme, që do të thotë se ato duhet t'i trajtojnë shkeljet e kryera gjatë fazës së parë të tranzicionit apo të konsiderohet se nuk ka një “moment” të veçantë në kohë për t'i trajtuar ato.⁶⁸ Kjo çështje është e rëndësishme nëse e kemi parasysh se masat e drejtësisë tranzicionale kërkojnë burime të jashtëzakonshme për shtetet në tranzicion, të cilat këto shoqëri nuk kanë gjithmonë mundësi t'i ofrojnë.

68 K. Kamp (2016). *Restorative Justice in Transitional Settings*. London: Routledge, fq.8.

2 Qasjet e drejtësisë tranzicionale

Tri qasje dominuese të drejtësisë tranzicionale do të trajtohen në këtë kapitull. E para është ajo retributive (ndëshkuese), e cila është qasja më e vjetër dhe që është e rrënjësor thellë në traditën perëndimore liberale të kërkimit të përgjegjësisë për krimet e kryera. Kjo qasje nënkupton ndëshkimin e personave përgjegjës përmes proceseve gjyqësore. Në kontekstin e drejtësisë tranzicionale kjo nënkupton ndjekjen penale të personave përgjegjës për kryerjen e krimeve gjatë konflikteve të armatosura, qoftë nga autoritetet ndërkombëtare përmes gjykatave ndërkombëtare penale, ad hoc, të përhershme, hibride, të ndërkombëtarizuara, ose edhe atyre vendore.⁶⁹ Qasja e dytë, e cila paraqitet si alternativë ndaj ndëshkimit, është qasja rindërtuese (riparuese), e cila promovon ballafaqimin e shoqërive me të kaluarën përmes institucioneve jogjyqësore, siç janë komisionet e së vërtetës dhe pajtimit. Sipas kësaj qasjeje, e vetmja mënyrë për të arritur pajtimin në nivel të individëve dhe në nivel të shoqërisë është ballafaqimi i viktimave me ofenduesit e tyre. Qasja e tretë është ajo tradicionale, e cila konsiston në arritjen e pajtimit përmes mekanizmave tradicionalë, të cilët ekzistojnë brenda shoqërive dhe që u kanë shërbyer atyre që të zgjidhin konfliktet me shekuj. Kjo lloj drejtësie promovon mekanizmat indigjenë për të arritur pajtimin në nivel ndërpersonal dhe grupor. Një ndër argumentet që i japin legjitimitet kësaj qasjeje është dalja nga brendësia e shoqërisë në raport me qasjet e imponuara nga lart, të cilat jo gjithmonë përputhen me kulturat lokale.

2.1. Drejtësia retributive

Drejtësia retributive është qasje ligjore, e cila e mbron idenë se nuk mund të ketë paqe të qëndrueshme afatgjate pa i gjykuar krimet e së kaluarës dhe se çdo tranzicion demokratik duhet të shoqërohet me mekanizma gjyqësorë, të cilët duhet t'i dënojnë personat përgjegjës për krimet e kryera gjatë regjimeve paraprake. Kjo qasje promovon transformimin politik të shoqërive në tranzicion përmes ligjit. Kjo qasje konsideron se shteti ligjor është baza e funksionimit të shoqërisë. Në kontekstin e drejtësisë tranzicionale, ku konfliktet gjenerojnë

69 Buckley-Zistel, Koloma Beck, Braun, Mieth, *Transitional Justice Theories*, fq. 20.

numër të madh të krimeve, roli i ndëshkimit është që t'u japë fund praktikave të përhapura të mosndëshkimit të personave, të cilët kanë kryer shkelje masive të të drejtave të njeriut. Në nivel individual, drejtësia retributive ka për qëllim ta gjejë përgjegjësinë tek individët. Kjo, sipas Kerr-it dhe Mobekk-ut, “ka qenë shpresa e madhe e avokuesve të tribunaleve që individualizimi dhe çkolektivizimi i fajit.... do të ndihmojnë në arritjen e paqes dhe pajtimit.”⁷⁰ Ky parim ishte afirmuar në Nuremberg, ku thuhej se “krimet kryhen nga njerëzit e jo nga entitete abstrakte, dhe vetëm përmes ndëshkimit të individëve, të cilët kanë kryer krime, dispozitat e së drejtës ndërkombëtare mund të forcohen.”⁷¹ Individualizimi i përgjegjësisë ndihmon në heqjen e barrës mbi grupet brenda shtetit, anëtarët e së cilave kanë mundur të kryenin krime. Kerr dhe Mobekk konsiderojnë se dënimi i krimeve ka ndikim edhe në nivel ndërkombëtar, sepse përmes materializimit të një dënimi universal “dënimet e shqiptuara përmes ligjit të ri konfirmojnë jo vetëm ligjet që i ndalojnë krimet e kryera, por edhe vetë idenë e ligjit.”⁷² Shumë studime kanë treguar se nëse personat nuk ndëshkohen për krimet e tyre, ata kanë tendencë që në një të ardhme t'i përsërisin ato. Hitleri, duke folur për shfarosjen e hebrenjve, kishte thënë: “Kush, në fund të fundit, flet sot për asgjësimin e armenëve?”⁷³ Gjenocidi kundër armenëve kishte ndodhur 25 vjet më herët dhe kishte mbetur i pandëshkuar.

Drejtësia retributive është një ndër qasjet më të vjetra të drejtësisë, e cila e ka origjinën tek religjionet.⁷⁴ Sipas kësaj qasjeje, vepra penale është konsideruar si “mëkat” ose edhe si sëmundje, kurse ndëshkimi si një lloj shërimi, i cili mund të arrihet përmes vuajtjes së ofenduesit.⁷⁵ Qasja teologjike e konsideron ndëshkimin si një e keqe nga e cila del një e mirë, një lloj kthimi tek pafajësia dhe shërimi i ofenduesit. “Sy për sy, dhëmb për dhëmb”, që figuron në “Dhiatën e Vjetër”, e ilustron më së miri këtë.⁷⁶ Me shekullarizimin e shoqërive kjo qasje është tejkualuar dhe ideja se sanksioni e anulon dhe e shlyen krimin është tejkualuar. Asnjë krim i kryer nuk mund të shlyhet kurrë.⁷⁷ Sanksioni është analizuar nga një qasje racionaliste sipas së cilës personat konsiderojnë se diçka që një person mund të fitojë përmes kryerjes së një vepre penale mund ta humbasë në anën tjetër.⁷⁸

70 Kerr dhe Mobekk, *Peace and Justice, seeking accountability after war*, fq. 4.

71 Aktgjykimi i cituar në: C. Damgaard, (2008). *Individual Criminal Responsibility for Core International Crimes*. Berlin, Heidelberg: Springer, fq.3.

72 Kerr dhe Mobekk, *Peace and Justice, seeking accountability after war*, fq. 4.

73 Po aty, fq. 5.

74 P. Bukuluki (2011). *Negotiating Retributive and Restorative Justice in the conflict of Northern Uganda*. Zurich, LIT Verlag, fq. 43.

75 Bukuluki, *Negotiating Retributive and Restorative Justice in the conflict of Northern Uganda*, fq. 43.

76 L. K. Gaines, R. LeRoy Miller (2018). *Criminal Justice in Action*. Boston : Cengage, fq. 353.

77 E. Prairat (2003). Réflexions sur la sanction dans le champ de l'Éducation, ERES, (3) 57, ff. 31- 44, fq. 40.

78 Bukuluki, *Negotiating Retributive and Restorative Justice in the conflict of Northern Uganda*, fq. 43.

2.1.1. Etika penale dhe ndëshkimi

Për ta kuptuar drejtësinë retributive në kontekstin e drejtësisë tranzicionale, duhet ta analizojmë rolin e sanksionit në filozofinë perëndimore. Ndëshkimi i krimit është temë e vjetër me të cilën janë marrë shumë filozofë, të cilët e kanë mbrojtur parimin e sanksionit si të pashmangshëm. Platoni, në veprën e tij *Gorgias*⁷⁹, thotë se është më mirë të vuash padrejtësi sesa ta bësh atë, dhe se dënimi është gjithmonë i preferuar në raport me mosndëshkimin, sepse e çliron shpirtin nga ligësia, e cila e sulmon atë. Kjo qasje ndëshkuese e krimit konsideron se faji është një e keqe, se gjithmonë është e mundur të gesh një ndëshkim, i cili është ekuivalent me fajin. Dënimi nuk është vetëm ekuivalent me fajin, ai është identik me të. Juristi dhe filozofi Michel Van de Kerchove bën një diferencë ndërmjet qasjes moraliste dhe asaj instrumentiste të drejtësisë si koncepte diametralisht të kundërta të etikës penale.⁸⁰

Qasja moraliste e etikës penale

Kjo qasje është e bazuar në parimin se “kryerja e veprës penale (e konsideruar në vetvete si një vepër jomorale si nga pikëpamja subjektive ashtu edhe objektive), përbën kushtin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për të justifikuar dënimin dhe natyra e serioziteti i veprës penale përbëjnë kriteret e vetme që duhet të justifikojnë natyrën dhe intensitetin e dënimit.”⁸¹ Sipas kësaj qasjeje, “asnjë argument i bazuar në pasojat që vijnë nga përcaktimi i dënimit nuk mund të përdoren për këtë efekt.”⁸² Kështu, një person mund të ndëshkohet vetëm për shkak se është shkelur ligji dhe ky ndëshkim duhet të bazohet vetëm në veprën e kryer, e cila është e vetmja gjë që e legjitimon të drejtën për të ndëshkuar. Sipas kësaj qasjeje, serioziteti dhe natyra e veprës e përcaktojnë shkallën e dënimit. Kjo qasje moraliste e etikës penale gjendet në shprehjen paradigmatiche në filozofinë kantiane të dënimit se “ndëshkimi ligjor nuk mund të konsiderohet kurrë thjesht si një mjet për të arritur një të mirë tjetër, qoftë nga krimineli ose për shoqërinë civile, por vetëm t’i jepet atij, për të vetmen arsye që ai ka kryer një krim.”⁸³ Për Kantin, “ndëshkimi mund të vlerësohet vetëm nga aspekti

79 Prairat, *Réflexions sur la sanction dans le champ de l'Éducation*, fq. 40.

80 M. Van De Kerchove (1997). *Éthique pénale*. In *Dictionnaire d'éthique et de philosophie morale* (nën drejtimin e M. Canto-Sperber). Paris : PUF, fq. 1108-1114, Cituar ne : Prairat, *Réflexions sur la sanction dans le champ de l'Éducation*.

81 Prairat, *Réflexions sur la sanction dans le champ de l'Éducation*, fq. 42.

82 Po aty.

83 E. Kant (1988). *Métaphysique des mœurs, doctrine du droit*, Paris : Librairie Vrin.

i drejtësisë, domethënë, në bazë të një argumenti të kualifikuar si “moral” (*quia peccatum est*) dhe jo në bazë të dobisë ose efikasitetit, d.m.th., në bazë të një argumenti të konsideruar “thjesht pragmatik” (*ne peccatur*).⁸⁴ Për sa i përket natyrës dhe intensitetit të sanksionit, Kanti mbështetet në Ligjin e Talionit pikërisht për shkak se ky ligj nuk bazohet në asnjë konsideratë të jashtme. “Vetëm Ligji i Talionit [...] mund të sigurojë me saktësi natyrën dhe shkallën e dënimit.”⁸⁵ Qasja kantiane refuzon që ofenduesi të mund të konsiderohet si mjet për të arritur qëllime të tjera. Ndëshkimi, sipas filozofisë së tij, nuk duhet të ketë për qëllim ta ndryshojë fajtorin, sepse kjo, sipas tij, do të përbënte shkelje të parimeve të larta të drejtësisë. Ndëshkimi duhet të jetë në parim. Sipas kësaj qasjeje, çdo veprimi të dhunshëm duhet t’i përgjigjemi me ndëshkimin e personit, i cili ka kryer shkeljen, dhe ai person ta vuajë dënimin. Personi, i cili ka kryer veprën penale, dënohet për shkelje të ligjit e jo personi që është dëmtuar.⁸⁶ Përkufizimi i veprës penale dhe reagimi shoqëror ndaj tij bazohen në ligj dhe kjo është arsyeja pse kjo drejtësi quhet ligjore.⁸⁷ Konflikti ekziston ndërmjet individit dhe shtetit e jo ndërmjet vetë individëve.

Qasja instrumentaliste (utilitariste) e etikës penale

Ndryshe nga qasja moraliste, ajo instrumentaliste ose utilitariste konsideron se dënimi që i jepet një keqbërësi duhet të justifikohet ekskluzivisht në funksion të interesit dhe dobisë për shoqërinë. Dënimi nuk mund të jetë qëllim në vetvete, por mjet për të arritur qëllime tjera. Për personat që kanë kryer krime dënimi mund t’u shërbejë si rehabilitim, kurse për kolektivitetin dënimi i keqbërësit i kontribuon parandalimit të krimeve të tjera. Përmes parandalimit të keqbërësve që të përsërisin veprën e tyre, ai i kontribuon parandalimit specifik. Përmes rolit parandalues tek shoqëria, ai i kontribuon parandalimit të përgjithshëm. Sipas kësaj qasjeje, nëse sanksioni nuk është i dobishëm ai duhet të pezullohet. Kjo qasje shkon në kundërshtim me qasjen moraliste të ndëshkimit, e cila përjashton çdo qëllim shoqëror nga sanksioni. Shkaku i dënimit të personit përgjegjës është prishja e ekuilibrit shoqëror, të cilin e ka shkaktuar kryerja e një vepre dhe ky ekuilibër mund të restaurohet vetëm nëse autori i krimit ndëshkohet.⁸⁸ Krimi, sipas qasjes instrumentaliste të drejtësisë,

84 Po aty.

85 Kant, *Métaphysique des mœurs, doctrine du droit*.

86 S. Buckley Zistel (2018). Transitional Justice. In, C. Brown, R. Eckersley (Eds.) *The Oxford Handbook of International Political Theory*. Oxford: Oxford University Press, fq. 156.

87 Po aty.

88 Prairat, *Réflexions sur la sanction dans le champ de l'Éducation*, fq. 44.

është transgresion i shtetit dhe ligjeve të tij për të cilat dënimi është përgjigje e duhur dhe e nevojshme, kurse nevojat e viktimave dhe të komunitetit më të gjerë plotësohen me përmbushjen e *just deserts* të ofenduesve.⁸⁹ Qasja është instrumentaliste sepse vuajtja ose ajo që ofenduesit e humbin është ajo që u kthehet viktimave dhe shoqërisë si kompensim. Kështu sanksioni nuk është një qëllim në vetvete por një mjet, përdorimi i të cilit është i ligjshëm vetëm sepse synon dobinë. Gjithashtu, mbrojtësit e kësaj qasjeje konsiderojnë se rrethanat dhe personaliteti i keqbërësit janë kritere pertinente për përcaktimin e një sanksioni.

Drejtësia tranzicionale retributive: moraliste apo instrumentaliste?

Nëse i shpjegojmë këto dy qasje në kontekstin e drejtësisë retributive tranzicionale është vështirë të supozohet se me dënimin e kriminelëve të luftës përjashtohet çdo utilitet i dënimin. Drejtësia retributive tranzicionale nuk është as krejtësisht moraliste dhe as krejtësisht instrumentaliste. Ajo i kombinon këto dy qasje. Dënimi i një personi për krime lufte ose krime të tjera të kryera gjatë konfliktit është instrumentalist. Ndëshkimi nuk mund të konsiderohet të jetë vetëm retributiv, sepse ai ka edhe rol social dhe politik si mjet i cili duhet t'i shërbejë komunitetit, viktimës, si dhe vetë ofenduesit, që përmes ndëshkimit kërkohet të përgjegjësohet. Roli i tribunaleve, të cilat kanë për detyrë dënimin e personave përgjegjës për krime lufte, është përtej dënimin të thjeshtë të personit përgjegjës. Proceseve gjyqësore u atribuohen qëllime, të cilat i tejkalojnë kapacitetet e tyre. Kora Andrieu konsideron se pritshmëritë nga këto procese janë të larta, si: “rikthimi i miteve nacionale, rikrijimi i një komuniteti politik, shërimi i viktimave, pajtimi i shoqërisë, shkrimi i historisë dhe prezervimi i kujtesës së të kaluarës.”⁹⁰ Ajo konsideron se drejtësia retributive luan rolin edhe “të rindërtimit të universit moral të shoqërive të rrënuara nga konflikti, si dhe u mundëson njerëzve të unifikohen përreth dënimin të krimineleve të luftës dhe gjithashtu kontribuon në rindërtimin e solidaritetit shoqëror.”⁹¹ Edhe Fichtelberg konsideron se synimet e drejtësisë retributive të zakonshme në kuadër të drejtësisë ndërkombëtare “janë vetëm një pjesë e një grupi synimesh më të gjera dhe shumë më amorfë [...] gjykatat ndërkombëtare pritet të ndihmojnë në vendosjen e paqes, rendit dhe sundimit të ligjit në disa nga pjesët më të trazuara të botës dhe të ndihmojnë në krijimin e një konteksti shoqëror

89 Po aty.

90 K. Andrieu (2015). *Juger, réconcilier, réparer: la justice transitionnelle pour sortir de la violence?*

91 Po aty.

për një të ardhme më të drejtë, më të qëndrueshme dhe më të begatshme.⁹² Këto qëllime janë edhe më të rëndësishme nëse konsiderojmë se shoqëritë në të cilat vendosen masa ndëshkuese retributive nuk janë shoqëri ku më parë ka pasur shtet ligjor të konsoliduar. Mungesa e shtetit ligjor krijon zakonisht më shumë pasiguri kur ajo kombinohet me trazira dhe kjo bën që drejtësia, e cila ndahet përmes tribunaleve penale ndërkombëtare ose hibride, ka për qëllim t'u shërbejë qëllimeve më të gjëra shoqërore.⁹³

2.1.2. Funksionet e ndëshkimit

Edhe pse në paragrafët paraprakë janë analizuar disa nga funksionet e ndëshkimit, për ta kuptuar drejtësinë retributive është me rëndësi të fokusohemi më gjerësisht tek funksionet e kësaj drejtësie në shoqëritë demokratike për të kuptuar më mirë rolin e ndëshkimit në kuadër të kontekstit të tranzicionit. Ndëshkimi plotëson disa funksione drejt shoqërisë, viktimave dhe ofenduesve. Ai u referohet zakonisht katër funksioneve bazë të sanksionit penal, që janë: ndëshkimi, parandalimi, paaftësimi dhe rehabilitimi. Le t'i analizojmë secilin nga këto funksione suksesivisht.

Ndëshkimi

Ndëshkimi është princip, i cili konsideron se të gjithë ata të cilët kanë kryer veprë penale duhet të ndëshkohen. Çdo person, i cili ka kryer veprë penale “e meriton” ndëshkimin për veprën e kryer nëse e ka kryer këtë veprë me vetëdije.⁹⁴ Vuajtja e dënimit i imponohet atij nga autoriteti si sanksion për dëmin që ia ka shkaktuar shoqërisë përmes mosrespektimit të rregullave, të cilat rregullojnë funksionimin e saj. Ndëshkimi është i bazuar mbi parimin *just deserts*, sipas të cilit duhet të këtë përputhshmëri ndërmjet shkallës së krimit dhe të ndëshkimit. Për marrjen e dënimit “të merituar” duhet të bazohemi në të keqen, e cila gjendet në veprën e kryer, së cilës duhet t'i përgjigjet me një të keqe ekuivalente, që është dënimi.⁹⁵ Megjithatë, duhet të diferencojmë ndëshkimin e ofenduesit përmes hakmarrjes,

92 A. Fichtelberg (2017). “Transitional justice and the end of impunity: Hybrid Tribunals.” In, In Lawther, Moffett, dhe Jacobs, *Research Handbook of Trnsitional Justice*, fq. 328.

93 Po aty.

94 Gaines dhe LeRoy Miller, *Criminal Justice in Action*, fq. 353.

95 Po aty.

e cila gjithashtu i takon kategorisë së ndëshkimeve, por për dallim nga ndëshkimi përmes gjykatave ajo hyn në kategorinë e ndëshkimeve, të cilat nuk kanë të bëjnë me shkeljen e ligjit. Ajo implikon që keqbërësi ndëshkohet vetëm me qëllim që të arrihet satisfaksion për viktimën apo viktimat, përdërisa retribucioni ka të bëjë më shumë me nevojat e shoqërisë si tërësi.⁹⁶ Kështu, ndëshkimi përmes hakmarrjes është i drejtuar kundër personit i cili e ka kryer veprën penale, që është në kundërshtim me ndëshkimin ligjor, i cili e ndëshkon veprën penale dhe shkeljen e ligjit. Drejtësia retributive bazohet mbi parimin se “hakmarrja duhet dhe mund të përmbahet, se ndëshkimi ligjor mund të bazohet në arsye, se procesi i rregullt ligjor mund të disiplinojë pasionin [...]”⁹⁷ Në raport me hakmarrjen, drejtësia retributive daton nga koha e krijimit të shtetit modern dhe kontrata sociale, ku ligjet e natyrës konvertohen në ato të shoqërisë civile dhe shteti mban monopolin e ndëshkimit. Kjo bëhet me pajtim të individëve, të cilët heqin dorë nga e drejta e tyre natyrore që të hakmerren.⁹⁸ Sarat thotë se [një] njeri “natyror” hakmarrës i drejtohet shtetit si një instancë e apelimit për padrejtësitë e natyrës dhe për ekzeset e hakmarrjes së tij.⁹⁹ Retribucioni ndryshon nga hakmarrja për nga virtytet e tij të ndëshkimit proporcional, virtyti i cili është në kundërshtim të plotë me hakmarrjen. Kjo e fundit në raport me ligjin konsiderohet si “zëri i tjetrit, primitivit, thirrja e egër e mungesës së arsyes, një “egërsi” brenda shtëpisë së ligjit, e cila, nga natyra, nuk u nënshtrohet formave racionale të drejtësisë.”¹⁰⁰ Hakmarrja duhet të mbahet larg, sipas këtij parimi, sepse përfaqëson një koncesion të pajustificuar ndaj një zemërimi dhe pasioni që nuk njihet kufij.¹⁰¹ Sara Jacoby thotë se “një shoqëri, e cila nuk është në gjendje t’i bindë njerëzit për aftësitë e saj për të ndëshkuar krimet proporcionalisht, ajo është shoqëri e cila është në rrezik konstant që anëtarët e saj të përdorin forma të ashpra (primitive) të drejtësisë.”¹⁰² Megjithatë, edhe përtej virtyteve të ndëshkimit proporcional, ky parim nuk është gjithmonë i lehtë të përcaktohet. Vrasjeve me premeditim deri në njëfarë mënyre do të mund t’u përgjigjej me një dënim ekuivalent, që është dënimi me vdekje për autorin, edhe pse një numër i vogël i shteteve sot e zbatojnë këtë lloj ndëshkimi. Kjo bëhet edhe më problematike kur është fjala për shkallën e dënimit të kriminelëve të luftës, të cilët kanë vrarë me qindra ose mijëra njerëz. Dënimi proporcional në këto situata

96 Po aty.

97 A. Sarat (2002). When Memory Speaks: Remembrance and Revenge in Unforgiven. *Indiana Law Journal* 77 (307), cituar në M. Minow (2009). *Breaking the Cycles of Hatred, memory, law and repair*. Princeton: Princeton University Press, fq. 237.

98 Minow, *Breaking the Cycles of Hatred, memory, law and repair*, fq. 238.

99 Po aty, 237-238

100 Po aty.

101 Po aty.

102 S. Jacoby (1983). *Wild Justice: The Evolution of Revenge*. New York: Harper dhe Row. Cituar në, Minow, *Breaking the Cycles of Hatred, memory*, fq. 256.

është i pakuptimtë. Filozofja Hannah Arendt thotë se dënimi me vdekje i liderit nazist Goring në Nuremberg ka qenë i nevojshëm, por krejtësisht joadekuat. Ajo konsideron se nganjëherë tragjedia mund të jetë aq e madhe, saqë dënimi i një individi as nuk i afrohet ndëshkimit proporcional.¹⁰³

Parandalimi

Një ndër funksionet më të rëndësishme të ndëshkimit është parandalimi i krimit. Parandalimi përmbush funksionin e frenimit të krimit në të ardhmen dhe është kështu i orientuar kryesisht përpara (parandalimi i një së keqeje në të ardhmen). Një ndër virtytet e parandalimit është ai i frikësimit. Në krahasim me ndëshkimin, qëllimi i të cilit është dënimi i keqbërësit, parandalimi ka për funksion që ndëshkimi të jetë mesazh, i cili u dërgohet keqbërësve se nëse kryejnë krime ata do të ndëshkohen. Funksioni i parandalimit është i bazuar tek teoria utilitariste e filozofit britanik të shekullit 19, Jeremy Bentham, sipas së cilit ndëshkimi është joefikas dhe nuk ndihmon në reduktimin e krimeve. Utilitarizmi konsideron se ndëshkimi duhet të jetë në përputhje me interesin e tij për komunitetin duke i dhënë kuptim ndëshkimit vetëm në raport me parandalimin dhe frenimin e krimit. Teoria utilitariste e sanksionit mbron idenë se ndëshkimi ka vlerë vetëm për aq sa ai arrin t'i parandalojë ose t'i reduktojë shkeljet e reja, pra të jetë një lloj shembulli për të tjerët. Kjo qasje është e ndryshme me atë ndëshkuese, e cila justifikimin e saj e gjen në vetë aktin e ndëshkimit.¹⁰⁴

Ashtu siç është shpjeguar më lart, parandalimi mund të ketë për shënjestër ose individin, ose shoqërinë. Kur ai ka për qëllim individin, atëherë kemi të bëjmë me parandalim specifik, i cili supozon se nëse një person që kryen krim ndëshkohet, kjo do të ketë për efekt që ai mos ta përsërisë më këtë vepër, sepse nuk dëshiron që të dënohet përsëri.¹⁰⁵ Parandalimi i përgjithshëm ka qëllim të njëjtë, por për dallim nga ai specifik, ky qëllim është i ngritur në nivel të shoqërisë. Nëse kryerja e krimeve ndëshkohet dhe se çdo anëtar i cili do të kryente një krim do të ndëshkohej, atëherë ndikimi do të ishte në nivel të shoqërisë. Ky është rasti, për shembull, kur dënohen trafikantët e drogës, dënimi i të cilëve dërgon mesazh tek shoqëria se trafiket e drogës janë të dënueshme me ligj.¹⁰⁶ Kjo

103 J.A. Frowein dhe R. Wolfrum (2002). *Max Plank Yearbook of United Nations Law*, 6, 1-35, fq. 2

104 Shih: D. Carter, "deterrence", In, A. S. Burke, D. Carter, B. Fedorek, T. Morey, L. Rutz-Burri, dhe S. Sanchez, *Introduction to the American Criminal Justice System*. Libri është i qasshëm në: <https://openoregon.pressbooks.pub/ccj230/chapter/8-3-deterrence/>

105 P. Bukuluki, *Negotiating Retributive and Restorative Justice in the conflict of Northern Uganda*, fq. 43.

106 Gaines dhe LeRoy Miller, *Criminal Justice in Action*, fq. 256.

qasje utilitariste supozon se keqbërësit i kalkulojnë veprimet e tyre në mënyrë racionale duke peshuar përfitimin dhe koston nga një akt keqbërës.¹⁰⁷

Kjo qasje i ka edhe defektet e saj për shkak se të rinjtë, për shembull, jo gjithmonë veprojnë sipas logjikës racionale të koston dhe përfitimit. Gjithashtu, kjo qasje nuk e merr parasysh as numrin e lartë të personave, të cilët kryejnë krime, por që nuk arrestohen dhe nuk dënohen kurrë, ose edhe atyre që edhe kur sillen para ligjit nuk mund të gjykohen për shkak të mungesës së provave. Kur bëhet fjalë për krimet e kryera nga palët antagonistë gjatë luftërave, atëherë numri i personave të pandëshkuar është edhe më i madh. Kjo është edhe një nga vërejtjet që u adresohet gjykatave ndërkombëtare penale se ato nuk kanë kapacitete të gjykojnë shumë persona (shih kapitullin për gjykatat). Sipas Stahn-it, parandalimi varet nga dy faktorë kryesorë, që janë: sa janë gjasat që një person të ndëshkohet dhe nga ashpërsia e dënimit. Dhe sipas saj, këta dy faktorë janë më problematikët kur bëhet fjalë për drejtësinë penale ndërkombëtare. Kjo drejtësi është tepër selektive dhe numri i personave është gjithmonë tepër i vogël, por edhe ndëshkimi në raport me krimet e kryera është disproporcional.¹⁰⁸ Se sa janë tribunalet penale ndërkombëtare parandaluese të krimit është e diskutueshme. Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi ka dështuar në parandalimin e gjenocidit të Srebrenicës, në vitin 1995.

Paaftësimi

Paaftësimi si sanksion ka për qëllim ndarjen e personave, të cilët kanë kryer krime nga pjesa tjetër e shoqërisë.¹⁰⁹ Forma më e vjetër është përmes burgimit. Qëllimi është që shoqëria të jetë e siguar nga rreziku që do të mund të paraqisnin personat e rrezikshëm që kanë kryer krime dhe që do të mund t'i përsëriteshin ato po qe se do të jetonin me të tjerët. Së paku, shoqëria mund të konsiderohet e sigurt nga këta persona për aq kohë sa ata janë të paaftësuar. Kjo qasje ka ndikuar që numri i popullsisë karcerale të shkojë duke u rritur në mënyrë konstante gjatë dekadave të fundit. Megjithatë, kjo qasje i ka disa mangësi të cilat e reduktojnë rolin e saj. Ndër ato që duhet përmendur është vështirësia e përcaktimit të proporcionalitetit sa i përket ndëshkimit në raport me krimin. Ndëshkimi me burgim të gjatë për disa krime, siç janë trafiket e drogës, e bën të mundur paaftësimin afatgjatë të trafikantëve, por a mund të justifikohet një dënim i tillë? Paaftësimi përmes dënimit dhe

107 Po aty.

108 C. Stahn (2019). *A critical introduction to international criminal law*. Oxford, Oxford University Press, fq. 175.

109 Gaines dhe LeRoy Miller, *Criminal Justice in Action*, fq. 256.

burgosjes së personave që kanë kryer krime gjatë konflikteve të armatosura është objektiv i tribunaleve ndërkombëtare penale me qëllim që personat, të cilët kanë kryer krime, të mos mund të jetojnë me viktimat e tyre, por edhe në këtë kontekst numri i personave të dënuar është shumë i vogël në raport me numrin e personave të cilët kanë marrë pjesë në krime dhe që në çdo shoqëri paskonfliktuale vazhdojnë të bashkëjetojnë me viktimat e tyre edhe pas përfundimit të konflikteve.

Sa i përket paaftësisimit, tribunalet ndërkombëtare penale kanë treguar efikasitet përmes delegjitimitimit të ish-liderëve të regjimeve paraprake, ose përmes aktakuzave të shpallura kundër tyre, ose përmes dënimit të tyre. Rast ilustrues është ai i dy shefave të serbëve të Bosnjës, Radovan Karadžić dhe Ratko Mladić, të cilët për shkak të aktakuzës së shpallur kundër tyre nga TNPJ-ja, në korrik 1995, nuk kanë mundur të marrin pjesë në negociatat e Dejtonit. As Milošević-i në vitin 1999 nuk ka mundur të marrë pjesë në nënshkrimin e Marrëveshjes së Kumanovës, e cila i ka dhënë fund luftës në Kosovë për shkak se një muaj më herët ishte shpallur aktakuza kundër tij nga TNPJ-ja. Megjithatë, në Serbi, aktakuza e lartpërmendur nuk e ka penguar atë të jetë kandidat në zgjedhje për president në vitin 2000. Disa liderë afrikanë kanë vazhduar ta ushtrojnë detyrën e tyre edhe përtej aktakuzave të shpallura kundër tyre nga GJNP-ja. I tillë ka qenë rasti i ish-presidentit të Sudanit, Al-Bachir, i cili ka qëndruar në pushtet deri në vitin 2019, edhe pse GJNP-ja kishte shpallur aktakuzë kundër tij për gjenocid në vitin 2007.¹¹⁰

Rehabilitimi

Në një analizë të rolit të rehabilitimit në sistemin gjyqësor ordinar, Gaines dhe Miller e krahasojnë sistemin e gjykatave me “sistemin e shëndetësisë”, ku keqbërësit janë pacientët, kurse gjykatat luajnë rolin e mjekëve. Këta të fundit i trajtojnë pacientët e tyre për t’i shëruar.¹¹¹ Keqbërësit konsiderohen si të sëmurë,, por jo të këqij, duke e bërë trajtimin e tyre moralisht të pranueshëm. Trajtimi i këtyre pacientëve, sipas tyre ndryshon nga rasti në rast dhe për disa prej tyre burgosja është e pashmangshme, por për të tjerët është e preferuar të rehabilitohen dhe të kthehen në shoqëri. Kjo, sipas tyre, është e mirë edhe për qytetarët e një shteti, të cilët në rast të lirimit të tyre nuk kanë nevojë të paguajnë për gjykimin dhe burgosjen e tyre, të cilët financohen nga taksat e tyre.¹¹²

110 Stahn, *A critical introduction to international criminal law*, fq. 176.

111 Gaines dhe LeRoy Miller, *Criminal Justice in Action*, fq. 256.

112 Po aty.

Rehabilitimi ka të bëjë me të tashmen (konsiderimi i një të keqeje aktuale) dhe një ndër qëllimet e tij është rehabilitimi i keqbërësit, i cili konsiderohet si qëllimi më “human” i ndëshkimit. Kjo qasje konsideron se keqbërja është “fenomen social”, e cila nuk është e shkaktuar nga natyra kriminale e ofenduesit, por më shumë nga faktorët të cilët dalin nga mjedisi i dhunshëm ku ai jeton. Me fjalë të tjera, keqbërësit janë më shumë produkt i mjedisit ku jetojnë dhe për këtë arsye largimi i tyre nga ky mjedis u mundëson atyre të “shërohen” ose të “trajtohen”. Kjo qasje konsideron se varësisht se çfarë politike ndjek shteti dhe se sa është i ashpër ndaj krimit, është përcaktuese e politikave rehabilituese.

Drejtësia retributive konsideron se dënimi doemos ka një efekt rehabilitues tek keqbërësi, i cili përmes dënimit kupton veprën e tij dhe ndërgjegjësohet për atë që ka bërë duke ia hapur rrugën kthimit të tij në shoqëri. Sanksioni kështu ka një rol socio-pedagogjik, i cili shpreh rëndësinë e vlerave të shoqërisë dhe përmes dënimit të keqbërësve u jep të drejtë atyre që i respektojnë rregullat. Mbështetësit e kësaj qasjeje potencojnë paanshmërinë e saj, dimensionin e saj parandalues, faktin se ajo i kontribuon kthimit të paqes dhe e lehtëson procesin e pajtimit, duke u nisur nga një bazë e qëndrueshme, e shëndoshë, që është dënimi penal, dhe në këtë mënyrë kontribuon në ndërtimin e shteti ligjor dhe demokratizimit të shoqërive.

Megjithatë, kjo qasje i ka edhe mangësitë e saj. Edhe përtej parimit të saj se çdo person, i cili ka kryer krime, duhet të japë përgjegjësi për aktet e veta dhe kështu të ndërgjegjësohet, ai pas kryerjes së veprave të tij luan rol pasiv, sepse në procese gjyqësore janë të tjerët (profesionistët e drejtësisë) ata të cilët e ndajnë drejtësinë. Njëjtë është edhe për viktimat. Howard Zehr konsideron se kjo është arsyeja pse kjo lloj drejtësie nuk i merr parasysh më së miri vuajtjet e viktimave të krimeve, sepse ato mbesin jashtë procesit. Ndëshkimi, sipas tij, ka për qëllim që autorët e krimeve të dekurajohen nga marrja e përgjegjësisë për veprat e tyre dhe dërgimi i tyre në burg ka për efekt t’i mësojë ata me aftësi të reja të mbijetesës në mjedisin dehumanizues të një burgu.¹¹³ Sipas tij, korrektësia e një procesi gjyqësor vlerësohet në bazë të respektimit të procedurave juridike më shumë sesa në funksion të përputhshmërisë së tij me pritshmëritë e të akuzuarit ose viktimave.¹¹⁴ Tjetër kritikë, e cila i adresohet qasjes retributive, është ajo e numrit tepër të vogël të personave të gjykuar në raport me numrin e përgjithshëm të personave, të cilët kanë marrë pjesë në organizimin dhe kryerjen e krimeve. Në shtete të cilat dalin nga lufta ose nga diktaturat ka një numër tepër të madh të personave, të cilët kanë kryer krime ose që kanë ndihmuar në kryerjen

113 Howard Zehr (1990), ‘A Restorative Lens’, in *Changing Lenses: A New Focus for Crime and Justice*. Waterloo, Ontario: Herald Press, ff. 177-214.

114 Po aty.

e tyre, dhe ka po ashtu një numër të madh edhe të viktimave në raport me kapacitetin e sistemit gjyqësor. Tjetër problem kur bëhet fjalë për sistemet retributive vendore është se ky sistem nuk ka pavarësi dhe nuk është efektiv. Më pas duhet cekur edhe shkatërrimin e provave të krimeve, ankthin, të cilin e kanë dëshmitarët nga kërcënimet dhe frikësimet etj. Në disa shtete, ndëshkimi pamundësohet nga parashkrimi i krimeve ose pengesat e tjera që kanë të bëjnë me ligjet e amnistisë të negociuara më herët ndërmjet palëve etj. Gjykimet paraqesin edhe problemin e financimit të tyre. Këto procese marrin shumë kohë dhe kostoja financiare e tyre është shumë e lartë. Kjo mungesë fondesh shoqërohet edhe me mungesë vullneti të qeverive pas tranicionit, që të ballafaqohen me të kaluarën për shkak të frikës nga destabilizimi.¹¹⁵

2.2. Drejtësia rindërtuese

Ashtu sikur drejtësia retributive, edhe drejtësia rindërtuese e ka origjinën tek ligjet e vjetra fetare, si dhe tek vetë drejtësia retributive, e cila për një kohë të gjatë nuk e ka konsideruar krimin si shkelje të ligjit, por ka qenë e fokusuar tek viktimat dhe familjet e tyre.¹¹⁶ Drejtësia rindërtuese është një alternativë ndaj drejtësisë retributive. Mbrojtësit e kësaj qasjeje konsiderojnë se ajo është më e përshtatshme dhe i përgjigjet më mirë ballafaqimit të shoqërive me të kaluarën e tyre dhe parandalimit të krimit, duke e bërë të mundshëm zgjedhjen e konflikteve brenda shoqërisë pa kaluar përmes gjykatave. Kjo qasje e drejtësisë e konsideron krimin si vepër penale të kryer kundër një personi e jo kundër ligjit dhe si e tillë shkon në kundërshtim me mjedisin e formalizuar të gjykatave. Preokupim i kësaj qasjeje nuk është shkelja e ligjit, por dëmet e shkaktuara nga veprimet kriminale dhe pasojat negative të këtyre veprave tek individët. Kjo lloj drejtësie karakterizohet edhe me kompensim që përcaktohet përmes një procesi të negociimit, i cili implikon jo vetëm ofenduesin dhe viktimën, por edhe familjet e viktimës dhe rrethin më të gjerë të saj, të cilët janë ofenduar nga vepra kriminale. Si pasojë, për shkeljet e kryera ofenduesi duhet të marrë përgjegjësinë e vet për krimet e kryera duke kërkuar falje e duke ofruar një lloj kompensimi për dëmin e shkaktuar. Viktimat, në anën tjetër, duhet të ballafaqohen me

115 M. Freeman dhe I. Orozko (2002). *Negotiating Transitional Justice: A Conceptual Framework*. Cambridge: Cambridge University Press, fq.4.

116 D. W. Van Ness dhe K. Heetderks Strong (2010). *Restoring Justice: An Introduction to Restorative Justice*. Providence: LexisNexis, fq.6.

ofenduesit e tyre, të dëshmojnë për vuajtjet e tyre përmes përshkrimit të dhunës që kanë përjetuar, se si ka ndikuar kjo dhunë në jetën e tyre dhe të negociojnë për masat riparuese të mundshme.¹¹⁷ Andrieu konsideron se riparimi i dëmit nuk mund të limitohet vetëm në kompensimin e viktimave, sepse “ai përfshin dëmin material, psikologjik dhe format e tjera të vuajtjes të shkaktuara ndaj viktimave dhe ndaj rrethit të tyre, por edhe çrregullimin dhe indinjatën në komunitet, pasigurinë sa i përket rregullit ligjor dhe kapacitetet e autoriteteve për të garantuar siguri publike.”¹¹⁸ Kështu, drejtësia rindërtuese shkon përtej viktimave të drejtpërdrejta dhe prek komunitetin më të gjerë, duke përfshirë edhe atë të ofenduesve.¹¹⁹

Kjo qasje inkluzive në raport me ofenduesit ka për qëllim që mos t’i përjashtojë ata, por t’i rehabilitojë duke u mundësuar që ta kthejnë dinjitetin e humbur njerëzor, gjithnjë duke tentuar që ta shërojnë efektin dehumanizues, të cilin krimi e ka shkaktuar tek viktimat.¹²⁰ Kjo qasje shkon në kundërshtim me hakmarrjen, e cila e ngre zemërimin dhe ndjenjën e viktimizimit dhe synon t’i ndihmojë viktimat që të shkojnë përtej zemërimit e ndjenjës së pafuqisë.¹²¹ Drejtësia rindërtuese potencon kështu “edhe humanizmin e ofenduesve edhe atë të viktimave.”¹²² Proceset riparuese janë kështu në rend të parë procese që kanë për qëllim rikthimin e mirëqenies fizike, psikologjike, sociale dhe ekonomike të individëve të dëmtuar, më shumë sesa procese që kanë për objektiv ndëshkimin e keqbërësve. Rehabilitimi, dëmshpërblimi dhe kompensimi janë elemente që në nivel të shoqërisë i kontribuojnë paqes, llogaridhënies, stabilitetit dhe pajtimit.¹²³ Një ndër premisat bazë të drejtësisë rindërtuese është riparimi i dëmit të shkaktuar nga ofenduesi.¹²⁴ Por ky riparim, i cili mund të jetë material ose simbolik, shkon përtej rolit të tij primar dhe synon që viktimave t’ua kthejë ndjenjën e kontrollit mbi jetën e tyre dhe të inkurajojë rivendosjen e raporteve “midis atyre që janë keqbërës, atyre që kanë pësuar dëm dhe anëtarëve të komunitetit.”¹²⁵

Si koncept, drejtësia rindërtuese është konstruktiviste, sepse ka për qëllim që përmes përafrimit të viktimave dhe ofenduesve të ndihmojë në tejkalimin e armiqësisë dhe kështu

117 Bukuluki, *Negotiating Retributive and Restorative Justice in the conflict of Northern Uganda*, fq. 47.

118 Andrieu, Juger, *réconcilier, réparer: la justice transitionnelle pour sortir de la violence?* fq. 116.

119 Po aty.

120 Po aty.

121 Oduro, *Transitional Societies, Democratic Accountability and Policy Responses*, fq. 44

122 Po aty.

123 Po aty.

124 Minow, *Breaking the Cycles of Hatred, memory, law and repair*, fq. 222.

125 Po aty, fq 223.

të krijojnë një realitet të ri shoqëror.¹²⁶ Për Christine Bell dhe Catherine O'Rourke, “kjo qasje i ka bazat teorike tek filozofia habermasiane e “komunikimit etik” dhe nocionit të drejtësisë të ndërtuar përmes dialogut.”¹²⁷ Sipas kësaj teorie, “i gjithë komunikimi ndërnjerëzor ndodh me një qëllim të mirëkuptimit të ndërsjellët, dhe përmes aktit të të folurit një kuptim i tillë mund të arrihet.”¹²⁸ Kjo teori siguron një bazë për teorizimin e këtij procesi ligjor me një ambicie komunikuese dhe me një realitet të përbashkët nga i cili del një komunikim i papenguar.¹²⁹ Një definicion të ngjashëm të drejtësisë rindërtuese e gjejmë edhe tek Braithwaite, i cili thotë se drejtësia rindërtuese është “një proces ku të gjitha palët e interesuara të prekura nga një padrejtësi kanë mundësi të diskutojnë se si janë prekur nga padrejtësia dhe të vendosin se çfarë duhet të bëhet për ta riparuar dëmin [...] bisedat me ata që janë lënduar dhe me ata që kanë shkaktuar lëndimin duhet të jenë esenciale për këtë proces.”¹³⁰ Howard Zehr e definon drejtësinë rindërtuese si proces “i cili përfshin, aq sa është e mundur, ata që kanë marrë pjesë në një shkelje specifike dhe i cili me kujdes dhe në mënyrë kolektive i identifikon dhe adreson dëmet, nevojat dhe obligimet, që gjërat të adresohen në mënyrë sa më të drejtë të mundur.”¹³¹

2.3. Drejtësia tradicionale

Drejtësia tradicionale është e përafërt me drejtësinë rindërtuese dhe ka të bëjë me format e drejtësisë, të cilat ekzistojnë brenda shoqërive dhe të cilat këto shoqëri i përdorin për t'i zgjedhur konfliktet mes vete. Këto forma kanë fituar në peshë dekadave të fundit, sepse janë përdorur për t'u ndihmuar shoqërive që të ballafaqohen me të kaluarën. Rëndësia e tyre ishte potencuar që në vitin 2004 në raportin e OKB-së, i cili konsiderohet si dokument “standardizues” i drejtësisë tranzicionale dhe mekanizmave të saj.¹³² Në këtë raport thuhet: “Duhet t'u kushtohet vëmendje e duhur traditave indigjene dhe joformale të administrimit

126 Buckley Zistel, *Transitional Justice*.

127 C. Bell dhe C. O'Rourke (2007). Does Feminism Need a Theory of Transitional Justice? An Introductory Essay. *International Journal of Transitional Justice* 1 (1), 23-44. Fq. 40.; Kamp, *Restorative Justice in Transitional Settings*, fq.8.

128 Po aty.

129 Po aty.

130 J. Braithwaite (2004). Restorative Justice and De-Professionalization. *The Good Society*, 13 (1), 28-31.

131 H. Zehr (2002). *The Little Book of Restorative Justice*, fq. 37.

132 R. Nagy (2013). “Centralizing legal pluralism? Traditional justice in transitional contexts.” In C. L. Sriram, J. García-Godos, J. Herman dhe O. Martin-Ortega (Eds.). *Transitional Justice and Peacebuilding on the Ground Victims and ex-combatants*. London, Routledge (ff. 81-101), fq. 81.

të drejtësisë [...] për t'i ndihmuar ato të vazhdojnë rolin shpesh vital të tyre dhe kjo të bëhet në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe traditën lokale. Kur këto injorohen ose mbivlerësohen, rezultati mund të jetë përjashtimi i sektorëve të tërë të shoqërisë nga drejtësia e qasshme.”¹³³ Megjithatë, afirmimi i plotë i këtyre formave të drejtësisë do të bëhet vetëm mbasi që format e standardizuara të drejtësisë tranzicionale t'i tregojnë limitet e tyre. Drejtësia tranzicionale ndërkombëtare do të perceptohet në nivel lokal si e eksternalizuar, teknokratike dhe e papërputhshme me vlerat kulturore lokale. Ky perceptim i drejtësisë ndërkombëtare si një lloj “transplanti ligjor”¹³⁴ i imponuar nga jashtë do të ndikojë fuqishëm në kërkimin e solucioneve lokale për ta zëvendësuar atë të parën. Drejtësia tradicionale konsiderohet si drejtësi e decentralizuar në raport me atë ndërkombëtare, e cila është e centralizuar.¹³⁵

Duke pasur parasysh numrin e madh të këtyre formave të drejtësisë tradicionale dhe në pamundësi që t'i analizojmë të gjitha ato, ne do të kufizohemi në tri forma të saj. Dy të parat janë ato të *Gacaca* në Ruandë dhe *Mato Oput* në Ugandë, dhe e treta është ajo e *nalyeeh* në SHBA. Për dallim nga dy të parat, të cilat praktikohen në shtete të cilat kanë kaluar nëpër konflikte të armatosura, *nalyeeh* praktikohet në një shtet demokratik. Kjo do të na shërbejë ta kuptojmë rëndësinë e kësaj drejtësie në shtete demokratike.

Gacaca e përkthyer do të thotë “bar i shkurtër” dhe ajo në shoqërinë tradicionale ruandeze i referohet hapësirës publike, ku burrat e një lagjeje janë takuar për të zgjidhur konfliktet që kanë lindur brenda grupit. Keqbërësit dhe viktimat janë bashkuar dhe në prezencën e anëtarëve të familjeve të tyre dhe atyre të grupit kanë diskutuar dhe i kanë zgjidhur konfliktet mes vete. Ky ritual i pajtimit indigjen kërkon që keqbërësi të vetëdijësohet dhe ta kuptojë peshën e dëmit që ia ka shkaktuar viktimës dhe kjo mund të interpretohet si një lloj ndëshkimi në vetvete, ndëshkim i cili nuk është i ashpër, por që duhet t'i kontribuojë pajtimit. Kështu, *gacaca* mund të përjetohet si drejtësi ndëshkuese dhe rindërtuese në të njëjtën kohë.¹³⁶

Në vitin 2001 ky institucion tradicional do të integrohet në ligjin shtetëror, i cili do t'i themelojë ato që janë quajtur “Gjykatat *Gacaca*”, por të cilat nuk kanë asgjë të përbashkët me gjykatat shtetërore. Institucionalizimi i *Gacaca* nga Qeveria ruandeze e Frontit patriotik ruandez e dominuar ekskluzivisht nga etnia Tutsi, e cila kishte qenë objekti i gjenocidit në fillim të viteve 1990, me themelimin e këtyre “gjykatave” ka pasur për qëllim shkarkimin

133 <https://www.un.org/ruleoflaw/files/2004%20report.pdf>, fq. 12.

134 R. Nagy, Centralizing legal pluralism? Traditional justice in transitional contexts, fq. 81.

135 Po aty, fq. 84.

136 Buckley-Zistel, Koloma Beck, Braun, Mieth, *Transitional Justice Theories*, fq. 21.

e sistemin gjyqësor shtetëror. Ky regjim, i cili kishte ardhur në pushtet pas gjenocidit, i kishte nxjerrë para gjyqit një numër të madh të anëtarëve të etnisë Hutu, të cilët ishin dënuar me dënime shumë të larta nga gjykatat lokale. Kjo kishte provokuar pakënaqësi brenda shoqërisë dhe gjykatat *Gacaca* ishin menduar ta reduktonin presionin mbi pushtetin.¹³⁷ Përtej promovimit të tyre nga Qeveria ruandeze si “solucioni i duhur” për të arritur pajtimin, këto “gjykata” i kanë treguar limitet e tyre. Zyrtarizimi i tyre e kishte bërë më të vështirë pranimin e viktimave që të dalin para ofenduesit dhe anëtarëve tjerë të komunitetit.¹³⁸ Gjithashtu, dëshmitarët potencialë ishin kërcënuar me vdekje nëse do të pranonin të dëshmonin. Qeveria ruandeze i kishte përdorur ato si pjesë të narrativit të vet, i cili thoshte se vetëm anëtarët e etnisë Hutu kishin kryer krime, pa i përmendur krimet e kryera nga anëtarët e grupit të vet.

Mato Oput në përkthim do të thotë “të pish ujë nga pema” dhe është institucion lokal i faljes së krimit tek fisi Acholi në Veri të Ugandës.¹³⁹ Kusht për faljen e krimit ka qenë që keqbërësi të kërkonte me sinqeritet që t’i falen krimet dhe ajo ka vlejtur për çfarëdo lloji krimi, pa marrë parasysh seriozitetin e tij. Në një ceremoni të organizuar brenda grupit, viktimat dhe ofenduesit janë sjellë së bashku të pinë ujë nga një pemë lokale (*Mato Oput*). Më pas ofenduesi është dashur të shkelte mbi një vezë, që simbolizon kthimin në pafajësi dhe në vijim të kalonte një vijë, e cila ka simbolizuar pranimin nga komuniteti. Nëse pas kësaj ceremonie ndonjëri person brenda grupit do ta akuzonte personin e falur për keqbërje, personi në fjalë do të ndëshkohej për ofendim të bërë ndaj grupit.¹⁴⁰ Van Ness dhe Heetderks Strong analizojnë një numër të madh të kulturave parakoloniale në Afrikë, ku shoqëritë kanë qenë të gatshme të heqin dorë nga ndëshkimi i keqbërësve për të lehtësuar pajtimin brenda grupit. Qëllimi ka qenë që shoqëria t’i kthehej *status quo ante*. Këta autorë analizojnë raste të tilla edhe në Japoni, ku pas kryerjes së shkeljeve theksi nuk vendoset tek ndëshkimi, por tek kompensimi i viktimave dhe restaurimi i paqes brenda komunitetit. Këtij procesi këta autorë i referohen si “konfesion, pendim dhe kërkim faljeje”.¹⁴¹

Praktika të tilla kanë ekzistuar edhe tek popujt indigjenë në Amerikë, Australi dhe Zelandë të Re. Në SHBA disa nga këto praktika janë kthyer tek indianët amerikanë në

137 Andrieu, Juger, *réconcilier, réparer: la justice transitionnelle pour sortir de la violence?* fq. 114.

138 Oduro, *Transitional Societies, Democratic Accountability and Policy Responses*, fq.44.

139 Për më shumë detaje përreth këtij institucioni shih: Bukuluki, *Negotiating Retributive and Restorative Justice in the conflict of Northern Uganda*.

140 V. Esquivel-Korsiak dhe K. Lonergan (2013). *The Role of Truth-Telling in Acholi Traditional Ceremonies*, i qasshëm në: <http://justiceandreconciliation.com/?p=2212>

141 Van Ness dhe Heetderks Strong, *Restoring Justice: An Introduction to Restorative Justice*, fq. 8.

rezervatet e tyre. Tek disa nga këto komunitete ekziston institucioni i quajtur *nalyeeh*, i cili nënkupton zgjidhjen e konflikteve brenda grupit përmes dëmshtëpërblimit. Ceremonia e *nalyeeh* është një lloj parodie e sistemit gjyqësor tradicional, por në të cilin pala ofenduese dhe ajo viktimë përballen me njëra-tjetrën me ndërmjetësimin e anëtarëve të tjerë të komunitetit. Viktima ftohet që të tregojë për vuajtjet e përjetuara nga ofenduesi. Pas kësaj pjesëmarrësit vendosin për kompensimin (*nalyeeh*), të cilin ofenduesi ose familja e tij duhet t'ia paguajë komunitetit.¹⁴² Për ndryshim nga ndëshkimi i dhënë nga një gjykatë, qëllimi i kompensimit të *nalyeeh*, i cili mund të përfshijë ose jo kompensim financiar, është që pala e dëmtuar dhe komuniteti të ndihen më mirë. Këto praktika janë përdorur për të zgjidhur edhe raste kriminale nga dhuna brenda grupit deri tek aktivitetet e gangave etj. Megjithatë, rastet e krimeve të rënda u transferohen gjykatave ordinere.¹⁴³ Suksesi i këtyre praktikave ka qenë i madh dhe ato tani praktikohen edhe jashtë rezervateve të indianëve. Si rezultat, 35 shtete të SHBA-së kanë votuar legjislacionin të bazuar në parimet e drejtësisë rindërtuese. Këto ligje janë një alternativë ndaj proceseve gjyqësore shtetërore, të cilat i dënojnë keqbërësit që t'i kompensojnë drejtpërdrejt viktimat ose fondet e tyre.¹⁴⁴ Kjo praktikë e bazuar mbi komunikimin e drejtpërdrejtë ofendues-viktimë është legalizuar edhe në burgje. Dispozita ligjore janë votuar për të lehtësuar dialogun e drejtpërdrejtë viktimë-ofendues (victim-offender dialogue- VOD) dhe e gjithë kjo në një mjedis të sigurt që është burgu. VOD-ja u mundëson ofenduesve t'u flasin viktimave drejtpërdrejt për shkaqet dhe rrethanat që i kanë shtyrë të kryejnë krimin, kurse viktimat, në anën tjetër, u tregojnë atyre se si dhuna e ushtruar ndaj tyre i ka prekur jetët e tyre. Qëllimi i këtyre takimeve është që t'u mundësojë ofenduesve që t'u kërkojë falje drejtpërdrejt viktimës dhe eventualisht për viktimat që t'ua falin atyre krimin. Sot më shumë se gjysma e departamenteve të burgjeve e përkrahin VOD-në në burgjet e tyre.

Edhe pse këto praktika janë kritikuar si të paqarta, disa studime tregojnë se recidivizmi ulet dukshëm kur përdoren këta mekanizma të drejtësisë.¹⁴⁵ Këto praktika janë integruar edhe në disa shtete evropiane. Franca më 15 gusht 2014 ka votuar një ligj, i cili e bën të mundur masën e drejtësisë rindërtuese. Kushti është që ofenduesi ta pranojë veprën penale. Artikulli 8 i këtij ligji përcakton se kjo drejtësi nënkupton “çdo masë që ia mundëson një viktimë, si dhe kryerësit të një veprë penale të marrin pjesë aktive në zgjidhjen e vështirësive

142 Gaines dhe Le Roy Miller, *Criminal Justice in Action*, fq. 356.

143 Po aty.

144 Po aty, fq. 356-358.

145 Po aty.

që rezultojnë nga vepra penale, dhe në veçanti çdo dëm i çfarëdo lloji që ka rezultuar nga kryerja e kësaj vepre.”¹⁴⁶

Çdo iniciativë e drejtësisë, e cila del nga brendësia e shoqërisë është treguar më e suksesshme sesa ato që janë imponuar nga jashtë. Një ndër arsytet pse në Afrikën e Jugut mekanizmat e drejtësisë tranzicionale kanë qenë më të suksesshëm sesa në shume vende të tjera është se ato kanë dalë nga brendësia e shoqërisë dhe nuk janë imponuar nga jashtë.¹⁴⁷ Mungesa e legjitimitetit lokal ka bërë që shumica e institucioneve të drejtësisë tranzicionale, qofshin ato gjyqësore apo jo, të obligohen të zhvillojnë strategji të promovimit të punës së tyre në nivel të shteteve ku janë kryer krimet. Drejtësia tranzicionale duhet të jetë e vendosur në agjendat e shoqërive në nivel lokal për t’i dhënë fund pandëshkueshmërisë dhe mospërsëritjes së dhunës në të ardhmen.¹⁴⁸

Megjithatë, Ross dhe Sriram konsiderojnë se këta mekanizma tradicionalë kanë shumë mangësi dhe madje për një sërë arsyesh. Ndër ato ata përmendin “abuzimin me procesin, dështimin për të përmbushur standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut, dominimin e grupeve të caktuara, dhe, në veçanti, përjashtimi i grave nga vendimmarrja.” Por, sipas tyre, edhe përtej të gjitha këtyre mangësive, ata janë të dobishëm, sepse dalin nga brendësia e shoqërisë. Por ky është edhe defekti i tyre, sepse nuk mund të zbatohen në vende të tjera.¹⁴⁹

Në Ballkanin Perëndimor deri sot nuk ka pasur mekanizma të drejtësisë tradicionale, të cilët janë përdorur. Drejtësia tranzicionale është limituar ekskluzivisht në mekanizma gjyqësorë ndërkombëtarë dhe shtetërorë, edhe pse këta të dytit janë treguar shumë pak efikas.

146 Ch. Beal (2018). Justice Restaurative et Justice Pénale. *College International de Philosophie*, 91 (1) 58-71, fq. 58.

147 Po aty.

148 A. Garcette, A. Laraby (2016). L'Approche française de la justice transitionnelle. E qashme në: <https://ihej.org/wp-content/uploads/2016/03/Lapproche-fran%c3%a7aise-de-la-justice-transitionnelle.pdf>

149 A. Ross, Ch. L. Sriram (2012). Closing Impunity Gaps: Regional transitional justice processes? *Transitional Justice Review*, 1 (1), 3-30, fq.25.

II. Mekanizmat gjyqësorë dhe jogjyqësorë të drejtësisë tranzicionale

3 Mekanizmat gjyqësorë

Mekanizmat e drejtësisë tranzicionale me kohë janë diversifikuar. Një dokument i publikuar nga OKB-ja në vitin 2004, i cili konsiderohet si referencë për masat të cilat shoqëritë duhet t'i ndërmarrin për të trajtuar shkeljet e të drejtave të njeriut nga regjimet paraprake, thotë se ballafaqimi me të kaluarën është proces i cili implikon një numër mekanizmesh, të cilët “mund të përfshijnë mekanizma gjyqësorë dhe jogjyqësorë, me shkallë të ndryshme të përfshirjes ndërkombëtare (ose jo) dhe ndjekjeve penale individuale, riparimet, kërkimi i së vërtetës, reforma institucionale, vetingu dhe shkarkimet, ose një kombinim të këtyre.”¹⁵⁰ Në këtë tekst thuhet se këta mekanizma duhet “të sigurojnë llogaridhënie, t'i shërbejnë drejtësisë dhe të arrijnë pajtimin.”¹⁵¹

Mekanizmat gjyqësorë të drejtësisë tranzicionale kanë të bëjnë me llogaridhënie ligjore për personat që kanë kryer krime në të kaluarën. Kjo bëhet zakonisht përmes gjykatave të cilat mund të jenë lokale, nacionale ose ndërkombëtare (hibride). Në këtë kapitull do të analizohen Tribunalet Ndërkombëtare Penale ad hoc (TNPJ dhe TNPR) dhe Gjykata Ndërkombëtare Penale. Në pjesën e dytë të kapitullit do të analizohen gjykatat penale hibride dhe/ose të ndërkombëtarizuara.

3.1. Gjykatat ndërkombëtare penale

Gjykatat e para ndërkombëtare penale *ad hoc* qenë Tribunalet Ushtarake të Nurembergut dhe Tokios të krijuara më 1945 dhe 1946, për të gjykuar krimet e luftës naziste. Lufta e Ftohtë do të ketë efekt bllokues për zhvillimin e më tutjeshëm të mekanizmave të tjerë gjyqësorë ndërkombëtarë deri në shembjen e komunizmit në vitin 1989. Në këtë aspekt vitet 1990 do të shënojnë një kthesë historike sa u përket mekanizmave gjyqësorë të drejtësisë tranzicionale. Pas 50 vjetësh status quo, OKB-ja do të krijojë dy tribunalet ndërkombëtare penale të tjera. I pari do të jetë Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, i cili do të krijohet në maj 1993, për të gjykuar krimet e kryera kundër popullsisë civile në Kroaci

150 Lawther, Moffett, Jacobs, *Research Handbook of Transitional Justice*, fq. 306.

151 Po aty.

dhe Bosnjë-Hercegovinë. Më pas ky Tribunal do të trajtojë edhe krimet në Kosovë. Në nëntor 1994, OKB-ja do të themelojë Tribunalin Ndërkombëtar Penal për Ruandë, për të gjykuar krimet e kryera në këtë shtet, në fillim të viteve 1990, kundër etnisë Tutsi nga rivalët Hutu. Institucionalizimi i mekanizmave gjyqësorë të drejtësisë tranzicionale do të mbërrijë kulmin me hyrjen në fuqi, më 1 korrik 2002 të Gjykatës Ndërkombëtare Penale. Përveç këtyre Tribunaleve, do të krijohen edhe një numër gjykatash penale hibride dhe/ose të ndërkombëtarizuara.

3.1.1. Tribunalet Ushtarake të Nurembergut dhe Tokios

Këto dy Tribunale kanë vendosur bazat e drejtësisë ndërkombëtare penale. Tribunali Ushtarak i Nurembergut është tribunali i parë ndërkombëtar penal në histori. Ai është themeluar bazuar në Marrëveshjen e Londrës të nënshkruar më 8 gusht 1945 nga qeveritë e Britanisë së Madhe, SHBA-së, Bashkimit Sovjetik dhe Francës, dhe ka pasur për mision gjykimin e liderëve nazistë. Ky Tribunal ka filluar punën më 20 nëntor 1945, pak muaj pas kapitullimit të Gjermanisë naziste dhe e ka përmbyllur procesin e parë gjyqësor të 21 liderëve nazistë më 1 tetor 1946.¹⁵² Gjykatësit dhe prokurorët e këtij Tribunali kanë qenë nga shtetet themeluese të tij. Këto gjykime janë zhvilluar në Pallatin e Drejtësisë në Nuremberg, qytet i cili pas ndarjes së Gjermanisë në sektorë pas luftës gjendej nën kontrollin e SHBA-së. Simbolika e organizimit të këtyre proceseve në Nuremberg ishte edhe më e madhe për faktin se ky qytet kishte qenë simbol i nazizmit. Aleatët konsideronin se Evropa dhe Gjermania nuk do të denazifikoheshin kurrë po qe se kjo e fundit nuk do të ballafaqohej me krimet e saj, nëse ajo nuk do t'i shikonte të bërat e saj në fytyrë. Qëllimi ishte që ajo ta rivendoste sundimin e ligjit përmes gjykimit dhe dënimit të personave përgjegjës për krime.¹⁵³ Kjo ishte konsideruar e nevojshme pas zbulimit të kampeve të përqendrimit nazistë. Kryeprokurori i kësaj gjykate, amerikani Robert Jackson, konsideronte se Tribunali do t'i mbante të pandryshueshme ligjet e njerëzimit dhe, duke vepruar kështu, do ta ruante vetë racën njerëzore.¹⁵⁴

Ky Tribunal ka proceduar gjithsej 24 persona, të cilët ishin zgjedhur për të qenë një grup reprezentativ i liderëve të regjimit nazist nga fushat e diplomacisë, politikës, ushtrisë dhe ekonomisë.¹⁵⁵ Adolf Hitler, Heinrich Himmler dhe Joseph Goebbels nuk do të gjykohen

152 Nga tetori 1946 deri në prill 1949 janë zhvilluar edhe 12 procese tjera gjyqësore nën organizimin amerikan, në të njëjtin qytet.

153 Andrieu, Juger, *réconcilier, réparer: la justice transitionnelle pour sortir de la violence?* Fq.111.

154 Po aty.

155 Për proceset e Nurembergut shih : P. Roland (2020). *The Nuremberg Trials, The Nazis and Their Crimes Against Humanity*. London: Arcturus Publishing.

kurrë për shkak se ata kishin bërë vetëvrasje para përfundimit të luftës. Ata nuk janë dënuar retroaktivisht. Nga të akuzuarit dymbëdhjetë janë dënuar me vdekje, shtatë prej tyre janë dënuar me burg, kurse tre prej tyre janë liruar.¹⁵⁶ Të dënuarit me vdekje janë ekzekutuar më pas.¹⁵⁷ Proceset gjyqësore në Nuremberg kanë luajtur rolin e platformave nga të cilat janë treguar vuajtjet dhe padrejtësitë si dhe persekutimet në shkallë të gjerë të regjimit nazist. Salla e gjyqit ishte furnizuar me një ekran kinemaje, ku prokurori amerikan Jackson kishte kërkuar projektimin e imazheve të krimeve dhe kampeve të përqendrimit për t'i vendosur të akuzuarit para realitetit të krimeve të tyre.¹⁵⁸ Njëkohësisht, personat e mbijetuar të këtyre atrociteteve kanë dëshmuar në praninë e këtyre imazheve.

Tribunali i Tokios, i cili ndryshe ishte emëruar Tribunali Ndërkombëtar Ushtarak për Lindjen e Largët ishte krijuar më 29 prill 1946 me dekret të gjeneralit amerikan, Douglas MacArthur, komandant suprem i Forcave Aleate për t'i gjykuar liderët japonezë pronazistë për krime kundër paqes, krimeve të luftës konvencionale dhe krimeve kundër njerëzimit.¹⁵⁹ Ngjashëm si në Nuremberg, edhe në Japoni amerikanët kishin përzgjedhur një grup reprezentativ të personave që do të gjykoreshin. Paraprakisht disa prej tyre, si gjenerali Tojo Hideki, ishin burgosur. Hideki kishte qenë kryeministër i shtetit në kohën e sulmit japonez kundër Pearl Harbor. Në prill 1946, ky Tribunal kishte lëshuar aktakuza kundër 28 personave. Në mesin e tyre ishin gjenerali Tojo dhe 17 oficerë të tjerë ushtarakë. Katër nga të akuzuarit kishin qenë kryeministra gjatë luftës.¹⁶⁰ Në mesin e tyre kishte edhe ministra dhe persona tjerë me peshë të ish-regjimit japonez pronazist. Dy të akuzuar nga ky grup kishin vdekur gjatë procedurave, kurse njëri ishte shpallur i paaftë për gjykim. Të gjithë të pandehurit e mbetur u shpallën fajtorë për të paktën një pikë të aktakuzës. Dënimet lëviznin nga shtatë vjet burgim deri në ekzekutim. Gjykata ishte mbyllur më 12 nëntor 1948. Në një studim krahasues ndërmjet këtyre dy Tribunaleve, Futamura nxjerr në pah shumë mangësi të Tribunalit të Tokios në raport me atë të Nurembergut. Tribunali i Tokios kishte qenë, sipas tij, më i politizuar, kishte pasur më pak staf të kualifikuar, kishte bërë më shumë lëshime procedurale etj.¹⁶¹ E gjithë kjo kishte bërë që të konsiderohet si drejtësi e fituesve.¹⁶²

156 Quinn, "The development of transitional justice," fq. 16.

157 Po aty.

158 Kora Andrieu (2014). Political liberalism after mass violence: John Rawls and a 'theory' of transitional justice. In Buckley-Zistel, Koloma Beck, Braun, Mieth, *Transitional Justice Theories*, fq. 90.

159 M. Futamura (2008). *War Crimes Tribunals and Transitional Justice, The Tokyo Trial and the Nuremberg legacy*. London: Routledge.

160 Po aty. fq. 53.

161 Po aty, fq. 60-62.

162 Andrieu, Juger, réconcilier, réparer: la justice transitionnelle pour sortir de la violence? fq 111.

Quinn konsideron se këto dy gjykata, edhe përtej mangësive të pakontestueshme që kanë pasur, kishin qenë të rëndësishme për së paku tri arsye. E para është roli i tyre në fuqizimin e së drejtës ndërkombëtare dhe shtrirjes së ligjit përtej krimeve të zakonshme të luftës. Krime të tjera kishin arritur të integroheshin në domenin e ligjit ndërkombëtar, të cilat në mungesë të këtyre Tribunaleve nuk ishin integruar kurrë. Së dyti, ato kishin arritur të krijonin një “jurisprudencë të re”, e cila duhej t’u shërbente shoqërive “të reja” të pasluftës. Së treti, ato kishin arritur “të ofronin një model të sundimit të ligjit për të riedukuar Gjermaninë dhe për të frymëzuar popujt e tjerë.”¹⁶³ Andrieu konsideron se “sfida e Nurembergut ishte e qartë: rithemelimi i një komuniteti politik dhe moral përmes rrëfimit të tmerreve të së kaluarës. Kështu, ligji fitoi një funksion mjaft normativ dhe simbolik.”¹⁶⁴

3.1.2. *Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi (TNPJ)*

Ky Tribunal është themeluar me Rezolutën 827¹⁶⁵ të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, më 25 maj 1993. Ky Tribunal kishte për mision ndjekjen penale të personave përgjegjës për shkelje serioze të ligjit ndërkombëtar humanitar, të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë nga viti 1991. Krijimi i tij mbi parimet e Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, e cila ka për qëllim ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, duhej t’u kontribuonte këtyre qëllimeve përmes arrestimit të kriminelëve të luftës, të cilët pikërisht paraqisnin rrezik për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.¹⁶⁶ Kështu, “ndjekja penale *per se* nuk ishte qëllimi për të cilin u krijua gjykata; ai ishte një mjet për të arritur qëllime më të gjera. Krijimi i TNPJ-së ishte një masë e ndërmarrë nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së për të përmbushur përgjegjësinë e tij kryesore për mirëmbajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.”¹⁶⁷ Një përkufizim, i cili datonte nga Tribunali i Nurembergut, thoshte se krimet kundër njerëzimit janë shkelje ndërkombëtare pasi që ato “kërcënojnë paqen, sigurinë dhe mirëqenien e botës.”¹⁶⁸

163 Quinn, “The development of transitional justice”, fq. 16-17.

164 Andrieu, “Political liberalism after mass violence: John Rawls and a ‘theory’ of transitional justice,” fq. 91.

165 Shih tekstin e Rezolutës në: [https://undocs.org/S/RES/827\(1993\)](https://undocs.org/S/RES/827(1993))

166 Andrieu, Juger, réconcilier, réparer: la justice transitionnelle pour sortir de la violence? Fq. 112.

167 Futamura, *War Crimes Tribunals and Transitional Justice*, fq. 3,

168 Stahn, *A critical introduction to international criminal law*, fq. 54.

Themelimi i këtij Tribunali është konsideruar si “një nga ngjarjet e mëdha politike të gjysmës së dytë të shekullit njëzet [...], një fazë e re në një proces të filluar gjysmë shekulli më parë në Nuremberg.”¹⁶⁹ Ngjashëm si Tribunalet e Nurembergut dhe Tokios, edhe TNPJ-ja ka qenë Tribunal *ad hoc* (gjykatë e përkohshme) me juridiksion të kufizuar, por, për dallim nga të parat, të cilat ishin krijuar brenda shteteve ku ishin kryer krimet, TNPJ-ja ishte vendosur në Hagë (Holandë).

Ky Tribunal ka filluar procesin e aktakuzave në vitin 1994 dhe e ka përmbyllur atë në vitin 2004. Gjithsej ka shpallur 162 aktakuza, duke përfshirë edhe ish-presidentin e RFJ-së, Slobodan Milošević. Ky i fundit kishte qenë kryetari i parë në detyrë i një shteti i akuzuar nga një tribunal penal ndërkombëtar. Përveç Milošević-it, i cili ka vdekur në burg në vitin 2006, para se të përfundonte procesi kundër tij, ky Tribunal ka gjykuar një numër të madh udhëheqësish politikë, ushtarakë, policorë dhe të sigurisë, serbë, kroatë, boshnjakë, malazezë, maqedonas të veriut dhe shqiptarë të Kosovës. Një pjesë e madhe e personave të akuzuar dhe të gjykuar kanë qenë të rangut të lartë hierarkik, por ka pasur edhe të rangut të mesëm dhe atij të ulët, sidomos në fazat e para të funksionimit të tij. Ndër personat e fundit të arrestuar dhe të transferuar në Hagë ka qenë shefi ushtarak serb i Bosnjës, Ratko Mladić, i cili është arrestuar në vitin 2011. Mladić ishte arrestuar 16 vjet pas shpalljes së aktakuzës kundër tij (1995). Në vitin 2017 ai është dënuar me burgim të përjetshëm për krime lufte krime kundër njerëzimit dhe gjenocid. Në vitin 2016, Tribunali ka dënuar me 40 vjet burg ish-liderin politik serb të Bosnjës, Radovan Karadžić.¹⁷⁰ Ky i fundit ishte arrestuar në Serbi në vitin 2007, 12 vjet pas shpalljes së aktakuzës kundër tij (1995). TNPJ-ja i ka mbyllur dyert më 31 dhjetor 2017 dhe një pjesë e proceseve gjyqësore të papërfunduara (në Apel) janë bartur tek Mekanizmat Rezidualë Ndërkombëtarë për Tribunalet Penale të krijuar në vitin 2010 nga OKB-ja për të mundësuar kompletimin e proceseve gjyqësore të mbetura të papërfunduara.¹⁷¹

Përveç rolit të tij në institucionalizimin e drejtësisë penale ndërkombëtare dhe sjelljes para drejtësisë të një numri të madh të personave që kishin organizuar dhe kryer krime, TNPJ-ja ka kontribuar edhe në zhvillimin e shumë aspekteve të ligjit për gjenocidin.¹⁷² Ky Tribunal ka përpunuar një numër të madh krimesh, të cilat nuk kanë qenë të përpunuara kurrë më parë. Një ndër ato është edhe përdhunimi si krim lufte. Në aktakuzën kundër të

169 A. Garapon (1999). De Nuremberg au TPIY: naissance d'une justice universelle ? *Critique Internationale*, 5, fq. 167.

170 Shih: Prosecutor v. Radovan Karadžić (IT-95-5/18-T) të 24 marsit 2016, www.icty.org.

171 Këta mekanizma janë krijuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së më 22 dhjetor 2010, për të kompletuar proceset e pambaruara para TPNJ-së dhe TPNR-së. Këta mekanizma kanë për funksion kompletimin e proceseve gjyqësore të papërfunduara për shkak të mbylljes së këtyre Tribunaleve. Shih: <https://www.irmct.org/en/about>

172 Stahn, *A critical introduction to international criminal law*, fq.37.

akuzuarve të Foča, *Kunarac et al.*,¹⁷³ përdhunimi është integruar në kategorinë e krimeve të luftës. Në aktgjykimin e gjeneralit serb të Bosnjës, Radislav Krstić, do të shkohet edhe një hap më larg ku përdhunimi do të konsiderohet si instrument i spastrimit etnik dhe i gjenocidit.¹⁷⁴ Dhuna seksuale kishte figuruar në raportet e ndryshme ndërkombëtare për Bosnjë-Hercegovinën në vitet 1992-1993 dhe kishte shërbyer si impuls shtesë për krijimin e këtij Tribunali në vitin 1993.¹⁷⁵ Nga 162 persona të akuzuar nga ky Tribunal, 58 ishin akuzuar mes tjerash edhe për akte të dhunës seksuale.¹⁷⁶ Gjenerali serb, Nebojsa Pavković, do të dënohet, mes tjerash, për përdhunime të kryera në Kosove në vitet 1998-1999 nga forcat serbe nën komandën e tij.¹⁷⁷

Si Tribunal i krijuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, ai ka pasur statusin e organit të OKB-së. Ky status do ta rrisë kredibilitetin e këtij Tribunali duke e bërë të vështirë etiketimin e tij si tribunal i fituesve, ashtu siç kishte ndodhur me Tribunalet e Nurembergut dhe Tokios.¹⁷⁸ Statusi i organit të OKB-së i ka dhënë këtij Tribunali (si dhe atij për Ruandën) siguri financiare, e cila është esenciale për funksionimin e këtyre Tribunaleve. Kjo ishte me rëndësi nëse e kemi pasur parasysh kompleksitetin e organizimit të proceseve gjyqësore nga këto Tribunale dhe kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore, të cilat kanë kosto të lartë financiare.

Interferenca me luftën

Një ndër karakteristikat e këtij Tribunali ka qenë edhe interferenca i tij me luftën. Krijimi i tij në vitin 1993, në një kohë kur lufta ishte në kulmim e sipër në Bosnjë (dhe në Kroaci), i ka dhënë këtij Tribunali një rol të pakontestueshëm politik. Kjo do ta shtrojë edhe pyetjen se deri në çfarë mase tribunalet penale ndërkombëtare të tilla janë të gatshme të interferojnë me luftën dhe me përpjekjet për kthimin e paqes në shoqëri të armiqësuar.¹⁷⁹ Për këtë arsye roli i TNPJ-së do të jetë i ndryshëm nga institucionet klasike të drejtësisë tranzicionale *ad hoc*, siç kishin qenë Tribunalet ushtarake të Nurembergut dhe Tokios, të cilat kishin vepruar

173 Në vitin 1996, TPNJ-ja ka shpallur aktakuzë kundër Dragoljub Kunarac, Radomir Kovac dhe Zoran Vuković, të cilët akuzoheshin për dhunë seksuale të ushtruar kundër grave boshnjake në kampin e këtij qyteti. Për një analizë të detajuar të këtij krimi shih: S. Brammert, M. J. Jarvis (2016). *Prosecuting Conflict-related Sexual Violence at the ICTY*. Oxford: Oxford University Press.

174 Po aty.

175 C. E. Arrabal Ward (2018). *Wartime Sexual Violence at the International Level: A Legal Perspective*. Hague: Brill Nijhoff, fq. 44.

176 Po aty.

177 Shih paragrafin 785 të aktgjykimit kundër Nebojsa Pavkovic në: <https://www.icty.org/en/case/milutinovic#tjug>

178 Rimmer, Gender and Transitional justice, fq 58.

179 M. M. Kaminski, M. Nalepa, B. O'Neill (2006). Normative and Strategic Aspects of Transitional Justice. *Journal of Conflict Resolution* 50, fq. 296.

“jashtë një rendi shoqëror opresiv ose të dhunshëm.”¹⁸⁰ TNPJ-ja ka interferuar më pas edhe me luftën në Kosovë, në vitet 1998-1999. Shpallja e aktakuzës kundër ish-presidentit serb, Slobodan Milošević, dhe 4 liderëve të tjerë më të lartë politikë, ushtarakë dhe policorë të RFJ-së, më 24 maj 1999, kishte ndodhur pikërisht në një kohë kur bombardimet e NATO-s kundër RFJ-së kishin arritur intensitetin më të lartë. Interferimi i këtij Tribunali me luftën do të bëjë që ai të konsiderohet si rival nga diplomacia perëndimore, e cila kërkonte t’i jepte fund luftës.¹⁸¹ Në një artikull të botuar më 3 tetor 1999, në gazetën *Washington Post*, juristi amerikan, Michael Scharf, shkruante: “gjatë negociatave për krijimin e gjykatës - bisedime në të cilat unë mora pjesë si përfaqësues i Qeverisë amerikane - u bë e qartë se disa nga anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit e konsideronin Tribunalin si pengesë të mundshme për një zgjidhje të negociuar të paqes. [...]”¹⁸² Diplomacia nuk ka hezitur ta përdorë Tribunalin edhe si mjet presioni. Ajo ka gjetur tek ky Tribunal një potencial të konsiderueshëm diplomatik në momente të caktuara. Scharf thotë se ish-kryenegociatori amerikan në Ballkan, Richard Holbrooke, ka pranuar që Tribunali është perceptuar brenda Qeverisë Amerikane “si pak më shumë sesa një mjet marrëdhënieje me publikun dhe si një mjet potencialisht i dobishëm i politikave”.¹⁸³ Kështu, sipas tij, aktakuzat kanë shërbyer “për të izoluar liderët kundërshtues diplomatikisht, për të përkrahur rivalët e brendshëm dhe për të forcuar vullnetin politik ndërkombëtar për të përdorur sanksione ekonomike ose për të përdorur forcën”.¹⁸⁴ Këtë këndvështrim e ka ndarë edhe juristi me renome ndërkombëtare, Cheriff Bassiouni, i cili ka kontribuar në fazat e para të funksionalizimit të këtij Tribunali dhe sipas të cilit “të gjitha gjykatat dhe hetimet ad hoc të krijuara kanë vuajtur nga interesat konkurruese të politikës ose nga ndikimi i një shtate sfiduese gjeopolitike.”¹⁸⁵

Një tjetër pengesë, e cila ka të bëjë më shumë me periudhën pas përfundimit të konflikteve kanë qenë kërkesat e diplomacisë që ky Tribunal të tregojë ndjeshmëri ndaj konteksteve politike brenda shteteve mbi të cilat kishte juridiksion, si dhe konteksteve ndërkombëtare.¹⁸⁶ Rachel Kerr thotë se për të qenë e suksesshme “Gjykata është dashur

180 Po aty.

181 Për ta kuptuar interferimin e drejtësisë penale ndërkombëtare me politikën shih: P. Hazan (2000) *La justice face la guerre : de Nuremberg à La Haye*. Paris: Stock.

182 N. M. Rajkovic (2012) *The Politics of International Law and Compliance. Serbia, Croatia and The Hague Tribunal*. Abington, New York: Routledge, fq. 60.

183 Po aty.

184 Po aty.

185 Ch. M. Bassiouni (1997). From Versailles to Rwanda in Seventy five Years: The need to establish a Permanent International Criminal Court. *Harvard Human Rights Journal* 10, 11-62, fq.11.

186 C. Del Ponte dhe Ch. Sudetic (2008). *Madame Prosecutor: Confrontations with Humanity's Worst Criminals and the Culture of Impunity*. New York: Other Press, fq. 117-118.

ta bënte një balancim delikat ndërmjet ligjit dhe politikës.”¹⁸⁷ Kjo sinergji politikë-drejtësi është vërejtur në punën e tre prokurorëve të parë të Tribunalit, Richard Goldstone, Louise Arbour dhe Carla del Ponte, të cilët kanë luajtur një rol të dyfishtë, atë të kryeprokurorëve dhe të përfaqësuesve (politikë) të gjykatës, duke qenë të obliguar të veprojnë politikisht për të siguruar bashkëpunimin e shteteve, transferimin e të akuzuarve, sigurimin e dokumenteve të kërkuara, sigurimin e dëshmitarëve, hetimin në terren etj. Megjithatë, ata kanë qenë të vetëdijshëm për rrezikun që i kanosej Tribunalit nga politika. Louise Arbour konsideronte se rreziku më i madh ishte “perceptimi që procesi penal manipulohet për qëllime politike”.¹⁸⁸ Edhe pasardhësja e saj, Carla del Ponte, konsideronte se “ekziston një rregull i hekurt që çdo prokuror, shtetëror ose ndërkombëtar, duhet ta mbajë në mendje: politika është për drejtësinë, ajo çfarë është uji për metalin. Ajo ha, prish, korrupton dhe në fund të fundit asgjëson!”¹⁸⁹

Raporti i komplikuar i TNPJ-së me shtetet e ish-Jugosllavisë

Ky Tribunal kishte edhe disa mangësi, të cilat vinin nga vetë natyra e tij dhe që e bënin atë të varur nga shtetet e ish-Jugosllavisë dhe nga shtetet perëndimore. Ky Tribunal kishte vështirësi për të përmbushur misionin e tij ndërkombëtar të policisë. Ai ishte i varur nga shtetet për t’i arrestuar dhe transferuar në Hagë të akuzuarit. Mungesa e një force detyruese, të cilën e kanë vetëm shtetet, e ka kufizuar rolin e tij. Kjo e ka reduktuar këtë institucion në një institucion ndëshkues dhe ndëshkimi në kohë reale ka qenë roli primar i tij.¹⁹⁰ Kjo mangësi kishte reperkusione të drejtpërdrejta në funksionimin e Tribunalit. I janë nevojitur 16 vjet për ta sjellë Ratko Mladić-in në Hagë. 12 vjet për Radovan Karadžić-in. Gjenerali i Policisë së Serbisë, Vlastimir Đorđević, i cili, mes tjerash, kishte qenë përgjegjës për operacionet e fshehjes së 900 kufomave të shqiptarëve të Kosovës në Serbi (Operacioni *asanacija*) ishte arrestuar 8 vjet pas shpalljes së aktakuzës kundër tij.¹⁹¹ Serbët e Bosnjës, të

187 R. Kerr (2004). *The international criminal Tribunal for the former Yugoslavia – an exercise in law, politics and diplomacy*. Oxford: Oxford University Press, fq. 9.

188 KERR, *The International Criminal Tribunal for the Former Yugoslavia- An Exercise in Law, Politics, and diplomacy*, fq. 177.

189 F. Hartmann (2007). *Paix et châtement, les guerres secrètes de la politique et de la justice internationale*. Paris : Flammarion, fq. 297. ; Vukpalaj, *Ex-Yougoslavie, de la guerre a la justice*.

190 H. Schoenfeld, H. Levy, R. Hagan (2007). Crises Extrêmes et Institutionnalisation de Droit Pénal International. *Critique Internationale*, 36, fq. 45.

191 Për më shumë përreth operacionit *asanacija*, shih: A. Vukpalaj (2021). “No Bodies-No Crimes”: The Reburial Operations of the Serbian Forces in Kosovo in 1999, In A. Hajrullahu, A. Vukpalaj (2021). *Forging Kosovo Between Dependence, Independence and Interdependence* (ff. 45-71) (Eds.) Bern, Bruxelles: Peter Lang.

cilët ishin strehuar në Serbi pas aktakuzave të shpallura kundër tyre nga Tribunali, kishin qarkulluar me vite të tëra pa u brengosur se do të arrestoheshin. Bashkëpunimi i shteteve ishte i nevojshëm edhe për t'i siguruar materialet e nevojshme për ngritjen e aktakuzave dhe organizimin e proceseve gjyqësore, për të siguruar dëshmitarët etj. Këtë më së miri e shpjegon kryeprokurorja e dytë e TNPJ-së, Louise Arbour, e cila në një intervistë të saj e krahasonte punën e saj si prokurore me punën e prokurorëve të Nurembergut:

Juristët e Nurembergut kishin çdo të akuzuar në paraburgim dhe ata që nuk i kishin i kanë gjykuar në mungesë. Ata nuk kishin apele; ata kishin çdo dokument; ata kishin plot përkthyes. Unë nuk jam duke thënë se do t'i aprovoja ose do t'i doja të gjitha këto gjëra, por kjo e bëri punën e tyre më të lehtë në shumë aspekte.¹⁹²

Puna e Tribunalit është sfiduar edhe nga elitat lokale, të cilat në vend se ta promovojnë punën e tij në nivel lokal, e kanë paraqitur atë si mjetin politik përmes të cilit Perëndimi dëshiron ta shtrijë ndikimin e vet. Kjo ka qenë e vërtetë për një pjesë të elitave politike të Serbisë, të serbëve dhe kroatëve të Bosnjës, dhe gjithashtu për një pjesë të elitave të Kroacisë. Këtij diabolizmi të Tribunalit i kishte shkuar në favor fakti se ai ishte vendosur në Hagë dhe kjo bënte që puna e tij nuk ka qenë e njohur në nivel lokal, aty ku më së shumti do të duhej të shërbenin dënimet e tij. Kjo ka krijuar hapësirë për elitat politike lokale që të pengojnë përvetësimin e punës së Tribunalit në nivel lokal.¹⁹³ Në këto shtete kundërshtarët e Tribunalit i kanë paraqitur aktakuzat dhe proceset gjyqësore si të motivuara politikisht. Kjo ka bërë që në disa nga këto shtete Tribunali është perceptuar si institucion me shkallë të ulët të besueshmërisë.¹⁹⁴ Në Serbi dhe Republika Srpska aktakuzat kundër serbëve janë paraqitur ekskluzivisht si të motivuara politikisht. Në një shkallë më të ulët kjo ka qenë situata edhe në Kroaci dhe tek kroatët e Bosnjës, në veçanti pas shpalljes së aktakuzave kundër ish-shefave ushtarakë dhe policorë kroatë në vitin 2001, dhe më pas edhe kundër lidërsipit të ish-Republikës kroate të Herceg-Bosnjës, i cili në vitin 2017 është dënuar rëndë. Në këto shtete do të mbizotërojë një pikëpamje realiste e drejtësisë penale ndërkombëtare sipas së cilës ky Tribunal ka për qëllim çmitizimin e sovranitetit të

192 P. Erna (2008). *The Sun Climbs Slow: The International Criminal Court and the Struggle for Justice*. Toronto: Random House, fq. 192.

193 Lawther, Moffett, Jacobs, *Research Handbook of Transitional Justice*, fq.145.

194 M. Braniff (2011). *Integrating the Balkans, conflict resolution and the impact of EU expansion*. London: I.B. Tauris, fq. 137; Shih gjithashtu tekstin: 'Kritike na račun Haškog suda', *Deutsche Welle*, < <http://www.dw.de/ha%C5%A1ki-sud-je-postao-karikatu-ra/a-18048739>

shteteve duke futur një element të rrezikshëm moralizues në të drejtën ndërkombëtare.¹⁹⁵ Sipas kësaj qasjeje, e drejta penale ndërkombëtare nuk ka asnjë cilësi dhe është thjesht një mjet i politikës dhe pushtetit. Elita politike në Serbi kishte ndërtuar një konsensus të gjerë kundër këtij Tribunali.¹⁹⁶ Në anën tjetër, viktimat e krimeve në Bosnjë dhe në Kosovë e kanë akuzuar Tribunalin se nuk ka bërë shumë për të bërë drejtësinë.¹⁹⁷

3.1.3. *Tribunali Ndërkombëtar Penal për Ruandën*

Ky Tribunal është themeluar më 8 nëntor 1994 nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së për të gjykuar gjenocidin e kryer në Ruanda ndërmjet 7 prillit dhe 15 korrikut 1994. Juridiksioni kohor i këtij Tribunali ishte nga 1 janari deri më 31 dhjetor 1994. Themelimi nga OKB-ja e bënte këtë Tribunal organ të OKB-së. Themelimi i këtij Tribunali kishte ndodhur në një moment kur konflikti në këtë shtet kishte përfunduar dhe situata ishte stabilizuar për dallim nga TNPJ-ja ku lufta po vazhdonte. Struktura e këtij Tribunali do të jetë e ngjashme me TNPJ-në. Ai do të jetë tribunal ad hoc, do të ketë dy dhoma themelore, të cilat do të numërojnë nga tre gjykatës secila dhe një dhomë të apelit me 5 gjykatës. Dhoma e apelit do të jetë e përbashkët me TNPJ-në. Më vonë do të shtohet edhe një dhomë e tretë e nivelit themelor. Këshilli i Sigurimit kishte vendosur që kryeprokurori i TNPJ-së do të ishte kryeprokuror edhe i Tribunalit për Ruandën dhe ai do të asistohet nga një zëvendësprokuror, i cili do të vepronte në Arusha. Dhe kjo do të jetë e vlefshme deri në emërimin e një prokurori të ndryshëm në vitin 2003. Arsyeja pse Këshilli i Sigurimit kishte vendosur t'i fuziononte këto organe të këtyre Tribunaleve kishin qenë mospajtimet midis shteteve në momentin e adoptimit të Rezolutës 955 me të cilën ishte themeluar ky Tribunal. Një pjesë e shteteve që kishin ulëse në Këshill të Sigurimit kishin kërkuar krijimin e një institucioni të pavarur të ngjashëm me atë për ish-Jugosllavinë, kurse të tjerat kishin qenë në favor të një Tribunali, i cili do të ishte një zgjerim i TNPJ-së. Si kompromis ishin fuzionuar dy organe të këtyre Tribunaleve. Shkrirja e organeve të tyre kishte pasur për qëllim që ato të mos merrnin vendime, të cilat do të shkonin kundër interesave të njëri-tjetrit.

195 F. Megret (2014). "International Criminal Justice, a critical research agenda," In, Ch. Schwobel, *Critical Approached to International Criminal Law*. Oxon, New York: Routledge, fq.19.

196 M. Ostojic (2014). *Between Justice and Stability, the political of War Crimes Prosecutions in Post -Milosevic Serbia*. Farham, Burlington: Ashgate Publishing, fq. 11-12.

197 Megret, "International Criminal Justice, a critical research agenda," fq. 20.

Megjithatë, TNPR-ja kishte edhe diferenca me TNPJ-në. Ai kishte kompetenca vetëm për krimet e kryera në kuadër të një konflikti të brendshëm të armatosur, kurse TNPJ-ja ishte kompetent edhe për krimet e kryera në kuadër të konflikteve të armatosura ndërkombëtare. Tjetër diferencë kishte qenë juridiksioni kohor, i cili për TNPR-në përfundonte më 31 dhjetor 1994, kurse TNPJ-ja nuk e kishte të fiksuar fundin e juridiksionit kohor.¹⁹⁸

Tribunali për Ruandën do të vendoset në Arusha të Tanzanisë dhe do të ketë një zyrë në Kigali, kryeqytetin e Ruandës. Shpërndarja e organeve të tij ndërmjet Arushas dhe Hagës do ta bëjë komunikimin ndërmjet këtyre organeve të vështirë. Ai gjithashtu do të ketë vështirësi në bashkëpunimin me autoritetet qeveritare ruandeze. Fronti patriotik ruandez (FPR) në pushtet në Ruandë e kishte kundërshtuar themelimin e këtij Tribunali në Këshill të Sigurimit edhe pse para se të themelohej ky Tribunal, ai i kishte kërkuar asistencë Këshillit të Sigurimit që të krijojë një Tribunal për gjykimin e gjenocidit. Kjo qeveri i kishte kundërshtuar disa dispozita të këtij Tribunali, siç ishin: juridiksioni kohor, prokuroria e përbashkët me TNPJ-në, vendosjen e tij në Tanzani, si dhe mospërfshirjen e dënimit me vdekje për organizuesit e gjenocidit (Hutu).¹⁹⁹

Një ndër problemet me të cilat shumë herët do të përballet ky Tribunal ishte kontrasti që ekzistonte ndërmjet strukturës ligjore të tij dhe realitetit politik. Këtë problem e kishte edhe TNPJ-ja. Ky kontrast ishte për shkak të skepticizmit se a do të mund të bëheshin këto Tribunale kredibile. Kjo pyetje shtrohej për shkak se ato ishin eksperimente të reja dhe nuk kishin përkrahje as brenda shteteve ku ishin kryer krimet dhe shpesh kishte munguar edhe përkrahja e shteteve perëndimore. Një ndër problemet e para që ishte shtruar kishte qenë sjellja para gjykatës e personave të akuzuar. TNPJ-ja kishte filluar me aktakuza që në vitin 1994, por kishte hasur në kundërshtime në terren. I arrestuari i parë, Dusko Tadic, ishte transferuar në Hagë nga Gjermania, ku ishte arrestuar. Tribunali për Ruandën kishte qenë më i shpejtë në përpilimin e aktakuzave, por i janë dashur 2 vjet për t'i burgosur personat e parë të akuzuar.²⁰⁰ Arrestimi i personave ishte edhe më i vështirë, sepse pas marrjes së pushtetit nga FPR-ja përgjegjësit kryesorë për krime në Ruandë kishin ikur në shtetet fqinje. Një pjesë e tyre ishin strehuar në shtetet perëndimore. Kjo paraqiste problem shtesë për prokurorinë, e cila duhej të siguronte bashkëpunim me shumë shtete në të njëjtën kohë për t'i arrestuar dhe sjellë personat e kërkuar para gjykatës. Raportet e vështira me Qeverinë ruandeze do ta bëjnë të vështirë edhe sigurimin e dokumenteve dhe dëshmitarëve të nevojshëm për organizimin

198 M. P. Scharf, M. Day (2011). "The *ad hoc* international criminal Tribunals Launching a new era of accountability." In W. A. Schabas, N. Bernaz, Routledge *Handbook of International Criminal Law* (ff. 51-67). London: Routledge, ff. 58-59

199 Po aty.

200 Stahn, *A critical introduction to international criminal law*, fq.192

e proceseve gjyqësore. Tensionet me Qeverinë ruandeze kishin të bënin edhe me refuzimin e autoriteteve atje që t'i arrestonin personat e kërkuar, të cilët ishin anëtarë ose të afërt me partinë në pushtet, të cilët Qeveria ruandeze refuzonte t'i arrestonte dhe t'i transferonte para Tribunalit. Një ndër strategjitë e prokurorëve të TNPR-së do të jetë të përdorin procedurën *40 bis*, e cila u mundësonte atyre që të kërkonin transferimin para Tribunalit të çdo personi të arrestuar nga gjykatat vendore, jo vetëm në Ruandë por edhe në shtetet fqinje të saj. Këtë prokurorët mund ta bënin bazuar në Kapitullin VII të OKB-së mbi të cilin ishte themeluar Tribunali. Me statut, TNPR-ja kishte primat edhe mbi gjykatat vendore të Ruandës. Edhe pas një fillimi të vështirë, TNPR-ja ka arritur të kryejë një punë të konsiderueshme. Në vitin 2009 ky Tribunal kishte kompletuar 50 procese gjyqësore. 29 persona ishin dënuar, në mesin e tyre shumë ministra, zyrtarë të lartë, si dhe ish-kryeministri i regjimit gjenocidar Hutu, Jean Kambanda. Ky Tribunal i ka mbyllur dyert në vitin 2015 dhe proceset e papërfunduara u kanë kaluar Mekanizmave Rezidualë Ndërkombëtarë për Tribunalet Penale.

3.1.4. Gjykata Ndërkombëtare Penale (GJNP)

Kjo gjykatë është themeluar në vitin 1998 me nënshkrimin e Statutit të Romës dhe ka hyrë në fuqi në korrik 2002, pas ratifikimit të saj nga 60 shtete. Statuti i Romës është traktat ndërkombëtar, të cilin e kanë nënshkruar 123 shtete (nga 193 sa ka OKB-ja). 63 shtete, në mesin e cilave është edhe SHBA-ja, e kanë nënshkruar këtë statut, por nuk e kanë aprovuar atë. 43 shtete të tjera, në mesin e të cilave janë edhe disa shtete të mëdha si Kina dhe India, nuk e kanë nënshkruar dhe as aprovuar atë.

GJNP-ja ka vokacionin universal, edhe pse nuk është aprovuar nga të gjitha shtetet. Kjo gjykatë dallon nga gjykatat e tjera penale ndërkombëtare dhe hibride në shumë aspekte. Duke qenë institucion permanent, ajo duhet të bashkëpunojë me shumë shtete të shpërndara në gjithë botën ku janë kryer krime, në krahasim me gjykatat ad hoc, të cilat zakonisht kanë juridiksion të kufizuar tek shtete të caktuara. Karakteristikë tjetër është se në raport me dy Tribunalet ad hoc për Ish-Jugosllavinë dhe Ruandën, të analizuar më lart, GJNP-ja nuk është themeluar përmes ndonjë rezolute të Këshillit të Sigurimit të OKB-së ose përmes ndonjë marrëveshjeje me OKB-në. Kjo edhe për shkak se ashtu siç e pamë më lart, disa shtete anëtare të Këshillit të Sigurimit me të drejtë vote nuk e kanë aprovuar atë. Kjo i ka përparësitë dhe mangësitë e veta. Një ndër përparësitë është se ajo nuk i jep

llogari OKB-së dhe funksionimi ndaras me OKB-në i jep gjykatës më shumë pavarësi.²⁰¹ Megjithatë, Këshilli i Sigurimit i OKB-së nuk është i përjashtuar krejtësisht nga Statuti i Romës, sepse artikulli 13 thotë se një nga mekanizmat referues të GJNP-së është Këshilli i Sigurimit, bazuar në Kapitullin VII të Kartës së OKB-së, që ka të bëjë me ruajtjen dhe restaurimin e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.²⁰² GJPN-ja ka një instancë qeverisëse, që është Asambleja e Shteteve Pjesëmarrëse, e cila përbëhet nga përfaqësues diplomatikë të shteteve që janë pjesë e Statutit të Romës. Secili shtet ka një përfaqësues në këtë instancë. Ajo ka për detyrë, mes tjerash, zgjedhjen e gjykatësve, prokurorëve, regjistrin, si dhe votimin e rregullave të procedurës dhe provave. Kjo asamble ka gjithashtu kompetenca për të propozuar ndryshime në Statutin e Romës.

Organet e kësaj gjykate janë: prokuroria, e përbërë nga kryeprokurori dhe dy zëvendësprokurorë, të cilët e asistojnë atë në punën e tij. Ata zgjidhen për një mandat 9-vjeçar, pa mundësi rizgjedhjeje. Divizioni gjyqësor (dhomat) është organi tjetër dhe që ka 18 gjyqtarë të shpërndarë ndërmjet Dhomës së procedurës paraprake, Dhomës themelore dhe Dhomës së apelit. Gjykatësit mund të jenë vetëm qytetarë të shteteve, të cilat e kanë aprovuar Traktatin e Romës. Ngjashëm si prokurorët, edhe gjykatësit zgjidhen për një mandat 9-vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes. Komponenti i tretë është kryetari i gjykatës, i cili zgjidhet nga gjykatësit e dhomave për një mandat trevjeçar me mundësi të rizgjedhjes edhe një herë. Roli i tij është të avokojë për promovimin e gjykatës tek shtetet të cilat nuk e kanë aprovuar Statutin e Romës dhe është kështu një pozitë e cila i obligon gjykatësit të luajnë një rol pothuajse politik. Dhe institucioni i katërt është regjistri, i cili ka për detyrë administrimin e çështjeve jogjyqësore të gjykatës. Në detyrat e regjistrin bëjnë pjesë, mes tjerash: buxheti, komunikimi i gjykatës me jashtë, menaxhimi i fondit për viktimat etj.²⁰³ Brenda regjistrin ka një zyrë publike për viktimat, e cila ka mandat për t'i përkrahur ata, si dhe përfaqësuesit e tyre ligjorë para gjykatës. Sa u përket krimeve, kjo gjykatë ka juridiksion për katër lloj krimesh që janë: gjenocidi, krimet kundër njerëzimit, krimi i agresionit dhe krimet e luftës.²⁰⁴

Një tjetër diferencë me të gjitha gjykatat e tjera ndërkombëtare dhe hibride është se kjo gjykatë nuk ka kompetenca për të shpallur aktakuza për krime që janë kryer para hyrjes së saj në fuqi. Kjo do të thotë se ajo ka mundësi të procedojë vetëm krimet e kryera

201 L. E. Carter, M. S. Ellis, Ch. Ch. Jalloh (2016). *The International Criminal Court in an Effective Global Justice System*. Cheltenham, Northampton: Edward Elgar Publishing, fq. 7.

202 Po aty, fq. 5.

203 Shih: H. N. Haddad (2018). *The Hidden Hands of Justice, NGOs, Human Rights and International Courts*. Cambridge: Cambridge University Press, fq.115.

204 Për një analizë të detajuar të juridiksionit të GJPN-së shih: Scheffer, "The International Criminal Court."

pas korrikut 2002. Ajo nuk ka juridiksion territorial dhe mund të shpallë aktakuza vetëm kundër qytetarëve të shteteve mbi të cilat ajo ka juridiksion e që janë ato që e kanë njohur atë. Kështu, ajo bazohet në parimin e “komplementaritetit,” që do të thotë se mund të shpallë aktakuzë vetëm kundër personave të cilët nuk janë nën hetim nga institucionet vendore në shtetin e tyre. Neni 17 i Statutit të GJNP-së thotë se ata mund të ndiqen penalisht nga kjo gjykatë vetëm nëse shteti nuk do t’i ndjekë ata ose nuk ka mundësi ta bëjë një gjë të tillë.²⁰⁵ Kjo ndryshon nga praktikat e gjykatave penale ndërkombëtare ose hibride, të cilat kanë pasur dhe kanë superioritet mbi gjykatat vendore të shteteve mbi të cilat kanë juridiksion. Në rast të interesimit të GJNP-së për një individ që ka kryer krime, shtetas i të cilit është qytetari, duhet të dëshmojë para GJNP-së se vërtet ka ndërmarrë masa serioze për t’i hetuar veprat penale për të cilat flitet. E gjithë kjo për të evituar që aktakuzat e shpallura nga autoritetet vendore të një shteti kundër një shtetasi të vet të përdoren si strategji për të evituar shpalljen e aktakuzës nga GJNP-ja.²⁰⁶ Për qytetarët e shteteve mbi të cilat GJNP-ja nuk ka juridiksion, ajo mund të shpallë aktakuzë vetëm nëse autorizohet nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së.

Deri sot kjo gjykatë ka shpallur aktakuza kundër 45 personave, përfshirë disa personalitete të nivelit të lartë, si ish-presidenti i Sudanit, Omar al-Bachir, presidenti i Kenyas, Uhuru Kenyatta ose ish-presidentit të Bregut të Fildishtë, Laurent Gbagbo. Presidenti i Sudanit (al-Bachir) nuk është dorëzuar kurrë në Hagë dhe mbetet ende i lirë. Ai ishte akuzuar, mes tjerash, për gjenocid të kryer nga forcat ushtarake të Sudanit në Darfour. Uhuru Kenyatta, presidenti i Kenyas ishte akuzuar në vitin 2010 dhe ishte paraqitur para gjykatësve në vitin 2012, por për shkak të mungesës së provave kundër tij aktakuza ishte tërhequr. Ai është aktualisht president i shtetit në Kenya. Laurent Gbagbo, ish-presidenti i Bregut të Fildishtë, pas humbjes së pushtetit në shtetin e tij dhe trazirave të shkaktuara nga forcat, të cilat e kishin përkrahur atë, ishte transferuar në Hagë në vitin 2011. Në janar 2019 ai është shpallur i pafajshëm së bashku me njërin nga bashkëpunëtorët e tij të afërt, i cili ishte akuzuar së bashku me të.²⁰⁷

Sfidat më të cilat është ballafaquar kjo gjykatë janë të shumta. Një ndër ato ka qenë tërheqja e disa shteteve nga Statuti i Romës, të cilin fillimisht e kishin aprovuar. Në vitin 2016 Burundi, Afrika e Jugut dhe Gambia e kishin paralajmëruar tërheqjen me pretekst se kjo gjykatë ishte e politizuar dhe kishte për qëllim gjykimin vetëm të afrikanëve. Më atë kohë shumica e personave nën aktakuzë dhe në gjykim ishin afrikanë. Në vitin 2019 edhe

205 Shih Staturin e GJNP-së në: <https://www.icc-cpi.int/resource-library/documents/rs-eng.pdf>

206 Lawther, Moffett, Jacobs, *Research Handbook of Transitional Justice*, fq. 310.

207 Për të gjitha gjykimet e GJNP-së shih: <https://www.icc-cpi.int>

Filipinet e kishin akuzuar këtë gjykatë si raciste dhe të politizuar për shkak se ajo ishte interesuar në krimet e kryera nga Forcat shtetërore filipinase gjatë luftës së tyre kundër trafikantëve të drogës në këtë shtet.²⁰⁸ Sulmet më të ashpra kundër kësaj gjykate do të ndodhin pas kërkesës së kryeprokurores së gjykatës, Fatou Bensouda, në nëntor 2017, që të hetohen krimet e kryera në Afganistan nga talebanët dhe Forcat e sigurisë afgane, si dhe ato eventuale të kryera nga Ushtria amerikane. Kjo kishte provokuar një përgjigje të ashpër të SHBA-së dhe administrata Trump do të ndërmarrë sanksione të ashpra kundër gjykatës dhe personelit të saj, përfshirë kryeprokuroren dhe gjykatësit.

208 Për të kuptuar raportet e komplikuara të gjykatës me shtetet afrikane shih : C. C. Jalloh dhe I. Bentekas (2017). *International Criminal Court and Africa* (Eds.). Oxford: Oxford University Press.

4. Tribunalet hibride dhe/ose të ndërkombëtarizuara

Tribunalet hibride janë gjykata penale, të cilat zakonisht janë themeluar me marrëveshje ndërmjet OKB-së dhe shteteve ku kanë ndodhur krimet. Tribunalet hibride “huazojnë kryesisht nga ligji i brendshëm i shteteve në fjalë, ndërkohë që janë të ndërkombëtarizuara për sa i përket personelit të tyre, funksionimit të tyre dhe kategorive të krimeve në fjalë.”²⁰⁹ Këto gjykata quhen “të përziera” ose “të ndërkombëtarizuara” për ndryshim nga ato ndërkombëtare. Deri tani janë krijuar shtatë institucione, të cilat i plotësojnë kriteret e gjykatave hibride/ të ndërkombëtarizuara. Institucionet e para hibride janë krijuar në Kosovë dhe në Timorin Lindor nga autoritetet transitore të OKB-së, të cilat i kanë administruar këto dy vende në vitet 2000. “Panelet Rregullorja 64” të Kosovës janë krijuar në vitin 2000 dhe janë emëruar sipas Rregullores 2000/64 të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (*United Nations Mission in Kosovo-UNMIK*). Në Timorin Lindor ato janë krijuar nga Autoriteti Transitor i Kombeve të Bashkuara në Timorin Lindor (*United Nations Transitional Authority of Eastern Timor-UNTAET*) me Rregulloren 2000/15 dhe janë emëruar “Panelet e Posaçme për krime të rënda brenda Gjykatës së Qarkut të Dilit.” Tri gjykata tjera janë krijuar përmes negociatave të drejtpërdrejta ndërmjet Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe shteteve në të cilat ato janë vendosur. Këtu bëjnë pjesë: Tribunali Special për Sierra Leonen (*Special Court of Sierra Leone-SCSL*) i themeluar në vitin 2002, Dhomat e Jashtëzakonshme brenda gjykatave të Kamboxhës (*Extraordinary Chambers in the Courts of Cambodia-ECCC*) të themeluara në vitin 2003 dhe Tribunali Special për Libanin (*Special Tribunal for Lebanon-STL*) i themeluar në vitin 2009. Për dallim nga dy të parat, ky i fundit është vendosur në Hagë. Në grupin e fundit të institucioneve gjyqësore hibride bëjnë pjesë Dhoma për Krime Luftë në Gjykatën e Bosnjë-Hercegovinës e krijuar në vitin 2003 dhe Dhomat e Specializuara të Kosovës të krijuara në vitin 2015.²¹⁰ Këto dy institucionet e fundit janë themeluar nga parlamentet e shteteve të Bosnjë-Hercegovinës dhe Kosovës, pa ndonjë marrëveshje me OKB-në dhe hibriditeti i tyre ka të bëjë me ligjin, të cilin ato e zbatojnë, si dhe me stafin, i cili në rastin e Dhomës së Bosnjës është i përbërë nga vendorë dhe ndërkombëtarë, kurse në rastin e Dhomave të Specializuara të Kosovës është krejtësisht ndërkombëtare. Këto të fundit edhe janë vendosur në Hagë.

209 J-M Sorel (2011). Les Tribunaux pénaux internationaux, Ombre et lumière d'une récente grande ambition. *Revue tiers Monde* (1) 205, ff. 29-46.

210 Shih: Fichtelberg, “Transitional justice and the end of impunity,” fq. 330. Fichtelberg nuk flet për Dhomat e Specializuara të Kosovës për shkak se ato janë funksionalizuar më vonë.

Iniciativat për krijimin e mekanizmave gjyqësorë hibridë kanë lindur si nevojë për të plotësuar mangësitë e potencuara të Tribunaleve për ish-Jugosllavinë dhe Ruandën, të cilët janë kritikuar për mungesë të legjitimitetit lokal. Tribunalet hibride janë konceptuar si institucione, të cilat do të kenë një depërtim më të madh tek shoqëritë paskonfliktuale duke ndikuar që norma e drejtësisë të jetë më e pranishme. Duke pasur parasysh se përvetësimi i vlerave të drejtësisë i promovuar nga tribunalet ad hoc kishte qenë i vogël, tribunalet hibride mendohej se do të kenë më shumë kapacitete ndërtuese duke përfshirë edhe fuqizimin e sistemeve gjyqësore lokale.²¹¹

Emërtimi i këtyre institucioneve ndryshon. Në disa raste ato janë quajtur “gjkata” ose “tribunale”, kurse në tjerat “panele” ose “dhoma.”²¹² Ndryshime në emërtime ka edhe në vetë organet e këtyre institucioneve. Secili nga këto institucione është krijuar si përgjigje ndaj një konflikti specifik, në rrethana politike specifike, gjë që i bën përgjithësimet e vështira.²¹³ Kjo është edhe arsyeja pse nuk ka një model unik, i cili do të mund t’u përgjigjej të gjitha situatave paskonfliktuale.²¹⁴ Megjithatë, edhe përtej diferencave ndërmjet tyre ato i kanë disa karakteristika të përbashkëta. Një ndër ato është se ato kombinojnë kombëtaren dhe ndërkombëtaren dhe, në përjashtim të Tribunalit Special për Libanin dhe Dhomave të Dpecializuara të Kosovës, ato kryesisht veprojnë ose kanë vepruar brenda juridiksioneve ku janë kryer krimet. Ato kanë ngjashmëri edhe me gjykatat penale ndërkombëtare për nga misioni i tyre, që është t’i përgjigjen dhunës masive të kryer në të kaluarën.²¹⁵ Ashtu sikur tribunalet ndërkombëtare penale (në përjashtim të GJNP-së), këto gjykata janë të përkohshme. Për dallim nga gjykatat penale ndërkombëtare, “ato kombinojnë elemente të drejtësisë ndërkombëtare me aspekte të drejtësisë së brendshme dhe forma specifike dhe të reja.”²¹⁶ Hibriditeti i këtyre gjykatave ka të bëjë edhe me personelin e tyre, i cili është po ashtu i përzier. Prokurorët, gjykatësit, avokatët mbrojtës, si dhe personeli administrativ dhe ndihmës i këtyre gjykatave përbëhet nga vendorë dhe ndërkombëtarë (në përjashtim të Dhomave të Specializuara të Kosovës, të cilat kanë staf ekskluziv ndërkombëtar).²¹⁷ Hibriditeti ka të bëjë edhe me ligjin, të cilin këto gjykata e zbatojnë, e që është një kombinim i ligjeve ndërkombëtare dhe atyre të shteteve në të cilat janë kryer krimet.²¹⁸ Përveç kësaj ka edhe diferenca të tjera. Disa nga këto gjykata janë krijuar fill pas përfundimit të konfliktit,

211 D. Sharp (2018). *Rethinking Transitional Justice for the Twnty First Century, beyond the End of History*. Cambridge: Cambridge University Press, fq. 48.

212 A. Fichtelberg (2015). *Hybrid Tribunals, a Comparative Examination*. New York Heidelberg Dordrecht London: Springer, fq. XII.

213 Fichtelberg, “Transitional justice and the end of impunity,” fq. 328.

214 Kerr dhe Mobekk, *Peace and Justice, seeking accountability after war*, fq. 2.

215 Fichtenberg, “Transitional justice and the end of impunity,” fq. 328

216 Po aty.

217 Po aty.

218 Po aty.

kurse të tjerat shumë vjet pas konfliktit. Nga aspektet që i bashkojnë këto gjykata është personeli ndërkombëtar, i cili ka lëvizur shpesh nga një gjykatë në tjetrën.²¹⁹

4.1. “Panelet Rregullorja 64” në gjykatat e Kosovës

Këto panele janë krijuar në kuadër të hapave të ndërmarrë nga UNMIK-u për të ndërtuar një sistem gjyqësor në Kosovë i cili, mes tjerash, ishte pjesë e mandatit të tij. UNMIK-u ishte mandatuar për të ushtruar pushtetin legjislativ, ekzekutiv, si dhe administrimin e gjyqësorit.²²⁰ Sistemi gjyqësor i trashëguar nga periudha e paraluftës në Kosovë kishte qenë në gjendje të vështirë. Kishte pasur infrastrukturë të dëmtuar, mungesë të gjykatave, mungesë të gjykatësve dhe prokurorëve të kualifikuar, mungesë të ekspertizës dhe, mbi të gjitha, mungesë të një mjedisi të sigurt për ndarjen e drejtësisë. Fakti se gjatë viteve 1990 gjykatësit dhe prokurorët shqiptarë të Kosovës kishin qenë të përjashtuar nga institucionet, e bënte gjendjen edhe më të vështirë.²²¹

UNMIK-u kishte filluar ndërtimin e sistemit gjyqësor të Kosovës që në shtator 1999 dhe kishte aprovuar Rregulloren 1999/7 me të cilën ishte themeluar Komisioni Këshillëdhënës Gjyqësor, roli i të cilit, sipas rregullores, ishte “të këshillonte Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm për çështjet që kanë të bëjnë me emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, sipas nevojës, si dhe me ankesat eventuale, nëse ka, kundër çdo gjyqtari ose prokurori [...] Komisioni mund të ofrojë këshilla edhe për çështje të tjera lidhur me sistemin gjyqësor.”²²² Komisioni përbëhej nga tetë ekspertë, nga të cilët tre duhej të ishin ndërkombëtarë dhe 5 vendorë. Kjo rregullore përcaktonte edhe rregullat e emërimit dhe shkarkimit të gjykatësve vendorë.²²³ Në muajt vijues Përfaqësuesi Special do të fillojë emërimin e gjykatësve në të gjitha nivelet e gjyqësorit në Kosovë. Nga momenti i aprovimit të Rregullores 1999/7 në shtator 1999, deri në gusht të vitit 2000, Përfaqësuesi Special kishte emëruar gjithsej 662 gjykatës dhe prokurorë, shumica e tyre shqiptarë të Kosovës.²²⁴

219 Fichtelberg, *Hybrid Tribunals, a Comparative Examination*, fq. XII.

220 F. Donlon, “Hybrid Tribunals,” In Schabas, Bernaz, *Routledge Handbook of International Criminal Law*, fq. 87.

221 Për sfidat me të cilat ishte ballafaquar sistemi gjyqësor në Kosovë pas luftës shih raportin e Amnesty International të janarit 2008 : “Kosovo (Serbia): The challenge to fix a failed UN justice mission,” i qasshëm në: <https://www.refworld.org/pdfid/47a0584a2.pdf>

222 Shih: UNMIK/RREG/1999/7, 7 shtator 1999, Neni 1. https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A1999regs/RA1999_07.htm

223 Një ndër funksionet e Komisionit Këshillëdhënës Gjyqësor do të jetë edhe përzgjedhja e gjykatësve dhe prokurorëve (neni 5). Nenet 6 dhe 7 të kësaj rregulloreje përcaktojnë kriteret.

224 F. Donlon, “Hybrid Tribunals,” fq. 88

Presioni i ushtruar ndaj gjykatësve vendorë, në veçanti në rastet që kishin të bënin me ngritjen e aktakuzave dhe gjykimin e shqiptarëve të cilët kishin kryer krime lufte ose shkelje tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare, do të krijojë brengë tek UNMIK-u se drejtësia nuk do të mund të shpërndahej në mënyrë të pavarur dhe të drejtë nëse të gjitha kompetencat janë në duart e shqiptarëve. Tensionet ndëretnike e bënin situatën edhe më të komplikuar. Komisioni Këshillëdhënës Gjyqësor i UNMIK-ut do të propozojë themelimin e një gjykate të Kosovës për krime lufte dhe krime etnike, e cila do të merrej vetëm me këto krime.²²⁵ Komisioni kishte rekomanduar që kjo gjykatë të vendosej në Kosovë dhe të jetë e përbërë nga gjykatës dhe prokurorë vendorë dhe ndërkombëtarë. Roli i saj do të ishte t'i gjykonte krimet e gjenocidit, krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës, si dhe dhunën ndëretnike përmes ligjit vendor. Kjo gjykatë nuk do të krijohet kurrë për shkak të kostos të cilën buxheti i UNMIK-ut nuk mund ta përballonte. Kishte pasur edhe kundërshtime të fuqishme brenda shumicës shqiptare kundër një gjykate të tillë.²²⁶

Sulmi me mortajë i një autobusi të Komisarariatit të lartë për refugjatë të OKB-së (UNHCR) më 2 shkurt 2000, i cili po transportonte serbë lokalë brenda enklavave serbe në veri të Kosovës, si dhe përshkallëzimi i trazirave ndëretnike që do të pasojë në Mitrovicë, kishte bërë që UNMIK-u të integrojë gjykatës dhe prokurorë ndërkombëtarë në sistemin gjyqësor të Kosovës. Qëllimi ishte që ta rriste besueshmërinë në gjykata, si dhe t'u bëjë ballë kritikave të adresuara nga serbët lokalë se gjykatësit shqiptarë nuk kishin qenë korrektë në ndarjen e drejtësisë kur bëhej fjalë për serbët.²²⁷ Më 15 shkurt 2000, UNMIK-u do të aprovojë Rregulloren 2000/6, e cila i jepte kompetenca Përfaqësuesit Special që "të mund të emërojë dhe largojë nga detyra gjyqarë dhe prokurorë ndërkombëtarë [...]."²²⁸ Kjo rregullore përcaktonte edhe përgjegjësitë dhe detyrat e gjykatësve ndërkombëtarë. Ata, sipas saj, "do të kenë autoritetin dhe përgjegjësinë për të kryer funksionet e tyre të zyrës, duke përfshirë autoritetin për të zgjedhur dhe marrë përgjegjësinë për raste të reja penale brenda juridiksionit të gjykatës në të cilën ai ose ajo është emëruar."²²⁹ Kjo u jepte atyre të njëjtat kompetenca si gjykatësve vendorë, edhe pse e limitonte veprimin e tyre në raste penale.²³⁰ Një prokuror dhe një gjykatës ndërkombëtar do të emëroheshin nga Bernard Kouchner në Gjykatën e Qarkut të Mitrovicës. Këtu do të fillojë një eksperiencë

225 Po aty.

226 Po aty.

227 Po aty.

228 Rregullorja 2000/6 e UNMIK-ut, (sect.1-1, 1-2, 1,3)

229 Po aty.

230 M. E. Hartmann (Tetor 2003). "International Judges and Prosecutors in Kosovo: A New Model for Post-Conflict Peacekeeping." US Institute of Peace, Special Report.

e re, e cila do t'ia hapë rrugën hyrjes së gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë në sistemin gjyqësor të Kosovës. Kjo do të çojë më pas në krijimin e paneleve të para hibride. Megjithatë, ky hap i parë do të tregohet i pamjaftueshëm për UNMIK-un, sepse gjykatësit ndërkombëtarë ishin pakicë dhe gjykatësit vendorë vazhdonin ta kontrollonin sistemin gjyqësor. Më 27 maj 2000, UNMIK-u do të aprovojë Rregulloren 2000/34, e cila do t'i japë kompetenca Përfaqësuesit Special që të emërojë gjykatës dhe prokurorë ndërkombëtarë në të gjitha institucionet gjyqësore të Kosovës. Kjo rregullore ia mundësonte atij edhe emërimin e një gjykatësi në Gjykatën Supreme. Megjithatë, as ky hap nuk do t'ua mundësojë gjykatësve të UNMIK-u që të kontrollojnë proceset gjyqësore që të mund t'i hapin rastet, sepse gjykatësit vendorë vazhdonin ta kontrollonin sistemin gjyqësor përmes mbivotimit të ndërkombëtarëve në panelet pesanëtarëshe, të cilat ishin krijuar bazuar në Kodin Penal të ish-Jugosllavisë, në fuqi para vitit 1989. Më 15 dhjetor 2000, UNMIK-u do ta aprovojë Rregulloren 2000/64, e cila u jepte primat ndërkombëtarëve në raport me vendorët. Në artikullin 2.1 të kësaj rregulloreje thuhet se “në çdo fazë të procedurës penale Departamenti i Drejtësisë [...] me vetiniciativë mund t'i bëjë rekomandime Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për caktimin e gjyqtarëve-prokurorëve ndërkombëtarë dhe për ndërrimin e vendit të tyre nëse ai konstaton se kjo është e nevojshme për të siguruar pavarësi dhe paanshmëri të gjyqësisë apo administrimin adekuat të judikaturës.”²³¹ Kjo rregullore i jepte Departamentit të drejtësisë së UNMIK-ut primat në të gjitha fazat e gjykimeve. Rregullorja precizonte se pas çdo aprovimi të kërkesave “Departamenti i drejtësisë menjëherë do të caktojë: (a) një prokuror ndërkombëtar, (b) një gjyqtar hetues ndërkombëtar dhe/ose (c) një koleg gjykues të përbërë vetëm nga tre (3) gjyqtarë, duke përfshirë së paku dy gjyqtarë ndërkombëtarë, prej të cilëve njëri do të jetë kryesues.”²³² Kjo rregullore vendosi rregulla rigorozë edhe sa i përket mbikëqyrjes së rasteve. Në shkurt 2001, UNMIK-u do të aprovojë Rregulloren 2001/2, e cila do t'ua mundësojë prokurorëve ndërkombëtarë që të kërkojnë rihapjen e çdo rasti, të cilin prokurorët vendorë e kishin mbyllur.

Këto katër rregullore të UNMIK-ut do të bëjnë që ndërkombëtarët përmes kontrollit të paneleve të mund të merreshin me të gjitha rastet e krimeve të luftës, si dhe me të gjitha rastet domethënëse si: krimi i organizuar [...] përfshirë terrorizmin, dhunën ndëretnike, vrasjet politike dhe korrupsionin.²³³ Këtu bënin pjesë edhe mandati për të gjykuar krimet e luftës të kryera para dhe pas vitit 1999. Megjithatë, numri i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë në Kosovë kishte qenë i limituar.

231 Shih rregulloren 2000/64 në: https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2000regs/RA2000_64.htm

232 Po aty, neni 2.

233 Hartmann, "International Judges and Prosecutors in Kosovo: A New Model for Post-Conflict Peacekeeping," fq.2.

“Panelet Rregullorja 64” të Kosovës janë krijuar paralelisht me panelet speciale të krijuara nga administrata ndërkombëtare në Timorin Lindor dhe këto dy modele hibride të drejtësisë si modelet e para deri atëherë do të luajnë një rol të rëndësishëm në krijimin e paneleve të ngjashme brenda Dhomës për krime lufte në Gjykatën e Bosnjë-Hercegovinës ose Tribunalit Special për Sierra Leonen.²³⁴ Madje, edhe Dhoma themelore e Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi dhe Ruandë do të përbëhet nga panele treanëtarëshe. Në kuadër të UNMIK-ut, “Panelet Rregullorja 64” u kishin dhënë qasje gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë në sistemin gjyqësor të Kosovës dhe kishin krijuar një precedent, i cili do t’u hapte rrugën prokurorëve dhe gjykatësve ndërkombëtarë që të integroheshin në sisteme lokale me të njëjtat kompetenca sikur ata vendorë. Kjo do të jetë një eksperiencë e re, e cila ndryshon nga drejtësia ndërkombëtare penale e tribunaleve të delokalizuar, të cilët ndanin një drejtësi “teknokratike” me mijëra kilometra larg. Megjithatë, këto panele nuk do të jenë edhe aq të suksesshme në administrimin e drejtësisë në Kosovë. Shkaqet janë të shumta. Mundësia që ndërkombëtarët t’ua merrnin rastet gjykatësve lokalë në çdo kohë kishte pasur edhe frustrimet e veta për këta të fundit, sepse kjo kishte pasur për efekt reduktimin e pushtetit të kryetarëve të gjykatave të qarkut si dhe prokurorëve, të cilët më parë kishin pasur pushtet absolut për caktimin e gjykatësve dhe zëvendësprokurorëve të rasteve.²³⁵ UNMIK-u ishte kritikuar për krijimin e një sistemi kuazi-paralel të drejtësisë në Kosovë, gjë që në fakt ishte e vërtetë, sepse kompetencat e tij nuk limitoheshin vetëm në emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, por edhe në seleksionimin e rasteve.²³⁶ Për të zbutur kritikën, UNMIK-u kishte emëruar në çdo “Panel Rregullorja 64” një gjykatës vendor edhe pse, në shumë raste të ndjeshme që kishin të bënin me krime lufte ose krim të organizuar, kosovarët kishin refuzuar të merrnin pjesë.²³⁷ “Panelet Rregullorja 64” kishin filluar të funksiononin menjëherë pas aprovimit të tyre dhe deri në fund të vitit 2001 rreth 80 procese gjyqësore në Kosovë ishin duke u gjykuar përmes tyre. Gjithashtu, një numër i madh i proceseve gjyqësore ishin nën mbikëqyrjen e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë.²³⁸

Në Kosovë dhe në Timorin Lindor administratat e OKB-së kishin pasur hapësirë t’i impononin këto panele përmes rregulloreve, të cilat ishin “legjislacioni” i tyre dhe u kishin dhënë atyre kompetenca të gjera. Aq sa do të konsiderohen këto panele si model i

234 Po aty.

235 Po aty, fq. 8.

236 Po aty, fq. 12.

237 Po aty.

238 Po aty.

ndërtimit të një sistemi të drejtësisë lokale të mirëfilltë, në shtete të tjera kjo do të provokojë skepticizëm dhe ky model i deposedimit të lokaleve do të kundërshtohet. Kështu, në disa vende si Kamboxhia, për shembull, qeveria e këtij shteti do të refuzojë dominimin e paneleve nga ndërkombëtarët. Kompetencat e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë do të limitohen vetëm për krimet e luftës dhe/ose krimet e tjera të kryera në kuadër të konflikteve të armatosura. Kështu, me rastin e diskutimeve të strukturës së këtyre dhomave është insistuar që gjykatësit vendorë të dominojnë në çdo panel. Gjithashtu prokurori ndërkombëtar do të ishte i subordinuar i prokurorit vendor (shih ECCC).

Nëse fokusohemi tek rasti i “Paneleve Rregullorja 64” mund të përfundojmë se përparësi e këtyre paneleve kishin qenë profesionalizmi dhe transparenca më e madhe e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë në raport me vendorët. Rastet e konsideruara “të nxehta”, ku vendorët do t’i ishin nënshtruar presionit, kanë mundur të trajtoheshin më mirë nga ndërkombëtarët edhe për shkak të sigurisë më të madhe që ata kishin. Në anën tjetër, rreziku ka qenë që gjykatësit dhe prokurorët vendorë të tërhiqeshin nga panelet dhe për çdo dështim t’i akuzonin ndërkombëtarët. Në anën tjetër, këto panele konsideroheshin nga vendorët si shkelje e pavarësisë gjyqësore duke pasur parasysh se UNMIK-u me këto rregullore ushtronte kontroll duke pasur mundësi që çdo rast t’ua marrë vendorëve pa u dhënë shpjegime se pse po e bënte këtë. Hartmann konsideron se fakti që gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë emëroheshin për një periudhë 6-mujore nga Përfaqësuesi Special, mund të krijonte spekulime se ata, “për hir të vazhdimit të mandatit të tyre, vepronin në përputhje me vullnetin e Përfaqësuesit Special dhe mund të ishin të ndikuar.”²³⁹

239 Po aty, fq. 8.

4.2. Panelet e Posaçme për Krime të Rënda brenda Gjykatës së Qarkut të Dilit

Timori Lindor ka qenë territor i okupuar nga Indonezia që nga viti 1974. Më 30 gusht 1999 kjo provincë ka organizuar referendum për atë se a donte të mbetej pjesë e Indonezisë me një autonomi më të gjerë apo donte të pavarësohej. Ky referendum ishte organizuar vetëm një vit pas rënies nga pushteti i diktatorit indonezian Suharto. Në këtë referendum, 78% e pjesëmarrësve kishin votuar për pavarësi. Ky referendum ishte mbikëqyrur nga një mision i OKB-së. Pas referendumit kundërshtarët e pavarësisë, të cilët përkraheshin nga ushtria dhe administrata indoneziane, kishin provokuar dhunë masive e cila kishte rezultuar, mes tjerash, me qindra të vdekur, të torturuar, të dhunuar, si dhe me shkatërrime masive të infrastrukturës së vendit. 80% e ndërtesave të Dilit, kryeqytetit të Timorit Lindor, ishin dëmtuar.²⁴⁰ Për t'i dhënë fund situatës kaotike dhe për ta rikthyer rregullin, më 25 tetor 1999, OKB-ja do të votojë Rezolutën 1272 me të cilën Timori Lindor do të vendoset nën administrimin e OKB-së. Në këtë vend do të dërgohet një mision i OKB-së, i cili do të ketë për detyrë ta administrojë vendin dhe t'i asistojë vendorët që të ndërtojnë shtetin. Administrata Transitore e Kombeve të Bashkuara në Timorin Lindor (*United Nations Transitional Administration of Eastern Timor-UNTAET*) do të jetë e mandatar për ta administruar Timorin Lindor duke ushtruar të gjithë pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv, përfshirë edhe administrimin e drejtësisë.²⁴¹ Forcat e OKB-së kishin për qëllim që ta ndihmonin Timorin që të përgatisë shpalljen e pavarësisë, e cila do të bëhet në vitin 2002.²⁴²

Në momentin e shtrirjes së trupave të OKB-së, në fund të vitit 1999, Timori Lindor ishte vend pa qeveri, pa infrastrukturë dhe me mungesë totale të sistemit gjyqësor. OKB-ja kishte krijuar një komision hetues, i cili kishte raportuar për qindra individë të vrarë, si dhe për mijëra persona të zhvendosur dhe për shkatërrime masive të pronave nga grupe, të cilat kishin qenë kundër pavarësisë. Shumica e këtyre krimeve ishin kryer në muajt që kishin vijuar referendumin, por kishte pasur edhe raste që ato i kishin paraprirë votimit. Komisioni hetues i OKB-së kishte propozuar që në këtë vend të krijohet një tribunal penal ndërkombëtar ad hoc i ngjashëm me TNPJ ose TNPR për t'i trajtuar këto krime, por ky propozim nuk kishte marrë përkrahjen e duhur në OKB. Në mungesë të një institucioni të tillë mbetej që këto krime të trajtoheshin nga UNTAET-i. Ngjashëm si UNMIK-u në Kosovë, edhe UNTAET-i ka qeverisur me rregullore.

240 L. Raub (2009). Positioning Hybrid Tribunals in International Criminal Justice. *International Law and Politics*, (41) 1013. ff. 1023-40.

241 Shih Rezolutën 1272 në : <http://unscr.com/en/resolutions/1272>

242 A-Y. Bilala (2014). *Le Tribunal spécial pour le Liban : une Juridiction Hybride d'un genre Nouveau*, Paris : Editions Connaissances et Savoirs, fq. 23.

Në përpjekjen për ndërtimin e sistemit gjyqësor në këtë vend, në mars 2000, UNTAET-i ka aprovuar Rregulloren 2000/11²⁴³, e cila përcaktonte organizimin e sistemit të gjykatave në këtë vend. Kjo rregullore përcaktonte dy shkallë të drejtësisë (gjykatat e qarqeve dhe ato të apelit) dhe në kuadër të këtyre gjykatave parashihte krijimin e paneleve të përbëra nga tre gjykatës. Në qershor 2000 do të aprovohej Rregullorja 2000/15²⁴⁴, e cila vendoste panelet në Gjykatën e Qarkut në Dili dhe precizonte se këto panele duhej të përbeheshin nga dy gjyqtarë ndërkombëtarë dhe një gjyqtar nga Timori Lindor.²⁴⁵ Rregullorja përcaktonte se edhe panelet në Gjykatën e Apelit në Dili “do të përbeheshin nga dy gjyqtarë ndërkombëtarë dhe një gjykatës nga Timori Lindor. Në raste me rëndësi të veçantë ose gravitet mund të themelohej një panel prej pesë gjyqtarësh i përbërë nga tre gjyqtarë ndërkombëtarë dhe dy gjyqtarë nga Timori Lindor.”²⁴⁶ Sa u përket krimeve të luftës që këto panele duhej t’i trajtonin, juridiksioni kohor ishte nga 1 janari 1999 deri më 25 tetor 1999. Këto panele ishin mandatuar për t’i gjykuar 6 kategori të krimeve, të cilat janë të precizuara në rregullore dhe që ishin: “gjenocidi, krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit, vrasjet, dhuna seksuale dhe tortura.”²⁴⁷ Shumica e krimeve që figuronin në Rregulloren 2000/15 ishin një përzierje e ligjeve të nxjerra nga Statuti i Romës dhe ligjeve të tjera ndërkombëtare, si dhe ligjeve të Indonezisë, të cilat i mbulonin ato ligje që nuk ishin të mbuluara nga Statuti i Romës.²⁴⁸ Deri në vitin 2003 ka pasur vetëm një panel në Gjykatën e Dilit dhe më pas janë krijuar dhe dy të tjera. Përveç paneleve të përzierra, UNTAET-i kishte krijuar edhe Njësinë për krime serioze, e cila vepronte në kuadër të Prokurorisë së Përgjithshme të Timorit Lindor dhe hetonte krimet serioze.

Panelet speciale kanë ngritur rreth 400 aktakuza, edhe pse një pjesë e madhe e personave nën aktakuzë kanë qenë të strehuar në Indonezi. Kjo e fundit ka refuzuar t’ia ekstradojë Timorit këta persona. Shumica e personave përgjegjës për krimet e kryera para dhe pas referendumit kishin qenë indonezianë, të cilët pas tërheqjes së trupave indoneziane kishin kaluar në Indonezi. Kjo kishte bërë që pak persona që kishin kryer krime kishin mbetur në Timorin Lindor. Këto gjykata kishin shpallur aktakuzë kundër gjeneralit indonezian, Wiranto, në vitin 2003, por ai nuk ishte paraqitur kurrë para drejtësisë.

243 Shih: UNTAET/REG/2000/11, 6 mars 2000, për organizimin e gjykatave në Timorin Lindor: <https://peacekeeping.un.org/mission/past/etimor/untaetR/Reg11.pdf>

244 UNTAET/REG/2000/15, 6 qershor 2000 mbi themelimin e paneleve me juridiksion të veçantë për krime serioze.

245 Po aty. Atr. 22, Neni 22.1.

246 Po aty. Art. 22, art. 2.2.

247 Po aty.

248 Raub, Positioning Hybrid Tribunals in International Criminal Justice, fq. 1030.

Pas shpalljes së pavarësisë së Timorit Lindor më 20 maj 2002, UNTAET-i do t'ia bartte panelet institucioneve vendore, të cilat më pas do të rregulloheshin me kushtetutë të këtij shteti. Kishte pajtim që këto panele të vazhdonin punën e tyre deri në përfundimin e rasteve.²⁴⁹ Gjithsej, panelet e specializuara kanë mbajtur 55 procese gjyqësore, ku janë gjykuar 88 persona. Katër persona janë liruar si të pafajshëm, kurse 84 prej tyre janë dënuar. Vendimi i Këshillit të Sigurimit të OKB-së që në maj 2005 t'ua shkurtojë punën paneleve i ka lënë 514 raste të hetuara të hapura.²⁵⁰

Një ndër sukseset e këtyre paneleve speciale ka qenë inkuadrimi i gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë në gjykatat lokale. Vendorsja e tyre brenda gjykatave vendore ka qenë element i rëndësishëm i respektimit të sistemit gjyqësor të Timorit Lindor, edhe pse mungesa e një ndarjeje të qartë të përgjegjësive ndërmjet OKB-së dhe Qeverisë së Timorit Lindor ka bërë që asnjëra palë mos të marrë përgjegjësi për dështimet e tyre.²⁵¹ Ngjashëm me Kosovën, panelet speciale janë ballafaquar me probleme të shumta operationale, teknike dhe logjistike, si dhe me mungesë të sigurisë për personelin gjyqësor. Në veçanti, kur ato kanë trajtuar profile të larta.²⁵² Një problem tjetër kanë qenë emërimet e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, si dhe i stafit në përgjithësi, të cilat shpesh kanë qenë të bllokuara për shkak të mospajtimeve ndërmjet Qeverisë së Timorit Lindor dhe OKB-së.²⁵³

4.3. Tribunali Special për Sierra Leonen

Ky Tribunal është themeluar në korrik 2002 nga Qeveria e Sierra Leones, në bashkëpunim me OKB-në dhe është vendosur në kryeqytetin e këtij shteti, Freetown. Zyrtarisht ai është aprovuar nga Parlamenti i Sierra Leones si pjesë e sistemit gjyqësor të këtij shteti. Në Sierra Leone kishte pasur një luftë civile gjatë viteve 1990, ku ishin konfrontuar disa fraksione rivale. Mandati i këtij Tribunali ishte ndjekja penale e personave përgjegjës për shkelje serioze të Ligjit ndërkombëtar humanitar dhe Ligjit të Sierra Leones, pas 30 nëntorit 1996. Statuti i TSSL përcaktonte se ky Tribunal "[...] ka kompetencë të ndjekë penalisht personat që mbajnë përgjegjësinë më të madhe për shkelje serioze të Ligjit ndërkombëtar humanitar dhe Ligjit të Sierra Leones të kryera në territorin e Sierra Leones pas 30 nëntorit 1996,

249 Donlon Fidelma, *Hybrid Tribunals*, fq. 87.

250 Raub, *Positioning Hybrid Tribunals in International Criminal Justice*, fq. 1030.

251 Po aty.

252 Po aty.

253 Po aty.

përfshirë ata udhëheqës të cilët, duke kryer krime të tilla, kanë kërcënuar vendosjen dhe zbatimin e procesit të paqes në Sierra Leone.²⁵⁴ Ngjashëm me Tribunalet Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavi dhe Ruandë, edhe këtu paqja dhe siguria duhej të arriheshin duke ndjekur penalisht kriminelët e luftës të konsideruar si kërcënim për paqen dhe sigurinë e Sierra Leones dhe atë ndërkombëtare.

Statuti i Tribunalit i jepte primat në çdo aspekt komponentit ndërkombëtar. Gjykatësit ndërkombëtarë i dominonin ata vendorë në të dyja Dhomat e Tribunalit (Themelores dhe Apelit). Nga tre gjykatës sa numëronte Dhoma Themelore, dy duhej të ishin ndërkombëtarë dhe një lokal. Nga 5 gjykatës sa duhej të kishte Dhoma e Apelit, 3 duhej të ishin ndërkombëtarë dhe dy vendorë. Gjykatësit ndërkombëtarë i emëronte Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, kurse ata vendorët Qeveria e Sierra Leones.²⁵⁵ Vendimet merreshin me shumicë në të dyja nivelet.²⁵⁶ Prokurori gjithashtu emërohej nga Sekretari i Përgjithshëm dhe asistohet nga një zëvendësprokuror vendor.²⁵⁷ Tribunali Special kishte primat mbi gjykatat vendore të Sierra Leones. Statuti përcaktonte se “në çdo fazë të procedurës, Tribunali Special mund të kërkojë zyrtarisht një gjykatë shtetërore që t’i nënshtrohet kompetencës së tij në përputhje me këtë Statut dhe Rregulloren e procedurës dhe provave.”²⁵⁸

Lufta civile në Sierra Leone kishte filluar në vitin 1991 dhe kishte zgjatur deri në vitin 2002. Numri i viktimave në këtë shtet supozohet se ka qenë rreth 70,000 dhe 2.6 milionë njerëz ishin të zhvendosur.²⁵⁹ Lufta civile ishte karakterizuar me krime të kryera në shkallë të lartë, duke përfshirë rrëmbimin e fëmijëve dhe përdorimin e tyre në luftë si ushtarë. Mijëra qytetarëve të këtij shteti u ishin prerë duart. Një raport reference mbi luftën civile në këtë shtet i bërë nga Mary Kaldor thuhet se “kushtet të cilat kishin çuar në luftë kanë qenë një shtet represiv grabitqar, varësia nga minierat, impakti i rregullimit strukturor, një popullsi e re e përjashtuar, prezenca e armëve të vogla pas përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe ndërhyrjet nga shtetet fqinje të rajonit.”²⁶⁰

254 Shih statutin e TSSL në: <https://web.archive.org/web/20120506064126/http://www.sc-sl.org/LinkClick.aspx?fileticket=uClnd1M-JeEw%3D&tabid=70>

255 Art. 12 i Statutit të TSSL-së

256 Art. 18.

257 Art. 15.

258 Art. 8.

259 Shih Raportin: M. Kaldor, J. Vincent (2006). Case Study Sierra Leone, Evaluation of UNDP Assistance to conflict-affected countries, <http://web.undp.org/evaluation/documents/thematic/conflict/SierraLeone.pdf>

260 Po aty.

Një ndër fraksionet më brutale, i cili i kishte luftuar forcat qeveritare kishte qenë Fronti i Bashkuar Revolucionar në krye me Faday Sankoh dhe Sam Bockary. Ky fraksion kishte qenë terrorizues i popullsisë në zonat që i kishte vendosur dhe mbajtur nën kontroll. Ai kishte synuar kontrollimin e minierave të diamantit në këtë shtet dhe ishte përkrahur nga presidenti i shtetit fqinj, Liberisë, Charles Taylor. Ky i fundit e kishte furnizuar këtë fraksion me armë dhe trajnime në këmbim të diamanteve. Para se të zgjidhej president i Liberisë, Taylor kishte qenë shef i Frontit Patriotik Nacional të Liberisë (*National Patriotic Front of Liberia*-NPFL). Ai do të gjykohet më pas nga Tribunali Special. Por krime nuk ishin kryer vetëm nga Fronti i Bashkuar Revolucionar. Dy fraksione të tjera, Forcat e Mbrojtjes Civile, të cilat kishin qenë aleate të Qeverisë së Sierra Leones dhe Këshilli Revolucionar i Forcave të Armatosura kishin kryer krime. Ky fraksioni i fundit në vitin 1997 kishte kryer grusht shtet dhe për disa muaj e kishte mbajtur pushtetin.²⁶¹

Tribunali Special ishte mandatar që të sjellë para drejtësisë liderët e këtyre fraksioneve. Nën koordinimin e prokurorit amerikan, David Crane, anëtarët e secilit nga këto grupe janë gjykuar ndaras. Ish-presidenti i Liberisë, Charles Taylor, pas arrestimit të tij ishte transferuar në Hagë dhe ishte gjykuar po ashtu ndaras.²⁶² Taylor ishte akuzuar nga TSSL-ja në mars 2003. Pas humbjes së pushteti në Liberi, disa muaj më vonë, ai kishte ikur në shtetin fqinj të Nigerisë, ku kishte qëndruar deri në arrestimin e tij, në vitin 2006. Pas transferimit të tij në Sierra Leone, Qeverie e Sierra Leones, për shkaqe sigurie, kishte kërkuar që procesi i tij gjyqësor të mbahej në Hagë, ku Tribunali Special e kishte një Dhomë. Në prill 2012, Taylor është dënuar me 50 vjet burg, dënim ky i cili është konfirmuar në shtator 2013 nga Dhoma e Apelit e këtij Tribunali. Taylor u bë kështu presidenti i parë i një shteti, i dënuar nga një gjykatë penale e ndërkombëtarizuar për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Ai është dërguar në Angli për të vuajtur dënimin. Aleatët e tij, Faday Sankoh dhe Sam Bockary, të cilët po ashtu kishin qenë nën aktakuzë të Tribunalit Special nuk janë gjykuar kurrë për shkak se kishin vdekur në vitin 2003. Sankoh kishte vdekur nga sëmundja, kurse Bockary supozohet se ishte vrarë në Liberi në po të njëjtin vit, me urdhër të vetë Charles Taylor, i cili kishte qenë mentori i tij për një kohë të gjatë. Supozohet se Taylor e kishte eliminuar për ta pamundësuar që të dëshmonte kundër tij në gjykatë.

TSSL-ja konsiderohet si një histori suksesi e drejtësisë penale ndërkombëtare. Kritikat e adresuara këtij Tribunali kanë pasur të bënin më së shumti me aktakuzat e shpallura kundër ish-liderëve të Forcave Civile të Mbrojtjes, fraksion i cili konsiderohej

261 Fichtelberg, "Transitional justice and the end of impunity: Hybrid Tribunals," fq. 330.

262 Po aty, fq 330-331.

si pjesë e forcave, të cilat e kishin mbrojtur shtetin e Sierra Leones dhe kishin qenë vendimtarë në rikthimin e presidentit Kabbah në krye të shtetit, pas rrëzimit të tij nga pushteti në vitin 1997. Fichtelberg konsideron se strategjia e prokurorisë së këtij Tribunali ka qenë që të ndiqen të gjitha palët luftuese të luftës civile në këtë shtet, në mënyrë të barabartë. Kjo strategji është kritikuar për arsye se përgjegjësia e Frontit të Bashkuar Revolucionar për krimet e kryera kishte qenë shumë më e madhe sesa ajo e fraksioneve të tjera.²⁶³ Por edhe të tjerat kishin pasur përgjegjësinë e tyre në krime. Tjetër kritikë e adresuar kësaj gjykate kishte qenë kostoja prej 300 milionë dollarësh, sa kishte kushtuar ky Tribunal. Kjo kosto konsiderohej e lartë për një tribunal hibrid, që pikërisht bazohej në koston më të ulët se tribunalet ndërkombëtare penale, të cilat kanë pasur buxhet shumëfish më të lartë.

Arritjet e këtij Tribunali janë të pakontestueshme. Përveç dënimit të Charles Taylor dhe shefave më të rëndësishëm të fraksioneve, të cilat kishin kryer krime, duhet përmendur edhe dënimet për martesat e detyrueshme, si krime kundër njerëzimit ose edhe rekrutimin e fëmijëve në grupe të armatosura. Ky Tribunal ka shpallur aktakuza kundër 23 personave. Tre prej tyre kanë vdekur para së të gjykohehin, tre të tjerë janë liruar si të pafajshëm dhe një person nuk është gjetur kurrë. Tetë nga këta janë dënuar lehtë dhe janë liruar.

4.4. Dhomat e Jashtëzakonshme në gjykatat e Kamboxhias

Dhomat e jashtëzakonshme brenda gjykatave kamboxhiane (ndryshe Tribunali i Kamboxhias ose edhe Tribunali Khmer²⁶⁴) është emri zyrtar i gjykatës që është krijuar në vitin 2003 në Kamboxhia për t'i gjykuar udhëheqësit kryesorë të regjimit Khmer Rouge për gjenocidin e kryer nga ky regjim nga vitet 1975-1979. Supozohet se 1.7 milionë viktima ishin vrarë nga ky regjim ose rreth 20% e popullsisë së këtij shteti.²⁶⁵

Megjithatë, zvarritja për gati një dekadë e themelimit të këtyre Dhomave do të bëjë që disa prej tyre të vdesin para se të dalin para drejtësisë. Disa prej tyre kishin vdekur para se të themeloheshin ato. Lideri historik i regjimit Khmer, Pol Pot, pasi që kishte ikur në xhungël, kishte vdekur në vitin 1998, por disa figura tjera të regjimit ishin ende gjallë edhe pse në një moshë shumë të shtyrë. Tranzicioni kaotik dhe mungesa e demokratizimit në

263 Fichtelberg, *Hybrid Tribunals, a Comparative Examination*, fq. XI.

264 Shih zërin e Gjykatës në: <https://www.britannica.com/topic/Khmer-Rouge-Tribunal>

265 Bilala, "Le Tribunal spécial pour le Liban," fq. 22.

këtë shtet kishte penguar vendosjen e shtetit ligjor dhe asnjë masë nuk ishte ndërmarrë për t'u ballafaquar me të kaluarën e krimeve të regjimit Khmer.

Në mungesë të ndonjë mekanizmi të brendshëm që do t'i kishte sjellë para drejtësisë ish-liderët Khmer, në vitin 1999, kryeministri i Kamboxhias, Hun Sen, i cili para se ta merrte pushtetin ishte distancuar nga regjimi Khmer, të cilit i kishte shërbyer më parë, kishte kërkuar nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së asistencë për gjykimin e ish-liderëve Khmer që ishin ende gjallë dhe disa prej të cilëve ishin arrestuar. Një komision ekspertësh që ishte dërguar në Kamboxhia nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së kishte rekomanduar themelimin e një tribunali ndërkombëtar ad hoc, i cili do të merrej me këto krime. Këtij opsiioni i ishte kundërvu Qeveria e Kamboxhias me pretekst se një institucion i tillë do ta cenonte sovranitetin e këtij shteti. Ajo i frikohej efektit destabilizues që do të kishte një institucion i tillë për regjimin autoritar të Hun Sen. Gjithashtu, krijimi i një gjykate të tillë kundërshtohej nga Kina, e cila në rast nevojë kishte mundësi ta përdorte veton e saj në Këshill të Sigurimit të OKB-së për ta bllokuar themelimin e saj. Si rezultat, Qeveria e Kamboxhias dhe OKB-ja do të akordohen që të krijojnë një gjykatë “me karakter ndërkombëtar ligjërish, institucionalisht dhe financiarisht të ndryshëm nga tribunalet ndërkombëtare ad hoc.”²⁶⁶ Ata ishin pajtuar që të themelohej një gjykatë kamboxhiane me një komponent ndërkombëtar roli i së cilës mbetej të definohej. Për ndërkombëtarët, ky komponent ndërkombëtar do të garantonte respektimin e rregullave dhe procedurave të gjykimin dhe do të pengonte ndikimet politike eventuale. Themelimi i përbashkët me OKB-në dhe stafi ndërkombëtar do t'u siguronte këtyre Dhomave konsistencë gjyqësore dhe përkrahje financiare të nevojshme.²⁶⁷ Në anën tjetër, fakti se ato formalisht ishin Dhoma kamboxhiane, ishte garanci për Qeverinë kamboxhiane se do të respektohej sovraniteti i shtetit të Kamboxhias, i cili gjatë kishte vuajtur nga ndërhyrjet e fqinjëve.²⁶⁸

Në korrik 1999, përfaqësuesit e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së dhe Qeverisë kamboxhiane kishin përgatitur ligjin, i cili do të krijonte bazat legale për themelimin e dhomave. Megjithatë, themelimi i këtyre Dhomave do të zvarritet për shkak të insistimit të Qeverisë kamboxhiane që t'i mbante ato nën kontroll. Për OKB-në, ato duhej të ishin plotësisht të pavarura nga ndikimi i politikës lokale. Gjithashtu, një sërë çështjes duhej të qartësoheshin që kishin të bënin me raportin që këto Dhoma duhej të kishin me gjykatat e tjera vendore. Qeveria kamboxhiane e kontestonte parimin e zbatuar nga Tribunali Special për Sierra Leonen që ky Tribunal të jetë mbi të gjitha gjykatat vendore. Mospajtime kishte

266 Fichtelberg, *Hybrid Tribunals, a Comparative Examination*, fq. 40.

267 Po aty, fq., 39.

268 Idid, Fq., 40.

pasur edhe përreth emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve, si dhe kuadrit ligjor, i cili do të dominonte. Si rezultat, kuadri ligjor kamboxhian do të jetë predominues në raport me atë ndërkombëtar, edhe pse OKB-ja do ta mbajë kompetencën e mbikëqyrjes. Emërimi i stafit ndërkombëtar ishte rregulluar me Ligjin mbi këto Dhoma. Artikulli 11 i këtij ligji përcaktonte se gjykatësit dhe prokurorët e këtyre Dhomave do t'i emëronte Këshilli i Lartë i Magjistraturës i Kamboxhias. 7 gjyqtarë do të jenë vendorë dhe 5 ndërkombëtarë. Gjykatësit ndërkombëtarë i emronte i njëjti këshill nga një listë e propozuar nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së. Kështu, komponenti vendor do të jetë dominues në këto Dhoma. Megjithatë, për të evituar mbivotimin e gjykatësve ndërkombëtarë nga ata vendorë, ishte vendosur rregulli i “super-shumicës” sipas të cilit, vendimet mund të merreshin vetëm nëse ato votoheshin nga “së paku një gjykatës ndërkombëtar i procedurës paraprahe ose gjyqësore.”²⁶⁹ Sa u përket prokurorëve, artikulli 16 i Ligjit për Dhomat precizonte se “dy prokurorë, një kamboxhian dhe një ndërkombëtar, të quajtur si në vijim “bashkëprokurorë”, do të jenë të ngarkuar me ndjekjet para këtyre Dhomave.”²⁷⁰

Dhomat e Kamboxhias janë karakterizuar me disfunktionime konstante dhe beteja ndërmjet vendorëve dhe ndërkombëtarëve ka qenë konstante. Këto Dhoma konsiderohen si më të politizuara nga të gjitha tribunalet hibride. Megjithatë, ato kanë arritur t'i dënojnë ish-liderët e Kampuceas Demokratike të gjallë dhe në gjendje për t'u gjykuar. Personi i parë i gjykuar, me numër 001, kishte qenë Kaing Guek Eav alias Duch, i cili e kishte udhëhequr Burgun e Sigurisë S-21 (Tuol Sleng). Ky burg simbolizonte më shumë se çdo institucion tjetër vuajtjet e popullit kamboxhian nga regjimi Khmer. I vendosur në kryeqytet (Pnom Phen), në një ndërtesë shkolle të konvertuar në burg, ky burg kishte qenë njëri nga 196 burgjet e Kmerëve, ku ishin torturuar dhe vrarë me qindra e mijëra persona. Në S-21 kishin kaluar rreth 20.000 persona dhe numri i të mbijetuarve kishte qenë më pak se dhjetë. Në korrik 2010, Duch ishte dënuar me 35 vjet burg për krime kundër njerëzimit dhe për shkelje të dispozitave të Konventës së Gjenevës. Në shkallën e Apelit ai ishte dënuar me burgim të përjetshëm. Ky proces kishte tërhequr interesim të madh dhe rreth 36.000 persona kishin marrë pjesë në seanca gjyqësore. Procesi i dytë me numër 002 kishte qenë ai i ideologut kryesor të regjimit Kmer, Nuon Chea, i cili ishte gjykuar së bashku me ish-kryetarin e Kampuceas Demokratike, Khieu Sampan. Së bashku me këta ishin akuzuar edhe dy zyrtarë tjerë të lartë, Ieng Sary dhe bashkëshortja e tij, Ieng Thirith. Ieng Sary kishte vdekur në vitin 2013, kurse Ieng Thirith ishte shpallur e paaftë për gjykim. Procesi gjyqësor 002 ishte ndarë më pas në dy pjesë 002/1

269 Stahn, *A critical introduction to international criminal law*, fq.203.

270 C. Zanghi, R. Ben Achour (2011). *Droits de l'homme et et juridictions pénales internationales*. Giuffrè editore, fq. 192.

dhe 002/2. Në 002/1, Nuon Chea dhe Khieu Sampan janë dënuar me burgim të përjetshëm për krime kundër njerëzimit. Në procesin 002/2 ata janë dënuar po ashtu me burgim të përjetshëm për gjenocid. Të tjera procese (003, 004) do të mbahen më vonë, në të cilat do të gjykohen zyrtarë tjerë të lartë të regjimit Kmer.

Duke pasur parasysh moshën e shtyrë të personave të gjykuar dhe faktin se këto procese janë mbajtur më shumë se 30 vjet pas kryerjes së krimeve, rëndësia e tyre kishte qenë para se gjithash simbolike dhe ato kanë shërbyer për të kuptuar historinë e regjimit Kmer, përmes dokumentimit të krimin, dëshmi të viktimave dhe kriminelëve, arkivave etj. Këto procese kishin tërhequr interesim të madh tek qytetarët dhe qëllimin e kishin pasur edhe t'i kontribuonin përforcimit të sistemit kamboxhian të drejtësisë.

Megjithatë, këto Dhoma janë karakterizuar me disfunkcionime të mëdha edhe për shkak të kundërshtimeve të fuqishme të Qeverisë kamboxhiane gjysmautoritare, e cila frikohej se suksesi i tyre mund ta destabilizonte regjimin. Prokurorët dhe gjykatësit ndërkombëtarë kishin refuzuar të luajnë lojën e qeverisë dhe nuk kishin hezitur edhe të jepnin dorëheqje në mënyrë demonstrative në shenjë proteste ndaj ndërhyrjeve konstante të Qeverisë përmes stafit vendor. Qeveria nuk i kishte lejuar politikanët kryesorë të regjimit në pushtet që të dëshmonin para Dhomave. Qeveria e Hun Sen kishte refuzuar edhe alokimin e mjeteve financiare që duhej të mundësonin punën e këtyre Dhomave.²⁷¹ Ndërhyrjet e Qeverisë kamboxhiane do të kenë për efekt ndarjen e komponentit ndërkombëtar dhe atij vendor në dy struktura të ndryshme paralele. Por edhe përtej të gjitha këtyre pengesave, qytetarët e Kamboxhias e kanë vlerësuar punën e dhomave.

4.5. Tribunali Special për Libanin (TSL)

Ky Tribunal është themeluar me Rezolutën 1757 të OKB-së më 30 maj 2007, “për të ndjekur penalisht personat përgjegjës për sulmin e 14 shkurtit 2005, që rezultoi me vdekjen e ish-kryeministrit libanez, Rafik Hariri, dhe me vdekjen ose plagosjen e personave të tjerë.”²⁷² Rezoluta nuk e kufizonte juridiksionin e këtij Tribunali vetëm tek ky krim, duke thënë se Tribunali mund të trajtonte edhe raste të tjera “nëse konstaton se sulme të tjera që kanë ndodhur në Liban midis 1 tetorit 2004 dhe 12 dhjetorit 2005, ose ndonjë datë të mëvonshme

271 Stahn, *A critical introduction to international criminal law...*

272 Artikulli 1, S/RES/1757, 30 maj 2007

të përcaktuar nga palët [...] janë të një natyre dhe graviteti të ngjashëm me sulmin e 14 shkurtit 2005.”²⁷³ Misioni i këtij Tribunali ishte të hetojë “qëllimin kriminal (motivin), qëllimi prapa sulmeve, natyrën e viktimave të shënjestruara, modelin e sulmeve (modus operandi) dhe kryerësit.”²⁷⁴ Në sulmin e 14 shkurtit në kryeqytetin libanez, Bejrut, përveç Rafik Haririt ishin vrarë edhe 21 persona të tjerë.

Edhe pse i themeluar me rezolutën e lartpërmendur të Këshillit të Sigurimit, këtij Tribunali i janë nevojitur edhe dy vjet të tjera për t’u funksionalizuar. Zyrtarisht ai është hapur më 1 mars 2009. Për shkaqe sigurie, ai është vendosur në Hagë, gjithnjë duke pasur edhe një Dhomë në Bejrut.

Struktura e këtij Tribunali është e përcaktuar me Artikulli 2 të Statutit të tij i votuar me po të njëjtën Rezolutë (1757) të OKB-së. Tribunali do të ketë Dhomat, Prokurorin, Regjistrin dhe Zyrën e Mbrojtjes. Sa u përket Dhomave, ato do të përbëheshin nga një gjykatës i procedurës paraprake, një dhomë themelore dhe një dhomë e apelit me mundësi të krijimit të një dhome themelore të dytë më vonë.²⁷⁵ Dhomat nuk duhet të kishin më pak se 11 dhe më shumë se 14 gjykatës gjithsej. Dhe ata ishin të shpërndarë si në vijim: një gjykatës i procedurës paraprake, tre gjykatës në Dhomën Themelore, dy prej të cilëve ndërkombëtarë dhe një gjykatës libanez. Në dhomën e apelit do të kishte 5 gjykatës gjithsej, tre nga të cilët do të jenë ndërkombëtarë dhe dy libanezë. Dhe dy gjykatës ndihmës, njëri libanez dhe tjetri ndërkombëtar.²⁷⁶ Kështu, komponenti ndërkombëtar do të jetë dominues në të dy dhomat e Tribunalit. Të gjithë gjykatësit, duke përfshirë edhe ata libanezë, do të emëroheshin nga Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së. Gjykatësit libanezë do t’i propozonte Qeveria e Libanit në një listë prej 12 vetave, nga të cilët sekretari i përgjithshëm do t’i përzgjidhte katër.²⁷⁷ Prokuroria dhe Regjistri janë të rregulluar me Art. 3 dhe 4 të Statutit. Prokurori zgjidhet po ashtu nga Sekretari i Përgjithshëm pas konsultimit me Qeverinë e Libanit për një mandat 3-vjeçar me mundësi të rizgjedhjes nëse ai e konsideron të nevojshme.²⁷⁸ Qeveria e Libanit në konsultime me Sekretarin e Përgjithshëm e emëron një zëvendësprokuror, i cili do ta asistonte prokurorin. Sekretari i Përgjithshëm e emëronte gjithashtu Regjistrin, i cili duhej të ishte staf i OKB-së.

Ky Tribunal do të ketë prioritet mbi të gjitha gjykatat vendore të Libanit dhe zbaton

273 Po aty.

274 Po aty.

275 Art. 2 (1,2)

276 Po aty. Art. 3 (a,b,c,d,e)

277 Art. 3.1.

278 Art 3.

ekskluzivisht ligjin vendor të Libanit. Kjo e dallonte nga Tribunali Special për Sierra Leonen dhe Dhomat e Kamboxhias, të cilët kombinonin ligjet vendore me ato ndërkombëtare. Tjetër veçori është themelimi i tij përmes një Rezolutive të OKB-së e jo nga institucionet libaneze, edhe pse formalisht ai është votuar nga Parlamenti Libanez. Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të OKB-së është bazuar në Kapitullin VII të Kartës së OKB-së. Kjo i jep këtij Tribunali një dimension të fuqishëm ndërkombëtar. Për nga kompetencat, ky Tribunal ka pak hapësirë veprimi, sepse mund të shpallë aktakuza dhe t'i gjykojë vetëm personat përgjegjës për vrasjen e ish-kryeministrit libanez, Rafik Hariri, dhe personave të cilët kanë vdekur gjatë këtij sulmi.²⁷⁹ Tribunalet e tjera kanë të bëjnë me gjykimin e krimeve masive. Veçori tjetër që e dallon nga të gjitha institucionet e tjera ndërkombëtare hibride është se ky Tribunal ka kompetencë të gjykojë edhe në mungesë (*in absentia*). Artikulli 22 i Statutit të këtij Tribunali numëron një numër rastesh në të cilat mundësohet gjykimi në mungesë.²⁸⁰ Situatat janë të ndryshme: nëse personi i akuzuar është shprehur me shkrim se nuk dëshiron të jetë prezent; nëse nuk i është dorëzuar Tribunalit nga autoritetet shtetërore; nëse nuk mund të lokalizohet edhe kur janë ndërmarrë të gjitha masat për sjelljen e personit të akuzuar në gjykatë.²⁸¹ Tjetër veçori e këtij Tribunali në raport me tribunalet e tjera ndërkombëtare dhe hibride është se ai mund të trajtojë krimin e terrorizmit. Artikulli 2 i Statutit të këtij Tribunali thotë se ai zbaton “dispozitat e Kodit Penal Libanez që kanë të bëjnë me ndjekjen penale dhe ndëshkimin e akteve të terrorizmit, krimet dhe veprat penale kundër jetës dhe integritetit personal [...]”²⁸²

Tribunali Special për Libanin konsiderohet si një ndër dështimet më të mëdha nga të gjitha institucionet penale ndërkombëtare ose hibride. Deri tani ai ka shpallur vetëm një aktakuzë për vrasjen e ish-kryeministrit libanez, Rafik Hariri, dhe nuk ka arritur kurrë që t'i sjellë në gjykatë të akuzuarit. Madje nuk ka arritur as ta vërtetojë përgjegjësinë e tyre. Njëri nga personat e akuzuar ka vdekur në vitin 2016 në Siri, kurse tre të tjerët janë shpallur të pafajshëm më 18 gusht 2020. Ky Tribunal ka gjykuar edhe një numër gazetarësh për obstrukcion ndaj drejtësisë.

279 Raub, Positioning Hybrid Tribunals in International Criminal Justice, fq. 1039.

280 Art. 22, S/RES/1757, 30 maj 2007

281 Po aty.

282 Art. 2. Po aty.

4.6. Dhoma për Krime Luftë në Gjykatën e Bosnjë-Hercegovinës

Kjo Dhomë është themeluar më 9 mars 2005 dhe është vendosur brenda Gjykatës së Bosnjë-Hercegovinës, e cila është instanca më e lartë gjyqësore e saj. Ajo është themeluar më 3 korrik 2002 nga Parlamenti i këtij shteti, bazuar në dispozitat e Marrëveshjes së Dejtonit të nënshkruar në vitin 1995. Kjo gjykatë është kompetente mbi të dy entitetet e Bosnjë-Hercegovinës (Republika Srpska dhe Federata e Bosnjë-Hercegovinës). Ajo zbaton ekskluzivisht ligjet e këtij shteti dhe përbëhet nga tri divizione, që janë: Administrativ, Penal dhe i Apelit. Divizioni Penal është po ashtu i ndarë në tri seksione, të cilat janë: Seksioni i parë, ku bën pjesë Dhoma për Krime Luftë, Seksioni i dytë, ky bëjnë pjesë krimi i organizuar, krimet ekonomike dhe korrupsioni dhe Seksioni i tretë, ku bëjnë pjesë krimet e përgjithshme. Divizioni i Apelit ka të bëjë me apelimin e vendimeve të divizioneve penale dhe administrative. Kjo gjykatë ka edhe Regjistrin për krime luftë, krim të organizuar, krime ekonomike dhe korrupsion.²⁸³

Dhoma për Krime Luftë është themeluar me reformën e drejtësisë të vitit 2004 dhe është vendosur brenda Gjykatës së Bosnjë-Hercegovinës.²⁸⁴ Me këtë reformë është themeluar edhe Departamenti Special për krime luftë brenda Zyrës së prokurorit shtetëror të Bosnjë-Hercegovinës. Juridiksioni dhe struktura që e përcakton funksionimin e Dhomës për krime luftë janë të definuar me Ligjin për Gjykatën e Bosnjë-Hercegovinës, kurse Departamenti special për krime luftë është i rregulluar me Ligjin për prokurorinë e Bosnjë - Hercegovinës. Në këtë aspekt kjo Dhomë është pjesë e sistemit gjyqësor të Bosnjë-Hercegovinës. Kështu, kjo Dhomë është e ndryshme nga gjykatat e tjera hibride të analizuara më lart dhe të cilat janë themeluar zakonisht në bashkëpunim me OKB-në.

Kjo Dhomë ka gjithsej pesë panele të përbëra nga tre gjykatës. Deri në vitin 2008, këto panele kishin qenë të përbëra nga dy gjykatës ndërkombëtarë dhe një gjykatës vendor. Ky model ishte marrë nga "Panelet Rregullorja 64" në Kosovë. Megjithatë, me kohë, kjo do të ndryshojë dhe numri i gjykatësve ndërkombëtarë do të reduktohet në një për panel. Kjo Dhomë ka edhe Kolegjin e apelit për krime luftë, i cili po ashtu, deri në vitin 2008, kishte qenë i përbërë nga tre gjykatës ndërkombëtarë dhe dy gjykatës vendorë. Më pas, numri i gjykatësve ndërkombëtarë është reduktuar edhe në këtë Dhomë. Sa u përket prokurorëve ndërkombëtarë brenda Departamentit Special për Krime Luftë, ata kurrë nuk kanë qenë shumicë. Gjykatësit ndërkombëtarë të kësaj Dhome kanë mandat dyvjeçar

283 Shih Ligjin për Gjykatën e Bosnjë-Hercegovinës në: https://www.un.org/en/genocideprevention/documents/atrocity-crimes/Doc.48_Law_on_Court_BiH_-_Consolidated_text_-_49_09.pdf

284 Për të njohur fazat e ndryshme të themelimit të kësaj dhome shih raportin e Human Rights Watch: "Looking for Justice, The War Crimes Chamber in Bosnia and Herzegovina," të publikuar më 7 shkurt 2007, i qasshëm në: <https://www.hrw.org/report/2006/02/07/looking-justice/war-crimes-chamber-bosnia-and-herzegovina>

me mundësi të prolongimit një mandat. Edhe brenda Regjistrisë të Gjykatës së Bosnjë-Hercegovinës kishte pasur staf ndërkombëtar karshi atij vendor.²⁸⁵ Emërimet të gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë i paraprin parapërgatitja nga Regjistri i gjykatës dhe rekomandimi i përbashkët i kryetarit të Gjykatës dhe kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial të Shtetit, dhe më pas ata emërohen nga Përfaqësuesi i Lartë për Bosnjë-Hercegovinën, bazuar në Aneksin 10 (art.5) të Marrëveshjes së Dejtonit. Gjykatësit ndërkombëtarë “emërohen vetëm në seksionet I dhe II, kurse prokurorët ndërkombëtarë vetëm në Departamentin Special për Krime Luftë dhe Departamentin special për krim të organizuar, krim ekonomik dhe korrupsion.”²⁸⁶ Gjyqtarët (vendorë dhe ndërkombëtarë) mund të lëvizin nga Seksioni I (krime luftë) në Seksionin II (krim i organizuar). Sa u përket gjykatësve vendorë, ligji parashih që të tri grupet etnike (boshnjakët, serbët dhe kroatët) të jenë të përfaqësuar proporcionalisht brenda Dhomës. Emërimi i tyre bëhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor i shtetit, kurse prokurorët vendorë nga Këshilli prokurorial. Kryetari i Gjykatës po ashtu zgjidhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Dhoma për Krime Luftë mbetet aktualisht institucioni më kredibil për gjykimin e krimeve të luftës në Bosnjë-Hercegovinë, edhe pse kjo Dhomë nuk është e vetmja, e cila është kompetente për të gjykuar krimet e luftës. Ka edhe 10 gjykata penale në nivel të dhjetë kantoneve që përbëjnë Federatën e Bosnjë-Hercegovinës, si dhe pesë gjykata të qarqeve në entitetin e Republika Srpskas që kanë kompetenca të tilla. Këtyre duhet shtuar edhe Gjykatën penale të distriktit të Brçkos.²⁸⁷

Deri në vitin 2017 institucioni relevant për krime luftë ka qenë Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, i cili ishte krijuar në vitin 1993 dhe ishte i vendosur në Hage. Inicimi i themelimit të Dhomës për krime luftë në vitin 2004 përputhet me kompletimin e shpalljes së aktakuzave të TNPJ-së. Puna e TNPJ-së ka qenë e afatizuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së.²⁸⁸ Krijimi i Dhomës për krime luftë kishte për qëllim që gjykimi i personave për krime luftë të vazhdonte në nivel lokal. Prezenca e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë simbolizonte këtë vullnet dhe kishte për qëllim t’u japë legjitimitet dhe kredibilitet proceseve gjyqësore, respektimit të procedurave dhe verdikteve. Kjo ishte e rëndësishme për një shtet si Bosnjë-Hercegovina, e cila kishte dalë e shkatërruar dhe e

285 Fistelberg, *Hybrid Tribunals, a comparative perspective*, fq.108.

286 <https://www.osce.org/bih/126173>

287 B. Ivanisevic (2011). *The War Crimes Chamber in Bosnia and Herzegovina: From Hybrid to Domestic Court*. International Center for Transitional Justice, fq. 5.

288 TPNJ-ja ka qenë i afatizuar nga OKB-ja që t’i kompletojë të gjitha aktakuzat deri në vitin 2004, t’i përmbyllë të gjitha proceset e shkallës së parë deri në vitin 2008 dhe t’i kompletojë ato të Apelit deri në vitin 2010. Përveç afatit për shpallje të aktakuzave, i cili është respektuar, dy afatet e tjera nuk kanë mundur të respektoheshin për shkak të arrestimit të vonshëm të disa profileve të larta që kanë qenë nën aktakuzë si Radovan Karadžić, i cili është arrestuar në vitin 2007, dhe Ratko Mlladic, në vitin 2011.

ndarë nga lufta. Kjo ishte e rëndësishme edhe për shkak se gjykatat penale të entiteteve nuk kishin arritur kredibilitetin e duhur për të gjykuar krimet e luftës. Çdo gjykim i personave, të cilët i takonin palës tjetër konsiderohej më shumë si hakmarrje.

Dhoma për Krime Luftë brenda Gjykatës së Bosnjë-Hercegovinës hyn në kuadrin e gjykatave hibride për nga prezenca brenda saj e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë. Por për dallim nga gjykatat e tjera, të cilat ose janë krijuar nga misionet e OKB-së (Kosovë dhe Timor Lindor), ose me marrëveshje ndërmjet OKB-së dhe qeverive të shteteve, ku janë kryer krimet (STSL, ECCC, STL), kjo Dhomë është themeluar jashtë ndonjë marrëveshjeje të tillë. Megjithatë, themelimi i kësaj Dhome nuk do të kishte qenë i mundur pa përkrahjen e Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë për Bosnjë- Hercegovinën dhe TNPJ-së.

Pas përfundimit të luftës në Bosnjë-Hercegovinë, implikimi i ndërkombëtarëve në këtë shtet ka qenë permanent dhe Përfaqësuesi i Lartë i OKB-së kishte pasur kompetenca ekzekutive në të gjitha fushat e veprimit, të cilat kishin të bënin me zbatimin e Marrëveshjes së Dejtonit. Por për dallim nga Kosova dhe Timori, në Bosnjë nuk kishte pasur gjykatës dhe prokurorë ndërkombëtarë të emëruar brenda gjykatave vendore. Në vitin 1996 kishte pasur një marrëveshje të nënshkruar në Romë ndërmjet palëve që proceset gjyqësore për krime luftës të mbikëqyren nga ndërkombëtarët. Dhe është Zyra e prokurorit të TNPJ-së, e cila kishte qenë e ngarkuar me mbikëqyrjen e këtij procesi. Marrëveshja e Romës kishte paraparë që para çdo shpalljeje aktakuze kundër ndonjë individi për krime lufte të kërkohej mendimi i Zyrës së prokurorit të TNPJ-së.²⁸⁹ Kështu, për të akuzuar një person për krime lufte autoritetet lokale duhej t'i raportonin paraprakisht njësisë së krijuar brenda prokurorisë së TNPJ-së, e cila vlerësonte nëse provat ishin kredibile dhe nëse kishte bazë të mjaftueshme për t'i ndjekur penalisht personat e dyshuar.²⁹⁰ Gjithashtu TNPJ-ja kishte autoritet mbi të gjitha gjykatat vendore të ish-Jugosllavisë kur bëhej fjalë për krime kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe gjenocidit. TNPJ-ja kishte kështu kompetencë të vendoste se cilat raste ishin nën juridiksionin e tij dhe cilat duhej t'u ktheheshin mbrapa gjykatave vendore.²⁹¹ TNPJ-ja kishte qenë e kufizuar në kapacitetet e saj dhe pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Dejtonit në vitin 1995, ai do të shpallë aktakuza vetëm kundër personave të rangut të lartë duke ua lënë personat e rangut të ulët gjykatave vendore.²⁹² Në fillim të funksionimit të saj kjo dhomë ka gjykuar rastet e rangut të ulët dhe të mesëm, të cilat i referoheshin nga TNPJ-ja.²⁹³

289 B. Ivanisevic, *The War Crimes Chamber in Bosnia and Herzegovina: From Hybrid to Domestic Court*, fq. 6

290 Fistelberg, *Hybrid Tribunals a comparative perspective*, Fq.108

291 Meernik and Barron, (2018), Fairness in National Courts Prosecuting International Crimes. *International Criminal Law Review* 18 (2018) 712-734, fq. 716.

292 Po aty.

293 Shih artikullin për këtë Dhomë në: <https://hybridjustice.com/the-war-crimes-chamber-in-bosnia-and-herzegovina/>

Në draftin e Strategjisë kombëtare për ndjekjen e çështjeve të krimeve të luftës në vitin 2018 figuronte se Prokuroria e shtetit kishte më shumë se 550 raste të pazgjidhura të krimeve të luftës në të cilat janë identifikuar më shumë se 4 500 autorë.²⁹⁴ Sipas kësaj strategjie, të gjitha krimet e luftës duhej të gjykoheshin deri në vitin 2023, edhe pse kjo është vështirë e arritshme.²⁹⁵ Një raport i OSBE-së, i publikuar në shtator 2020, është tejet kritik përreth kualitetit të hetimeve të rasteve të krimeve të luftës nga prokuroria, si dhe kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore.²⁹⁶ Megjithatë, arritjet e Dhomës për krime lufte janë të pakontestueshme dhe mund të themi se është institucioni i cili ka pasur më se shumti sukses në procedimin e krimeve të luftës në të gjitha shtete e ish-Jugosllavisë. Nga viti 2004 deri në vitin 2019 kjo Dhomë ka trajtuar 250 raste nga një total prej 577 rastesh të trajtuara nga të gjitha gjykatat kompetente në Bosnjë-Hercegovinë.²⁹⁷

4.7. Dhomat e Specializuara të Kosovës

Këto Dhoma janë të përbëra nga Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe Dhomat e Specializuara të Kosovës. Ato janë themeluar më 3 gusht 2015 nga Parlamenti i Kosovës, me votimin e nenit kushtetues 122, me Ligjin e veçantë, nr. 05 / L053 dhe me një shkëmbim letrash midis presidentes së Kosovës dhe përfaqësueses së lartë të Bashkimit Evropian. Këto Dhoma kanë juridiksion kohor nga 1 janari 1999 deri më 31 dhjetor 2000. Kështu, duke pasur parasysh se lufta në Kosovë ka përfunduar në qershor 1999, këto Dhoma mbulojnë edhe një periudhë kohore shtatëmuajshe pas përfundimit të luftës. Krimet e kryera për të cilat këto Dhoma kanë juridiksion janë ato të cilat figurojnë në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE), të publikuar në janar 2011.²⁹⁸

294 Po aty.

295 Shih: N. Kulogllija, H. Rovcanin (16 shtator 2010). 'Radical Changes Needed' at Bosnian State Prosecution: UK Judge. BIRN.

296 Shih Raportin e OSBE-së : Improving War Crimes Processing at the State Level in Bosnia and Herzegovina, I qashëm në: <https://www.osce.org/files/f/documents/6/4/463728.pdf>

297 Po aty, fq. 73-74.

298 Shih Raportin: "Inhuman treatment of people and illicit trafficking in human organs in Kosovo," I qashëm në: http://assembly.coe.int/committeedocs/2010/20101218_ajdoc462010provamended.pdf

Në prapavijë të krijimit të këtyre Dhomave kanë qenë pretendimet e ish- kryeprokurores së TNPJ-së, Carla del Ponte, e cila në librin e saj të publikuar në vitin 2008 së bashku me gazetarin amerikan, Chak Sudetic, kishte shkruar se ushtarë të UÇK-së, gjatë dhe pas luftës në Kosovë, kishin kryer një sërë krimesh, të cilat kishin mbetur të pandëshkuara.²⁹⁹ Pohimi më serioz i saj kishte qenë se një pjesë e personave të zhdukur, pas ndalimit të tyre në Kosovë, ishin transportuar në Shqipëri, ku u ishin nxjerrë organet për trafikim. Ajo pretendonte se pas nxjerrjes së organeve ata ishin ekzekutuar. Për t'i verifikuar këto pohime Këshilli i Evropës do ta mandatojë senatorin zviceran, Dick Marty, që të bëjë një raport mbi këto pohime pasi që t'i kishte verifikuar ato. Senatori Marty do ta prezantojë raportin e tij më 12 dhjetor 2010 para APKE-së. Marty do të jetë shumë kritik ndaj ndërkombëtarëve, të cilët e kishin qeverisur Kosovën pas vitit 1999, duke i akuzuar ata se për shkaqe pragmatike të vendosjes së rregullit dhe sigurisë kishin neglizhuar këto krime duke i lënë të pandëshkuara. Kjo do të figurojë edhe në Draft-Rezolutën e APKE-së. Në këtë rezolutë të votuar nga APKE-ja, pas prezantimit të gjetjeve të Dick Marty-t, thuhej mes tjerash se “është e nevojshme të hartohet një instrument ligjor ndërkombëtar [...] për të ndjekur penalisht autorët e krimit.”³⁰⁰ Për t'i vërtetuar këto pretendime në fillim të vitit 2011 do të krijojë një task-forcë të quajtur Task Forca Speciale Hetuese (*The Special Investigation Task Force-SITF*) për të bërë një hetim të plotë gjyqësor të këtyre krimeve të supozuara. Në tetor 2011, në krye të kësaj task- force do të emërohet prokurori amerikan Clint Williamson. Ai kishte njohuri për Kosovën, sepse në vitet 2001 dhe 2002 kishte shërbyer si drejtor i Departamentit të Drejtësisë në kuadër të UNMIK-ut.³⁰¹ Por eksperiencia e tij me Kosovën kishte filluar që në vitin 1999, kur ai kishte qenë pjesë e ekipit të ish-kryeprokurores së TNPJ-së, Louise Arbour, kur kjo e fundit, pas masakrës së Reçakut kishte tentuar të hynte në Kosovë për ta hetuar këtë krim përmes Maqedonisë së Veriut.³⁰² Më pas Williamson kishte kontribuar në përpilimin e aktakuzës kundër Milošević-it, por edhe aktakuzës kundër Željko Ražnatović Arkan-it. Williamson kishte pasur një eksperiencë të gjatë të punës në TNPJ, ku kishte qëndruar nga vitet 1994-1997. Ai kishte mbikëqyrur hetime dhe operacione në Kroaci dhe në Bosnjë-Hercegovinë. Të gjitha këto kishin kontribuar që ai të emërohej në krye të Task-Forcës Speciale.

299 Del Ponte dhe Sudetic, *Madame Prosecutor: Confrontations with Humanity's Worst Criminals and the Culture of Impunity*, fq. 301-303.

300 Neni 20 i Rezolutës 1782 (2011) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

301 Shih biografinë e tij në sajtin e Departamentit amerikan të shtetit në: <https://2001-2009.state.gov/r/pa/ei/biog/75505.htm>

302 C. Williamson (2013) “Real justice, in Time, the indictment of Slobodan Milosevic.” In T. W. Waters (eds). *The Milosevic Trial, An Autopsy* (ff.77-92). Oxford: Univesity Press, fq. 78.

Për tre vjet me radhë kjo task-forcë e udhëhequr nga Williamson-i do të intervistojë me qindra dëshmitarë në Kosovë, në Shqipëri, në Serbi, si dhe në shumë shtete perëndimore. Më 29 korrik 2014, Williamson do të prezantojë gjetjet në një konferencë për media në Bruksel. Sipas tij, Task-forca kishte siguruar prova të mjaftueshme për të shpallur aktakuza kundër disa zyrtarëve të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Me këtë rast ai tha se “këta njerëz mbajnë përgjegjësi për një fushatë persekutimi të drejtuar kundër serbëve, romëve dhe pakicave të tjera etnike në Kosovë, si dhe kundër bashkëqytetarëve të tyre shqiptarë të Kosovës, të cilët ata i kualifikonin ose si bashkëpunëtorë të serbëve”, ose më përgjithësisht “të kenë qenë kundërshtarë politikë të lidershit të UÇK-së.”³⁰³ Sipas tij, “disa elemente të caktuara të UÇK-së kanë shënjestruar qëllimshëm grupet e pakicave me akte persekutimi duke përfshirë vrasje të paligjshme, rrëmbime, zhdukje me forcë, mbajtje të paligjshme në kampe në Kosovë dhe në Shqipëri, dhunë seksuale dhe forma tjera të trajtimit çnjerëzor, zhvendosje të detyrueshme të individëve nga shtëpitë dhe komunitetet e tyre.”³⁰⁴ Provat e shpalosura nga kjo task-forcë do të jenë vështirë të kundërshtueshme nga amerikanët dhe evropianët. Megjithatë, Task-Forca nuk kishte arritur të siguronte prova të mjaftueshme për pretendimet për trafikim organesh që figuronin në librin e Carla del Pontes dhe në Raportin Marty. Trafikimi i organeve i kishte shërbyer Dick Marty-it si argument kyç për të afirmuar të gjithë hetimin e tij. Një hulumtim i publikuar nga gazeta franceze *L’Opinion*, më 28 qershor 2020, tregon për mënyrën se si ky argument i trafikimit të organeve ishte përdorur në seancën e APKE-së gjatë adoptimit të Rezolutës së saj, më 25 janar 2011, në bazë të së cilës ishte themeluar Task-Forca. Sipas kësaj gazete, aktivizimi i deputetëve rusë, serbe, grekë dhe qipriotë kishte qenë i madh atë ditë dhe se dy deputetët rusë, të cilët e kishin hapur seancën, kishin filluar me trafikimin e organeve njerëzore të pretenduara nga UÇK-ja.³⁰⁵

303 Shih deklaraten e prokurorit të Task-Forcës në: http://www.balkaninsight.com/en/file/show/Statement_of_the_Chief_Prosecutor_of_the_SITF_EN.pdf

304 Po aty.

305 Jacques Massey, “Du Kosovo à La Haye, la justice internationale à l’épreuve de la désinformation,” *L’Opinion*, 28 qershor 2020. Në këtë tekst thuhet gjithashtu se Dick Mary kishte qenë i afërt me konsullin e përgjithshëm rus në Strasburg, Valery Levitsky, i cili, në prill 2018, ishte dëbuar nga Franca për shkak të aktiviteteve të tij klandestine si agjent i GRU-së (shërbimeve sekrete ushtarake ruse). Në tekst thuhet “ky spiun kishte qenë në kontakt me senatorin Marty nga fillimi i vitit 2010. Kjo do të thotë një vit para shkrimit të raportit të tij. I caktuar zyrtarisht nga administrata e Dumës, Levitsky e kishte shoqëruar atë në Kaukazin e Veriut.”

Themelimi i Dhomave

Sqarimin e parë se si do të dukej gjykata e paralajmëruar që do t'i trajtonte krimet e pretenduara në Raportin Marty, dhe më pas edhe në hetimet e Task-Forcës, ishin dhënë nga ambasadorja e SHBA-së në Prishtinë, Tracy Ann Jacobson, më 11 prill 2014, katër muaj para prezantimit të gjetjeve të SITF-it. Kjo tregon se krijimi i një gjykate nuk kishte pasur alternativë për amerikanët. Ambasadorja Jakobson kishte deklaruar se duhej një tribunal kosovar “i kërkuar nga Kosova, i miratuar nga Parlamenti me një shumicë prej dy të tretave të votave - i cili dërgon një sinjal që Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara dhe të gjithë ne mund të pohojmë se Qeveria e Kosovës është e angazhuar në një proces transparent dhe kredibil në planin ndërkombëtar.”³⁰⁶ Tri ditë më vonë, më 14 prill 2014, në shkëmbimin e letrave ndërmjet presidentes së Kosovës, Atifete Jahjaga, dhe përfaqësueses së lartë të BE-së për Punë të Jashtme, Catherin Ashton, thuhej se “nëse hetimi i SITF çon në një aktakuzë dhe në një gjykim, duhet të krijohet një mjedis i përshtatshëm për administrimin e duhur të drejtësisë.” Më pas thuhej se “do të përdorej një tribunal i specializuar [...]. Ky tribunal do të ketë një dhomë në Kosovë, por procedurat e ndjeshme, përfshirë auditimin e dëshmitarëve, do të zhvillohen jashtë duke pasur parasysh natyrën e akuzave.”³⁰⁷

Megjithatë, krijimi i gjykatës së paralajmëruar nuk do të ndodhë menjëherë. Kriza politike pas zgjedhjeve të qershorit 2014 do të bëjë që themelimi i saj të shtyhej. Koalicioni, i cili do të formohej nga dy partitë politike me numrin më të madh të deputetëve në Parlament, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) do të jetë hapi i parë drejt arritjes në Parlament të një shumice prej dy të tretave që ishte e nevojshme për të proceduar me ndryshimet kushtetuese, të cilat do t'ia hapnin rrugën krijimit të gjykatës. Paralelisht do të ushtrohet presion ndaj liderëve politikë kosovarë nga amerikanët dhe evropianët, në veçanti ndaj atyre të PDK-së, disa prej të cilëve figuronin në Raportin Marty.³⁰⁸ Madje ata konsideroheshin në këtë Raport si përgjegjës kryesorë për krimet e pretenduara.

Votimi në Parlament të Kosovës i këtyre Dhomave do të zvarritet disa muaj. Përpyekja e parë në qershor 2015 për t'i votuar ato nuk kishte qenë e suksesshme, sepse nuk ishin arritur 80 votat e nevojshme (nga 120 sa ka Parlamenti i Kosovës) që të votohen ndryshimet kushtetuese, të cilat duhej t'u hapnin rrugën krijimit të Dhomave. Pas këtij dështimi të parë,

306 M. Holvet (2017). The Continuing Relevance of the Hybrid or Internationalized Justice Model: The Example of the Kosovo Specialist Chambers. *Criminal Law Forum*, 28 (1), fq.14.

307 Po aty.

308 Po aty, fq. 45.

lidershipi politik kosovar do t'i nënshtrohet përsëri presionit të fuqishëm amerikan dhe evropian. Disa javë para se amendamenti kushtetues të procedohej për votim në Parlament, në Prishtinë kishte ardhur ndihmësekretarja amerikane e Shtetit, Victoria Nuland, e cila me një ton kërcënues u kishte thënë atyre: "Nëse ju vetë nuk e krijoni këtë gjykatë, nëse nuk ndërmerrni hapat tuaj për të arritur drejtësinë, bashkësia ndërkombëtare do ta bëjë atë për ju."³⁰⁹ Ajo i kishte paralajmëruar liderët e partive të dala nga UÇK-ja se nëse nuk i votojnë Dhomat deri më 1 gusht do të përballeshin me pasoja.³¹⁰ Më 3 gusht 2015, Parlamenti i Kosovës do t'i votojë fillimisht ndryshimet kushtetuese (neni 162 i Kushtetutës), të cilat autorizonin themelimin e Dhomave të Specializuara. Në Artikullin 1 të këtij amendamenti kushtetues thuhet:

Për t'i përmbushur obligimet ndërkombëtare në lidhje me Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Dokumenti 12462, datë 7 janar 2011, Republika e Kosovës mund të themelojë Dhoma të Specializuara dhe një Zyrë të Prokurorit të Specializuar në kuadër të sistemit të drejtësisë të Kosovës. Organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i Dhomave të Specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar rregullohen me këtë nen dhe me ligj të veçantë.³¹¹

Në një seancë të dytë të mbajtur të njëjtën ditë, Parlamenti do të votojë Ligjin e veçantë, 05/L-053 për Dhomat e Specializuara. Këto do të jenë dy komponentët ligjorë të këtyre Dhomave.³¹² Krijimi i këtyre Dhomave do të prodhojë tensione në skenën politike kosovare. Në veçanti pas koalicionit të krijuar në vitin 2017 nga partitë politike të dala nga UÇK-ja (PDK, AAK, NISMA). Në fund të dhjetorit 2017, ky koalicion do të tentojë edhe zhbërjen e Dhomave të Specializuara, e cila do të ndalohej vetëm pas presionit të fuqishëm amerikan dhe evropian. Hashim Thaçi dhe deputetët e PDK-së që e kishin pranuar votimin e kësaj gjykate do të kritikohen fuqishëm. Këto kritika do të intensifikohen pas aktakuzave të paralajmëruara, në qershor 2020, kundër vetë Thaçit dhe kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli.

Por, a kanë pasur liderët kosovarë hapësirë që mos ta votojnë këtë gjykatë ashtu siç është pretenduar shpesh në Kosovë? Zyrtarë të lartë amerikanë kishin thënë para se të themelohej ajo se nëse Kosova nuk do ta themelonte atë, ajo do të themelohej nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së. Shqyrtimin e këtij opsioni e konfirmoi më 24 nëntor 2020 ish-

309 P. Çollaku (22 dhjetor 2015). Kosovo feels the pressure over new war court. *BIRN*.

310 C. Sudetic (21 korrik 2015). The bullies who run Kosovo, *Politiko*.

311 Shih Amandamentin kushtetues 121 në: file:///C:/Users/Admin/Downloads/amendamenti_kushtetues_-_nr_24.pdf

312 Shih Ligjin 05/L-053 në: <https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-053%20a.pdf>

kryeprokurori amerikan i Task-Forcës Speciale, Clint Williamson, në një intervistë me *Ora News*. Ai tha se pas publikimit të Raportit Marty, Rusia dhe Serbia kishin kërkuar që krimet e pretenduara të gjykoreshin nga një gjykatë e themeluar nga OKB-ja.³¹³ Ai madje tha se Rusia kishte insistuar shumë në këtë drejtim dhe se në Këshill të Sigurimit të OKB-së kishte pasur një debat përreth kësaj çështjeje, ku kishte pasur pajtim të gjerë se krimet e pretenduara duhej të silleshin para një gjykate penale. Williamson tha se Qeveria Amerikane, e cila kishte përgjegjësi për zbatimin e ligjit në Kosovë, nuk kishte pasur mundësi t'i kundërvihet procedimit gjyqësor të krimeve të pretenduara, të cilat, sipas tij, kishin qenë shumë serioze. Si rezultat, SHBA-të, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar, tri shtete me të drejtë vetoje në Këshill të Sigurimit, ua kishin bërë të ditur liderëve të Kosovës se nëse ata do ta refuzonin krijimin e kësaj gjykate nga institucionet vendore, kjo çështje do të kthehej në Këshill të Sigurimit të OKB-së. Në atë rast ata nuk do ta përdornin veton e tyre për ta penguar themelimin e një gjykate të tillë.³¹⁴ Amerikanët dhe evropianët do ta kishin pasur shumë vështirë që në Këshilli të Sigurimit t'i kontestonin gjetjet e Task-Forcës Speciale, të cilën e kishin financuar evropianët dhe që ishte udhëhequr nga një prokuror i mandatuar nga Departamenti i Shtetit amerikan.

Çdo gjykatë, e cila do të kishte kaluar përmes OKB-së, kishte qenë opsion më i dëmshëm për Kosovën. Një gjykatë e OKB-së do t'u kishte dhënë Rusisë dhe Kinës më shumë hapësirë për ta ndikuar atë. Gjithashtu, një gjykatë e tillë u kishte krijuar hapësirë këtyre shteteve që ta sfidonin shtetin e ri të Kosovës në nivel ndërkombëtar duke e përdorur argumentin e krimeve të kryera nga shqiptarët, si argument për të bllokuar njohjet e reja ose integrimin e mëtejshëm në organizata ndërkombëtare. Çdo gjykatë, e cila do të krijohet nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, do ta bënte atë organ të tij, dhe kjo do të kishte për efekt kthimin tek Rezoluta 1244 dhe do të ishte kthim mbrapa për Kosovën. BE-ja dhe SHBA-ja kishin insistuar që gjykata që do të krijohet të mbetet zyrtarisht brenda "kufijve zyrtarë ligjorë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës" përderisa BE-ja do të ngarkohej "me kontroll të plotë operacional dhe juridiksional të tyre."³¹⁵ BE-ja do ta kontrollonte plotësisht krijimin, funksionimin dhe financimin e këtyre Dhomave.³¹⁶ Për Bashkimin Evropian, i cili ka investuar shumë në ndërtimin e institucioneve në Kosovë, përfshirë këtu edhe drejtësinë (EULEX), një gjykatë e OKB-së kishte qenë një pranim i dështimit. Dhe në këtë

313 Shih intervistën me Clint Williamson në *ORA News* në: <https://www.youtube.com/watch?v=5xGzRp8CNUw>

314 Po aty.

315 F. Korenica, A. Zhubi, D. Doli (2016). The EU-Engineered Hybrid and International Specialist court in Kosovo: How 'Special' is it? *European Constitutional Law Review*, (12), fq. 477.

316 Po aty. ff. 479-480.

rast dështimi nuk do të ishte vetëm i shqiptarëve të Kosovës, por edhe ndërkombëtarëve, të cilët e kanë qeverisur Kosovën pas vitit 1999 dhe të cilët nuk i kanë proceduar krimet e supozuara. Të gjitha këto efekte të mundshme janë tentuar të limitoheshin përmes krijimit të një gjykate “vendore” të krijuar nga Kosova dhe e cila do të gjykonte me ligje të Kosovës. Çdo dënim eventual i çdo të akuzuari nga kjo gjykatë do të jetë dënim nga një institucion i Kosovës. Nëse e krahasojmë këtë model gjykate me tribunalet ndërkombëtare penale ad hoc ose me ato hibride, të analizuara më lart në këtë kapitull, nuk ka dyshim se kjo gjykatë përputhet më shumë me interesat e shtetit të Kosovës sesa që ishte përputhur një gjykatë e OKB-së.

Modeli i Dhomave të Specializuara

Çfarë mekanizmi gjyqësor janë këto Dhoma dhe cilat janë specifikat e tyre në raport me mekanizmat tjerë hibridë ose të ndërkombëtarizuar? Në përgjithësi, modeli gjyqësor i këtyre Dhomave ka ngjashmëri edhe me tribunalet ndërkombëtare penale ad hoc, edhe me gjykatat e tjera hibride, edhe pse ato nuk janë krijuar përmes një marrëveshjeje të nënshkruar ndërmjet OKB-së dhe Kosovës. Stahn thotë se këto Dhoma deri në njëfarë mase janë “Dhoma të përziera vendore regjionale.”³¹⁷ Vendore, për shkak se ato formalisht janë themeluar nga Parlamenti i Kosovës dhe janë pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por janë edhe regjionale për shkak se të gjithë barrën e themelimit, funksionalizimit dhe financimit e ka bartur dhe e bart Bashkimi Evropian. Misionit të BE-së në Kosovë (EULEX-it) i është dhënë përgjegjësi ekskluzive në emërimin e gjykatësve, asistimin e hetimeve, transferimin e të akuzuarve në Hagë etj.

Këto Dhoma zbatojnë Kushtetutën e Kosovës, Ligjin Special për këto Dhoma, i cili po ashtu me votimin e tij nga Parlamenti i Kosovës është bërë ligj i Kosovës, të drejtën zakonore ndërkombëtare, si dhe Ligjin mbi të drejtat ndërkombëtare të njeriut.³¹⁸ Kështu që kemi të bëjmë me një gamë ligjesh mjaft të gjera, kjo edhe për shkak të burimeve të zbatueshme brenda Kosovës.³¹⁹ Por edhe këto Dhoma i japin përparësi zbatimit të ligjit ndërkombëtar në raport me atë vendor. Neni 3 i Ligjit për Dhomat e Specializuara precizon se në raport me ligjet vendore përparësi ka e drejta zakonore ndërkombëtare, si dhe Ligji mbi të drejtat ndërkombëtare të njeriut, ku përfshihen një sërë konventash evropiane dhe ndërkombëtare. Më pas, në artikullin 3 thuhet se “për përcaktimin e së drejtës zakonore ndërkombëtare në kohën kur janë kryer

317 Stahn, *A critical introduction to international criminal law*, fq. 207.

318 Po aty.

319 Po aty.

krimet, gjyqtarët mund të ndihmohen nga burime të së drejtës ndërkombëtare, përfshirë burime dytësore, siç janë jurisprudenca nga Tribunalet ndërkombëtare ad hoc, Gjykata Ndërkombëtare Penale dhe gjykatat e tjera penale.” Gjithashtu, ngjashëm me shumicën e mekanizmave gjyqësorë hibridë, Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë superioritet të shprehur mbi gjykatat tjera të Kosovës. Neni 10 e konfirmon këtë përparësi dhe precizon se ato gjithashtu kanë mundësi që “në çdo fazë të hetimeve ose procedurave [...] të urdhërojnë transferimin e procedurës brenda juridiksionit të tyre nga ndonjë prokuror tjetër ose ndonjë gjykatë tjetër [përveç Gjykatës Kushtetuese] në territorin e Kosovës tek Dhomat e Specializuara dhe Prokurori i Specializuar.”³²⁰ Në këtë aspekt këto Dhoma janë në harmoni me praktikat e gjykatave të UNMIK-ut dhe EULEX-it, të cilat u kanë paraprirë me kompetenca të tilla në Kosovë, por edhe atyre të shumicës së mekanizmave të tjerë gjyqësorë hibridë.

Megjithatë, përtej ngjashmërive me mekanizmat e tjerë gjyqësorë, Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë një konstruksion ligjor unik.³²¹ Vendosja e këtyre Dhomave jashtë Kosovës, që do të thotë jashtë shtetit ku janë kryer krimet, i bën të ndryshme nga shumica e tribunaleve të tjera hibride (në përjashtim të atij për Libanin), të cilat janë të vendosura brenda shteteve ku janë kryer krimet. Madje, vendosja brenda shteteve ku janë kryer krimet ka qenë një ndër argumentet kryesore që është përdorur nga konceptuesit e këtyre mekanizmave gjyqësorë hibridë ose të ndërkombëtarizuar në raport me gjykatat penale ndërkombëtare (të përhershme ose të përkohshme). Në rastin e Dhomave të Specializuara të Kosovës, ky eksternalizim është justifikuar me argumentin e sigurisë dhe rrezikun potencial që gjykimet brenda Kosovës do të paraqisnin për prokurorët dhe gjykatësit, si dhe për dëshmitarët. Dhe në veçanti për këta të fundit. Eksperiencat e gjykimeve të UNMIK-ut dhe EULEX-it kishin treguar më parë se gjykatësit dhe prokurorët vendorë në panelet e përziera kishin qenë objekt i presioneve. Në veçanti ka qenë problematike mbrojtja e dëshmitarëve që përveç paneleve të lartpërmendura ka qenë problem edhe në proceset gjyqësore të zhvilluara kundër shqiptarëve të Kosovës para TNPJ-së.

Përveç eksternalizimit të Dhomave jashtë Kosovës, i gjithë stafi i tyre është staf ndërkombëtar. Edhe kjo paraqet një risi, e cila nuk figuron në asnjë institucion tjetër hibrid ndërkombëtar. Kjo është karakteristikë e tribunaleve ndërkombëtare penale ad hoc dhe GJNP-së. Kjo është edhe arsyeja, mes tjerash, pse këto Dhoma janë konsideruar nga disa autorë si “ndërkombëtare” më shumë sesa hibride.³²²

320 Neni 10, art. 1 dhe 2

321 Stahn, *A critical introduction to international criminal law*, fq. 194.

322 Muharremi, “The Kosovo Specialist Chambers and Specialist Prosecutor’s Office”, fq. 969.

Tjetër karakter unik i këtyre Dhomave është integrimi i tyre në të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor të Kosovës. Gjykatat hibride, si dhe gjykatat penale ndërkombëtare i kanë zakonisht dy shkallë gjyqësore (Themelore dhe të Apelit), kurse këto Dhoma i kanë katër. Neni 24 përcakton se ato përbëhen nga “Dhoma, që përfshijnë Dhomën e Gjykatës Themelore, Dhomën e Gjykatës së Apelit, Dhomën e Gjykatës Supreme dhe Dhomën e Gjykatës Kushtetuese.” Carsten Stahn konsideron se “ky pasqyrim i saktë i institucioneve vendore të drejtësisë jo vetëm në një nivel, por në të gjitha nivelet e sistemit të drejtësisë [...] bie në kundërshtim me idenë e përzjerjes së strukturave ndërkombëtare dhe vendore, që është tipike për mekanizmat hibridë.”³²³ Por ai konsideron se kjo është bërë “për t’i mbrojtur Dhomat e Specializuara nga kontrolli i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ose subjektet e tjera vendore.”³²⁴ Këtu është krijuar një Dhomë, e cila e interpreton Kushtetutën e Kosovës sa i përket punës së Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Dhe këtë e bën ndaras nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

Karakteristikë tjetër që i diferencion ato nga tribunalet e tjera hibride është se Zyra e Prokurorit të Specializuar është krijuar si institucion i pavarur, jashtë strukturës së Dhomave.³²⁵ Në tribunalet e tjera hibride prokuroria është pjesë e gjykatave ose është e integruar në sistemin e prokurorisë vendore. Sa u përket kompetencave të Prokurorit të Specializuar që figurojnë në nenin 35 të Ligjit të veçantë, ato janë të ngjashme me kompetencat e shumicës së prokurorëve të gjykatave të tjera hibride të analizuara më lart e që, mes tjerash, janë: “intervistimi i të dyshuarve, dëshmitarëve ose viktimave, grumbullimi i informacionit dhe provave, kërkimi i bashkëpunimit të shteteve.”³²⁶ Por, Prokurori i Specializuar ka në zyrën e tij policinë, dispozitë kjo që mungon tek prokurorët e tribunaleve tjera ndërkombëtare dhe hibride. Artikulli 9 (neni 35) i Ligjit thotë se “Zyra e Prokurorit të Specializuar përbëhet nga Prokurori i Specializuar, prokurorë të tjerë, policia dhe stafi tjetër i kualifikuar, siç mund të kërkohet.”³²⁷ TNPJ-ja dhe TNPR-ja nuk kanë pasur polici të tillë në dispozicion dhe për të kryer punën e tyre është dashur ose të kërkonin asistencën e policive të shteteve, ose atë të ndërkombëtarëve (në Bosnjë dhe në Kosovë).³²⁸

Kompetencat e këtyre Dhomave janë shumë më të gjera sesa ato të gjykatave tjera të Kosovës. Ato kanë mundësi të nënshkruajnë marrëveshje ndërkombëtare me shtetet

323 Stahn, *A critical introduction to international criminal law*, fq. 207.

324 Po aty.

325 Shih: “Kosovo Specialist Chambers – Part 2: Fundamentals of the KSC Statute,” në: <http://michaelgkarnavas.net/blog/2017/06/01/ksc-statute-fundamentals>

326 Neni-a,b,c...

327 Shih Ligjin 05-L-053, në: <https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-053%20a.pdf>

328 Shih analizën e Michael Karanavas në: <http://michaelgkarnavas.net/blog/2017/06/05/ksc-part-3-peculiar-features/>

e tjera, edhe pse neni 5 i Amendamentit kushtetues thotë se: “Para hyrjes në ndonjë marrëveshje ndërkombëtare me një shtet të tretë në lidhje me bashkëpunimin juridik, që përndryshe do të kërkonte ratifikim sipas nenit 18, Dhomat e Specializuara do të kërkojnë pajtimin paraprak të Qeverisë.”³²⁹ Specifikë tjetër e këtyre Dhomave është Zyra e Ombudspersonit e krijuar në kuadër të Regjistrisë të Dhomave. Kjo zyrë ka për detyrë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të personave të cilët bashkëveprojnë me Dhomat. Zyra të tilla nuk ka në tribunalet e tjera as hibride, as ndërkombëtare. Gjithashtu është edhe Zyra për Mbrojtjen dhe Pjesëmarrjen e Dëshmitarëve, roli i së cilës është i definuar me art. 34 (8), ku thuhet “në emër të administratorit, në konsultim me Prokurorinë e Specializuar [...], zbaton masa mbrojtëse të urdhëruara nga gjykata apo masat e tjera mbrojtëse të nevojshme dhe aranzhimet e sigurisë, këshillim dhe asistencën tjetër të nevojshme për dëshmitarët dhe personat e tjerë, të cilët janë të rrezikuar për shkak të dëshmisë së dhënë nga dëshmitarët”. As kjo lloj zyre nuk ekziston në asnjë gjykatë tjetër hibride.

Aktakuzën e parë Zyra e Prokurorit të Specializuar e ka bërë publike më 24 shtator 2020 kundër ish-komandantit të UÇK-së, Salih Mustafa, i cili është arrestuar dhe dërguar në Hagë në të njëjtën ditë. Aktakuza e ngarkon atë me “krime lufte sipas ligjit ndërkombëtar.”³³⁰ Por kjo aktakuzë kishte mbetur në hijen e aktakuzës së paralajmëruar dy muaj më herët kundër dy ish-liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, i cili ushtronte detyrën e presidentit të shtetit, dhe Kadri Veselit, i cili ishte kryetar i PDK-së. Prokuroria e Dhomave të Specializuara përmes një komunikate për shtyp kishte paralajmëruar se më 24 prill 2020, një aktakuzë kundër tyre ishte në shqyrtim e sipër nga gjykatësi i procedurës paraprake. Kjo aktakuzë do të konfirmohet më 24 tetor 2020 dhe do të bëhet publike më 4 nëntor.³³¹ Përveç Thaçit dhe Veselit do të akuzohen edhe Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, dy ish-zyrtarë tjerë të lartë të UÇK-së. Të njëjtën ditë Hashim Thaçi do të japë dorëheqjen nga pozita e tij e presidentit të Kosovës dhe së bashku me tre të bashkakuzuarit e tjerë do të dorëzohen në Hagë.

Edhe përtej përpjekjeve që në Kosovë të krijohet një mekanizëm gjyqësor, i cili do të mbetej brenda sistemit gjyqësor të Kosovës (së paku formalisht), këto Dhoma janë perceptuar në Kosovë si të ndara nga realiteti kosovar. Madje në opinionin publik në Kosovë vendosja e tyre në Hagë ka bërë që ato të asimilohen me TNPJ-në, i cili po ashtu ka qenë i vendosur në Hagë. Një ndër mangësitë e këtyre Dhomave është fokusimi ekskluziv tek

329 Shih art. 5 të nenit 1 të amendamentit kushtetues në: file:///C:/Users/Admin/Downloads/amendamenti_kushtetues_-nr_24.pdf

330 Shih aktakuzën në: https://repository.scp-ks.org/details.php?doc_id=091ec6e9803599fa&doc_type=stl_filing_annex&lang=eng

331 Shih aktakuzën në: <https://www.scp-ks.org/en/indictment-against-hashim-thaci-kadri-veseli-rexhep-selimi-and-jakup-krasniqi-confirmed-ksc-pre>

krimet e kryera nga pala shqiptare. Asnjë gjykatë ndërkombëtare ose hibride nuk është themeluar deri sot për të trajtuar vetëm krimet e njëjës palë në konflikt. Kjo rrezikon të krijojë një asimetri ndërmjet Kosovës dhe Serbisë sa i përket dënimit të krimeve të luftës. Asimetria ka të bëjë pikërisht me mungesën e gjykimit të krimeve në Serbi, përderisa pala kosovare do të përballlet me një mekanizëm gjyqësor, i cili do të gjykonte krimet e supozuara të shqiptarëve.

Nuk ka dyshim se mungesa e gjykatësve dhe prokurorëve vendorë në panelet e këtyre Dhomave do të ketë pasoja sa i përket “diversitetit të ekspertizës dhe perceptimit lokal të Dhomave.”³³² Gjithashtu, vetë fakti se nuk ka asnjë gjykatës ose prokuror vendor brenda stafit të këtyre Dhomave, rrezikon të krijojë shkëputje të gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë nga realiteti kosovar të cilit gjykimet e dhomave do të duhej t’i shërbenin. Kjo shkëputje mund të jetë më e madhe edhe për faktin se gjyqtarët nuk janë të angazhuar në baza permanente në këto Dhoma. Neni 26 i Ligjit thotë se gjyqtarët e këtyre Dhomave “janë të pranishëm në selinë e Dhomave të Specializuara vetëm sipas nevojës me kërkesë të kryetarit, për të ushtruar funksionet që e kërkojnë praninë e tyre. Nëse është e mundur, dhe sipas vendimit të kryetarit, funksionet mund të ushtrohen nga distanca.”³³³ Kjo bën që ata duhet t’i kombinojnë angazhimet e tyre me institucionet e tyre bazë në shtetet e tyre.³³⁴

332 Stahn, *A critical introduction to international criminal law*.

333 Shih nenin 26 të Ligjit 05-L-053, në: <https://www.kuvendikosoves.org/common/>

334 J. Hubrecht (2019). *Les Chambres specialisees du Kosovo face au mur du doute et de la peur*. Paris: Institut des Hautes Etudes sur la Justice.

5. Mekanizmat jogjyqësorë të drejtësisë tranzicionale

Në këtë kapitull do të analizohen mekanizmat jogjyqësorë të drejtësisë tranzicionale që janë, mes tjerash: komisionet e së vërtetës dhe pajtimit, reformat institucionale, vetingu/lustrimi, amnistitë etj. Ndryshe nga mekanizmat gjyqësorë, këta ofrojnë mundësi alternative për t'u ballafaquar me të kaluarën. Madje, këta mekanizma mund të jenë komplementarë me ata gjyqësorë të analizuar më lart. Për shembull, komisionet e së vërtetës dhe pajtimit, përmes zbardhjes së krimeve dhe shpалosjes së tyre, si dhe të emrave të personave që i kanë kryer ato, në raportet e tyre u mundësojnë institucioneve gjyqësore vendore të ndërmarrin masa ndaj personave të implikuar. Por ky nuk është qëllimi i tyre primar. Ato kanë për qëllim t'i sjellin përballë njëri-tjetrit viktimat dhe keqbërësit dhe të kthejnë komunikimin brenda shoqërisë. Ato duhet të krijojnë kushtet e përshtatshme për të mundësuar një gjë të tillë. Disa mekanizma, siç janë reformat institucionale ose vetingu, të cilët do të analizohen në pjesën e dytë të këtij kapitulli, synojnë që përmes verifikimit të personave, të cilët punojnë në institucione, t'u japin fund praktikave të keqpërdorimit dhe shkeljes së të drejtave të njeriut brenda këtyre institucioneve. Ngjashëm si mekanizmat gjyqësorë, edhe këta mekanizma kanë status normativ, sepse krijohen dhe mbikëqyren nga shteti.

5.1. Komisionet e së vërtetës dhe pajtimit

Komisionet e së vërtetës dhe pajtimit janë mekanizma jogjyqësorë të drejtësisë tranzicionale, të cilët janë të orientuar nga viktimat e dhunës së regjimeve represive dhe paraqesin një alternativë në raport me gjykatat penale. Në qendër të punës së tyre është zbulimi i krimeve të regjimeve paraprake me qëllim që t'i ndihmojnë shoqëritë që të ballafaqohen me të kaluarën. Megjithatë, vetë fakti se ato krijohen pas rënies së regjimeve represive, qëllimi i tyre është edhe vendosja e një rendi të ri demokratik dhe pamundësimi i rikthimit në pushtet të regjimit paraprak. Ekspozimi publik i krimit të anëtarëve të regjimit paraprak pikërisht ka për qëllim delegjitimimin e tij. Kështu, në prapavijë të krijimit të këtyre komisioneve është edhe vendosja e një rendi të ri demokratik liberal “përmes përcaktimit të përgjegjësive, konsensusit dhe përkujtimit kolektiv.”³³⁵ Si mekanizma të drejtësisë

335 Andrieu, Juger, réconcilier, réparer: la justice transitionnelle pour sortir de la violence? Fq.112

tranzicionale, komisionet i kanë kontribuar diversifikimit të tyre.³³⁶ Ato i kanë paraprirë institucionalizimit dhe globalizimit të drejtësisë tranzicionale. De Grief dhe Duthie i konsiderojnë ato si “shtyllë kryesore e iniciativave të drejtësisë tranzicionale dhe ka gjasa që ato të mbesin të tilla në të ardhmen.”³³⁷

Komisioni i parë i së vërtetës dhe pajtimit është themeluar në Ugandë, në vitin 1974, gjatë udhëheqjes së këtij shteti nga diktatori Idi Amin dhe ky konsiderohet si komisioni i vetëm që është krijuar nga një regjim diktatorial. Ky komision kishte dështuar në prodhimin e ndonjë raporti për shkak edhe të presioneve të shumta të ushtruara ndaj anëtarëve të tij dhe mungesës së përkrahjes politike.³³⁸ Në Bolivi është krijuar komisioni i dytë në vitin 1982, pas rënies së juntës ushtarake në këtë shtet dhe pas zgjedhjeve demokratike, të cilat e kishin sjellë në pushtet presidentin Hernan Siles Zuazo. Komisioni bolivian kishte pasur për qëllim që të zbardhte fatin e personave të vrarë dhe të zhdukur pas vitit 1967, por as ky komision nuk kishte pasur sukses në përmbushjen e misionit të tij.

Komisioni i parë i së vërtetës, i suksesshëm, ka qenë Komisioni i Argjentinës, i cili është krijuar në vitin 1983, pas rënies së juntës ushtarake nga pushteti. Raporti i këtij komisioni, i cili do të zbardhë fatin e mijëra të zhdukurve, ia kishte hapur rrugën sjelljes para drejtësisë dhe dënimit, dy vjet më vonë, të ish-liderëve të juntës ushtarake argjentinase. Më pas do të ketë shumëfishim të komisioneve të së vërtetës dhe pajtimit në gjithë botën, edhe pse deri në vitin 2004 Amerika e Jugut dhe Afrika ishin kontinentet ku ishin 74% të të gjitha komisioneve të krijuara.³³⁹ Sot numri i këtyre komisioneve ka arritur në 45 dhe ato janë të shpërndara në të gjitha kontinentet. Në një numër shtetesh këto komisionet do të jenë komplementare me tribunalet penale hibride. Kështu, në Sierra Leone, në Ruandë ose në Timorin Lindor do të ketë edhe komisionet të së vërtetës, edhe gjykata penale.

Me kohë, modelet e komisioneve të së vërtetës do të ndryshojnë. Deri në vitet 2000 ato ishin krijuar ekskluzivisht në shtete të dala nga konfliktet. Më pas ato do të zgjerohen edhe tek disa shtete demokratike, të cilat do t'i përdorin për të zbardhur pjesë të së kaluarës së tyre.³⁴⁰ Rast ilustrues është Komisioni i së vërtetës dhe pajtimit kanadez i themeluar në vitin 2008, për të shqyrtuar përgjegjësinë e shtetit kanadez për *Sistemin Shkollor Rezidencial për Indianët*. Qëllimi kishte qenë dokumentimi i historisë së këtij sistemi shkollor rezidencial

336 Po aty.

337 P. De Grief, R. Duthie (2009). *Transitional Justice and Development, Making Connections*. New York: International Center for Transitional Justice, fq. 353.

338 <https://www.ictj.org/sites/default/files/ICTJ-Briefing-Uganda-Confronting-Past-2012-English.pdf>, fq.3

339 Oduro, *Transitional Societies, Democratic Accountability and Policy Responses*, fq. 157.

340 Për drejtësinë në shtetet demokratike shih :S. Winter (2014), *Transitional Justice in Established Democracies: A political Theory*. London: Palgrave.

për indigjenët, i cili për më shumë se një shekull kishte konsistuar në tërheqjen e fëmijëve indigjenë nga vendi dhe familjet e tyre, dhe ishin vendosur në qendra të krijuara enkas për ata. Rreth 150 000 fëmijëve indigjenë ishin marrë nga mjedisi i tyre tradicional, gjë që paraqiste rreth 30% të të gjithë fëmijëve indigjenë në këtë shtet.³⁴¹ Komisioni kishte pasur për objektiv dokumentimin e historisë dhe analizën e pasojave që kishte pasur ky sistem tek indigjenët. Komisioni kishte organizuar debate në gjithë vendin, gjë që u kishte mundësuar indigjenëve, të cilët kishin kaluar nëpër këtë sistem, të dëshmojnë dhe të tregojnë për eksperiencën e tyre. Në qershor 2015, ky Komision do të publikojë një raport shumëvëllimësh në të cilin ftonë për pajtim ndërmjet kanadezëve dhe indigjenëve, të cilët, sipas raportit, kishin përjetuar një “gjenocid kulturor.”³⁴²

Sa u përket shteteve të Ballkanit Perëndimor, tri komisione janë krijuar nga këto shtete. I pari ishte krijuar nga ish-kryeministri i Serbisë, Vojislav Koštunica, në mars 2001. “Komisioni Koštunica”, siç ishte quajtur, ishte krijuar në një moment kur qeveria e tij po ballafaqohej me aktakuza të shumta nga TNPJ-ja dhe gjithashtu kur asaj po i kërkohej ta dorëzonte Milošević-in në Hagë. Edhe pse, në fillim, anëtarë të këtij komisioni ishin emëruar historianë serbë eminentë si Latinka Perovic ose Vojin Dimitrijevic, ky komision kishte dështuar dhe kishte rezultuar me dorëheqjen e tyre pas dy muajsh. Asnjë raport nuk është prodhuar nga ky komision. Tjetër komision është ai i krijuar në Kosovë, në mars 2017, nga presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi. Ky komision ishte krijuar në një moment kur Dhomat e Specializuara të Kosovës ishin funksionalizuar dhe po përgatiteshin për aktakuzat e para. As ky komision deri tani nuk ka prodhuar ndonjë raport. Në vitin 2019 është themeluar edhe një komision “i përzier” nga Bullgaria dhe Maqedonia e Veriut për të zgjidhur disa mospajtime që kanë të bëjnë me interpretimin e historisë dhe raporteve historike ndërmjet këtyre dy shteteve. Ky komision është krijuar në perspektivën e hapjes së negociatave të Maqedonisë së Veriut me BE-në. Bullgaria si anëtare e BE-së kishte paralajmëruar se pa një marrëveshje të tillë ajo do ta përdorte veton e saj për të penguar hapjen e këtyre negociatave. Këto dy shtete në të kaluarën nuk kishin hezituuar ta akuzonin njëra-tjetrën për “falsifikim” të historisë.³⁴³ Ky komision ende nuk ka dorëzuar raport.

341 J.R. Miller (2017). Residential Schools and Reconciliation, Canada confronts its history. Toronto: University of Toronto Press

342 Po aty.

343 https://www.euractiv.com/section/all/short_news/bulgaria-could-block-north-macedonias-eu-path-over-common-history-interpretation/

Karakteristikat e komisioneve të së vërtetës

Në një ndër studiuëset e para të këtyre komisioneve, Priscilla Hayner, dallon katër karakteristika të tyre kryesore. E para, sipas saj, është fokusimi i tyre në të kaluarën. E dyta është se ato hetojnë një konflikt në përgjithësi brenda një periudhe kohore e jo një ngjarje specifike brenda një konflikti. Karakteristikë e tretë është se ato janë organe të përkohshme, të cilat kryesisht veprojnë gjatë një periudhe ndërmjet gjashtë muajsh dhe dy vjet, dhe e përfundojnë punën e tyre me dorëzimin e një raporti. Dhe e katërta është se këto komisione janë zyrtarisht të lejuara, të autorizuar ose të fuqizuara nga shteti (dhe nganjëherë edhe nga opozita e armatosur, nëse themelimi i tyre rezulton nga ndonjë marrëveshje e paqes).³⁴⁴

Si të gjithë mekanizmat e drejtësisë tranzicionale, komisionet janë të fokusuar në të kaluarën, sepse kanë të bëjnë me zbardhjen e ngjarjeve të së kaluarës dhe daljen në sipërfaqe të së vërtetës së krimeve, si dhe me identifikimin e personave përgjegjës. Por ato kanë një rol edhe për të ardhmen e shoqërive, sepse kanë të bëjnë, mes tjerash, edhe me ndërtimin e një narracioni kredibil dhe të pranueshëm të së kaluarës, i cili në shoqëritë e polarizuara nga konfliktet, pas përfundimit të konfliktit, është element esencial për bashkëjetesë. Kontributi kryesor i tyre është zbulimi i së vërtetës së shkeljeve të kryera në të kaluarën dhe kuptimi i shkaqeve dhe pasojave të këtyre shkeljeve. Dhe e gjithë kjo bëhet publikisht, gjë që i jep kredibilitet këtij procesi. Sa i përket kontributit për të ardhmen, ato rekomandojnë se cilat duhet të jenë masat e duhura për të arritur pajtimin brenda shoqërisë dhe disa nga ato kanë edhe dispozita kompensuese për viktimat e dhunës.³⁴⁵ Diferencat ndërmjet këtyre komisioneve dhe atyre të cilat krijohen nga institucionet e tjera shtetërore është se ato janë të kufizuara në kohë, në raport me ato të parat që mund mos të jenë. Gjithashtu, këto dy lloj komisionesh dallohen edhe për nga natyra e hetimeve për të cilat ato janë mandatuar. Komisionet e tjera shtetërore bëjnë hetime gjyqësore ose jogjyqësore për çështje të veçanta politike, shoqërore ose ekonomike, ose edhe çështje që i kombinojnë këto. Komisionet e së vërtetës nuk merren me krime të veçanta ose individuale, ato janë të fokusuar kryesisht tek ato më seriozet dhe sistematiket. Shumica e këtyre komisioneve, sidomos ato të krijuara më 1980 dhe 1990, kanë qenë të përqendruara vetëm në krimet që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut brenda një periudhe të caktuar kohore.³⁴⁶ Megjithatë, disa nga këto komisione, si ai i Tunizisë, për shembull, ka pasur edhe kompetenca ndëshkuese. Madje, edhe ato komisione të cilat zyrtarisht nuk kanë pasur kompetenca të tilla, siç është ai i

344 H. B. Priscilla (1994). Fifteen Truth Commissions-1974 to1994: A comparative Study. *Human Rights Quarterly*, (597) 6014, cituar në: Lawther, Moffett, Jacobs, *Research Handbook of Transitional Justice*, fq. 21.

345 Oduro, *Transitional Societies, Democratic Accountability and Policy Responses*, fq. 147.

346 Po aty, fq. 46-57.

Afrikës së Jugut, Komiteti i amnistive i ngarkuar me shqyrtimin dhe aprovimin e amnistive ka pasur kompetenca kuazigjyqësore.³⁴⁷ Ky proces i amnistisë është mbajtur i ndarë nga pjesa tjetër dhe aty kanë pasur mundësi të marrin pjesë vetëm komisionarë, të cilët kanë pasur formim gjyqësor.³⁴⁸

Komisionet e së vërtetës dhe pajtimin kanë zakonisht një autoritet shumë të madh dhe janë më të përkrahur për të bërë hetimet e tyre. Në shumicën e rasteve, ato udhëhiqen nga personalitete të pakorruptuara. Komisioni i Afrikës së Jugut është udhëhequr nga prifti protestant, Desmond Tutu, i cili gëzonte një autoritet të lartë në këtë shtet. Kjo bën që këto komisione kanë ndikim më të madh tek shoqëria. Në shumicën e rasteve, fakti se këto komisione janë të autorizuara nga shteti, bën që ato të kenë kompetenca shumë të gjëra, duke i tejkalar kompetencat e çdo lloj komisioni që vepron në të njëjtën fushë. Dimensionin e tyre zyrtar ua mundëson atyre pjesëmarrjen e publikut dhe vendosjen në dispozicion të mjeteve për një bashkëpunim të gjerë me popullsinë e afektuar nga vuajtjet dhe e cila është edhe burim i rëndësishëm i informacionit për këto komisione. Kjo u mundëson këtyre komisioneve të tregojnë mbi përjetimet e viktimave të dhunës në të kaluarën. “Informacioni i grumbulluar dhe dëshmitë e viktimave, si dhe të keqbërësve u mundësojnë të dalin me raporte kredibile, të cilët rekomandojnë masa që duhet ndërmarë, siç janë reforma institucionale ose dëmshpërblime për viktimat.”³⁴⁹ Kështu për shembull, Komisioni i së vërtetës dhe dinjitetit i krijuar në Tunizi në vitin 2014, për të hetuar shkeljet e të drejtave të njeriut në këtë shtet, pas vitit 1955, dhe i cili kishte kompetenca edhe për t’i kompensuar viktimat e dhunës, kishte audituar më shumë se 11 000 dëshmitarë dhe kishte pranuar gjithsej 62 000 kërkesa për kompensim.³⁵⁰ Në vitin 2019, Komisioni ka dorëzuar një raport 2000 faqesh.

Megjithatë, komisionet e para nuk e kanë pasur gjithmonë autonominë e duhur sepse në disa vende ku ishin krijuar komisione të tilla, kishte pasur më parë amnisti, si pjesë e marrëveshjeve që i kishin dhënë fund luftës. Dhe në masë të madhe, autonomia e komisioneve varet nga ajo se sa të fuqishëm janë njerëzit e ish regjimit pas tranzicionit.³⁵¹

347 Në Afrikën e Jugut personat të cilët kishin kryer krime mund të beneficojnë nga amnistia, e cila u jepej vetëm nëse bashkëpunonin me komisionin dhe nëse ishin të gatshëm të tregonin të gjithë të vërtetën e krimeve që kishin kryer. Rrëfimi i tyre para viktimave në prezencën e të tjerëve konsiderohej si ndëshkim në vetvete. Shih: Andrieu, “Juger, réconcilier, réparer: la justice transitionnelle pour sortir de la violence?” Fq. 116. Shih gjithashtu: M. Zunino (2019). *Justice Framed, A Genealogy of Transitional Justice*, Cambridge: Cambridge University Press, fq.123. Amnistia përmes komisioneve ndryshon rrënjësisht nga format tjera të amnistive, sepse keqbërësit e shpalojnë tmerrin e krimeve të tyre para komisionit dhe dhuna e përjetuar integrohet në narracionin kolektiv.

348 Po aty.

349 D. Dyzenhaus (1998). *Judging the Judges, Judging Ourselves: Truth, Reconciliation and the Apartheid Legal Order*. Oxford: Hart Publishing, fq.3.

350 Shih: “[Revolutionary Truth: Tunisian Victims Make History on First Night of Public Hearings for TDC](https://en.wikipedia.org/wiki/Truth_and_Dignity_Commission).” International Center for Transitional Justice. 17/11/2016, cituar në : https://en.wikipedia.org/wiki/Truth_and_Dignity_Commission (Tunisia)#cite_note-9

351 Dyzenhaus, *Judging the Judges, Judging Ourselves: Truth, Reconciliation and the Apartheid Legal Order*, fq.3.

Qëllimet e komisioneve të së vërtetës dhe pajtimit

Në një studim empirik të 40 Komisioneve të së vërtetës, Guthrey konsideron se pesë qëllimet kryesore të këtyre komisioneve janë: E vërteta, pajtimi, riparimi, mos përsëritja dhe shërimi. Guthrey thotë se e vërteta është qëllim për 32 prej tyre (nga 40), për 25 tjera është pajtimi, për 19 është riparimi kurse për 18 mos përsëritja dhe shërimi. Para se të arrinin ndonjërin nga këto qëllime, ajo konsideron se këto komisione duhet të krijojnë një mjedis i cili u mundëson viktimave që të tregojnë për vuajtjet e tyre dhe për dhunën e përjetuar.³⁵² Për këtë arsye, dëshmia është në qendër të këtyre komisioneve sepse përmes rikonstruksionit të ngjarjeve bëhet i mundur rindërtimi i individëve. Sipas Andreiu, hapësirën të cilën këto komisione e krijojnë për viktimat me qëllim që ato të mund të paraqesin ngjarjen i përngjan një “skene” ku bashkohen viktimat dhe agresorët e tyre për një katarsis të përbashkët.³⁵³ Motoja e dëshmimeve para Komisionit të së vërtetës në Afrikën e Jugut kishte qenë “të tregosh të vërtetën është të shërosh.”³⁵⁴ Dimensioni zyrtar i këtyre komisioneve ka një rol të rëndësishëm në arritjen e këtyre qëllimeve. Gjithnjë sipas Andreiu, “zbulimi i së vërtetës dhe narracioni i vuajtjeve, në një hapësirë të pranuar publikisht dhe të aprovuar nga shteti, konsiderohen si një lloj “terapi” si për viktimat ashtu edhe për agresorët.”³⁵⁵ Vuajtjet, të cilat i tregojnë viktimat integrohen më pas në një histori kolektive dhe kjo mundëson identifikim me viktimat dhe pranimin e vuajtjeve të tyre nga të tjerët. Për viktimat, kuptimi se vuajtje të tilla kanë përjetuar edhe të tjerët i shkon në favor këtij qëllimi. Gjithashtu, sjellja e keqbërësit që të tregojë publikisht për veprat e tij merr formën e një lloj ndëshkimi edhe pse nuk ka ndëshkim penal.³⁵⁶ Një ndër aspektet më të rëndësishme të këtyre komisioneve është largimi i fokusimit nga keqbërësit dhe kthimi i vëmendjes tek viktimat. Kjo i jep, sipas saj, dimension grupor këtij procesi.³⁵⁷

352 M.Tadesse Tessema (2018). *Prosecution of Politicide in Ethiopia, The Red Terror Trials*. London : Springer, fq. 141.

353 Andreiu, “Juger, réconcilier, réparer: la justice transitionnelle pour sortir de la violence?” Fq. 116.

354 H. L. Guthrey ((2015). *Victim Healing and Truth Commissions, Transforming Pain through Voice in Solomon Islands and Timor – Leste*. London: Springer, fq. 21.

355 Andreiu, “Juger, réconcilier, réparer: la justice transitionnelle pour sortir de la violence?” Fq. 116.

356 Po aty.

357 Po aty.

Përparësitë dhe mangësitë e komisioneve të së vërtetës dhe pajtimit

Përkrahësit e këtyre komisioneve konsiderojnë se ato mund të arrijnë rezultate, të cilat tribunalet nuk mund t'i arrijnë kurrë. Kjo për shkak se autorët e krimeve, të cilët dëshmojnë para këtyre komisioneve, shpalosin informacione për krimet, të cilat në një proces gjyqësor ku do të ishin të akuzuar do të tentonin t'i fshihnin për të shpëtuar nga dënimi ose për të marrë dënim më të ulët. Komisionet e së vërtetës e kanë edhe përparësinë e ofrimit të një vizioni global të dhunës së ushtruar ndaj shoqërisë dhe nuk fokusohen vetëm në disa raste specifike, ashtu siç bëjnë gjykatat. Gjykatat fokusohen vetëm në krime për të cilat mund të sigurohen prova të mjaftueshme ose kredibile. Gjithashtu, komisionet u ndihmojnë viktimave që ta kthejnë dinjitetin e tyre përmes krijimit të një mjedisi të përshtatshëm për dëshmitë në krahasim me gjykatat ku viktimat shpesh keqtrajtohen nga ekipet e mbrojtjes së të akuzuarve. Madje, në raste ku të akuzuarit e mbrojnë veten drejtpërdrejt, viktimat duhet të ballafaqohen me keqbërësit drejtpërdrejt. Kjo është treguar në shumë raste problematike për viktimat. Këto komisione kanë gjithashtu përparësinë e kostos së ulët në raport me gjykatat penale ndërkombëtare. Kështu, për shembull, Komisioni i së vërtetës në Afrikën e Jugut ka kushtuar rreth 18 milionë dollarë amerikanë në vit, për dy vjet e gjysmë sa ka zgjatur. Dhe madje, për një staf prej 304 personash ka qenë kosto e ulët nëse e krahasojmë me gjykatat penale ndërkombëtare, të cilat kanë pasur kosto disa qindra miliona dollarësh në vit dhe të cilat kanë zgjatur në disa raste me dekada.³⁵⁸ Gjithashtu, këto komisione kanë mundësi t'i trajtojnë me mijëra raste, aty ku tribunalet mund të trajtojnë më së shumti disa dhjetëra sosh. Një tjetër argument në favor të këtyre komisioneve është edhe shpejtësia me të cilën ato punojnë. Aty ku proceset gjyqësore mund të zgjasin deri në një dekadë ose më shumë, këto komisione në shumicën e rasteve e kryejnë punën e tyre brenda dy ose tre vjetësh.

Megjithatë, ato i kanë edhe mangësitë e tyre. Ndër to duhen përmendur implikimet politike, të cilat i bëjnë ato të ngjashme me mekanizma të tjerë të drejtësisë tranzicionale.³⁵⁹ Ndërhyrjet politike në shumë raste i kanë dëmtuar ato dhe kanë ndikuar në suksesin e tyre. Edhe përtej pretendimeve se ato kanë për mision nxjerrjen në pah të një të vërtete të përgjithshme të krimeve, ato në shumicën e rasteve dështojnë që të nxjerrin në pah të gjitha shkeljet e regjimeve paraprake. Një prej mangësive tjera është dalja e lirë e keqbërësit nga këto komisione pas dhënies së dëshmisë se tij, pa u brengosur për ndjekje eventuale nga gjyqësori. Kështu që, edhe përtej mundësisë që ato u japin viktimave që të tregojnë

358 J. Meltzer (2004). *Transitional Justice and Reconciliation in Post-Conflict Colombia: Some Considerations for Future Canadian Engagement*. Canadian Foundation for the Americas. fq. 8.

359 O. Bakiner (2016). *Truth Commissions, Memory, Power, and Legitimacy*. Philadelphia: University of Pennsylvania Press.

publikisht për vuajtjet e tyre, ato i privojnë nga e drejta e tyre elementare që t'i denoncojnë agresorët e tyre para drejtësisë dhe t'i shohin ata të dënuar.³⁶⁰ Për shkak të kompromiseve politike nga të cilat këto komisione rezultojnë, ato bazohen në “të mirën e përgjithshme” dhe ky mohim i së drejtave elementare që u bëhet viktimave nga këto komisione justifikohet “me kontributin e tyre në arritjen e së vërtetës kolektive.”³⁶¹ Shumë studime kanë treguar se dëshmitë e viktimave para komisioneve mund të kenë efekt psikologjik katastrofal tek ato, sepse vuajtjet e treguara zgjojnë dhimbje të vjetra. Në Afrikën e Jugut, midis 50 dhe 60% të viktimave që kanë dëshmuar para Komisionit jug-afrikan kanë raportuar pasoja psikologjike të shkaktuara nga dëshmitë e tyre para Komisionit. Në Sierra Leone ka pasur studime, të cilat kanë treguar se disa viktima edhe kishin vdekur nga sulmi në zemër pas dëshmisë së tyre para Komisionit.³⁶²

5.2. Amnistitë

Amnistia hyn në kuadër të mekanizmave të drejtësisë tranzicionale për shkak se për një kohë të gjatë ajo ka qenë mjet efikas, që u ka mundësuar shoqërive të rivendosin stabilitetin dhe paqen.³⁶³ Supozohet se pas Luftës së Dytë Botërore më shumë se 500 konflikte kanë rezultuar me amnisti duke e bërë atë mjet dominues të zgjedhjes së konflikteve.³⁶⁴ Brenda këtyre amnistive bëjnë pjesë ato që janë nënshkruar për t'u dhënë fund konflikteve të armatosura, por edhe të tjera të cilat i kanë shoqëruar tranzicionet pasautoritare. Në këtë aspekt amnistitë luajnë një rol të rëndësishëm në avancimin e transformimeve politike.³⁶⁵ Si të tilla, amnistitë paraqesin një alternativë ndaj mekanizmave gjyqësorë të drejtësisë tranzicionale. Ato mund të vendosen vetëm me ligj dhe votohen ose dekretohen nga institucionet shtetërore më të larta. Në periudhat të cilat kanë vijuar luftërat, amnistitë u janë dhënë të burgosurve të luftës, praktikë kjo e cila do të integrohet edhe në Protokollin II të Konventës së Gjenevës (1977).³⁶⁶

360 Andrieu, “Juger, réconcilier, réparer: la justice transitionnelle pour sortir de la violence?”

361 Po aty.

362 Po aty.

363 T. Hadden (2017). “Transitional justice and amnesties.” In, Lawther, Moffett, Jacobs, *Research Handbook of Transitional Justice*, (ff. 358-377), fq. 358.

364 Po aty.

365 Teitel, *Transitional justice*, fq. 51.

366 Tom “Hadden, Transitional justice and amnesties,” fq. 358.

Në anën tjetër, për mbrojtësit e drejtësisë penale ndërkombëtare amnistitë mbeten burim kryesor i mosndëshkimit.³⁶⁷ Legjitimiteti i tyre mbetet një ndër çështjet më të kontestueshme të drejtësisë tranzicionale duke i konsideruar ato më shumë si pengesë për arritjen e drejtësisë sesa mekanizëm që i kontribuon paqes.³⁶⁸ Në kontekstin e ri ndërkombëtar pas krijimit të tribunaleve ndërkombëtare penale dhe atyre hibride “normalisht amnistia dhe amnezia nuk janë të pranueshme.”³⁶⁹ Progresivisht, amnistia si mjet i zgjidhjes së konfliktit është eklipsuar në favor të kërkit të llogaridhënies për krimet e kryera. Madje në disa raste, si në Sierra Leone për shembull, ku amnistitë ishin nënshkruar si rezultat i proceseve të brendshme dhe ku ishin amnistuar krime ndërkombëtare, ato ishin shpallur të pavlefshme nga Tribunali Special për Sierra Leonen.³⁷⁰

Amnistitë dhe tranzicioni

Përdorimi i amnistive varet edhe nga lloji i tranzicionit politik. Në situata paskonfliktuale në të cilat një pushtet opresiv është ndryshuar me dhunë, ose në situata ku një konflikt ka përfunduar me një fitues, amnistitë nuk përdoren. Në këto situata predominon qasja retributive e drejtësisë tranzicionale. Në situata të tjera ku ndryshimi i pushtetit bëhet nga reformatorët brenda regjimit, atëherë favorizohet amnistia.³⁷¹ Offe dhe Poppe konsiderojnë se amnistitë janë mjet efikas gjatë periudhave të tranzicionit dhe se ato shpesh janë parakusht për anëtarët e regjimit të vjetër që të pranojnë të negociojnë e që në mungesë të një premtimi se nuk do të procedohen penalisht, nuk do ta kishin bërë kurrë.³⁷² Amnistitë luajnë rol para dhe pas konflikteve. Para përfundimit të konfliktit ato kanë meritën t’i sjellin palët në tavolinën e negociimit duke krijuar kështu terrenin e përshtatshëm për të biseduar fundin e armiqësive. Pas konfliktit palët sigurohen se nuk do të kenë pasoja për krimet e kryera gjatë konfliktit. Autokratët pranojnë kështu dorëzimin e pushtetit “vetëm pasi atyre u garantohet imuniteti për shkeljet e të drejtave të njeriut në të kaluarën.”³⁷³

367 Bloomfield, Barnes, Huysse, *Reconciliation after violent conflict, A Handbook*, fq. 109.

368 Tom Hadden, “Transitional justice and amnesties,” fq. 358.

369 Andrieu, “Political liberalism after mass violence,” fq. 89.

370 De Grief dhe Duthie, *Transitional Justice and Development, Making Connections*, fq. 291.

371 Bloomfield, Barnes dhe Huysse, *Reconciliation after violent conflict, A Handbook*, fq. 42-43.

372 C. Offe, U. Poppe (2006). “Transitional Justice in the German Democratic Republic and in Unified Germany.” In, J.Elster (Eds.), *Retribution and Reparation in the Transition to Democracy* (ff. 239-276). Cambridge: Cambridge University Press. Fq. 273.

373 M. Nalepa (2010). *Skeletons in the Closet: Transitional Justice in Post-Communist Europe*. Cambridge: Cambridge University Press. Fq. 33

Megjithatë, për të qenë mekanizëm efikas i drejtësisë tranzicionale, Offe dhe Poppe konsiderojnë se amnistia duhet të jetë e ndryshme nga amnezia dhe se:

Amnistia mund të përdoret si alternativë ndaj ndjekjes penale ose si një hap pasues. Për më tepër, nëse amnistia jepet individualisht (më shumë sesa kolektivisht ose kategorikisht), nëse ajo duhet të kërkohet nga individë (në vend se të jepet në mënyrë të njëanshme nga shteti), nëse është e kufizuar në kategori më pak të rënda të krimeve (duke përjashtuar të gjitha vrasjet), dhe nëse ajo jepet si kompensim për rrëfimet e vërteta dhe shprehjen publike të keqardhjes, ajo mund të funksionojë si instrument serioz i arritjes së drejtësisë tranzicionale dhe efektit të saj të synuar [...].³⁷⁴

Në formën e saj klasike amnistia nënkupton lirin nga përndjekja penale si dhe lirin e keqbërësit nga kërkimfalja para komunitetit.³⁷⁵ Përjashtim janë amnistitë, të cilat kalojnë përmes komisioneve të së vërtetës dhe pajtimit. Nga amnistia përfitojnë një numër i caktuar personash ose ajo përfshin një kategori të caktuar të krimeve. Amnistitë në përbërjen e tyre kanë “masat ligjore të miratuara nga shtetet që kanë efektin e ndalimit të mundshëm të ndjekjeve penale kundër individëve të caktuar, të akuzuar për akte të shkeljeve të të drejtave të njeriut.”³⁷⁶ Para se të nënshkruhen, ato paraqiten si masë e jashtëzakonshme me qëllim që t’i përgjigjen një situatë të jashtëzakonshme dhe me qëllim të arritjes së pajtimit.

Amnistitë unilaterale dhe të negociuara

Amnistitë mund të jenë unilaterale dhe të negociuara. Amnistitë unilaterale janë ato ku një regjim ende në pushtet vendos t’i amnistojë krimet e veta. Këto lloj amnistish marrin formën e vetamnistimit. Raste të tilla ka shumë. Në vitin 1979, në Brazil, është votuar një amnisti e tillë, ku gjeneralët e juntës ushtarake në pushtet kishin votuar një ligj përmes të cilit ndalonin përndjekjen e çdo anëtari të juntës ushtarake për krimet e kryera. Në Argentinë, në vitin 1982, junta ushtarake në pushtet kishte votuar vetamnistinë si “mburojë të mosndëshkimit” para se të ndryshonte pushteti.³⁷⁷ Vetamnistia më e studiuar është ajo e Kilit, e votuar në vitin 1978 nga regjimi i Augusto Pinochet-it. Ajo i amnistonte krimet e kryera midis 1973-1978

374 Po aty.

375 Minow, *Breaking the Cycles of Hatred, memory, law and repair*, fq. 18.

376 Po aty. fq. 21.

377 T. Fernandes Paredes (2010). Transitional Justice in Democratisation Process: The Case of Spain From an International Point of View. *International Journal of Law, Transitional Justice and Human Rights*, 1, fq. 132.

që përputheshin me rrëzimin e Salvador Allende në vitin 1973. Ligji për amnistinë ndalonte përndjekjen e çdo anëtari të juntës ushtarake, i cili gjatë dhe pas rrëzimit të pushtetit të Allendes kishte kryer krime. Do të përfitojnë nga kjo amnisti kryesisht anëtarët e forcave të sigurisë së regjimit Pinochet. Edhe pushteti i dalë nga zgjedhjet demokratike të vitit 1990 do të ketë vështirësi për të ndryshuar këto ligje, sepse ish-regjimi i kishte integruar ato në Kushtetutë të shtetit. Vetëm në vitin 1999, 22 vjet pas votimit të vetamnistisë, viktimave të dhunës së juntës ushtarake do t'u kthehet shpresa për drejtësi dhe për zbulimin fatit të të afërmeve të tyre. Një vendim i Gjykatës Supreme të këtij shteti do të vendosë se Ligji i amnistisë i votuar në vitin 1978 nuk i mbulonte rastet e personave të zhdukur gjatë diktaturës. Ky vendim do të mundësojë arrestimin dhe burgosjen e 25 ish-oficerëve të ish-juntës ushtarake. Madje edhe vetë Pinochet do të intervistohet. Pinochet nuk ishte sjellë para drejtësisë pasi që ishte shpallur i paaftë për gjykim. Kjo kishte mundësuar fillimin e ballafaqimit të shoqërisë kiliane me të kaluarën e diktaturës së Pinoches.³⁷⁸ Raste tjera të amnistive unilaterale ka pasur në shumë shtete afrikane dhe ato nuk kanë qenë gjithmonë të lidhura me krimet e kryera nga regjimet paraprake. Në disa shtete si Zimbabveja, për shembull, janë amnistuar anëtarë të partisë në pushtet për krimet e kryera kundër anëtarëve të opozitës. Dhe kjo është bërë zakonisht pas çdo periudhe zgjedhore. Ligjet e para që kanë votuar qeveritë e reja kanë qenë ato të vetamnistimit.³⁷⁹

Amnistitë e negociuara përbëjnë shumicën e amnistive dhe ato arrihen mes palëve në konflikt. Qëllimi i tyre është t'i japin fund një konflikti të armatosur. Në këto raste amnistia e luan rolin e një mekanizmi të drejtësisë tranzicionale të brendshme që krijon kushtet minimale të nevojshme për t'i dhënë fund konfliktit dhe kthimit të bashkëjetesës. Amnistitë e negociuara në Guatemalë, në vitin 1996, ose në Angolë, në vitin 2002, kanë qenë të tilla, por numri i tyre është i madh. Raste të amnistive të negociuara janë edhe ato të cilat kanë për qëllim lehtësimin e një tranzicioni pasautoritar. Diferenca me të parat është se këtu kemi të bëjmë më shumë me situata në të cilat nuk ka konflikt të armatosur, por në të kaluarën ka pasur krime masive të kryera nga regjimi paraprak. Rastet e Spanjës dhe Afrikës së Jugut janë raste tipike të këtyre llojeve të amnistive. Në Spanjë, pas rënies së diktatorit Franko, në fund të viteve 1970, kishte pasur një konsensus të gjerë politik që tranzicioni demokratik të bëhet përmes amnistisë.³⁸⁰ Amnistia duhej t'ia hapte rrugën pajtimit. Në korrik të vitit 1976, Qeveria spanjolle kishte amnistuar 400 të burgosur politikë, të cilët ishin liruar më pas.³⁸¹ Në tetor 1977 ishte votuar Ligji i amnistisë, i cili shkonte edhe një

378 Minow, *Breaking the Cycles of Hatred, memory, law and repair*, fq. 22.

379 Bloomfield, Barnes, Huyse, *Reconciliation after violent conflict, A Handbook*, 109.

380 Elster, *Closing the books, transitional justice in historical perspective*, fq. 61.

381 Po aty.

hap më larg duke liruar edhe të burgosurit e tjerë politikë, ku bënin pjesë edhe persona të dënuar për vrasje politike. Ky ligj do të ndërpriste çdo proces gjyqësor, i cili kishte për qëllim dënimin e anëtarëve të ish-regjimit, si dhe do t'u mundësonte nëpunësve civilë të ish-regjimit, të larguar nga puna pas rënies së Frankos, që të kthehen në vendet e tyre të punës dhe të mund të bonifikonin pensionet e tyre.³⁸² Amnistia kishte qenë pjesë e një “pakti të tranzicionit”, pjesë e të cilit kishte qenë edhe mbyllja e arkivave të policisë sekrete, legalizimi i Partisë Komuniste, si dhe adoptimi i një kushtetute konsensuale.³⁸³ Megjithatë, kujtesa e luftës civile është kthyer fuqishëm në debat publik në fillim të viteve 2000.

Rasti tjetër i amnistisë së negociuar ka qenë ai në Afrikën e Jugut. Negociatat të cilat i kishin paraprirë fundit të Aparteidit dhe dorëzimit të pushtetit nga të bardhët në këtë shtet kishin përfshirë amnistinë si parakusht për tranzicionin paqësor të pushtetit. Disa autorë kanë konsideruar se shkaku pse amnistinë në këtë shtet ishin respektuar kishte qenë kontrolli mbi burimet ekonomike të shtetit, të cilin komuniteti i bardhë jug-afrikan e kishte trashëguar nga Aparteidi. Kërcënimet me ndëshkim do të kishin provokuar ikje të kapitalit dhe bankrotim të shtetit. Madje organizimi i proceseve gjyqësore rrezikonte të rezultonte më shumë me hakmarrje sesa që do të sillte drejtësi.³⁸⁴ Por amnistia në Afrikën e Jugut do të jetë paksa e ndryshme nga ato të lartpërmendura, të cilat kishin rezultuar me lirim nga përndjekja. Këtu amnistia ishte inkuadruar në kuadër të Komisionit të së vërtetës dhe pajtimit, të krijuar në vitin 1996. Akti themelues i këtij komisioni i kishte dhënë atij këtë kompetencë me qëllim që t'ia bënte më të lehtë zbulimin e të së vërtetës së krimeve. Kjo kompetencë, e cila e dallonte atë nga të gjitha komisionet tjera të së vërtetës të krijuara deri atëherë, ishte konsideruar si “inovacioni më i madh i këtij komisioni, por edhe një nga kompetencat më kontroverse të tij.”³⁸⁵ Nga tri nënkomitetet, të cilat e përbënin këtë komision, Komiteti i Amnistisë kishte qenë përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për amnisti, organizimin e seancave dëgjimore dhe dhënien e amnistisë për aplikuesit individualë.³⁸⁶ Komiteti për shkeljet e të drejtave të njeriut kishte pasur për detyrë marrjen e deklaratave nga viktimat dhe dëshmitarët, si dhe dokumentimin e natyrës dhe shkallës së shtrirjes së abuzimeve të të drejtave të njeriut, si dhe udhëheqjen e seancave dëgjimore publike. Komponenti i tretë kishte qenë Komiteti për Riparime dhe Rehabilitim, i cili ka pasur për rol të hartonte një sërë rekomandimesh për dëmshpërblimin e viktimave. Sa i

382 Po aty.

383 Po aty, fq. 62.

384 Elster, *Retribution and Reparation in the Transition to Democracy*, fq. 9.

385 Oduro, *Transitional Societies, Democratic Accountability and Policy Responses*, fq. 176.

386 Po aty.

përket amnistisë, kusht për ta marrë atë kishte qenë që aplikuesit të tregoheshin të sinqertë në dëshmitë e tyre para Komisionit dhe që rrëfimet për krimet të jenë kredibile. Amnistia jepej vetëm për krimet e kryera mbi baza politike dhe, para se të aprovohej, duhej që krimi në fjalë të jetë zbardhur plotësisht. Megjithatë, nëse e shikojmë numrin e amnistive të akorduara nga ky komision, ai ka qenë shumë i limituar. Nga përfaqësuesit 7000 persona që kishin aplikuar para këtij komisioni, vetëm 10% kishin arritur ta merrnin atë. Komisioni në raportin e tij përfundimtar kishte thënë se “duhej t’i rezistohesh amnistisë së përgjithshme në mënyrë që të shmangej një kulturë e mosdëshkimit.”³⁸⁷ Megjithatë, numri i personave të dënuar për krimet e Aparteidit, pas ndryshimit të pushtetit, do të jetë i vogël. Si rezultat, kjo lloj amnistie do të jetë më shumë një imunizim ndaj përndjekjes sesa amnisti në kuptim të plotë të fjalës.³⁸⁸

Elementet e amnistive

Amnistia, sipas Verdussen-it, i ka katër elemente dalluese.³⁸⁹ Elementi i parë është se ajo e shlyen karakterin ofendues dhe të ndëshkueshëm të krimeve të kryera. Ajo nuk i fshin veprat penale, por vetëm i pushon përndjekjet ligjore të atyre që kanë kryer krime dhe që janë subjekt i amnistisë duke e bërë të pamundur për prokurorët dhe gjykatat që të ndërmarrin veprime publike në raport me këto vepra penale. Elementi i dytë është se amnistia ka dimension kolektiv. Nga ajo përfitojnë të gjithë personat, të cilët kanë kryer veprën e amnistuar. Nuk ka amnisti për një person specifik dhe as për një krim specifik. Karakteristika e tretë është se amnistitë votohen dhe si të tilla ato marrin formën e ligjeve. Në këtë aspekt ato simbolizojnë tërheqjen mbrapa të legjislatorit. Dhe karakteristika e katërt është se në shumicën e kushtetutave të shteteve demokratike ato mungojnë.³⁹⁰

Një ndër nocionet e përafërta me amnistinë është falja.³⁹¹ Falja dhe amnistia dallojnë varësisht se a kemi të bëjmë me falje juridike apo etike. Amnistia është një lloj faljeje, e cila mund të jetë vetëm juridike. Kjo për shkak se ajo bëhet me ligj duke implikuar kështu shtetin dhe shoqërinë në përgjithësi dhe bëhet për qëllime politike. Ajo ka kështu

387 Po aty.

388 M. Verdussen (2016). “L’amnistie : contours juridiques et enjeux sociétaux.” In, Verdussen, M., Bruckner, P., Vike-Freiberga, V., Gacon, S., Lefranc, S., Garapon, A., Elorza, A., Delangre, J.F., Kotek, J., Luminet, O. *De la mémoire à l’oubli. L’amnistie en question(s)* (ff. 7-16). Actes de colloque international. Academie Royale de Belgique, Brussels, 6-8 tetor.

389 Po aty.

390 Po aty.

391 Po aty.

një dimension kolektiv edhe pse mund të amnistohet vetëm një kategori e krimeve të kryera brenda një afati kohor të caktuar ose një kategori e personave. Falja ekziston edhe si kompetencë e ekzekutivit, i cili ka mundësi të zbusë ndëshkimin e personave të dënuar dhe që kompetenca i takon vetëm presidentit (monarkut). Por, në raport me amnistinë, e cila është kolektive, falja si kompetencë e ekzekutivit nuk e shlyen dënimin e personit të falur, por vetëm e redukton atë ose e shndërron në një dënim tjetër.³⁹² Amnistitë dallojnë rrënjësisht nga kjo falje, sepse i lirojnë personat nga ndjekja penale, kurse personat e falur përmes ekzekutivit janë persona, të cilët kanë kaluar procesin gjyqësor dhe janë dënuar. Falja nga ekzekutivi nuk ka incidencë mbi shlyerjen e veprave për të cilat personat janë dënuar.

Amnistia si lloj i faljes juridike dallon rrënjësisht nga falja si nocion etik. Paul Ricoeur thotë se falja etike është e ndryshme nga ajo juridike për shkak të dimensionit të saj “të pariparueshëm që ka për viktimat.”³⁹³ Kjo është arsyeja pse, sipas tij, “amnistia është një formë e institucionalizuar e amnezisë,”³⁹⁴ një lloj “amnezie e imponuar me ligj”³⁹⁵ dhe potencon si argument pamundësinë e ndjekjes penale të personave të amnistuar. Megjithatë, Ricoeur nuk e mohon faktin se “amnistia i kontribuon qetësisë publike që është një nga përgjegjësitë e shtetit”, por kjo është, sipas tij, një lloj harrese që ka edhe rreziqet e veta. Michel Van de Kerchove e potencon dimensionin instrumentalist të amnistisë duke e kontestuar kategorizimin e amnistisë si harresë për shkak se ajo nuk i zhdok veprat, por vetëm karakterin e tyre penal.³⁹⁶ Dimensionin instrumental i amnistisë ka të bëjë edhe me rikthimin e shoqërive në normalitet, kompensimin e viktimave etj. Madje amnistitë nuk mund të dekretojnë harresën e krimeve, të cilat mbeten në kujtesë. Të gjitha këto elemente ia japin asaj një dimension prospektiv.

392 Po aty.

393 Simms, K. (2003). *Paul Ricoeur*. London, Routledge, fq. 120.

394 Po aty.

395 Luc Huyse, “Belgian and Dutch Purges after World War II Compared.” f. 170.

396 M. Van De Kerchove, “Éthique pénale”.

5.3. Reforma institucionale

Për të qenë i suksesshëm, tranzicioni nga autoritarizmi në pasautoritarizëm ose nga lufta në paqe duhet të shoqërohet me reforma institucionale, të cilat mundësojnë krijimin e një fryme të re brenda institucioneve dhe e gjithë kjo bëhet me qëllim të pamundësimit të kthimit të shoqërive në dhunë. Reforma institucionale ka për qëllim ndërtimin dhe rritjen e besimit midis qytetarëve dhe institucioneve.³⁹⁷ Sipas Qendrës Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale (QNDT), reforma institucionale “është procesi i rishikimit dhe ristrukturimit të institucioneve shtetërore në mënyrë që ato t’i respektojnë të drejtat e njeriut, të zbatojnë shtetin ligjor dhe t’u japin llogari zgjedhësve të tyre [...] masat e reformës mund të sigurojnë përgjegjësi për autorët individualë dhe t’i çaktivizojnë strukturat, të cilat kishin lejuar që të ndodhnin abuzime.”³⁹⁸ Kështu, reforma institucionale duhet të krijojë një standard të ri sipas të cilit zyrtarët shtetërorë duhet të seleksionohen në bazë të integritetit të tyre dhe nga ajo kategori e personave, të cilët nuk kanë qenë të përzier në çfarëdo forme me regjimet represive paraprake. Institucionet të cilat më së shumti duhet të reformohen janë ato që në të kaluarën kanë qenë kryesoret në zbatimin e politikave represive të regjimeve. Këto institucione janë zakonisht ushtria, policia, shërbimet sekrete dhe gjykatat. Edhe pse reformat institucionale kërkojnë kohë dhe nuk mund të zbatohen shpejt, një ristrukturim i shpejtë duhet t’u paraprijë reformave më të thella, si dhe demokratizimit të tyre, i cili është objektiv afatgjatë. Sipas QNDT-së, reformat institucionale përfshijnë një gamë të gjerë masash të cilat janë: vetingu, i cili ashtu siç do ta shohim në pjesën vijuese, ka të bëjë me verifikimin e së kaluarës së personave që konkurrojnë për pozita publike; reformat strukturore, të cilat duhet të jenë të pavarura në punën e tyre; krijimin e trupave mbikëqyrës që do të favorizojnë qeverisjen e mirë; votimin e ligjeve që nuk janë diskriminuese; politikat e çarmatimit, demobilizimit dhe riintegritit (*Demobilisation, Disarmament and Reintegration-DDR*) që kanë për qëllim çarmatimin e grupeve të armatosura pas konfliktit; programet e edukimit për zyrtarë publikë, të cilët duhet të krijojnë njohuri të reja por të bazuara në standarde të larta të të drejtave të njeriut.³⁹⁹

Për ta ilustruar rëndësinë e reformave institucionale mund ta marrim si shembull reformën e forcave ushtarake. Të gjitha shtetet, të cilat kanë kaluar nga autoritarizmi në demokraci ose nga lufta në paqe, e kanë bërë këtë reformë në disa faza. Në shtetet ku ka pasur luftë, kjo reformë është bërë pas demobilizimit të palëve luftuese. Në këto shoqëri faza e parë nënkupton kthimin e ish-fraksioneve luftuese në kazerma dhe vendosjen nën kontroll

397 Shik dosjen e QNDT-së për reformat institucionale dhe rëndësinë e tyre në: <https://www.ictj.org/our-work/transitional-justice-issues/institutional-reform#>

398 Po aty.

399 Po aty.

të armëve. Demobilizimi i fraksioneve ushtarake të angazhuar në konflikte bëhet përmes çarmatimit dhe vendosjes nën kontroll të armatimit. Por për të qenë proces i suksesshëm dhe për të pamundësuar rikthimin e luftimeve, duhet që ish-luftëtarët të riintegrohen në shoqëri. Politikat e çarmatimit, demobilizimit dhe riintegritit kanë pikërisht për qëllim që të sigurojnë uljen e tensioneve brenda shoqërisë. Në Kosovë, për shembull, reforma DDR është zbatuar nga qershori në shtator 1999. Ish-luftëtarët e UÇK-së janë integruar, mes tjerash, në Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe në Policinë e Kosovës. Përmes demobilizimit të ish-luftëtarëve dhe vendosjes nën kontroll të armatimit, qëllimi është që t'i kthehet shtetit monopoli i dhunës legjitime (M. Weber). Në një fazë të dytë kjo reformë kërkon ndryshimin e dispozitave kushtetuese, të cilat duhet ta përcaktojnë rolin e këtij institucioni në të ardhmen. Në shtetet që kishin dalë nga komunizmi, për shembull, kjo reformë kishte konsistuar fillimisht në reduktimin e numrit të ushtarëve, reduktim i cili më pas është vazhduar me profesionalizimin e forcave ushtarake. Hapi vijues ka qenë vendosja e tyre nën kontrollin e pushtetit civil. Ndryshimet e tjera kanë pasur për objektiv ristrukturimin e sektorit të inteligjencës, nën kontrollin e ushtrisë etj. Në vende të tjera reformat kanë nënkuptuar largimin e politikës nga ushtria. Në një studim të reformave në El Salvador, Zamora dhe Holiday konsiderojnë se këto reforma kanë pasur rol kyç në “demilitarizimin e politikës.”⁴⁰⁰

Në pamundësi që t'i trajtojmë të gjithë këta mekanizma të lartpërmendur, në vijim do të fokusohemi tek vetingu si mekanizëm, i cili simbolizon më se miri reformën institucionale.

5.4. Vetingu dhe lustrimi

Përmes verifikimit të integritetit të personave, të cilët pretendojnë të integrojnë institucionet e reja, vetingu i kontribuon kthimit të besimit tek institucionet dhe ndikon në rritjen e legjitimitetit të tyre.⁴⁰¹ Vetingu ka të bëjë me masat, të cilat “përfshijnë verifikimin e individëve në institucionet publike, pozicionet gjysmëpublike dhe / ose pozicionet e lira të besimit publik për të verifikuar që personeli ka integritetin dhe kapacitetin për të përmbushur pozicionet e tyre në mënyrë që të mbështesë qëllimet e regjimit të ri.”⁴⁰²

400 R. Zamora, D. Holiday (2007). “The Struggle for Lasting Reform: Vetting Processes in El Salvador.” In, A. Mayer-Rieckh, P. De Greiff, *Justice as Prevention, Vetting Public Employees in Transitional Societies* (ff. 80-120). New York: ICTJ, fq. 109.

401 S. Lavinia (2017). “Lustration and Vetting.” In, Simic O., (Eds.). *An Introduction to Transitional Justice* (ff. 137-154). London, New York: Routledge, fq. 138.

402 C. M. Horne (2017). “Transitional justice: Vetting and lustration.” In, Lawther, Moffett, Jacobs, *Research Handbook of Transitional Justice* (ff. 424-445), fq. 424.

Integriteti i individëve për të zënë pozita publike pas ndryshimit të regjimit në këtë rast ka të bëjë me atë se deri në çfarë mase një person “aderon në standarde përkatëse të të drejtave të njeriut, aftësitë e tij profesionale, si dhe në raport me pronat që ai posedon.”⁴⁰³ Kështu, përmes skanimimit vlerësohet se a janë këta persona të përshtatshëm për të mbajtur pozitat për të cilat kandidojnë. Vetingu është mekanizëm, i cili përdoret edhe jashtë drejtësisë tranzicionale, por në kontekstin e tranzicionit ai, para së gjithash, ka të bëjë me verifikimin e implikimit të personave në shkeljet e kryera nga regjimet paraprake. Si i tillë vetingu i takon “drejtësisë administrative”, sepse ai implikon zbatimin e ligjit administrativ, i cili e definon raportin e institucioneve qeveritare mes tyre.⁴⁰⁴

Spastrimet (purges)

Spastrimet si formë specifike e vetingut e kanë karakterizuar periudhën pas Luftës së Dytë Botërore dhe janë përdorur në kuadër të denazifikimit në Gjermani, ose edhe për largimin nga puna të bashkëpunëtorëve nazistë në Francë, Belgjikë etj.⁴⁰⁵ Në Francë spastrimi ligjor (*épuration légale*) ka qenë i drejtuar kundër bashkëpunëtorëve të regjimit nazist të Vichy-së. Megjithatë, në shumicën e shteteve ku janë zbatuar, ato kanë qenë të limituara dhe kanë pasur karakter selektiv, si nga personat ashtu edhe nga institucionet, të cilat i janë nënshtruar. Spastrimet kanë qenë të drejtuara vetëm kundër disa personave që kanë pasur pozita të larta.⁴⁰⁶ Shkaqet pse ato kanë qenë të limituara janë të shumta, por një ndër ato ka qenë ruajtja e funksionimit të administratës shtetërore. Çdo largim masiv do të kishte pasur për efekt largimin e profesionistëve nga administrata dhe reduktimin e kapaciteteve të saj. Institucionet të cilat janë “spastruar” kanë qenë kryesisht ato të sigurisë, që edhe kanë qenë më të implikuarat në kryerjen e krimeve. Këtu duhet dalluar gjykatat, policinë, ushtrinë dhe shërbimet e inteligjencës.⁴⁰⁷ Spastrimet u kanë mundësuar regjimeve të reja në këto shtete që t’i vendosin ato nën kontroll. Ky proces është bërë përmes shpërbërjes së rrjetave me qëllim që të bëhet i pamundur veprimi i tyre.

Në shumë shtete të dala nga regjimet diktatoriale dhe të cilat kanë brishtësi sa i përket tranzicionit, spastrimi ka marrë formë hakmarrjeje. Regjimi i ri hakmerret ndaj njerëzve

403 Zamora dhe Holiday, “The Struggle for Lasting Reform: Vetting Processes in El Salvador,” fq. 109.

404 Lavinia, “Lustration and Vetting,” fq. 138.

405 A. Mayer-Rieckh, P. De Greiff, *Justice as Prevention, Vetting Public Employees in Transitional Societies* (ff. 80-120). New York: ICTJ, fq. 18.

406 Lavinia, “Lustration and Vetting,” fq. 139.

407 Po aty.

të regjimit të vjetër duke larguar masivisht nga puna zyrtarët publikë të ish-regjimit. Ky ka qenë rasti në Irak, për shembull, pas rënies së regjimit të Sadam Husein-it, ku nën pretekstin e largimit të personave, të cilët i kishin shërbyer diktaturës, ishin larguar të gjithë ata të cilët kishin qenë të punësuar nga regjimi paraprak.

Lustrimi

Etimologjia e fjalës lustrim vjen nga greqishtja *lustratio*, që ka qenë ritual grek dhe më pas edhe romak i spastrimit. Në raport me spastrimet, të cilat e kanë karakterizuar periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, lustrimi u referohet më shumë “spastrimeve” të bëra në shtetet ish-komuniste, pas rënies së komunizmit. Ligjet e lustrimit kanë qenë “mjete më i përdorur për shqyrtimin dhe “ndjekjen penale” të ish-udhëheqësve komunistë, kandidatë për zyra dhe punonjës të zgjedhur publikë. Këto ligje, të cilat zakonisht mbështeten në informacionet e përfshira në dosjet e policisë sekrete, përdoren për të verifikuar nëse individët e dyshuar kishin bashkëpunuar me ish-shërbimin e sigurimit të shtetit.”⁴⁰⁸ Lustrimi është përdorur në këto shtete për të larguar nga disa institucione shtetërore persona, të cilët në të kaluarën e regjimit komunist kishin abuzuar me pozitat e tyre. Kështu, lustrimi është mekanizëm i cili i verifikon individët, ua pamundëson atyre punësimin në institucione publike ose i largon ata nëse konstatohet se kanë qenë të implikuar në shkeljet e kryera nga regjimi paraprak.

Ligjet e lustrimit ndalonin mbajtjen e një sërë pozitash publike me ndikim, siç ishin ato të gjykatësve ose prokurorëve, por edhe pozita tjera, siç ishin drejtorë të televizioneve publike, kryetarëve të universiteteve publike etj.⁴⁰⁹ Në disa shtete si Hungaria, subjekt i këtyre ligjeve kishin qenë 25 kategori të zyrtarëve të lartë të shtetit.⁴¹⁰ Në shtetet ku ky proces ka qenë më i limituar, subjekt i lustrimit kanë qenë persona, të cilët kishin bashkëpunuar me shërbimet sekrete ose me policinë/ ushtrinë. Ligjet e lustrimit kishin rezultuar edhe me krijimin e institucioneve verifikuese, edhe pse në disa shtete verifikimi është bërë përmes gjykatave ose agjencive shtetërore.

Shteti i parë pas rënies së komunizmit, i cili e ka votuar Ligjin e lustrimit, ka qenë Gjermania, në vitin 1990, në kuadër të Traktatit të unifikimit. Qëllimi i këtij ligji ka qenë verifikimi i personave nga ish-Gjermania Lindore se a kanë qenë bashkëpunëtorë të shërbimit sekret gjermano-lindor, Stazi. Punëdhënësit kanë pasur mundësi që para se të punësojnë një person të kërkojnë nga një agjenci e specializuar se a kanë qenë personat në

408 Ellis, *Purging the past: The Current State of Lustration Laws in the Former Communist Bloc*, fq.181.

409 Lavinia, “Lustration and Vetting.”

410 Ellis, *Purging the past: The Current State of Lustration Laws in the Former Communist Bloc*, fq.184.

fjalë bashkëpunëtorë të këtij shërbimi. Kjo agjenci ishte krijuar nga shteti për të mundësuar një gjë të tillë. Deri në vitin 2006 asnjë person që kishte qenë informator i këtij shërbimi nuk kishte pasur mundësi të punësohej në administratë shtetërore.⁴¹¹ Por, përveç Gjermanisë, ligje të tilla kanë votuar edhe Polonia, Republika Çeke, Hungaria, Estonia, Lituania, Bullgaria dhe Shqipëria. Kjo e fundit ka votuar dy ligje për lustrimin, në vitin 1995 dhe më 1998, por të cilat për shkak të mungesës së stabilitetit politik dhe politizimit të tyre nuk kanë pasur shumë sukses.⁴¹²

Individët i janë nënshtruar këtij procesi përmes pranimit se kanë pasur përgjegjësi në kryerjen e shkeljeve nga regjimi paraprak ose janë paditur nga të tjerët. Në ato shtete ku ka qenë e vështirë të verifikohet e kaluara e individëve u është kërkuar atyre që të deklarohen vetë me shkrim se a kanë qenë apo jo të implikuar në ndonjë mënyrë apo tjetër me shkeljet e regjimit paraprak, ose a kanë bashkëpunuar me shërbimet sekrete komuniste. Në situata ku personat kanë pranuar vetë bashkëpunimin kjo u ka mundësuar atyre që t'u ikin procedimeve penale në rast të zbulimit të dosjeve të tyre në arkiva më vonë. Kështu, në vend se të procedohen përmes komisioneve të lustrimit dhe të stigmatizohen, këta persona kanë pasur mundësi që të vazhdojnë jetën e tyre pa u shantazhuar.⁴¹³ Kjo ka qenë mënyra e zbatimit të lustrimit në Poloni, Hungari etj. Në disa vende të tjera ky proces është bërë përmes denoncimeve. Pas verifikimeve të kryera nga organet kompetente, emrat e personave të implikuar në shkeljet e regjimit të vjetër janë bërë publik.⁴¹⁴ Megjithatë, programet e lustrimit nuk kanë përfshirë të njëjtat kategori njerëzish gjithkund. As sanksionet të cilat kanë rezultuar nga lustrimi nuk kanë qenë të njëjta. Bashkëpunëtorët e shërbimit famëkeq gjermano-lindor, Stazi, për shembull, e kanë pasur të ndaluar punësimin në administratë shtetërore gjermane deri në vitin 2006. Në Bullgari e kanë pasur të ndaluar punën në institucione publike për një periudhë kohore 5-vjeçare. Në vende të tjera ata janë pushuar nga puna përgjithmonë.⁴¹⁵

Pyetja që shtrohet është se cili ka qenë interesi i lustrimeve? Në disa nga shtetet ish-komuniste lustrimi ka mundësuar reformimin e institucioneve, të cilat me dekada të tëra kishin qenë në shërbim të regjimeve diktatoriale, gjë që kishte rezultuar me kapacitete të dobëta administrative. Në këto shtete jo vetëm institucionet e sigurisë, por të gjitha institucionet dominuese kishin qenë nën kontrollin e regjimeve duke ia filluar nga ekonomia, administrata shtetërore, mediat, universitetet etj. Pas rënies së komunizmit ndryshimet

411 Lavinia, "Lustration and Vetting," fq.140

412 Ellis, *Purging the past: The Current State of Lustration Laws in the Former Communist Bloc*, fq.185.

413 Lavinia, "Lustration and Vetting," fq 140.

414 Po aty. fq. 140

415 Po aty.

brenda këtyre institucioneve kishin qenë të pashmangshme dhe ato kishin filluar me ndryshimin e personelit. Lavinia konsideron se nëse nuk do të ishte proceduar me lustrimin, ky kishte qenë problem serioz për regjimet e reja, të cilat kishin pasur kërkesa nga viktimat e ish-regjimit që të ndërmarrin masa në këtë drejtim. Regjimet paskomuniste e kanë përdorur lustrimin edhe si metodë për t'u diferencuar nga regjimet paraprake. Një rëndësi të veçantë ka pasur lustrimi i sektorit të drejtësisë për të treguar se aty nuk kishte më vend për abuzuesit, një qasje krejt tjetër nga regjimi i vjetër, i cili jo vetëm se nuk i kishte sanksionuar abuzuesit, por edhe i kishte mbrojtur ata. Tjetër rëndësi që ka pasur lustrimi ka qenë ndërprerja e rrjeteve të korrupsionit të krijuara për shkak të qëndrimit të gjatë të personave në këto institucione. Lustrimi ka pasur edhe meritën e zbulimit të së vërtetës së krimeve të së kaluarës. Publikimi i arkivave ka kontribuar në daljen në sipërfaqe të praktikave të ish-regjimit.

Megjithatë, lustrimi ka qenë mekanizëm, i cili nuk ka rekomanduar sanksionimin e keqbërësve dhe shumë prej personave të larguar nga puna, sidomos ata që kishin qenë pjesë e shërbimeve sekrete, ishin konvertuar në biznesmenë të fuqishëm dhe ishin pasuruar përmes privatizimit të pronave publike. Ata nuk kishin hezituar t'i përdornin rrjetet, të cilat i kishin ruajtur brenda administratës për të arritur qëllimet e tyre. Kjo e kishte rritur pastaj ndikimin e tyre tek regjimet e reja paskomuniste. Një situatë e tillë ka mbizotëruar gjatë në Rumani, në Bullgari, por edhe në Sllovaki.

Procesi i lustrimit ka pasur shumë mangësi, të cilat kanë ndikuar që në shumë shtete ai të ketë sukses të limituar. Kryesisht ka qenë problematik politizimi i këtij procesi. Shpesh regjimet e reja paskomuniste kanë vendosur njerëzit e vet për të udhëhequr këtë proces dhe e kanë përdorur për interesa politike. Tjetër mangësi që duhet përmendur ka qenë natyra e tij selektive. Ashtu siç u tha më lart, janë lustruar kryesisht bashkëpunëtorët e agjenturave komuniste ose më gjerësisht sektorit të sigurisë. Por në disa shtete një lustrim sistemik ka qenë i pamundur për shkak të numrit të madh të personave të implikuar. Personat të cilët janë lustruar e kanë konsideruar këtë dimension selektiv si tendencioz dhe të padrejtë.⁴¹⁶ Tjetër mangësi ka qenë mungesa e kredibilitetit të arkivave. Në shumë shtete arkivat ishin manipuluar duke e bërë të mundur spekulimin dhe stigmatizimin e personave të pafajshëm. Në anën tjetër, shumë arkiva ishin shkatërruar duke u mundësuar të tjerëve që t'i shmangen përgjegjësisë. Mbasandaj ka qenë edhe çështja e kohëzgjatjes së bashkëpunimit. Çfarë sanksioni të aplikohet ndaj atyre që kishin bashkëpunuar disa ditë në raport me ata që i kishin shërbyer sistemit me dekada?⁴¹⁷

416 Lavinia, "Lustration and Vetting," fq. 145.

417 Po aty.

Vetingu

Vetingu si mekanizëm i reformës institucionale ndryshon nga spastrimi dhe lustrimi. Vetingu, sipas Horne, ka për qëllim të krijojë besim dhe “të promovojë ndërtimin e shtetit në një kontekst të drejtësisë të orientuar përpara”, kurse lustrimi “është më shumë instrument i orientuar kah e kaluara.”⁴¹⁸ Vetingu ka të bëjë më shumë me verifikimin e personave, të cilët kandidojnë për punësim në pozita publike. Për këtë arsye ndikimi i vetingut është shumë më i vogël sesa i lustrimit, sepse vetingu bën vetëm verifikimin e personave që kandidojnë për pozita zyrtare dhe ndalimin e tyre në rast se vërtetohen se kanë kryer shkelje. Lustrimi përveç ndalimit bën edhe largimin e personave nga institucionet. Kjo bën që lustrimi ka potencial më të madh se vetingu, sepse teorikisht do të mund ta ndryshonte krejtësisht administratën nëse do të zbatohet plotësisht. Vetingu mund të përdoret edhe për të pastruar listat elektorale nga persona, të cilët kanë qenë të implikuar në kryerje të krimeve. Një praktikë e tillë është zbatuar në Afganistan në vitin 2009-2010 ku janë spastruar listat nga personat e dyshimtë.⁴¹⁹

Edhe vetingu, si çdo mekanizëm i drejtësisë tranzicionale, për të qenë i suksesshëm duhet të zbatohet standarde të larta të verifikimit duke qenë transparent dhe duke përdorur informacione kredibile dhe të verifikuara.⁴²⁰ QNDT-ja dhe UNDP-ja kanë përpiluar një udhëzues se si duhet të evitohen keqpërdorimet e vetingut. Aty thuhet se procesi i vetingut “mund të keqpërdoret për qëllime politike partiake. Për shembull, vetingu i gjyqtarëve mund të përdoret për të minuar pavarësinë e gjyqësorit. Largimet mund të bëhen mbi përkatësinë grupore ose partiake, më shume sesa në bazë të sjelljeve individuale, të targetohen kundërshtarët politikë dhe të degjenerojnë në spastrime politike.”⁴²¹ Për të evituar që një proces i tillë të dështojë, raporti prekornizon se vetingu duhet të bazohet mbi standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të cilat “duhet të respektohen gjatë zbatimit të vetë procesit të verifikimit, në mënyrë që të shmanget keqpërdorimi i tij politik.”⁴²² Gjithashtu, ky raport tërheq vëmendjen tek “hendeku qeverisës” që një largim masiv i personave nga puna do të krijonte. Dhe në veçanti largimi i ekspertëve mund të krijojë “boshllëk qeverisës.” Në raport me boshllëkun qeverisës që mund të shkaktojë një largim masiv i njerëzve, raporti thotë se më mirë është të ketë një shërbim publik minimal,

418 Horne, “Transitional justice: Vetting and lustration,” fq. 426.

419 Shih hulumtimet e QNDT-së për vetingun në: <https://www.ictj.org/our-work/research/vetting>

420 Horne, “Transitional justice: Vetting and lustration,” fq. 427.

421 Raporti është i qasshëm në: <https://www.ictj.org/sites/default/files/ICTJ-UNDP-Global-Vetting-Operational-Guidelines-2006-English.pdf>, Seksioni B, art. 1.

422 Po aty.

edhe nëse ai nuk është më i miri, sesa të mos këtë shërbim publik fare. Raporti thotë se vetingu duhet të zhvillohet me faza për të evituar vakumin qeverisë.⁴²³

Vetingu është mekanizëm, i cili përdoret edhe jashtë kontekstit paskonfliktual e që ka të bëjë me verifikimin e prejardhjes së pasurisë së personave të caktuar, të cilët kanë mundur të përdornin pozitat e tyre zyrtare për t'u pasuruar. Si shembull të përdorimit të vetingut jashtë kontekstit të drejtësisë tranzicionale mund ta marrim Shqipërinë, e cila në prag të hapjes së negociatave me BE-në ka përdorur vetingun në kuadër të reformës së institucioneve. Në këtë rast vetingu është limituar në integritetin e gjykatësve dhe prokurorëve duke verifikuar, mes tjerash, pasurinë e tyre, si dhe profesionalizmin për punën e kërkuar.

423 Po aty.

III. Pajtimi dhe drejtësia tranzicionale

6. Pajtimi

Një ndër qëllimet finale të drejtësisë tranzicionale në shoqëritë e dala nga konflikti është pajtimi. Ky qëllim figuron në dokumentin normativ të OKB-së të publikuar në vitin 2004, ku thuhet se gama e mekanizmave të drejtësisë tranzicionale ka për qëllim “t’i japë fund një trashëgimie të abuzimeve të së kaluarës në shkallë të gjerë, në mënyrë që të sigurojë llogaridhënie, t’i shërbejë drejtësisë dhe të arrijë pajtimin.”⁴²⁴ Megjithatë, arritja e pajtimit në shoqëritë e përçara nga konfliktet e gjata, ku ka pasur dhunë ekstreme dhe numër të madh të viktimave, dhe në të cilat armiqësia dhe urrejtjet janë të mëdha, është proces i gjatë dhe kërkon shumë kohë për t’u arritur. Madje në shumë raste, edhe përtej përpjekjeve të gjata, shumë shoqëri nuk janë pajtuar kurrë. Edhe në ato shoqëri në të cilat ky proces është kryer me sukses, nuk mund të themi se të gjithë individët kanë arritur pajtimin mes vete, një gjë e tillë është e pamundur.⁴²⁵

Një prej pyetjeve të para që shtrohen në shoqëritë paskonfliktuale është se “a mundet armiqësia të shndërrohet në miqësi?”⁴²⁶ A mundet ajo që duket e pafalshme të shndërrohet në bashkëjetesë paqësore?⁴²⁷ Kjo pyetje shtrohet edhe për shkak se pajtimi është proces, i cili ndryshon nga një vend në tjetrin dhe si i tillë nuk mund t’u imponohet shoqërive të përçara dhe nuk ka një model universal që do të mund të zbatohet kundër vullnetit të njerëzve. Madje çdo pajtim i suksesshëm nënkupton ndryshime të thella brenda shoqërive si në nivel individual, si në atë shoqëror.⁴²⁸ Ai është proces, i cili implikon të gjithë shoqërinë dhe nuk mund të limitohet vetëm tek viktimat e dhunës ose agresorët e tyre, edhe pse këto kategori janë në qendër të këtij procesi. Kështu, pajtimi varet nga specifikat që i kanë shoqëritë, llojet e konflikteve etj.⁴²⁹ Në shumë shoqëri paskonfliktuale pajtimi ka tendencë të eklipsohet në favor të reformave ekonomike dhe politike. Por vuajtjet dhe padrejtësitë e së kaluarës mbijetojnë në çdo shoqëri dhe mënjanimi i tyre gjithmonë rrezikon sabotimin

424 Shih: UN Doc S/2004/616 (2004). Sekretari i përgjithshëm i OKB-së, *The Rule of Law and Transitional Justice in Conflict and Post-Conflict Societies*.

425 Ernesto Verdeja (2009) *Unchopping the Tree, Reconciliation in the Aftermath of Political Violence*, Temple University Press, Philadelphia. fq. 161.

426 Bjorn Krondorfer (2018) *Reconciliation in Global Context, Why it is Needed and How It Works*, State University of New York Press, New York, fq. 1.

427 Po aty.

428 Bloomfield, Barnes, Huyse, *Reconciliation after violent conflict, A Handbook*, fq. 19.

429 Po aty.

e arritjeve tjera.⁴³⁰ Rekomandimet janë që edhe nëse në fazat e para të tranzicionit shoqëritë nuk mund të ndërmarrin masa të plota në drejtim të pajtimit, duhet të ndërmerren masa më pak ambicioze deri në krijimin e kushteve për masa të plota.⁴³¹

Megjithatë, Bar Tal dhe Bennink konsiderojnë se kur bëhet fjalë për pajtimin ekzistojnë dy lloj situatash, të cilat kërkojnë përgjigje të ndryshme. Dhe kjo ka të bëjë me statusin e grupeve, të cilat kanë luftuar ndërmjet vete. A jetojnë ato në dy shtete të ndryshme ashtu siç ka qenë rasti i gjermanëve dhe francezëve pas Luftës së Dytë Botërore apo grupet rivale vazhdojnë të jetojnë brenda të njëjtit shtet, siç ka qenë rasti i Spanjës ose Afrikës së Jugut?⁴³² Kjo është e rëndësishme, sepse është përcaktuese e procesit, i cili duhet të çojë tek pajtimi. Sfida është më e madhe për grupet rivale, të cilat vazhdojnë të jetojnë bashkë, në raport me ato të cilat jetojnë në shtete të ndryshme është se ato duhet të krijojnë mekanizma që u mundësojnë riintegrimin në shoqëri.⁴³³ Shumica e rasteve i takojnë kësaj kategorie të dytë. Nëse i analizojmë shtetet e lindura mbi territorin e ish-Jugosllavisë, atëherë vërejmë se Kroacia dhe Kosova i takojnë kategorisë së parë për shkak se konfliktet në këto shtete kanë përfunduar me ndarje dhe numri i vogël i pakicave të mbetura si në Kroaci dhe në Kosovë, ashtu edhe në Serbi është i vogël për ta ndryshuar këtë. Në anën tjetër, Bosnjë-Hercegovina teorikisht i takon kategorisë së shteteve ku grupet duhet të riintegrohen dhe të vazhdojnë të jetojnë së bashku, por ndarja e grupeve në entitete brenda shtetit e vendos atë ndërmjet këtyre dy modeleve. Si shembull tipik i rastit të pajtimit të grupeve të ndara pas konfliktit kanë qenë Franca dhe Gjermania, pas Luftës së Dytë Botërore. Ky model i pajtimit, i suksesshëm, merret si model për të gjitha vendet, të cilat janë karakterizuar me dhunë të gjatë dhe sistematike, qoftë në nivel të brendshëm ose në atë të jashtëm. Në pjesën e dytë të kapitullit do të analizohet ky rast.

430 Po aty.

431 Po aty, fq.5.

432 D. Bar-Tal dhe G. H. Bennink, "The Nature of Reconciliation as an Outcome and as a Process," In: Yaacov Bar-Siman-Tov (2004) *From Conflict Resolution to Reconciliation*, (ed.) Oxford, Oxford University Press. Ff. 11-39. fq. 14.

433 Po aty, fq. 14.

6.1. Qasjet minimale dhe maksimale të pajtimit

Koncepti i pajtimit është polisemik dhe nuk mund të reduktohet në një definicion të vetëm.⁴³⁴ Nuk ka një konsensus përreth asaj se cilat janë kushtet e nevojshme për arritjen e pajtimit në një shoqëri, as për atë se si duhet të zhvillohet procesi, i cili e karakterizon këtë fenomen.⁴³⁵ Qasjet normative që kanë të bëjnë me pajtimin mund të renditen nga ato minimale deri tek ato maksimale. Për mbrojtësit e qasjes minimale pajtimi arrihet kur ndalohet dhuna politike, respektohet shteti ligjor formal dhe të gjitha palët angazhohen për të mbetur pjesë e të njëjtit komunitet politik.⁴³⁶ Një ndër parakushtet e para është që mos të ketë më frikë dhe të mund të bashkëjetojnë njerëzit pa ushtruar dhunë. Duhet të rivendoset komunikimi mes palëve, të cilat kanë qenë kundërshtarë, dhe e gjithë kjo duhet të promovohet nga të gjithë individët dhe organizatat e implikuara në këtë proces.⁴³⁷ Pajtimi, sipas kësaj qasjeje, duhet të shmangë kërkesat “e ndjeshme”, siç janë ato për falje të krimeve midis palëve ose dënimin e personave përgjegjës, solidaritet shoqëror etj. Këtë qasje e hasim shpesh tek definicioni, të cilin disa organizata për mbrojtjen e të drejtave të njeriut ia bëjnë pajtimit. Kjo qasje ka një përparësi, sepse është realiste dhe mund të matet lehtë.⁴³⁸ Por ky nivel i ulët i pritshmërive është i kritikueshëm, sepse kritere të tilla, siç janë dorëzimi i armëve për të arritur paqen, jo domosdo rezultojnë me ndryshime të nevojshme brenda shoqërisë. Personat që kanë mundur të kryenin krime vazhdojnë të mbeten në pushtet, si dhe shoqëria nuk mund të ballafaqohet me të kaluarën e vet të dhunshme.⁴³⁹ Përtej këtij definicioni minimal pajtimi mund të jetë politik dhe ndërpersonal/shoqëror. Pajtimi politik është proces lart-poshtë, kurse pajtimi ndërpersonal është proces poshtë-lart. Qasja lart-poshtë i jep përparësi pajtimit në nivel nacional, kurse ajo poshtë-lart stimulon pajtimin në nivel lokal. Këto dy qasje janë komplementare mes tyre dhe në asnjë mënyre nuk janë përjashtuese me njëra-tjetrën.⁴⁴⁰

434 B. Krondorfer (2018). *Reconciliation in Global Context, Why it is Needed and How It Works*. New York: State University of New York Press, fq. 4.

435 V. Rosoux (2009). Réconcilier : ambition et piège de la justice transitionnelle, le cas de Rwanda. *Droit et Société*, 73 (3), 613-633, fq. 617.

436 E. Verdeja (2014). *What is Political Reconciliation?* Center for the Study of Social Movements at the University Notre Dame, e qasshme në: <https://mobilizingideas.wordpress.com/2014/02/03/what-is-political-reconciliation/>

437 Bloomfield, Barnes, Huyse, *Reconciliation after violent conflict, A Handbook*.

438 E. Verdeja, *What is Political Reconciliation*.

439 Po aty.

440 Bloomfield, Barnes, Huyse, *Reconciliation after violent conflict, A Handbook*.

6.1.1. Pajtimi politik

Këtë qasje politike Rosoux e quan strukturore dhe thotë se për të arritur pajtimin shoqëritë duhet të bëjnë ndryshime, të cilat implikojnë të gjitha sferat e shoqërisë. Në një analizë të pajtimit politik, Philpott dallon 5 elemente të këtij pajtimi. I pari, sipas tij, është implikimi i institucioneve shtetërore. Kjo për shkak se pajtimi kalon para së gjithash përmes ligjeve të cilat i votojnë qeveritë dhe parlamentet e shteteve.⁴⁴¹ Karakteristika e dytë e pajtimit politik është se pajtimi e përmbys fitoren e keqbërësve dhe çrregullimin shoqëror të shkaktuar nga ata përmes riintegritit të tyre në komunitet, si dhe përmes mirënjohjes dhe riparimeve eventuale që ua akordon vuajtjeve të viktimave para komunitetit. Ky është, sipas tij, kontributi i pajtimit në krijimin e legjitimitetit për rregullin e ri shoqëror. Elementi i tretë karakterizues është pjesëmarrja aktive në këtë proces të riparimit jo vetëm të viktimave, por edhe keqbërësve dhe anëtarëve tjerë të komunitetit, të cilët “akuzojnë, kërkojnë, tregojnë, kuptojnë, mësojnë, dëgjojnë, afirmojnë, pendohen, pranojnë, falin dhe tregojnë empati.”⁴⁴² Elementi i katërt, sipas tij, është se sado që ky riparim të jetë i kompletuar, pajtimi në sferën politike mund të arrihet vetëm pjesërisht.⁴⁴³ Dhe karakteristika e pestë është se pajtimi politik implikon gjithmonë kthimin në një gjendje të mëparshme.⁴⁴⁴

Përmes përfshirjes së të gjitha grupeve të shoqërisë në këtë proces qëllimi është t’u jepet kredibilitet diskutimeve mbi tema, të cilat janë në thelb të riintegritit të grupeve brenda shoqërisë e të cilat janë kujtesa historike, riafirmimi i të drejtave themelore etj. Ky proces nuk mund të arrihet pa proceduar me kritikë publike të ideologjive, të cilat kanë mbështetur dhunën në të kaluarën dhe në shumë raste pa kërkimin e përgjegjësisë për autorët e krimeve, riparimet eventuale, si dhe njohjen publike të vuajtjeve. Philpott konsideron se “një nga qëllimet më të rëndësishme të praktikave të pajtimit politik është t’i ndryshojë gjykimet që njerëzit formojnë si përgjigje ndaj padrejtësive politike dhe plagëve, kujtimeve dhe emocioneve që padrejtësitë lënë pas.”⁴⁴⁵ Kështu, thelbi i suksesit të pajtimit, sipas kësaj qasjeje, është një proces, i cili inspiron besim të mjaftueshëm për t’u dhënë fund përçarjeve. Besimi nënkupton pranimin e humanizmit të të tjerëve. Siguria fizike, mungesa e dhunës dhe fillimi i zhvillimit politik janë parakushtet e krijimit të besimit. Besimi në këtë situatë supozon që personat të jenë në gjendje të “parashikojnë

441 D. Philpott (2012). *Just and Unjust Peace, An ethics of Political Reconciliation*. Oxford: Oxford University Press, fq. 59.

442 D. Philpott, *Just and Unjust Peace, An ethics of Political Reconciliation*, fq. 60.

443 Po aty.

444 Po aty.

445 Po aty, fq. 46.

që individët ose grupet e tjera do të veprojnë në një mënyrë të denjë, kompetente dhe të pranueshme.”⁴⁴⁶ Amstutz konsideron se nëse nuk ka besim “shoqëritë janë të paafta për të zhvilluar rrjetet e bashkëpunimit vullnetar të domosdoshëm për shoqëritë pjesëmarrëse, ekonomikisht produktive” dhe se “besimi presupozon të vërtetën, mbajtjen e premtimeve dhe solidaritetin shoqëror, konceptimi i pajtimit në terma të besimit siguron një mënyrë të prekshme të përcaktimit të etikës së pajtimit politik.”⁴⁴⁷

Krondorfer konsideron se pajtimi politik synon të shkojë përtej formave kolektive të armiqësisë duke favorizuar qasjen strukturore të rindërtimit të shoqërisë përmes përparësisë që u jep krijimit të institucioneve të pavarura politike, ekonomike, ligjore, të sigurisë etj.⁴⁴⁸ Megjithatë, pajtimi politik varet nga intensiteti i dhunës, i cili është ushtruar në shoqëri në të kaluarën, “i cili e dikton shkallën e optimizmit dhe pesimizmit, si dhe ndjenjën e përgjithshme të urgjencës sa i përket pajtimit.”⁴⁴⁹

6.1.2. Pajtimi ndërpersonal

Kjo është një qasje maksimale e pajtimit dhe ka të bëjë “me rivendosje të marrëdhënieve shoqërore dhe personale përmes pendimit dhe faljes.”⁴⁵⁰ Nga aspekti i mekanizmave të drejtësisë tranzicionale, pajtimi ndërpersonal hyn në kuadër të mekanizmave të drejtësisë rindërtuese, e cila ka për qëllim riparimin e dinjitetit të viktimave dhe ofenduesve përmes komunikimit të drejtpërdrejtë.⁴⁵¹ Në prapavijë të këtyre përpjekjeve është transformimi personal i viktimave dhe ofenduesve, të cilët pas kalimit nëpër këtë proces mund të kthehen të jetojnë përsëri së bashku.⁴⁵² Rosoux e konsideron këtë qasje socio-psikologjike dhe shpirtërore.⁴⁵³ Në raport me pajtimin politik, i cili bëhet në nivel të shoqërisë me mekanizma që mund të jenë vetëm shtetërorë ose të mbështetur nga shteti, kjo qasje supozon pajtimin në nivel lokal ndërmjet personave që kanë kryer transgresion dhe të cilët

446 M. Amstutz, *International Ethics, Concepts, Theories, and Cases in Global Politics*, fq. 150.

447 Po aty.

448 B. Krondorfer (2018). *Reconciliation in Global Context, Why it is Needed and How It Works*. State University of New York Press, New York, fq. 4

449 Bloomfield, Barnes, Huyse, *Reconciliation after violent conflict, A Handbook*.

450 Verdeja, Ernesto (2014). *What is Political Reconciliation*, Center for the Study of Social Movements at the University Notre Dame, e qasshme në: <https://mobilizingideas.wordpress.com/2014/02/03/what-is-political-reconciliation/>

451 Po aty.

452 Po aty.

453 Rosoux, “Reconcilier: ambition et piège de la justice transitionnelle.”

nuk kanë pikëpamje të njëjta për botën dhe as nuk ndajnë vlera ose eksperiencën të njëjta.⁴⁵⁴ Ky lloj pajtimi mund të arrihet kur personat në pyetje kanë vullnet që të pajtohen duke zgjedhur momentin e përshtatshëm për një gjë të tillë.⁴⁵⁵ Arsyeja pse ky lloj pajtimi është maksimal, është sepse ai ka origjinë teologjike dhe konsiderohet si pajtim “transcendental”, i cili implikon të vërtetën, faljen dhe paqen, qëllime këto të cilat kërkojnë më shumë kohë dhe mund të arrihen më vështirë.⁴⁵⁶ Në prapavijë të këtij pajtimi janë aspektet kognitive dhe emocionale.⁴⁵⁷ Në nivel ndërpersonal arritja e pajtimit është komplekse dhe falja, e cila bëhet nga personat në pyetje, mund të mos jetë e sinqertë. Ka një diferencë ndërmjet faljes dhe deklarimit të personit se ka falur.⁴⁵⁸ Personat të cilët kanë përjetuar dhunë mund të deklarohen se kanë falur edhe për t’i çarmatosur ofenduesit para se të ndërmarrin masa hakmarrëse ndaj tyre. Hakmarrja, të cilën Robert Nozik e konsideron si “qasje primitive” të drejtësisë, shpesh pas krimeve masive konsiderohet nga viktimat si mjet i përshtatshëm për t’i ndëshkuar ofenduesit, të cilët e “meritojnë” një gjë të tillë.⁴⁵⁹ Në raste të tjera, persona të caktuar mund të falin, por mos t’i tregojnë ofenduesit se kanë falur. T’i thuash dikujt se ia ke falur krimin nuk është e njëjtë me faljen, e cila është vendim i brendshëm emocional dhe shpirtëror. Në tjera raste, shumë persona falin me sinqeritet të brendshëm, por për shkak të vdekjes së viktimave ose mosqenies në dispozicion të tyre nuk mund t’u tregojnë atyre.⁴⁶⁰

Pajtimi ndërpersonal është proces, i cili fillon me vendosjen për të arritur pajtimin. Ky hap i parë që në aparençë duket i lehtë, shpesh është vështirë të arrihet për shkak se persona të caktuar nuk kanë mundësi që ta bëjnë një gjë të tillë. Ashtu sikur në nivel shoqëror, momenti duhet të jetë i përshtatshëm për të iniciuar pajtimin. Momenti i përshtatshëm duhet të bëhet në një mjedis në të cilin personi i dëmtuar është i pranuar dhe i respektuar. Këto janë parakushte për të folur për transgresionet. Kjo fazë e diskutimeve shpesh implikon konfrontime të ashpra ndërmjet personave të implikuar. Në këtë pjesë të procesit pala ofenduese duhet të tregohet e kuptueshme ndaj palës së dëmtuar duke shpjeguar arsyet që e kanë çuar që të bëjë një vepër të tillë. Sipas Mittelstadt dhe Sutton, gjatë këtyre ballafaqimeve të drejtpërdrejta protagonistët mund ta mohojnë keqbjërjen, të refuzojnë pranimin e asaj që ka ndodhur, të fajësojnë personin tjetër, të kërkojnë falje

454 Për një qasje shpirtërore të pajtimit shih: M. W. Mittelstadt, G. W. Sutton (2010). *Forgiveness, Reconciliation and Restoration, Multidisciplinary Studies from a Pentecostal Perspective* (ed.). Eugene, Oregon: Pickwick Publications, fq. 226.

455 Po aty.

456 Rosoux, “Reconcilier : ambition et piège de la justice transitionnelle.”

457 Kronorfer, *Reconciliation in Global Context, Why it is Needed and How It Works*, fq.4.

458 Mittelstadt dhe Sutton, *Forgiveness, Reconciliation and Restoration*, fq. 226.

459 Verdeja, *Unchopping the Tree, Reconciliation in the Aftermath of Political Violence*, fq. 162.

460 Mittelstadt dhe Sutton, *Forgiveness, Reconciliation and Restoration*, fq. 226.

për t'i ikur përgjegjësisë ose edhe të bëjnë koncesion dhe ta pranojnë keqbërjen. Madje, edhe pranimi i fajit është kompleks, sepse për të qenë i pranueshëm konfesionit duhet të jetë pa justifikim. Kërkimfalja duhet të shoqërohet me sinqeritet dhe shprehje të eupatisë për dhimbjen e përjetuar nga personi tjetër.⁴⁶¹ Keqbërësi në fund mund të ofrojë edhe riparim për veprën e tij në situata kur kjo është e pranueshme për palën e dëmtuar. Jo gjithmonë pala e dëmtuar është e gatshme të pranojë riparim. Në fazën e fundit të këtij procesi keqbërësi deklaron se do të evitohet sjellje të tilla në të ardhmen dhe kërkon falje nga viktimat/t. Ky është pendimi për veprat e kryera. Sjellja e ofenduesit në publik më pas ka rëndësi për viktimat. Kjo për shkak se disa studime kanë treguar se edhe në raste kur ofenduesit paguajnë riparim dhe e pranojnë fajësinë, viktimat mund ta ndiejnë veten të pashtuara kur ofenduesit e zvogëlojnë publikisht turpin për veprat e tyre.⁴⁶² Kështu, kërkimfalja ofron njëfarë pranimi të ofenduesit si të barabartë sa i përket bashkëjetesës sociale, pa ndonjë kërkesë për transformim të thellë ontologjik nga ana e viktimës dhe ofenduesit.⁴⁶³

Megjithatë, sado të sinqerta që mund të jenë kërkimfalja dhe pendimi, ato nuk rezultojnë gjithmonë me falje nga ana e viktimave. Në këto raste ku mungon falja, e gjithë kjo mund t'i kthehet ofenduesit si bumerang për shkak se ekspozimi publik i veprave të tij dhe pranimi publik i fajit ka një çmim të lartë për të ardhmen e tij brenda shoqërisë. Kur përpjekjet e ofenduesit janë të sinqerta, çdo përgjigje më pak se falja e plotë mund të konsiderohet e pamjaftueshme.⁴⁶⁴ Pajtimi ndërpersonal është ndikuar fuqishëm nga etika fetare e krishterë, ku pendimi është sinonim me “faljen e mëkatit”. Prifti protestant, Desmond Tutu, i cili kishte qenë udhëheqës i Komisionit të së vërtetës dhe pajtimit në Afrikën e Jugut, e konsideron këtë lloj pajtimi si një “ideal të harmonisë sociale”, i cili do të ndryshonte raportet ndërmjet njerëzve.⁴⁶⁵

Kjo qasje e pajtimit është kritikuar si qasje, e cila në politikë është e paarritshme.⁴⁶⁶ Michael Ignatief thotë se kjo ide sipas së cilës shoqëria mund të shërohet përmes zbulimit të së vërtetës ka qenë e gabueshme, sepse e vërteta kontestohet gjithmonë nga viktimat dhe agresorët.⁴⁶⁷ Madje edhe në raste kur viktimat e fal ofenduesin, ky i fundit mund të mos jetë

461 Po aty, fq. 227.

462 Verdeja, *Unchopping the Tree, Reconciliation in the Aftermath of Political Violence*, fq. 161.

463 Po aty, fq. 169.

464 Mittelstadt dhe Sutton, *Forgiveness, Reconciliation and Restoration*, fq. 228.

465 Verdeja, *What is Political Reconciliation*.

466 Philpott, *Just and unjust: An Ethic of Political Reconciliation*, fq. 79.

467 Po aty.

në gjendje ta pranojë faljen e viktimës për shkak të fajit të madh që ndien brenda vetes.⁴⁶⁸

Mbi nivelin e pajtimit ndërpersonal kemi pajtimin shoqëror, ku arritja e pajtimit është shumë më e vështirë. Në këtë nivel ka gjithmonë rrezik që shoqëria t'i kthehet përsëri dhunës. Arsyeja pse ky pajtim është më kompleks ka të bëjë me kategoritë brenda shoqërisë, të cilat mbajnë qëndrime ekstreme. E gjithë kjo domosdo çon në situata në të cilat shoqëria në një moment të caktuar nuk ka mundësi t'i zgjedhë konfliktet midis këtyre grupeve ekstreme dhe t'i kthehet dhunës përsëri. Kjo bën që kalimi nga pajtimi ndërpersonal në pajtim shoqëror është i vështirë për mos të themi i pamundur. Arsyet janë të shumta duke ia filluar nga ata të cilët solidarizohen me ofenduesin, kundër të tjerëve që mund të jenë kundërshtarë të tyre ose atyre të cilët bazohen në drejtësi për të vendosur dominimin e tyre brenda grupit etj.

6.1.3. Diferenca ndërmjet pajtimit politik dhe atij ndërpersonal

Pajtimi politik dallon nga ai ndërpersonal edhe për nga dimensionin e tij zyrtar, sepse ai negociohet zakonisht nga institucione të autorizuara zyrtare, siç janë komisionet e së vërtetës dhe pajtimet ose institucione tjera të krijuara për këtë qëllim dhe në prapavijë është shteti. Pajtimi ndërpersonal, në anën tjetër, u jep përparësi marrëdhënieve njerëzore (psikologjike, emocionale, kognitive, riparuese) në raport me çështjet strukturore dhe zakonisht praktikon takimet dhe dialogun në nivel lokal.⁴⁶⁹ Këto dy lloj pajtimesh dallojnë edhe nga vetë metoda, të cilën e përdorin për të arritur qëllimet e tyre. Pajtimi politik supozon arritjen e pajtimit përmes zbulimit të së vërtetës, kurse ai shoqëror bazohet mbi kërkimfaljen, pranimin e fajit dhe pendimin nga ana e personave që kanë kryer krime. Pajtimi politik kërkon zbulimin e së vërtetës përmes grumbullimit të fakteve dhe dëshmive për shkeljet e kryera në të kaluarën dhe e gjithë kjo duhet t'i kontribuojë krijimit të një baze faktuale sa u përket shkeljeve të së kaluarës, të cilat i kanë paraprirë nevojës së pajtimit për palët.⁴⁷⁰ Komisionet e së vërtetës dhe pajtimet i shpallsin këto fakte përmes seancave publike, dëshmive të viktimave dhe ofenduesve, raporteve të tyre finale, vetingu dhe lustrimi, në anën tjetër, mundësojnë hapjen e arkivave dhe zbulimin e shkeljeve specifike. Amnistitë me kusht, në shumë raste, si në Afrikën e Jugut, kontribuojnë për shembull në zbulimin e së vërtetës etj. Madje edhe gjykatat penale, qofshin ato ndërkombëtare

468 Po aty.

469 Krondorfer, *Reconciliation in Global Context, Why it is Needed and How It Works*, fq.4.

470 Po aty.

ose hibride, kontribuojnë në zbardhjen e shkeljeve përmes ekspozimit të provave gjatë proceseve gjyqësore, dëgjimit të viktimave, dëshmitarëve etj. E gjithë kjo kontribuon në krijimin e një baze të njohurive, e cila është e nevojshme për pajtimin politik. Pajtimi ndërpersonal/shoqëror, në anën tjetër, është i fokusuar tek pranimi i fajit që konsiderohet si hap i domosdoshëm për riparimin moral të viktimës. Dhe ky pranimi i fajit, i cili bëhet në nivel ndërpersonal, transmetohet përmes tregimeve dhe fokusi është tek kujtesa personale më shumë sesa “tek faktet e forenzikës.”⁴⁷¹ Pranimi i veprave është me rëndësi për palët e dëmtuara, sepse ai u jep mirënjohje vuajtjeve të viktimave individuale dhe komuniteteve të viktimizuara.⁴⁷² Qasja e pajtimit ndërpersonal favorizon një proces të shërimit kolektiv të bazuar mbi nocionin e faljes dhe rehabilitimin e viktimave dhe ofenduesve. Pajtimi politik ka të bëjë me interesat në lojë dhe rivendosjen e raporteve të vjetra, kurse ai shoqëror ka për qëllim krijimin e raporteve të reja brenda shoqërisë.⁴⁷³

6.2. Pajtimi franko-gjerman pas Luftës së Dytë Botërore, si model i pajtimit të suksesshëm

Pajtimi franko-gjerman pas Luftës së Dytë Botërore konsiderohet si model ideal-tipik, të cilin të gjithë popujt që kanë pasur rivalitet hegjemonist do të duhej ta merrnin si shembull. Francezët dhe gjermanët kanë luftuar me shekuj para se të vendosin që ta ndërpresin ciklin e urrejtjes dhe të afrohen me njëri-tjetrin për një të ardhme paqësore. Pas një shekulli konfrontimesh dhe luftërash të përgjakshme, raportet ndërmjet këtyre dy shteteve do të ndryshojnë në mënyrë spektakolare.⁴⁷⁴ Janë dashur 23 luftëra ndërmjet Francës dhe Gjermanisë që nga Koha e Karlit V dhe Francois I për të ndërtuar më në fund Evropën.⁴⁷⁵ Pas Luftës së Parë Botërore (1914-1918) një përafrim i tillë nuk kishte qenë i mundur edhe përtej përpjekjeve që të ndalohet lufta me ligj. Pakti Briand-Kellogg i nënshkruar në vitin 1928 nga 63 shtete, në mesin e të cilave Franca kishte qenë iniciuese, dënonte luftën si mjet të rregullimit të konflikteve ndërmjet shteteve. Transformimi i kujtesës së Luftës së Parë

471 Po aty.

472 Amstutz, *International Ethics, Concepts, Theories, and Cases in Global Politics*, fq. 150.

473 Rosoux, *Reconcilier: ambition et piège de la justice transitionnelle, le cas de Rwanda*, fq. 617.

474 Rosoux, “La réconciliation franco-allemande,” fq. 23.

475 U. Lappenküper (2008). “On the Path to a “Hereditary Friendship”? Franco-German Relations since the End of the Second World War.” In, Carine Germond and Henning Türk (eds.), *A History of Franco-German Relations in Europe, from “Hereditary Enemies” to Partners (151-164)*, London, Palgrave, fq. 153.

Botërore, e cila kishte qenë deri atëherë lufta më e përgjakshme që kishte njohur njerëzimi, me 10 milionë viktima, kishte zgjatur me dekada para se të ndryshonte. Do të duhej kohë derisa thirrjet për hakmarrje të shndërrohen “në një rrëfim të vetëm pajtues.”⁴⁷⁶

Pajtimi franko-gjerman pas Luftës së Dytë Botërore do të jetë politik për shkak se palët do të vazhdojnë të jetojnë në dy shtete të ndryshme. Kjo bënte që mekanizmat, të cilët duhej të përdreshin për të arritur pajtimin kishin qenë para së gjithash politike. Si parakusht i këtij pajtimi kishte qenë thellimi i marrëdhënieve politike dhe ekonomike.⁴⁷⁷ Në vitet e para pas luftës, liderët e këtyre dy shteteve do të luajnë një rol kyç përmes gjesteve pajtuese dhe këto gjeste do të vazhdojnë me dekada si shenjë e vazhimit të këtij pajtimi. Te parët liderë kishin qenë Robert Schuman, ministri i Jashtëm francez, dhe Konrad Adenauer, kancelari i parë gjerman pas luftës, të cilët me nënshkrimin e Planit Schuman, në vitin 1950, kishin kontribuar në shkrirjen e marrëdhënieve antagoniste duke iniciuar këtë plan, i cili është i njohur si “ngjarja e pajtimit.”⁴⁷⁸

Përafrimi i Gjermanisë dhe Francës në vitet e para pas luftës do të iniciohet me integrimin e Gjermanisë Perëndimore në traktatet suksesive të bashkëpunimit, siç ishin: Komuniteti Evropian i Thëngjillit dhe Çelikut (1951) dhe Komuniteti Evropian i Mbrojtjes (1954), si dhe NATO-ja në vitin 1955. Inicimit të këtij procesi të gjatë i kishin shkuar në favor konteksti ndërkombëtar dhe nevoja për të ndaluar Bashkimin Sovjetik. Tjetër faktor unifikues kishte qenë plani Marshall, i financuar nga SHBA-ja në vitin 1947, për të ndihmuar rimëkëmbjen e shteteve evropiane të shkatërruara nga lufta. Ky plan i kishte obliguar këto dy shtete që të bashkëpunonin mes vete.⁴⁷⁹ Ky proces i integritit do të intensifikojë marrëdhëniet diplomatike, vizitat e ndërsjella të udhëheqësve, shkëmbimet e delegacioneve, të cilat do të stimulojnë ndërtimin e marrëdhënieve të reja. Më vonë do të pasojnë marrëdhëniet bilaterale, të cilat do t'i kontribuojnë përafrimit politik. Ato do të forcohen nga marrëdhëniet ekonomike, të cilat do të shumëfishohen në kuadër të integritit evropian.⁴⁸⁰ Paralelisht, diskurset politike do t'i eklipsojnë referimet e popullit të tyre si heroik dhe stigmatizimit të tjetrit si rojtari i djallit.⁴⁸¹

476 Rosoux, “La réconciliation franco-allemande,” fq. 26.

477 Daniel Bar-Tal and Gemma H. Bennink (2004). “The Nature of Reconciliation as an Outcome and as a Process.” In, Bar-Siman-Tov, Y., (Eds). *From Conflict Resolution to Reconciliation*, (ed.). Oxford: Oxford University Press. fq. 25.

478 S. E. Heo (2012). *Reconciling Enemy States in Europe and Asia*. London: Palgrave, fq. 81.

479 K. Malley-Morrison, A. Mercurio, G. Twose (2013). *International Handbook of Peace and Reconciliation*, London: Springer, fq. 304.

480 Bar-Tal and Bennink, “The Nature of Reconciliation as an Outcome and as a Process,” fq. 25.

481 Po aty, fq. 23.

6.2.1. Pajtimi si strategji e Republikës Federale Gjermane për kthimin e sovranitetit të humbur

Duke pasur parasysh se pajtimi nuk ka qenë kurrë koncept atraktiv për politikën dhe se shtetet nga një pikëpamje realiste kanë më shumë tendencë të konkurrojnë me njëra-tjetrën sesa të pajtohen, shtrohet pyetja se cilat kanë qenë motivet të cilat i kanë shtyrë Gjermaninë dhe Francën të afrohen me njëra-tjetrën?⁴⁸² Në çfarë aspekti pajtimi u ka shërbyer interesave shtetërore të këtyre shteteve? Për t'i kuptuar interesat e këtyre shteteve duhet t'i analizojmë shkurtimisht motivet e këtyre shteteve që të angazhohen në rrugën e pajtimit.

Gjermania pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore ishte ndarë në katër zona të ndryshme (Amerikane, Franceze, Britanike dhe Sovjetike). Qëllimi i shteteve, të cilat kishin triumfuar mbi nazizmin, kishte qenë që ta mbanin atë nën kontroll dhe të mos mund të bëhej përsëri kërcënim për të ardhmen, ashtu siç kishte ndodhur në pjesën e parë të shekullit 20. Për Gjermaninë dhe kancelarin e saj të parë pas luftës, Konrad Adenauer, kthimi i sovranitetit ishte qëllim primar. Megjithatë, Republika Federale e Gjermanisë (RFGJ) në këtë fazë të rindërtimit të saj kishte së paku katër mangësi, të cilat e limitonin veprimin e saj. Ato ishin: e kaluara e saj jodemokratike; historia e freskët e Holokaustit; shteti i copëtuar në një Evropë të ndarë; dhe Lufta e Ftohtë, që paraqiste rrezikun e okupimit nga BRSS-ja dhe e cila e bënte atë të varur nga SHBA-ja. Feldman konsideron se këto kishin qenë kushtet politike, psikologjike dhe strukturore, të cilat kishin nxjerrë tri qëllime të politikës së jashtme, që ishin: siguria, rehabilitimi dhe unifikimi.⁴⁸³ Duke pasur parasysh këtë situatë, strategjia e Adenauer-it do të jetë integrimi me çdo kusht i RFGJ-së në Perëndim si interes primar nacional. Pajtimi me Francën duhej t'i shërbente rritjes së kredibilitetit të shtetit. Dhe angazhimi fillestar i RFGJ-së do të jetë integrimi në strukturat multilaterale, të cilat do të krijohen pas luftës. Institucionet e para multilaterale ishin Plani Schuman (1950), Komuniteti Evropian i Thëngjillit dhe Çelikut (1951) dhe Komuniteti Evropian i Mbrojtjes (1954).⁴⁸⁴ Me ndryshimet që do të sjellë Lufta e Ftohtë, Gjermania do të armatohet dhe do të integrohet në NATO, në vitin 1955.⁴⁸⁵ Kjo duhej të evitonte absorbimin e saj nga Bashkimi Sovjetik.

482 Heo, *Reconciling Enemy States in Europe and Asia*, fq. 3.

483 L. G. Feldman (2012). *Germany's Foreign Policy of Reconciliation, From Enmity to Amity*. Lanham, Boulder, Toronto, Plymouth, New York: Rowman & Littlefield publishers, f. 26.

484 G.H. Soutou (2012). L'émergence du couple franco-allemand : un mariage de raison. *Politique Etrangere*, 4 fq. 727-738.

485 Feldman, *Germany's Foreign Policy of Reconciliation, From Enmity to Amity*, f. 26.

RFGJ-ja, duke u deleguar këtyre institucioneve pjesë të sovranitetit të saj, synonte t'ua dërgonte një mesazh të qartë aleateve perëndimorë se ajo ishte e vendosur dhe serioze që mos të ketë kthim mbrapa. Ajo që është e njohur si “politika e paqes” e Adenauer-it kishte për qëllim të shkonte përtej multilateralizmit. Kancelari Konrad Adenauer kishte qenë ithtar i pajtimit franko-gjerman për një kohë të gjatë. Në muajt e parë të marrjes së pushtetit kishte deklaruar se “konflikti franko-gjerman, i cili dominoi historinë evropiane për shekuj dhe shkaktoi kaq shumë luftëra dhe kaq shumë shkatërrime...duhet të eliminohet njëherë e përgjithmonë.”⁴⁸⁶ Angazhimi i fuqishëm i Adenauer-it drejt Perëndimit kishte për qëllim marrjen e përkrahjes për unifikimin e Gjermanisë, e cila ishte ndarë në dy shtete pas Luftës së Dytë Botërore. Kjo kishte krijuar frustrim te gjermanët dhe riunifikimi i Gjermanive të ndara në atë perëndimore dhe lindore duhej domosdo të kalonte përmes përkrahjes së Perëndimit. Adenauer mendonte se vetëm përmes integritit të plotë politik dhe ekonomik RFA-ja mund t'i jepte garanci Perëndimit se nacionalizmi gjerman nuk do të ringjallej për të paraqitur kërcënim në të ardhmen. Adenauer ishte i bindur se rikthimi i sovranitetit të Gjermanisë dhe unifikimi i dy Gjermanive duhej të merrte mbrapa këtë rrugë.⁴⁸⁷ Nuk ka dyshim se pajtimi me Francën do t'ia hapte rrugën integritit të Gjermanisë si në Evropë ashtu edhe në skenën ndërkombëtare, duke ia mundësuar asaj që të artikulojë interesat e veta.⁴⁸⁸

6.2.2. Pajtimi si strategji e Francës për të mbajtur Republikën Federale Gjermane nën kontroll

Interesi i Francës, në anën tjetër, ishte i natyrës tjetër dhe kishte për qëllim mbajtjen nën kontroll të Gjermanisë dhe arritjen e një pozite dominuese brenda shteteve të Evropës Perëndimore. Soutou konsideron se multilateralizmi, i cili e ka karakterizuar themelimin e institucioneve të para të përbashkëta evropiane ka qenë projekt i përbashkët i kristian-demokratëve në pushtet në gjashtë vendet themeluese që kishte qenë “i projektuar vërtet për të tejkaluar antagonizmin franko-gjerman, por jo për të vendosur Evropën nën udhëheqjen e ndonjë çifti franko-gjerman. Dhe nëse është e vërtetë se Adenauer është një nga baballarët e kësaj Evrope, kjo e fundit ishte para së gjithash e destinuar për të kontrolluar Republikën e re Federale të Gjermanisë (RFGJ) në një tërësi, leadershipin e

486 Lily Gardner Feldman (2012). *Germany's Foreign Policy of Reconciliation, From Enmity to Amity*. Lanham, Boulder, New York, Toronto, Plymouth: Rowman & Littlefield publishers, f. 28.

487 B. Soetendorp (2014). *Foreign Policy in the European Union : History, theory and practice*. London: Routledge, fq. 23.

488 C. Germond, H. Türk (2008). *A History of Franco-German Relations in Europe, from "Hereditary Enemies" to Partners* (ed.). London: Palgrave, fq. 7.

së cilës e sigurate Parisi.”⁴⁸⁹ Komuniteti Evropian i Thëngjillit dhe Çelikut kishte qenë projekt evropian por në prapavijë, qëllimi i Francës ishte të kontrollonte siderurgjinë e Gjermanisë. Gjithashtu, edhe Komuniteti Evropian i Mbrojtjes (KEM) ishte iniciuar nga Franca pas kërimit të riarmatimit të Gjermanisë nga amerikanët. KEM-i duhej t’ia mundësonte Francës që ta kontrollonte këtë armatim. Deri në fillim të viteve 1960 të gjitha veprimet e Francës kishin pasur për qëllim mbajtjen e RFGJ-së nën kontroll.⁴⁹⁰ Ambiguiteti i qëndrimit francez në raport me RFGJ-në do të dalë në pah pas refuzimit të Parlamentit francez që ta ratifikonte KEM-in në vitin 1954. Kjo marrëveshje e iniciuar nga Franca me RFGJ-në dhe shtetet e Beneluksit parashihte krijimin e një ushtrie evropiane nën patronazhin e NATO-s. Riarmatimi i RFGJ-së, i cili ishte bërë i pashmangshëm pas fillimit të Luftës së Koresë, në vitin 1950, për t’u mbrojtur nga Bashkimi Sovjetik, duhej të bëhej përmes KEM-it. Para se të refuzohet nga Franca, këtë marrëveshje e kishin ratifikuar më parë RFGJ-ja, Belgjika, Luksemburgu dhe Holanda. Në Francë nuk kishte pasur konsensus përreth hyrjes së RFGJ-së në NATO.

Pas dështimit të ratifikimit të KEM-it, Franca dhe Gjermania do të lëvizin progresivisht drejt bilateralizimit. Hapi i parë do të jetë vizita e Adenauer-it në Francë, më 19 tetor 1954, dhe negociimi i një sërë çështjesh, të cilat deri atëherë kishin qenë pengesë për të avancuar. Më 23 tetor 1954, kancelari Adenauer dhe kryeministri i ri francez, Pierre Mendes, do të nënshkruajnë Marrëveshjen e Parisit, e cila do të thellojë bashkëpunimin ndërmjet dy shteteve si në planin politik ashtu edhe ekonomik. Një sërë marrëveshjesh bilaterale ishin nënshkruar e që parashihnin edhe nënshkrimin e marrëveshjeve të tjera tregtare, këmbimin e produkteve bujqësore, etj. Gjatë këtyre tri ditëve sa ishte negociuar, ishte zgjidhur edhe çështja e regjionit të Saar-it, të cilin Franca e kishte vendosur nën kontroll të saj pas luftës dhe e cila mendonte që në perspektivë t’ia bashkëngjiste Francës. Kthimi i Saar-it Gjermanisë ishte nënshkruar me Marrëveshjen e Luksemburgut në vitin 1956 dhe ky territor i ishte kthyer Gjermanisë në vitin 1957, por kjo ishte negociuar gjatë vizitës së lartpërmendur të Adenauer-it në tetor 1954.

Me kthimin e De Gaulle-it në pushtet në vitin 1958, Franca dhe Gjermania do t’i intensifikojnë marrëdhëniet bilaterale. Pajtimi ndërmjet tyre kishte qenë i nivelit të lartë dhe kishte pasur impakt në nivel evropian për të prodhuar një frymë të pajtimit, e cila deri atëherë kishte munguar. De Gaulle dhe Adenauer ishin pajtuar që t’ia kthenin Evropës unitetin e saj dhe të avancojnë Evropën politike. Nga ky përafrim do të dalë Traktati i

489 G.H. Soutou, *L'émergence du couple franco-allemand : un mariage de raison*.

490 Po aty.

Elysee-së në vitin 1963, që paraqet marrëveshjen më të rëndësishme ndërmjet këtyre dy shteteve dhe e cila do të krijojë mekanizma të bashkëpunimit intensiv ndërmjet tyre. Nënshkrimi të kësaj marrëveshjeje i kishin paraprirë vizitat e Adenauer-it në Francë dhe De Gaulle-it në Gjermani, të cilat kishin qenë shumë të suksesshme. Gjatë vizitës së Adenauer-it në Francë, në qershor 1962, ishte mbajtur një paradë ushtarake dhe së bashku me De Gaulle-in kishin marrë pjesë në një meshë në Katedralen e Reims-it, vend me simbolikë të lartë, ku me shekuj ishin kurorëzuar mbretërit e Francës. Dy muaj më pas De Gaulle do të vizitonte RFGJ-në. De Gaulle në fjalimet e tij kishte folur për “popullin e madh gjerman” dhe një pjesë të fjalimeve i kishte mbajtur në gjermanisht.⁴⁹¹ Ai gjithashtu do të shkojë të bëjë homazhe në Munih para Felderhallen të ngritur në kujtim të viktimave të vitit 1870 dhe 1914-1918, duke përkujtuar se edhe francezët në rrethana të caktuara kishin kryer krime kundër gjermanëve.⁴⁹² Gjestet e përafrimit nuk do të mungojnë gjatë kësaj kohe dhe do të kenë një rëndësi të veçantë në këtë proces të përafrimit ndërmjet këtyre dy shteteve. De Gaulle nuk do të hezitonte t’i diferencojë nazizmin dhe popullin gjerman.⁴⁹³

6.2.3. Traktati i *Elisée-së*

Ky traktat i nënshkruar më 22 qershor 1963 ndryshe është i njohur edhe si Traktati i miqësisë franko-gjermane. Ky traktat ka një rëndësi të veçantë sa i përket pajtimit franko-gjerman, sepse do të rezultojë me krijimin e mekanizmave të bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve në një numër të madh fushash, që ishin: politike, të marrëdhënieve ndërkombëtare, të mbrojtjes dhe të arsimit. Duke pasur parasysh se RFGJ-ja ishte partner i ri, ky traktat në fazat e para do t’i shërbejë Francës për ta kontrolluar RFGJ-në. Por pas viteve 1970 dhe recesionit ekonomik të shkaktuar nga kriza e naftës, ai do të kthehet në favor të RFGJ-së.⁴⁹⁴ Të gjitha dispozitat, të cilat figuronin në këtë tekst ishin vendosur nën autoritetin e krerëve politikë të këtyre shteteve, të cilët do të monitoronin zbatimin e këtyre dispozitave duke u takuar “sa herë që është e nevojshme dhe, në parim, të paktën dy herë në vit.”⁴⁹⁵ Takime të rregullta do të ketë edhe ndërmjet ministrave të Jashtëm, çdo tre muaj. Në nivel të ambasadave dhe Ministrive të Punëve të Jashtme, zyrtarët e këtyre institucioneve do të takoheshin çdo muaj

491 H. A. Winkler (2007). *Germany: The long road West: Volume 2: 1933-1990*. Oxford: Oxford University Press. fq. 197.

492 V. Rosoux, *La réconciliation franco-allemande*.

493 V. Rosoux, M. Anstey (2017). *Negotiation reconciliation in peacemaking quandaries of Relationship Building*. London: Springer, fq. 155.

494 Germond dhe Türk, *A History of Franco-German Relations in Europe, from “Hereditary Enemies” to Partners*, fq. 8.

495 Neni 1 (I).

alternativisht, në Paris dhe në Bonn.⁴⁹⁶ Qeveritë duhej të konsultoheshin mes vete para marrjes së çdo vendimi të rëndësishëm në politiken e jashtme dhe të tentonin të gjenin qëndrime të përbashkëta.⁴⁹⁷ Gjithashtu Traktati parashihte mbajtjen e takimeve të rregullta në sektorët e mbrojtjes, arsimit dhe rinisë. Ministrat e Mbrojtjes dhe ata të arsimit do të takoheshin së paku një herë në tre muaj.⁴⁹⁸ Një herë në dy muaj do të takoheshin shefat e shtabit të përgjithshëm të ushtrive.⁴⁹⁹ Në kuadër të strategjisë dhe taktikës, dy shtetet angazhoheshin që të përaftronin doktrinat e tyre ushtarake dhe në këtë kontekst do të krijoheshin institutet franko-gjermane të hulumtimit operacional.⁵⁰⁰ Traktati parashihte këmbime të personelit ushtarak, ngjashëm edhe në fushën e armatimit dhe të dy qeveritë angazhoheshin të punonin bashkë në politikat e armatimit.

Në nivel ekonomik shtetet do të koordinoheshin për bashkëpunim në politikat e agrikulturës dhe pyjeve, politikës energjetike, komunikacionit dhe transportit, zhvillimit industrial në kuadër të tregut të përbashkët etj.⁵⁰¹ Dhe në fund, Traktati parashihte thellimin e bashkëpunimit në nivel të arsimit dhe rinisë.⁵⁰² Këtu figurojnë disa masa, siç janë mësimi i gjuhëve frënge dhe gjermane, ku parashihej ligjërimi praktik i gjuhëve, i siguruar nga institucionet respektive të arsimit të dy shteteve, dhe që do të ishte i hapur për të gjithë studentët.⁵⁰³ Një sërë dispozitash të tjera duhej të lehtësonin këtë bashkëpunim, siç ishin ekuivalenca e diplomave dhe testeve, si dhe bashkëpunimi shkencor përmes krijimit të instituteve shkencore. Në këtë aspekt Traktati thoshte se:

[...] të gjitha mundësitë do t'u ofrohen të rinjve të të dy vendeve për të forcuar lidhjet që i bashkoinjë dhe për të forcuar mirëkuptimin e tyre të ndërsjellë. Shkëmbimet kolektive do të shumëzohen në veçanti. Një organ i krijuar për të zhvilluar këto mundësi dhe për të nxitur shkëmbimet do të krijohet nga të dy vendet, në krye të tij një bord autonom i drejtorëve. Kjo organizatë do të ketë një fond të përbashkët franko-gjerman që do të përdoret për shkëmbime midis dy vendeve të nxënësve, studentëve, zanatçinjve të rinj dhe punëtorëve të rinj.⁵⁰⁴

496 Neni 2 (I).

497 Pika 1 (A).

498 Po aty.

499 Pika 3. (c)

500 Pika 1 (B)

501 Pika 4 (A).

502 Pika C

503 Pika 1. (a.).

504 Shih tekstin e Traktatit në : <https://de.ambafrance.org/Texte-du-Traite-de-l-Elysee-22>

Në nivel kulturor, shkëmbimet kulturore dhe të mësuarit reciprok të gjuhës si dhe librat e përbashkët shkollorë, binjakëzimet e qyteteve, shkëmbimet e studentëve, programet e përbashkëta universitare, dhe me pas edhe themelimi i kanalit Arte më 1992, do t'i kontribuojnë fuqishëm këtij procesi. Intensifikimi i takimeve kishte për qëllim njohjen më të mirë mes të rinjve me qëllim që t'i kontribuojnë ndryshimit të perceptimeve të mëparshme ndaj njëri-tjetrit. Në këtë aspekt përdorimi i simboleve të përbashkëta, programet me shkëmbimin e të rinjve dhe subvencionimi i aktiviteteve të ndryshme ndërkulturore do t'i kontribuojnë fuqishëm këtij procesi. Do të iniciohen gjithashtu procese në nivel të akademive për libra të historisë së përbashkët, dhe e gjithë kjo në perspektivën e ndryshimit të marrëdhënieve nga ato armiqtësore në miqësore.⁵⁰⁵

Në vitet e para pas luftës, opinioni publik gjerman kishte pasur rezerva të mëdha përreth iniciativave të ndërmarra për t'u pajtuar me Francën. Kjo vërehej për nga mosdistancimi i gjermanëve nga e kaluara e tyre naziste. Kështu për shembull, kur në vitin 1952 gjermanët ishin pyetur se në rast të një lufte të re cili burrështetas gjerman kishte qenë më i miri, 48% e tyre kishin thënë se Hitleri do të kishte qenë ai. Në vitin 1964 kjo kishte ndryshuar dhe 44% kishin thënë se Hitleri nuk do të ishte burrështetasi më i mirë në rast lufte. Në vitin 1952, në një sondazh i cili kishte pyetur se kush kishte qenë politikani gjerman që kishte bërë më së shumti për gjermanët, në vend të parë kishte qenë Bizmarku, i dyti Hitleri me 9%, kurse Adenaueri ishte renditur i fundit me vetëm 3%. Në vitin 1964 Hitleri kishte zbritur në 3%, kurse Adenaueri ishte ngritur në 38%. Ngjashëm kishte qenë edhe me qëndrimin e gjermanëve për Francën. Në vitet e para pas luftës gjermanët kishin shprehur rezerva të mëdha, por me kohë kjo do të ndryshojë.⁵⁰⁶

505 Heo, *Reconciling Enemy States in Europe and Asia*, fq.23.

506 Feldman, *Germany's Foreign Policy of Reconciliation, From Enmity to Amity*, fq. 27.

6.2.4. Konsolidimi i pajtimit franko-gjerman

Periudha e kancelarit Willy Brandt (1966-1974) kishte qenë më pak pajtuese për dy shtetet edhe pse Brandt kishte vazhduar politikën e Adenauer-it. Megjithatë, angazhimi i Brandt-it në Lindje kishte krijuar skepticizëm tek francezët, të cilët konsideronin se ai po luante rolin balancues, Perëndim-Lindje, që De Gaull-i kishte synuar që ta luante Franca. Franca konsideronte se RFGJ-ja po ia merrte lidërsipin e “détente-s.”⁵⁰⁷ Politika e drejtuar kah Lindja e Brandt-it (*Ostpolitik*) kishte pasur për qëllim zbutjen e tensioneve me shtetet fqinje të Lindjes dhe normalizimin e raporteve me Bashkimin Sovjetik. Në prapavijë të gjithë kësaj ishte edhe përafrimi me Gjermaninë Lindore dhe evitimi i krijimit të një hendeku ndërmjet dy Gjermanive, i cili do të mund ta largonte atë përgjithmonë nga pjesa tjetër. Brandt-i ishte social-demokrat dhe në programin e kësaj partie unifikimi i Gjermanive kishte zënë një vend të rëndësishëm. Kësaj politike të Brandt-it i kishte shkuar në favor edhe relaksimi i raporteve Lindje-Perëndim në nivel global. Brandt-i donte që përmes kësaj të krijonte një shkëputje nga politika e CDU-CSU, që e kishin mbajtur pushtetin nga viti 1949-1969 dhe, të cilët kishin refuzuar çdo kompromis me BRSS-në, si dhe çdo marrëdhënie me Gjermaninë Lindore.⁵⁰⁸ Një numër traktatesh do të nënshkruhen ndërmjet RFGJ-së dhe shteteve të bllokut të Lindjes. Kjo do të ketë efekt pozitiv për banorët e qytetit lindor të Berlinit. Brandt, i cili kishte qenë kryetar i Komunës së Berlinit perëndimor nga 1957-1966, i dinte më së miri vuajtjet e gjermanëve në pjesën lindore të qytetit dhe donte të evitonte konsolidimin e ndarjes së Berlinit lindor, por edhe të dy Gjermanive.⁵⁰⁹ Politika e Adenauer-it e integritit të RFGJ-së në Perëndim është plotësuar kështu nga politika afirmative e Brandt-it drejt Lindjes. Për dallim nga Adenaueri, Brandt nuk ia kishte dhënë Francës rolin që ia kishte dhënë Adenauer-it, edhe pse ai në asnjë moment nuk e kishte harruar se vetëm përmes një qasjeje konstruktive me Perëndimin mund të kishte sukses në Lindje, dhe se vetëm ashtu kjo politikë do të pranohej nga aleatët perëndimorë.⁵¹⁰ Qeveria e Brandt-it do të rezultojë me nënshkrimin e traktateve bilaterale me Bashkimin Sovjetik (1970), Poloninë (1970), Gjermaninë Lindore (1972) dhe Çekosllovakinë (1973). Këto traktate do të pranojnë gjendjen faktike të kufijve të vendosur pas Luftës së Dytë Botërore dhe Gjermania do të distancohet nga çdo rivendikim i territoreve të aneksuara nga Polonia.

Sa i përket pajtimit, dhe si gjest i ballafaqimit të Gjermanisë me të kaluarën, Brandt

507 Lappenküper, “On the path to a “hereditary Friendship.” fq. 157.

508 Po aty.

509 Po aty.

510 Lappenküper, “On the path to a “hereditary Friendship.” fq. 157.

do të bëjë disa gjeeste simbolike gjatë vizitave të tij në Lindje, siç ishte gjuhëzimi i tij para monumentit të viktimave të Getos së Varsovisë, më 7 dhjetor 1970. Ky veprim tregon fuqinë simbolike të gjeesteve në politikë dhe imperativin politik mbrapa *Ostpolitik*-ës së tij. Përmes këtij gjesti Brandt pranonte se Gjermania kishte kryer krime dhe se kishte qenë përgjegjëse për eksterminimin e miliona hebrenjve dhe të tjerëve.⁵¹¹ Gjeeste të tilla apologjetike kanë rol të rëndësishëm në pajtimin e popujve mes tyre. Përmes këtyre gjeesteve liderët dërgojnë mesazhe paqeje dhe pranojnë gabimin e shtetit të tyre në të kaluarën.⁵¹²

RFGJ-ja në kohën kur Brandt kishte marrë pushtetin, kishte pasur rritje ekonomike spektakolare dhe fuqia e saj ekonomike po rritej çdo ditë. Ajo kishte nevojë të stabilizonte raportet me fqinjët lindorë për të avancuar në rrugën e rehabilitimit ndërkombëtar si shtet. Brandt do t'i referohet pajtimit franko-gjerman për të ndërtuar raporte të ngjashme me Poloninë dhe Çekosllovakinë, gjithnjë duke ruajtur raportin “special” që kishte me SHBA-në. Pajtimi me Francën ishte treguar aq i suksesshëm sa që pas progresit të arritur një dekadë më vonë ai do të merret si shembull për të iniciuar pajtimin me shtetet në Lindje të RFGJ-së.

Largimi i Brandt-it dhe ardhja në Kancelari e Helmut Schmidt-it, si dhe zgjedhja president e Valéry Giscard d'Estain në Francë, në vitin 1974, do t'i japë një kuptim të ri pajtimit franko-gjerman, i cili do të përdoret për të avancuar integrimin evropian. Këta dy liderë do të vazhdojnë konsolidimin e arritjeve të Adenauer-it dhe Brandt-it, por në këtë kohë “détent-a” ishte shembur.⁵¹³ Një ndër arritjet e para në drejtim të konsolidimit evropian do të jetë institucionalizimi i Këshillit të Evropës si institucioni më i lartë vendimmarrës brenda BE-së.⁵¹⁴ Ky institucion është njëkohësisht edhe institucioni më politik i saj. Kjo periudhë është ajo e një fryme të besimit mes dy shteteve, e cila shkonte përmes mirëkuptimit të mirë të Giscard-it me Helmut Schmidt-in.⁵¹⁵ Këta të dy kishin shërbyer më parë si ministra të Financave të shteteve të tyre dhe e njihnin njëri-tjetrin mirë. Ata donin të kalonin nga pajtimi ndërshtetëror në një bashkëpunim të gjerë në kuadër të integritit evropian, i cili tashmë ishte treguar shumë i suksesshëm. Schmidt dhe Giscard do të krijojnë raporte të mira mes tyre edhe për të avancuar BE-në. Këtu do të lindë shprehja “çifti franko-gjerman.”⁵¹⁶

511 Heo, *Reconciling Enemy States in Europe and Asia*, fq. 86.

512 Gjeeste të tilla simbolike nuk kanë munguar edhe në vende të tjera. Kështu për shembull, Mustafa Kemal Atatürk me shndërrimin e Ayasofya të Stambollit në muze kishte bërë gjest pajtimi drejt Greqisë. Reçep Tayip Erdogan bëri të kundërtën para disa muajsh duke e shndërruar atë përsëri në xhami. Në Ballkan raste të tilla kanë qenë të rralla. Për rolin e gjeesteve simbolike Shih: Heo, *Reconciling Enemy States in Europe and Asia*, fq. 86.

513 Feldman, *Germany's Foreign Policy of Reconciliation, From Enmity to Amity*, f. 36.

514 Lappenküper, On the path to a “hereditary Friendship”, fq. 158.

515 M. Weinachter (2004). *Valéry Giscard d'Estaing et l'Allemagne : Le double reve inachevé*. Paris : Harmattan.

516 Soutou, *L'émergence du couple franco-allemand : un mariage de raison*.

Periudha Kohl-Mitterrand, e cila do të pasojë pas zgjedhjes president të Francois Mitterrand në Francë, në vitin 1981, dhe ardhjes së Helmut Kohl-it kancelar në RFGJ, në vitin 1982, do të jetë e vështirë në dy vjetët e parë. Kjo për shkak edhe të diferencave ideologjike ndërmjet tyre. Kohl, i cili ishte i djathtë (CDU-CSU), ishte treguar skeptik ndaj reformave të majta të Qeverisë franceze gjatë dy vjetëve të parë, por pas kthesës së Mitterrand-it drejt politikave më të afërta me qendrën e majtë raportet do të stabilizohen. Mitterrand-i në qeverinë e tij kishte pasur 5 ministra nga Partia komuniste e Francës dhe kjo e shpjegonte kthesën e tij.

Në vitin 1987 Franca dhe Gjermania do t'i krijojnë brigadat ushtarake franko-gjermane jashtë komandës së NATO-s. Kjo kishte qenë një dispozitë që figuronte në Traktatin e Elysee-së, por nuk ishte zbatuar kurrë. Gjithashtu, duke u bazuar në dispozitat e këtij traktati, ato do të iniciojnë themelimin e Këshillit të Mbrojtjes, i cili do të kompletohet në vitin 1996 nga Kohl dhe Chirac. Në kuadër të integritimit evropian do të negociohet Akti i Vetëm Evropian, në vitin 1986, i cili do të vendosë bazat e monedhës së përbashkët evropiane (euro) dhe qarkullimit të lirë të mallrave dhe personave. Periudha Kohl-Mitterrand do të ketë një periudhë të vështirë, që ishte koha e reunifikimit të Gjermanisë. Në fillim Mitterrand kishte tentuar që ta ngadalësonte dhe ta pengonte këtë proces përmes tentimit të inkuadrimin të Gjermanisë në një sistem të sigurisë, i cili do të përfshinte edhe Bashkimin Sovjetik. Kjo kishte qenë arsyeja e takimit Mitterrand-Gorbachev në Kiev, në dhjetor 1989.⁵¹⁷ Ky kundërshtim i Francës do të tejkalohet në pranverë 1990, pasi që Kohl propozoi krijimin e një unioni politik evropian i cili, me iniciativën e kancelarit gjerman, në Samitin e Dublin-it u bë propozim franko-gjerman. Nga ky propozim do të dalë Traktati i Maastricht-it dhe monedha e përbashkët (euro). Franca kishte për qëllim thellimin e BE-së për ta mbajtur nën kontroll Gjermaninë.⁵¹⁸ Presidenti francez, Mitterrand, kishte potencuar gjithmonë rëndësinë e pajtimit franko-gjerman. Në shumë fjalime të tij ai kishte deklaruar se armiku i Francës nuk kishte qenë populli gjerman, por “pushteti, sistemi, ideologjia, e cila e kishte kapur atë” dhe kishte bërë homazhe te varrezat e gjermanëve, të cilët kishin vdekur gjatë luftës.⁵¹⁹ Në vitin 1994, gjatë festës nacionale të 14 Korrikut, Mitterrand i kishte ftuar trupat ushtarake gjermane që së bashku me ato të EUROCORPS⁵²⁰ të defilonin në Paris. Ky gjest simbolizonte unifikimin e Evropës dhe ftesa e 200 ushtarëve gjermanë që të defilojnë në Elysee, në tanket e tyre kishte simbolikë të fuqishme të pajtimit.

517 Po aty.

518 Po aty.

519 Rosoux dhe Anstey, *Negotiation reconciliation in peacemaking quandaries of Relationship Building*, fq. 155.

520 Eurocorpsi është forcë ushtarake e BE-së, e cila është e vendosur në Strasburg.

Kjo kishte ndodhur me rastin e 50-vjetorit të zbakimit të aleatëve në Normandi, që kishte shënuar fitoren ndaj nazizmit. Me këtë rast Helmut Kohl ishte prezent në tribunën presidenciale krahas presidentit francez dhe liderëve të tjerë evropianë. Më 8 maj 1995, me rastin e komemorimit të fitores ndaj nazizmit, Mitterrand mbajti një fjalim në të cilin ai pyeste veten se: “a është kjo një humbje që po festojmë, apo është fitore?. Thjesht fitore e lirisë mbi opresionin [...] ajo është, mbi të gjitha, një fitore e Evropës mbi vetveten.” Në fjalimet e presidentëve francezë interpretimi i Luftës së Dytë Botërore do të shndërrohet progresivisht në një luftë “vëllavrasëse” brenda Evropës.⁵²¹

Gjestet e pajtimit nuk do të mungojnë as në periudhat e mëpasshme dhe të gjithë liderët qofshin ata francezë apo gjermanë (Sarkozy, Hollande, Merkel) do të vazhdojnë me simbolikën e pajtimit. Pajtimi franko-gjerman dhe krijimi i BE-së janë dy procese të ndërthurura, të cilat nuk do të kishin mundur të ndodhnin pa njëri-tjetrin. Këto dy procese do ta ndryshojnë perspektivën shekullore të paraqitjes së tjetrit si armik. Ato do të bëjnë që ndarjet moralizuese midis francezëve dhe gjermanëve të fillojnë të shuhen progresivisht. Përulja dhe stigmatizimi i të tjerëve dhe paraqitja e vetes si hero do të shndërrohet progresivisht me njohje të ndërsjellë të një të kaluarë të përbashkët. Pajtimi franko-gjerman do të ndikojë fuqishëm në stabilizimin e paqes në Evropë dhe në konsolidimin e demokracisë. Vlerat evropiane, të cilat janë pjesë e politikave të zgjerimit dhe pa të cilat popujt që aspirojnë të integrohen në BE nuk do të mund të hynin në BE, janë vlera të cilat kanë dalë nga ky proces i pajtimit. Ky proces u ka shërbyer dhe do t’u shërbejë popujve të tjerë evropianë dhe më gjerë që të tejkalojnë konfliktet mes tyre dhe të avancojnë në rrugën e integrimit evropian.⁵²²

521 Rosoux, *La réconciliation franco-allemande*.

522 Soutou, *L'émergence du couple franco-allemand : un mariage de raison*.

Konkluzion

Për një kohë të gjatë ballafaqimi i shoqërive me të kaluarën në shoqëritë paskonfliktuale është shpjeguar përmes qasjes realiste të marrëdhënieve ndërkombëtare, e cila ka mbrojtur idenë se çdo pretendim i gjykimit të personave të regjimit paraprak për krimet që ata kishin organizuar ose kryer gjatë kohës që kishin qenë në pushtet do të kishte për efekt zgjatjen e pafund të konfliktit ose kthimin e shoqërive në dhunë. Çdo kërkesë për drejtësi në fazat që i paraprijnë fundit të konfliktit konsiderohej si kërcënim nga personat të cilët ishin aktorë të tranzicionit dhe pa të cilët nuk mund të arrihej paqja. Kështu, kërkesat e viktimave për drejtësi kishin mbetur pa përgjigje adekuate. Kjo qasje ka qenë dominuese gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, e cila kishte pamundësuar çdo lloj ballafaqimi të shoqërive me të kaluarën. Ky argument i kishte shkuar në favor mosndëshkimit dhe shumica e tranzicioneve kishin përfunduar me amnisti.

Pas rënies së komunizmit do të dominojë qasja idealiste e marrëdhënieve ndërkombëtare nga e cila do të dalë drejtësia tranzicionale. Diversifikimi i mekanizmave të saj gjyqësorë dhe jogjyqësorë është i lidhur ngushtë me paradigmen e re, e cila do të mbrojë idenë se regjimet represive duhej të ndaloheshin që të shtypnin qytetarët e tyre. Drejtësia tranzicionale, e cila kishte qenë më shumë opsion sesa solucion i konflikteve, progresivisht do të imponohet dhe do të konsolidohet. Dilema “paqe apo drejtësi”, e cila i kishte karakterizuar tranzicionet paskonfliktuale më parë, do të zëvendësohet me imperativin “paqe përmes drejtësisë”, të shpjeguar në këtë studim. Mosndëshkimi do të konsiderohet si rrezik për tranzicionin dhe për vendosjen e paqes afatgjatë. Këtë paradigmë të re të paqes përmes drejtësisë më se miri e shpjegon kryeprokurori i parë i Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavi, Richard Goldstone, i cili në një fjalim të tij thotë se “një paqe që do të kontrollohej nga distanca, nga kriminelët e luftës, keqbërës dhe përbuzës të të gjitha rregullave ose normave themelore të së drejtës ndërkombëtare, dhe të preokupuar për të mbrojtur interesat e tyre, nuk mund të jetë as e zbatueshme dhe as e qëndrueshme.”⁵²³ Konsolidimi i drejtësisë tranzicionale do të bëhet paralelisht me konsolidimin e demokracive në shumë vende të botës, ku ishin vendosur masa të drejtësisë tranzicionale. Megjithatë, kjo drejtësi nuk do të arrijë të imponohet gjithkund dhe për një

523 Cituar në : Hazan, P. (2007). *Juger la guerre, juger l'histoire*. Paris : PUF, fq. 205.

numër të madh shtetesh ajo mbetet ende e dëshirueshme. Siria, Jemeni, Libia etj., dhe shumë shtete tjera të botës nuk kanë pasur sukses në vendosjen e ndonjë mase të drejtësisë tranzicionale. Në këto shtete fazat e para të tranzicionit janë karakterizuar me hakmarrje ndaj anëtarëve të ish-regjimit duke i përjashtuar të gjithë nga institucionet shtetërore. Kjo më pas u është kthyer si bumerang, sepse një pjesë e këtyre personave u janë bashkuar organizatave, të cilat i luftojnë këto shtete.

Bibliografia:

- Amstutz, M. (2013). *International Ethics, Concepts, Theories, and Cases in Global Politics* (Edizioni i katërt). Lanham, Boulder, New York, Toronto, Plymouth : Rowman and Littlefield Publishers, Inc.
- Arrabal Ward C.E. (2018). *Wartime Sexual Violence at the International Level: A Legal Perspective*. Hague: Brill Nijhoff.
- Andrieu, K. (2015). Juger, réconcilier, réparer: la justice transitionnelle pour sortir de la violence? In, IRG (Eds.), *Tous Responsables ? chronique de la gouvernance* (ff. 111-123). Paris : Edition Charles Léopold Mayer.
- Bar-Siman-Tov, Y. (2004). *From Conflict Resolution to Reconciliation* (Eds.). Oxford: Oxford University Press.
- Bilala, A.Y. (2014). *Le Tribunal spécial pour le Liban : une Juridiction Hybride d'un genre Nouveau*, Paris : Editions Connaissances et Savoirs.
- Bloomfield, D., Barnes, T., Huyse, L. (2003). *Reconciliation after violent conflict, A Handbook*, Stockholm: International IDEA.
- Soetendorp B. (2014). *Foreign Policy in the European Union : History, theory and practice*. London: Routledge.
- Bakiner, O. (2016). *Truth Commissions, Memory, Power, and Legitimacy*. Philadelphia: University of Pennsylvania Press.
- Beal, Ch. (2018). Justice Restaurative et Justice Penale. *College International de Philosophie*, 91 (1) 58-71.
- Bell, Ch., O'Rourke, C. (2007). Does Feminism Need a Theory of Transitional Justice? An Introductory Essay. *International Journal of Transitional Justice* 1 (1), 23-44.

- Buckley-Zistel, S., Koloma Beck, S., Braun, C., Mieth, F. (2014). *Transitional Justice Theories*, London: Routledge.
- Buckley Zistel, S. (2018). “Transitional Justice.” In Ch. Brown, R. Eckersley (Eds.), *The Oxford Handbook of International Political Theory*. Oxford: Oxford University Press.
- Bukuluki, P. (2011). *Negotiating Retributive and Restorative Justice in the conflict of Northern Uganda*. Zurich: LIT verlag.
- Braithwaite, J. (2004). Restorative Justice and De-Professionalization. *The Good Society*, 13 (1), 28–31
- Braniff, M. (2011). *Integrating the Balkans, conflict resolution and the impact of EU expansion*. London: I.B. Tauris and Co Ltd, London.
- Bassiouni, Ch. M., (1997). From Versailles to Rwanda in Seventy five Years: The need to establish a Permanent International Criminal Court. *Harvard Human Rights Journal* 10, 1997, 11-62.
- Carter, L.E., Ellis, M.S., Jalloh, C. C. (2016). *The International Criminal Court in an Effective Global Justice System*. Cheltenham, Northampton: Edward Elgar Publishing.
- Del Ponte, C., Sudetic, Ch. (2008). *Madame Prosecutor: Confrontations with Humanity’s Worst Criminals and the Culture of Impunity*. New York: Other Press.
- Dyzenhaus, D. (1998). *Judging the Judges, Judging Ourselves: Truth, Rconciliation and the Apartheid Legal Order*. Oxford: Hart Publishing.
- Damgaard, C. (2008). *Individual Criminal Responsibility for Core International Crimes*. Berlin, Heidelberg: Springer.

- D'Amato, A. (1996). Peace vs. accountability in Bosnia. *American Journal of International Law*, (88), 500–506.
- Denicourt-Fauvel, C. (2020). Au-delà du chaos : l'héritage de l'impunité institutionnalisée pour expliquer l'extrême violence au Guatemala post-conflit. https://ruor.uottawa.ca/bitstream/10393/40565/1/DenicourtFauvel_Camille_2020_the%CC%80se.pdf.
- Elster, J. (2006), *Retribution and Reparation in the Transition to Democracy*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Ellis M. (1996). Purging the past: The Current State of Lustration Laws in the Former Communist Bloc. *Law and Contemporary Problems*, 59 (4), fq.181-196, fq.181.
- Ensalaco, M. (1994). Truth Commissions for Chile and El Salvador: A Report and Assessment. *Human Rights Quarterly*. 16 (4): 656–675.
- Elster, J. (2004). *Closing the books, transitional justice in historical perspective*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Erna, P. (2008). *The Sun Climbs Slow: The International Criminal Court and the Struggle for Justice*. Toronto: Random House.
- Fichtelberg, A. (2015). *Hybrid Tribunals, a Comparative Examination*, Springer, New York Heidelberg Dordrecht London.
- Figari Layus, R. (2010). *Transitional Justice in the midst of ongoing armed conflicts, the case of Colombia*. Potsdam: Universitätsverlag Potsdam.
- Fernandes Paredes, T., (2010). Transitional Justice in Democratisation Process: The Case of Spain From An International Point of View. *International Journal of Rule of Law, Transitional Justice and Human Rights*, Volume 1.
- Frowein, J.A., Wolfrum, R. (2002). *Max Plank Yearbook of United Nations Law*, 6, 1-35.

- Freeman, M., Orozko, I. (2002). *Negotiating Transitional Justice: A Conceptual Framework*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Futamura, M. (2008). *War Crimes Tribunals and Transitional Justice, The Tokyo Trial and the Nuremberg legacy*. London: Routledge.
- Garapon, A., (1999). De Nuremberg au TPIY : naissance d'une justice universelle ? *Critique Internationale*, (5).
- Gardner Feldman, L. (2012). *Germany's Foreign Policy of Reconciliation, From Enmity to Amity*. Lanham, Boulder, New York, Toronto, Plymouth: Rowman & Littlefield publishers.
- Germond, C., Türk, H. (2008). *A History of Franco-German Relations in Europe, from "Hereditary Enemies" to Partners* (ed.). London: Palgrave.
- Guilhot, N., Schmitter, Ph. C. (2000). De la transition a la consolidation, une lecture retrospective des democratisation studies. *Revue Française de Science Politique*, 50 (4-5), 615-632.
- Gaines, L. K., Le Roy R. M. (2018). *Criminal Justice in Action*. Boston : Cengage.
- Haddad, H. N (2018). *The Hidden Hands of Justice, NGOs, Human Rights and International Courts*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Hartmann, M. E. (Tetor 2003). International Judges and Prosecutors in Kosovo: A New Model for Post-Conflict Peacekeeping. US Institute of Peace, Special Report.
- Hazan, P. (2008). Les Dilemmes de la Justice Transitionnelle. *Mouvements*, 53 (1), 41-47.
- Hazan, P. (2010). *Judging War, Judging History, Behind Truth and Reconciliation*. Stanford: Stanford University Press.
- HAZAN P. (2000). *La justice face la guerre : de Nuremberg à La Haye*. Paris : Stock.

- Holly L. Guthrey (2015). *Victim Healing and Truth Commissions, Transforming Pain through Voice in Solomon Islands and Timor – Leste*. London: Springer, fq. 21.
- Hubrecht, J. (2019). Les Chambres specialisees du Kosovo face au mur du doute et de la peur. Paris: *Institut des Hautes Etudes sut la Justice*.
- Hayner B. P. (1994). Fifteen Truth Commissions-1974 to1994: A comparative Study. *Human Rights Quarterly*, 597, 6014.
- B. Ivanisevic (2011). *The War Crimes Chamner in Bosnia and Hertzegovina: From Hybrid to Domestic Court*. International Center for Trasnsitional Justice.
- Jalloh, C. C., Bentekas I. (2017). *International Criminal Court and Africa* (Eds.). Oxford: Oxford University Press.
- Joinet, L. (2002). *Lutter contre l'impunit , 10 questions pour comprendre et agir* (Ed.), Paris: La D couverte.
- Jacoby, S. (1983). *Wild Justice: The Evolution of Revenge*. New York: Harper & Row.
- Kaldor, M., Vincent, J. (2006). Case Study Sierra Leone, Evaluation of UNDP Assistamce to conflict-affected countries. <http://web.undp.org/evaluation/documents/thematic/conflict/SierraLeone.pdf>
- Kamp, K. (2016). *Restorative Justice in Transitional Settings*. London: Routledge.
- Krondorfer, B. (2018). *Reconciliation in Global Context, Why it is Needed and How It Works*. New York: State University of New York Press.
- Korenica, F., Zhubi, D., Doli, D. (2016). The EU-Engineered Hybrid and International Specialist court in Kosovo: How ‘Special’ is it? *European Constitutional Law Review*, Vol. 12.
- Kaminski, M.M., Nalepa, M., O’Neill, M., (2006). Normative and Strategic Aspects of Transitional Justice. *Journal of Conflict Resolution* 50.

- Kerr, R. (2004). *The International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia – an exercise in law, politics and diplomacy*. Oxford: Oxford University Press.
- Kerr, R., Mobekk, E. (2007). *Peace and Justice, seeking accountability after war*. Cambridge: Polity Press.
- Kant, E. (1988). *Métaphysique des mœurs, doctrine du droit*. Paris : Vrin.
- Kritz, N. J. (1995). *Transitional justice: How emerging democracies reckon with former regimes* (Volume I, II, III). Washington, D.C: United States Institute of Peace Press.
- Lappenküper, U. (2008). On the Path to a “Hereditary Friendship”? Franco-German Relations since the End of the Second World War. In, Carine Germond and Henning Türk (eds.), *A History of Franco-German Relations in Europe, from “Hereditary Enemies” to Partners (151-164)*. London: Palgrave.
- Lawther, Ch., Moffett, L., Jacobs, D., (2017). *Research Handbook of Transitional Justice*. Cheltenham: Edward Elgar Publishing.
- Meernik, J., Barron, J. (2018). Fairness in National Courts Prosecuting International Crimes. *International Criminal Law Review* 18, 712-734.
- Muharremi, R. (2016). The Kosovo Specialist Chambers and Specialist Prosecutor’s Office. *Zeitschrift für ausländisches öffentliches Recht und Völkerrecht (ZaöRV)*, 76 (4).
- Meltzer, J. (2004). *Transitional Justice and Reconciliation in Post-Conflict Colombia: Some Considerations for Future Canadian Engagement*. Canadian Foundation for the Americas.
- Malley-Morrison, K., Mercurio, A., Twose, G. (2013). *International Handbook of Peace and Reconciliation*. London: Springer.
- Mittelstadt, M. W., Sutton G. W. (2010). *Forgiveness, Reconciliation and Restoration, Multidisciplinary Studies from a Pentecostal Perspective* (ed.), Eugene, Oregon: Pickwick Publications.

- Minow, M. (2009). *Breaking the Cycles of Hatred, memory, law and repair*. Princeton: Princeton University Press.
- Nalepa, M. (2010). *Skeletons in the Closet: Transitional Justice in Post-Communist Europe*. Cambridge: Cambridge University Press.
- O'Donnel, G., Schmitter Ph., Whitehead, L. (1986) *Transitions from the Authoritarian Rule*. Baltimore: John Hopkins University Press.
- Oduro, F. (2012). *Transitional Societies, Democratic Accountability and Policy Responses: The Formulation of the Truth Commission-Approach to a Transitional Justice Policy (South Africa, Nigeria, Ghana)*. Ottawa: Carleton University.
- Preysing, D. (2016). *Transitional Justice in Post-Revolutionary Tunisia (2011–2013) How the Past Shapes the Future*. Wiesbaden: Springer.
- Posner, E., Vermeule, A. (2003). Transitional Justice as Ordinary Justice. *Harvard Law Review*, 117.
- Philpott, D. (2012). *Just and unjust: An Ethic of Political Reconciliation*. Oxford : Oxford University Press.
- Prairat, E., (2003). Réflexions sur la sanction dans le champ de l'Éducation. *ERES*, (3) 57, 31- 44.
- De Grief, P., Duthie, R. (2009). *Transitional Justice and Development, Making Connections*. New York, International Center for Transitional Justice.
- Rajkovic, N. M. (2012) *The Politics of International Law and Compliance. Serbia, Croatia and The Hague Tribunal*. Abington, New York: Routledge.
- Roht-Arriaza, N., Mariezcurrena, J. (2006). *Transitional Justice in the Twenty-First Century: Beyond Truth versus Justice*. CUP.

- Rosoux, V. (2009). Réconcilier : ambition et piège de la justice transitionnelle, le cas de Rwanda. *Droit et Société*, 73 (3) 613-633.
- Rosoux, V. (2007). La réconciliation franco-allemande : crédibilité et exemplarité d'un « couple à toute épreuve » ? *Cahiers d'histoire. Revue d'histoire critique*, 100, 23-36.
- Rosoux, V., Anstey, M., (2017). *Negotiation reconciliation in peacemaking quandaries of Relationship Building*. London: Springer.
- Raub, L. (2009). Positioning Hybrid Tribunals in International Criminal Justice. *International Law and Politics*, (41) 1013. ff. 1023-40.
- Rimmer, H. (2010). *Gender and Transitional justice, the women of East Timor*. London: Routledge.
- Simms, K. (2003). *Paul Ricoeur*. London, Routledge.
- Soutou, G. H. (2012). L'émergence du couple franco-allemand : un mariage de raison. *Politique Etrangere* 4, 727-738.
- Schwobel, C. (2014). *Critical Approached to International Criminal Law*. Oxon, New York: Routledge.
- Stahn, C. (2019). *A critical introduction to international criminal law*. Oxford : Oxford University Press.
- Seunghoon, E. H. (2012). *Reconciling Enemy States in Europe and Asia*. London: Palgrave.
- Simic O. (2016). *An Introduction to Transitional Justice*. London, New York: Routledge.
- Sikink, K. (2012). *The Justice Cascade: How Human Rights Prosecutions are Changing World Politics*. New York, London: W.W. Norton and Company.
- Schabas, W. A., Nadia, B. (2011). *Routledge Handbook of international criminal law*. London: Routledge.

- Sorel, J.-M. (2011). Les Tribunaux pénaux internationaux, Ombre et lumière d'une récente grande ambition. *Revue tiers Monde* (1) 205, 29-46.
- Sharp, D. (2018). *Rethinking Transitional Justice for the Twenty First Century, beyond the End of History*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Tessema, M., T. (2018) *Prosecution of Politicide in Ethiopia, The Red Terror Trials*, London: Springer.
- Ostojic, M. (2014). *Between Justice and Stability, the political of War Crimes Prosecutions in Post – Milošević Serbia*. Farnham, Burlington: Ashgate Publishing.
- Ross, A., Sriram, C. L. (2012). Closing Impunity Gaps: Regional transitional justice processes? *Transitional Justice Review*, (1) 1, 3-30.
- Schoenfeld, H., Levy, R., Hagan, J. (2017) Crises Extrêmes et Institutionnalisation de Droit Pénal International. *Critique Internationale*, 36.
- Sriram, C. L., García-Godos, J., Herman J., Martin-Ortega, O., (2013), *Transitional Justice and Peacebuilding on the Ground Victims and ex-combatants*. London: Routledge.
- Teitel, R. (2000). *Transitional Justice*. Oxford: Oxford University Press.
- Teitel, R. (2003). Transitional Justice Genealogy. *Harvard Human Rights Journal*/ Vol. 16.
- Turgis, N. (2015). La justice transitionnelle, un concept discuté. *Les Cahiers de la Justice*, (3), 333-342.
- Verdeja, E. (2009). *Unchopping the Tree, Reconciliation in the Aftermath of Political Violence*. Philadelphia: Temple University Press.
- Vukpalaj, A. (2010). *Ex-Yougoslavie, de la guerre a la justice, La Serbie, la Croatie et la Bosnie-Herzégovine a l'épreuve du Tribunal penal international pour l'ex-Yougoslavie (TPIY)*. Paris : Michel Houdiard Editeur.

- A. Vukpalaj (2021). “No Bodies-No Crimes”: The Reburial Operations of the Serbian Forces in Kosovo in 1999, In A. Hajrullahu dhe A. Vukpalaj (Eds.) *Forging Kosovo Between Dependence, Independence and Interdependence* (ff. 45-71), Bern, Bruxelles: Peter Lang (forthcoming).
- Van De Kerchove, M. (1997). Éthique pénale. In, *Dictionnaire d'éthique et de philosophie morale*. Paris: PUF.
- Van Ness, D. W., Heetderks Strong, K. (2010). *Restoring Justice: An Introduction to Restorative Justice*. Providence: LexisNexis.
- Verdussen, M., Bruckner, P., Vike-Freiberga, V., Gacon, S., Lefranc, S., Garapon, A., Elorza, A., Delangre, J.F., Kotek, J., Luminet, O. (2016). *De la mémoire a l'oubli. L'amnistie en question(s)*. Actes de colloque international. Academie Royale de Belgique, Bruksel, 6-8 tetor.
- Winkler, H. A. (2007). *Germany: The long road West: Volume 2: 1933-1990*. Oxford: Oxford University Press.
- Williams, M. S., Nagy, R., Elster J. (2012). *Transitional Justice (Eds.)*. New York and London: New York University Press.
- Williamson, C. (2013). “Real justice, in Time, the indictment of Slobodan Milošević.” In T. W. Waters (eds), *The Milosevic Trial, An Autopsy* (ff.77-92). Oxford: Univesity Press
- Weinachter, M. (2004). *Valéry Giscard d'Estaing et l'Allemagne : Le double reve inachveee*. Paris : Harmattan.
- Winter, S. (2014), *Transitional Justice in Established Democracies: A political Theory*. London: Palgrave.
- Zunino M., (2019). *Justice Framed, A Genealogy of Transitional Justice*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Zanghi C., Ben Achour, R. (2011). *Droits de l'homme et juridictions pénales internationale*. Giuffré Editere.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

34

Vukpalaj, Anton

Drejhtësia tranzicionale : qasjet, mekanizmat dhe qëllimet / Anton Vukpalaj. -

Prishtinë : Fondacioni-Konrad-Adenauer në Republikën e Kosovës, 2020. -

149 f. ; 25 cm.

ISBN 978-9951-8871-7-5

